

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE**

**E FOLMJA DHE TOPONIMIA E MARTANESHIT**

Punoi

**MA. Arjeta CUKA**

Udhëheqës shkencor

**Akad.prof.dr. Gjovalin SHKURTAJ**

Tiranë, 2014

# Doktoratë

Përgatitur nga: Arjeta Cuka  
Për marrjen e gradës shkencore „DOKTOR“  
Specialiteti: Dialektologji (Gjuhësi)

## E folmja dhe toponimia e Martaneshit

Udhëheqës shkencor: Akad. Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj

Mbrohet më, dt. \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_ para jurisë:

\_\_\_\_\_ (Kryetar)

\_\_\_\_\_ (Anëtar)

\_\_\_\_\_ (Anëtar)

\_\_\_\_\_ (Anëtar)

\_\_\_\_\_ (Anëtar)

## PASQYRA E LËNDËS

---

1. Objekti dhe detyrat e studimit	6
2. Hyrje e përgjithshme për krahinën e Martaneshit	10
3. E folmja e Martaneshit në kuadrin e ndarjes dialektore të shqipes	19
4. Fonetikë	22
4.1.Gjatësia e zanoreve	22
4.2.Hundorësia e zanoreve	23
4.3.Zanoret e theksuara	24
4.4.Zanoret e patheksuara	25
4.5.Togjet e zanoreve	26
4.6.Bashkëtingëlloret	27
4.7.Grupet e bashkëtingëlloreve	31
5. Morfologjia	35
5.1.Emri	35
5.1.1. Gjinia	35
5.1.2. Trajta	37
5.1.3. Rasa	39
5.1.4. Numri	46
5.1.5. Nyja	49
5.2.Përemri	51
5.2.1. Përemrat vetorë	51
5.2.2. Përemrat dëftorë	53
5.2.3. Përemrat pronorë	55
5.2.4. Përemrat pyetës e lidhorë	63
5.2.5. Përemrat e pacaktuar	63
5.3.Folja	64
5.3.1. Zgjedhimi vepror	64
Mënyra dëftore	64
Mënyra lidhore	81

Mënyra habitore	83
Mënyra kushtore	83
Mënyra dëshirore	83
Mënyra urdhërore	84
Përcjellorja	86
Paskajorja	86
5.3.2. Zgjedhimi jovepror	86
5.3.3. Format foljore aspektive	92
5. 4. Ndajfoljet	92
5. 5. Lidhëzat	93
5. 6. Pjesëza	94
5. 7. Psthirrat	94
5. 8. Onomatopetë	94
5. 9. Fjalëformimi	95
6. Ndikimi dhe depërtimi i gjuhës standarde në të folmen e Martaneshit	98
7. Shqyrtime sociolinguistike rreth etnografisë së të folurit në krahinën e Martaneshit	108
7. 1. Grupimi i njerëzve sipas moshës dhe varacionet gjuhësore përkatëse	108
7. 2. Grupimi i njerëzve sipas gjinisë	110
7. 3. Zbunimi dhe përkëdhelia në të folmen e Martaneshit	115
7. 4. Zbunime sipas shqiptimit fëminor të emrit	116
7. 5. Mashkullorizimi i emrave të vajzave për zbunim (përkëdheli)	116
7. 6. Sharja dashamirëse	116
7. 8. Antroponimet eufemistike	117
7. 9. Përtëritja apo rigjallërimi i emrit	117
7. 10. Emri i bashkëshortit „tabu“	118
8. Onomastika e Martaneshit	119
8. 1. Ndërtimi i toponimeve	120
8.2. Emrat e njerëzve dhe bigëzimi i tyre në forma zyrtare dhe jozyrtare	124
8. 3. Emrat vetjakë të mirëfilltë	125
8. 4. Bigëzimi i emrave në forma jozyrtare	127
9. Dysorët dilalektorë në hartat e ADGJSH-së	129

10. Leksiku	172
11. Fjalorth	178
12. Tekste	188
13. Përfundime	192
14. Bibliografi historike	198
15. Bibliografi gjuhësore	199

## E FOLMJA DHE TOPONIMA E MARTANESHIT

### Objekti dhe detyrat e studimit

Në gjuhësinë shqiptare janë të shumta studimet në fushën e dialektologjisë dhe të onomastikës. Në këtë fushë studimesh, nga mesi i viteve '50 deri në mesin e viteve '70 është bërë një punë e organizuar për hetimin e përgjithshëm të dialekteve të gjuhës shqipe. Edhe ne, duke u mbështetur në njohjen dhe prurjet e deritanishme të studimeve të veçanta për të folmet e krahinave kryesore të Shqipërisë, me ideimin dhe udhëzimet e udhëheqësit shkencor, akad.prof.dr.Gjovalin Shkurtaj, zgjodhëm të bëjmë objekt të studimit tonë të folmen dhe toponiminë e Martaneshit. Studimi i kësaj të folmeje dhe i onomastikës së krahinës së Martaneshit meriton të studiohet për dy arsye: së pari, sepse Martaneshi është vendlindja ime dhe kërkimet rreth veçorive dalluese të të fomes së kësaj treve i kam nisur qysh me herët, kur sapo kisha nisur studimet universitare; së dyti, për të folmen e krahinës së Martaneshit nuk kemi një studim të plotë, përjashtuar ndonjë material të shkëputur, që është mbledhur herë pas here gjatë studimit të të folmeve përreth:

Jorgji Gjinari ka dhënë disa njoftime për këtë të folme në librin: *Dialektologjia shqiptare*, 1963.

Mehmet Çeliku e trajton shkurtimisht të folmen e Martaneshit në punimin: “*Vëzhgime mbi grupin e të folmeve të Gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre*”, Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1968.

Po kështu Bahri Beci flet për disa veçori dialektore të të folmes së Martaneshit në punimin: “*Të folmet qendrore të gegërishtes*”, *Dialektologjia shqiptare V*, Tiranë 1987.

Hetimi i dialekteve të shqipes ka rëndësi të veçantë për thellimin njohjes së veçorive dalluese fonetike, morfologjike dhe leksiko-frazeologjike të të folmeve të ndryshme, duke nxjerrë në dukje si ruajtjet ashtu edhe rritjet e shndërrimet e sotme të ligjëtimeve krahinore nën ndikimin e shqipes standarde. Studimi i dialekteve të shqipes ka pasur disa faza dhe arritje shumë të rëndësishme. Dialektologjia shqiptare i ka fillimet që nga mesi i shek. XIX. Puna për kërkimin dhe studimin e të folmeve të shqipes në të gjithë truallin e saj u shtrua si domosdoshmëri që në vitin 1952. Janë bërë kërkime në rreth 300 pika, pothuajse në të gjithë territorin e Shqipërisë. Lënda e mbledhur është sistemuar dhe ruhet në kartotekën dhe fonotekën e Dialektologjisë. Janë hartuar nga dialektologët Jorgji Gjinari, Bahri Beci, Mehmet Çeliku, Minella Totoni, Gjovalin Shkurtaj, Xheladin Gosturani, Qemal Haxhihasani, Emil Lafe etj., rreth 60 skica e monografi dialektologjike që përshkruajnë tiparet dalluese të të folmeve në sistemin fonetik, gramatikor e leksikor, shumica e të cilave janë botuar në revista shkencore e në përmbledhjen “*Dialektologjia shqiptare*”. Janë bërë gjithashtu studime për disa çështje të veçanta të historisë së

dialekteve e të ndarjes dialektore të gjuhës shqipe. Kërkime dhe studime dialektologjike janë bërë edhe për të folmet shqipe në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, sidomos prej gjuhëtarëve të Kosovës në vazhden e hullisë së nisur qysh herët nga Idriz Ajeti, L. Mulaku etj. Për dialektologjinë shqiptare dhe historinë e saj janë me rëndësi sidomos kërkimet dhe studimet për të folmet arbëreshe të Italisë e të Greqisë, të Borgo Ericos, të Mandricës dhe të Ukrainës, të kryera nga studiues shqiptarë, arbëreshë dhe albanologë të huaj, si E. Çabej, E. Hemp, M. Camaj, K. Taljavini, K. Hebler, F. Altimari, Gj. Shkurtaj. Dh. Shuteriqi, B. Sokolova etj. Pas këtij hetimi të përgjithshëm u ndërmor hartimi i *Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe*<sup>1</sup>. Realizimi i kësaj vepre madhore shënon arritjen më të rëndësishme për Dialektologjinë shqiptare.

Mbështetur mbi traditën e kësaj fushe studimesh shkencore, por edhe mbi arritjet e viteve të fundit, nëpërmjet këtij punimi do të përpiqemi të japim veçoritë kryesore të të folmes së kësaj treve. Që t'ia arrijmë qëllimit tonë, kemi ndërmarrë disa ekspedita gjuhësore, gjatë të cilave anketuam më shumë se 50 subjekte të dy sekseve dhe moshave të ndryshme. Materialet janë grumbulluar prej nesh në 7 qendra të banuara të kësaj krahine në periudhën në mes të viteve 2007-2012. Ekspedita e parë u bë më 1-30 qershor 2007 në fshatrat Peshk, Lenë, Val. Ekspedita e dytë u bë më 1-15 gusht 2007 në fshatrat Gjon, Ndërfushas, Mëlçu, Staveç , ndërsa ekspedita e tretë u bë më 23 maj - 27 qershor 2010 në qytetin e Krastës. Në vitet e mëvonshme kemi shkuar disa herë në Martanesh për të verifikuar materialin. Për mbledhjen e materialeve dialektologjike kemi përdorur Pyetësin dialektologjik të Spiro Floqit<sup>2</sup>, duke kombinuar metodën e bisedës së lirë me atë të pyetje-përgjigjeve. Po kështu kemi përdorur edhe udhëzuesin metodik dhe pyetësin e hartuar nga prof. Gjovalin Shkurtaj dhe prof. Ali Jashari.<sup>3</sup> Materiali dialektor, i mbledhur gjatë ekspeditave, përfshin: tregime të ndryshme, përralla, gojëdhëna popullore, këngë popullore, legjenda, tema të ndryshme nga jeta e përditshme, për zakonet e dasmës, të lindjes, të vdekjes, për bujqësinë dhe blektorinë. Gjithashtu kemi mbledhur edhe fjalë të rralla të sferave të ndryshme. Kjo, nisur edhe nga dëshira për të fiksuar gjendjen e ruajtur të së folmes, sikundër bëhej në fakt edhe në studimet e tjera bashkëkohëse të dialektologëve shqiptarë për dialektet e shqipes.

Meqenëse punimi im po realizohet pas botimit të *Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe*, i jemi referuar edhe pyetësit të „Atlasit“, për të nxjerrë material në fushën e fonetikës, morfologjisë, sintaksës dhe leksikut, hartuar nga prof. Jorgji Gjinari, prof. Gjovalin Shkurtaj dhe prof. Xheladin Gosturani.

Ky studim do të ndërtohet në bazë të dhënave të grumbulluara prej nesh dhe parashtrimi i tyre në këtë studim është bërë në përgjithësi sipas një metode të njësuar që lejon të

<sup>1</sup> Shih: *Fjalor enciklopedik shqiptar*, V.I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f.466.

<sup>2</sup> Shih: S. Floqi, *Pyetësor për mbledhjen e materialit dialektor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1971.

<sup>3</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, A. Jashari, *Anketimi dhe ekspeditat gjuhësore*, Korçë, 2007.

nxirren edhe përfundime të një karakteri më të përgjithshëm. Për ta njohur, përshkruar e shqyrtuar në mënyrë sa më të plotë të folmen e Martaneshit jemi përqendruar në sistemin fonetik, sistemin gramatikor, si dhe atë leksikor. Paraqitja e tipareve më karakteristike, si dhe e dukurive më të veçanta do të jepen në gjendjen e ruajtur të së folmes, duke u mbështetur krejtësisht në të dhënat e mbledhura nga brezi i vjetër dhe brezi i mesëm. Po kështu do të shikohet e folmja e Martaneshit në hartat e ADGJSH-së, duke krahasur tiparet kryesore fonetike, morfologjike të kësaj të folmeje me pikat më të afërta të saj: Klos, Zerqan, Dibër, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh.

Në një pjesë tjetër do të shikohet prirja e zhvillimit të së folmes së krahinës së Martaneshit. Këtu do të veçohet ndikimi i gjuhës standarde, sidomos në të folurit e brezit të ri, duke u dhënë vendin dhe rëndësinë e duhur faktorëve bashkëkohorë të ndikimit në zhvillimin e përgjithshëm kulturor dhe gjuhësor të ligjërimeve të gjalla, siç janë ato që prof. Shkurtaç i quan „flukse të dukshme“ (shkolla, arsimimi, institucionet publike, qendrat e reja tregtare e të biznesit të vogël etj.) dhe sidomos të „flukseve të padukshme“ (radio, televizioni, telefoni fiks dhe celular e netëork-et e shkëmbimeve on-line nëpërmjet internetit). Mbi bazën e një kundrimi të tillë të hapët e relativisht të plotë në shtresëzimet ligjërimore të së folmes do të japim paraqitjen e fytyrës dhe ecurisë së të folmes së Martaneshit nën ndikimin e faktorëve shoqërorë jashtëgjuhësorë. Për realizimin e këtij kapitulli i jemi referuar modelit të studimeve të prof. Gjovalin Shkurtaç, i cili, me studimin për të folmen e qytetit të Lezhës, shënon edhe hapin e parë drejt dialektologjisë urbane në vendin tonë. Prof. Shkurtaç thekson se ajo e folme, si një e folme e përzier, paraqet variante konkurrenente në të njëjtin mjedis, sepse aty jetojnë grupe etnolinguistike me origjinë të ndryshme shoqërore dhe gjeografike.<sup>4</sup> Studime të tilla janë kryer edhe nga Xheladin Gosturani për të folmen e qytetit të Elbasanit<sup>5</sup>. Shqyrtime sociolinguistike janë kryer edhe për dallimet e të folmes së qytetit të Shkodrës sipas besimeve fetare të këtij qyteti.

Në vëzhgimet tona lidhur me të folmen e Martaneshit kemi vënë re dhe ndryshime midis folësve dhe „lëkundje“ brenda të të njëjtit subjekt dhe këto, në varësi të disa ndryshorëve sociolinguistikë siç janë ato të gjinisë dhe moshës. Rrjedhimisht, përveç krahasimeve dhe përjasjeve sipas objektit të përcaktuar të këtij studimi, do paraqesim edhe disa përfundime të nxjerra nga vëzhgimet dhe shqyrtimet përjasëse të ligjërimeve në breza të ndryshëm, natyrisht sipas gjinisë së folësve, duke e shpënë studimin në krahun sociolinguistik të së folmes së Martaneshit, gjë që besojmë se do të jetë me interes dhe jep mundësi për disa piketa të reja rreth situatës së sotme të një të folmeje si ajo e Martaneshit, një krahinë sa tradicionale, aq edhe në rritje e sipër me dukuri sociolinguistike me interes studimor.

<sup>4</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Studime filologjike* 3, 1981, f. 155-163.

<sup>5</sup> Shih: Xh. Gosturani, „*Struktura gramatikore e së folmes së qytetit të Elbasanit dhe leksiku i saj*“, *Dialektologjia shqiptare VII*, Tiranë, 2005, f. 124-144.



Veçan në një pjesë tjetër do të shikohet leksiku, duke u përqendruar në disa sfera që na janë dukur më kryesore për përfaqësimin e së folmes. Po kështu kemi krahasuar me pikat më të afërta (Klos, Zerqan, Dibër, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh) edhe leksikun e kësaj të folmeje, duke iu referuar modelit që prof. Gjovalin Shkurtaç ka ndjekur në librin e tij “ *Dialektet e shqipes. Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore sipas hartave të ADGJSH-së*” <sup>6</sup>

Gjej rastin të falenderoj të gjithë ata që kanë pasur mirësinë të më ndihmojnë në rrugën time për realizimin e këtij punimi. Falenderoj Departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë që ma miratoi temën dhe kërkesën për t’u pranuar në studimet doktorale, shpreh nderimet dhe vlerësimet e rastit për profesorët titullarë të lëndëve formuese që i ndoqëm gjatë viteve të studimeve universitare e pasuniversitare (akademik Ethem Likaj, Prof. Rami Memushaj, Prof. Shezai Rrokaj, Prof. Seit Mansaku dhe, sidomos, prof. dr. Aljula Jubani, shefe e departamentit. Në mënyrë të veçantë, dua të falenderoj akademik Gjovalin Shkurtaç, për ideimin, udhëhëqjen metodologjike dhe udhëzimet shumë të vleshme që nuk më kanë munguar në asnjë moment. Një falenderim të ndier u blatoj të gjithë të intervistuarve të mi, të cilët, gjatë gjithë viteve të punës time për mbledhjen e materialeve në terren, në të gjithë fshatrat e Martaneshit, kanë treguar një përkushtim të pashoq për të më ndihmuar. Prej tyre kam përfituar të gjithë të dhënat nga anketimet e drejtpërdrejta me ta, të cilat më kanë vlejtur në punën time. Një falenderim shkon edhe për historianin dr. Teki Kurti, i cili, si njohës i mirë i historisë së Martaneshit, nuk e ka kursyer ndihmën e tij, duke më ofruar shumë dokumente autentike, të cilat më kanë ndihmuar në hartimin e kapitullit “*Hyrje e përgjithshme për krahinën e Martaneshit*“. Mbështetja e ofruar prej tij ka qenë edhe shtysa për t’u ndalur hollësisht në trajtimin e këtij kapitulli.

---

<sup>6</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “*Dialektet e shqipes. Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore sipas hartave të ADGJSH-së*”, Tiranë, Morava 2012, f. 105.

## **Hyrje e përgjithshme për krahinën e Martaneshit**

Martaneshi si njësi administrative bën pjesë në qarkun e Dibrës. Ka në përbërjen e tij shtatë fshatra (Gjon, Peshk, Val, Ndërfushas, Mëlçu, Staveç) dhe qytetin e Krastës.<sup>7</sup>

Martaneshi si njësi gjeografike bën pjesë në verilindje të Shqipërisë, në zonën e Mesme të Krahinës Malore Qendrore.

Krahina e Martaneshit kufizohet në lindje e verilindje me Okshtunin, Tërnovën dhe Bulqizën; në jug me fshatrat e Çermenikës, si Kostenjë, Neshtë etj., kurse në perëndim me Shëngjergjin e Tiranës; në veri e veriperëndim me Planin e Bardhë dhe Gurin e Bardhë të Matit.

Terreni tepër i thyer e malor që përfshin kjo krahinë fillon nga lagja ( mëhalla) Blishtë, e cila ndodhet 600m mbi nivelin e detit dhe arrin në malin e Dhoksit mbi 2000m lartësi. Fshatrat e Martaneshit rrethohen nga male që shërbejnë si kufinj natyrorë, që e ndajnë atë nga krahina të tjera që ndodhen në anën tjetër.

Në trevën e Martaneshit përfshiheshin:

1. Fshati Lenë shtrihet në faqen perendimore të malit të Kaptinës dhe përbëhet nga lagjet: Mullijas, Lqijas, Kengaj, Ndërfushas, Pllaçaj, Gurzakë etj., me rreth 150 familje.
2. Më poshtë, në perëndim, në një ultësi të rrethuar nga shkëmbinj, shtrihet fshati Peshk, qendra administrative e Martaneshit e përbërë nga lagjet: Peshkaj, Gjonaj, Gërricaj, Dukaj etj.
3. Përballë fshatit Peshk, poshtë qytetit Krastë, shtrihet fshati Gjon, i cili ndahet nga fshati Peshk nëpërmjet zallit, rrjedhë e lumit Mat, që fillon nga Shkëmbi i Kuq për të vazhduar në drejtim lindor deri në afërsi të fshatit Lenë, përbëhet nga lagjet: Demiraj, Zhaboli, Gjonaj, Koxherraj, Haslikaj, Letaj, Çukaj e Staveçi.
4. Një pozitë të veçantë zë fshati Val që shtrihet në luginën midis malit të Snoit (Shën Ndoi)<sup>8</sup>, Brinjës së Qarrit dhe Qytezës. Është një luginë e thatë, pa ujë dhe përbëhet nga lagjet Ramaj, Fezaj, Balajt e Epërm, Balajt e Poshtëm etj.

Pas kësaj ndarjeje administrative të dikurshme pati ndryshime demografike dhe, si rezultat i kërkimeve, nxjerrjes e përpunimit të kromit, në vitin 1970, në Martanesh u ngrit

---

<sup>7</sup> Shih: Përmbledhje e legjislacionit për pushtetin vendor, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Ligji nr 86/83, dt. 31.7.200 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 91/23, dt. 29.07. 2003, Tiranë 2006, f.58.

<sup>8</sup> Vendasit i thonë Snoi, por mendohet se vjen nga Shën Ndoi.

qyteti i Krastës, i cili u popullua fillimisht nga punëtorë, ushtarakë e specialistë jo vetëm martaneshas por edhe nga treva të tjera, kryesisht nga Mati, Dibra, Bulqiza, Kukësi, Tirana, Gjirokastra, Saranda e Koça. Një pjesë e tyre vazhdojnë të jetojnë në këtë trevë edhe sot e kësaj dite. Kjo solli edhe ndarjen e re administrative që parashtruan më lart, e përbërë nga 7 fshatra dhe një qytet (Krasta).

Malësia e Martaneshit rrethohet nga lugina të bukura e të thella në të cilat përfundojnë të gjithë rrjedhat ujore të saj. Pjesa jugore e krahinës është e veshur me bimësi të shumëllojshme, ku bien në sy pyjet e larta të pishës dhe ahut. Pjesa veriore përbëhet kryesisht nga magmatikë, nga buron edhe pasuria e kromit që shfrytëzohet prej vitit 1959 dhe shtrihet nga Batra, Lugu i Gjatë, Zona e Re, Krasta, Thellësia, Thekna e deri në malin e Kaptinës. Malet që e rrethojnë këtë krahinë janë: në verilindje mali i Dhoksit (2020m), në juglindje Kaptina (1874m), në jugperëndim Snoi (1846m) dhe në perëndim Bërdheta (1600m).

Emri i dikurshëm i krahinës dhe historiku i tij, i përmendur në forma të ndryshme nga gojëdhëna dhe dokumente historike të kohës, herë shfaqet duke e ruajtur rrënjën e tij e herë është zhdukur. Në vëllimin “*Shqiptarët dhe trojet e tyre*”, historiani Kristo Frashëri, tek shpjegon emërtimin *Arbanon* si një emër i një krahine të ngushtë, i trevës rreth e rrotull Krujës, e krahason atë me emra të krahinave të tjera të vendit, ku Martaneshi vihet në origjinë nga *Kunavia*. Emrat e krahinave të përmendura janë: *Polati (Pulti)*, *Kunavia (Martaneshi)*, *Crnika (Çermenika)*, *Trajendena (Mirdita)*, *Matia*, *Skuria*, *Tamadea*, *Trajendena*, *Benda*, *Mokra* etj.<sup>9</sup>

Historiani kroat Milan Shuflaj në veprën e tij “*Serbët dhe Shqiptarët*“, duke iu referuar shkrimtarit grek Gjergj Akropoliti, shkruan: “Ndërmjet Durrësit dhe rrjedhës së sipërme të lumit Mat përmend shkrimtari grek Gjergj Akropoliti në shek. XIII krahinën Hunavia ( o v ). Shumë kohë më parë , në shek. IX përmendet ipeshkvi i kësaj krahine nën mitropolinë e Durrësit: o v . (...) Etiomologjia popullore e mesjetës, emrin Hunavi e bjen prej shqipes kunavi, kunadi, në greqishten e re v (slav. “kunic” nga sllavishtja e vjetër “kuna”). Në një listë serbe të vjetër kombesh të shpallur nga Shafariku, të cilët mbanin shenja totemizmi, shqiptari shënohet si “dabar”=kostar, hunavi si lepur, serbi si ujk (...). Megjithatë emri i krahinës Hunavia është shumë i vjetër dhe kurrësesi nga burimi indoeuropjan.

Ka lidhje me e Strabonit, me „*candavii montes*“ (malet e Kandavisë ... në verilindje të Hunavis shtrihej krahina e Dibrës (1223 . 1308 *contrata de Debr*). Prej kësaj krahine rrjedh padyshim, në listën e vjetër serbe, që u përmend më sipër, shenja „dabar“ për shqiptarin. Kjo ka qenë një krahinë e dyfishtë, e sipërme dhe e

<sup>9</sup> Shih: K. Frashëri, *Trojet shqiptare në shek. XV*, Shqiptarët dhe trojet e tyre, 1982, f. 201.

poshtme (1467 nella Dibra inferiore). Në jug të këtyre dy krahinave shtrihej Çermenika e sotme. Musachi (1510) e njohu me emrin Chermenichi.“<sup>10</sup>

Duke iu referuar këtyre historianëve të huaj, që kanë trajtuar historinë e trojeve shqiptare që nga antikiteti e në vazhdim , krahina e Martaneshit në origjinë nga Kunavia herë i afrohet gjeografikisht trevës së sotme të Martaneshit e herë i largohet. Duke u ndalur te historiani i njohur Milan Shuflaj, që përcakton kufinj të dhe kufizimet e ipeshkvisë së Kunavisë, që trajtuam më lart, sot ky pozicion gjeografik përkon me vendndodhjen gjeografike të Komunës Martanesh. Realisht, sot në verilindje të Martaneshit është treva e Dibrës dhe në juglindje ndodhet treva e Çermenikës.

Origjina e Martaneshit nga Kunavia përmendet edhe nga historiani Petrika Thëngjilli, tek trajton aspekte të kombësisë shqiptare: “Emri i përbashkët „vendi i Shqiptarëve“ tregon edhe një herë se ishte kapërcyer koha e uniteteve gjeografike-etnografike-administrative si Devoll, Mokër, Pult (Polati), Martanesh (Kunavi), Mati, Çermenika (Crnika), Mirdita (Trafondena) ....”<sup>11</sup>

Për një periudhë të gjatë kohe Martaneshi nuk përmendet në dokumentet e kohës.

Emri Martanesh mendohet se është formuar nga *Martin* + prapashtesa *-esh*. Këtë e mbështesim edhe te pohimet me rëndësi të shprehura në studime me peshë, si p.sh. nga Prof. Shaban Demiraj, i cili shkruan se ”siç na dëshmojnë Xhuvani – Çabej (1962,37v), me prapashtesën *-esh* janë formuar disa emra katundesh si Bradashesh, Godolesh, Martanesh, Zgërdhesh etj.”<sup>12</sup>

Rreth etimologjisë së emrit Martanesh, duke u mbështetur në dokumente të ndryshme të shek.XVII e më vonë citojmë:

1. Në revistën „*Hylli i Dritës*“ e vitit 1932, në shkrimin me titull „*Shqypnia katolike në vjetë 1671*“ (nxjerrë prej dokumentit të vizionarit D. Shtjefen Gasparit) thuhet: „Ashtu edhe nder katunde të Gurit të Bardhë (Pietrabanca) e të Martaneshit (San Martino) kishin mohue shumica fën katolike e bâ musliman nper mungesë të klerit. Atje kishin mbetë 400 e këtu veç 350 katolikë: këtyne u shërbejshin D. Ndreu e D. Martini prej Gurit të Bardhë“.<sup>13</sup> Nga ky dokument Martaneshi lidhet me San Martino, pra me kishën e Shën Martinit, ku po në të njëjtin artikull të

<sup>10</sup> Shih: M. Shuflaj, “*Serbët dhe shqiptarët*”, Tiranë, 2004, 39-40.

<sup>11</sup> Shih: P. Thëngjilli, *Disa aspekte të kombësisë shqiptare në burimet osmane në shek. XV-XVI*, botuar në përmbledhjen “*Shqiptarët dhe trojet e tyre*”, Tiranë, 1982, f.325.

<sup>12</sup> Shih: Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1999, f. 178.

<sup>13</sup>Shih: Hylli i Dritës, “*Shqypnia Katolike në vjetë 1671*”, 1932, f. 536.

kësaj reviste jepen edhe emrat e famulltarëve të secilës trevë, ku famulltari i Martaneshit ishte D. Martini p. G. të B.<sup>14</sup>

2. Në vëllimin „*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme të shek. XVII*“<sup>15</sup> thuhet: “Ha Santo Martino della terra detta S. Martino antichamente Abbadia con gran rendita intiera di sasso, la quale ha 2 campane, alcune vigne, e campi da seminare, che fruttano o da 25 rialli annui colli quali, et altri aiuti, hora si sostiene un fratte Minore oss evuante di S. Francesko ha anime christiane 1 mille 50.”<sup>16</sup>
3. Kristo Frashëri në botimin „*Historia e Tiranës*“ shkruan se në dioqezën e Bendës kishte vetëm 2988 frymë të krishterë, por pa peshkop e pa kanonikë. Sipas tij, popullsinë më të krishterë e më të shumtë e kishte Shmërtini (San Martino, Martaneshi) seli e një abacie të lashtë me 1050 frymë të krishterë, por pak më vonë, të gjithë burrat nën shembullin e priftit të tyre, u kthyen në myslimanë duke mbetur të krishterë vetëm gratë, të cilat ruanin fenë e mëparshme edhe në vitin 1672.<sup>17</sup>

Nga të dhënat që cituam mund të na jepet e drejta të mendojmë se emri Martanesh vjen nga Shën Martini. Ndoshta evolucioni i fjalës duhet menduar lidhur me periudhën e myslimanizmit të kësaj krahine. Ardhja e osmanëve u imponoi krahas të tjerave edhe disa elementë të përdorimit të gjerë. Në këto kushte mendojmë se nga *Shën Martini* kemi *Martin Shën – Martinishën – Martinesh – Martanesh*.

Për prejardhjen e emrit Martanesh ekzistojnë edhe disa gojëdhëna dhe një etimologji popullore për emrin e krahinës. Thuhet se me hyrjen e pushtuesit turk në zonë, ata synuan të rrëmbenin disa vajza, të cilat për të mos rënë në dorë të turqve, janë mbledhur për të vendosur si të veprojnë, në një shesh të vogël mbi një shkëmb që ndodhet afër fshatit Gjon, i quajtur “*Kuvendi i Gocave*”. Nismëtare për këtë vendim ka qenë një vajzë me emrin Martë. Pasi kanë kuvenduar, ata kanë vendosur të flijojnë për të mos rënë në dorë të turkut. Pas Martës ato u hodhën të gjitha nga Shkëmbi i Kuq dhe ranë të vdekura në bregun e lumit. Sipas kësaj gojëdhëne kemi nga “*Marta u nda prej nesh*” (siç thuhet se kanë thirur shoqet e saj) ka mbetur emri Martanesh.

Gojëdhëna tjetër flet për 10 vajza, të cilat luftuan bashkë me të afërmit e tyre kundër forcave të ushtrisë turke në vendin e quajtur Qafa e Qarrit. Nga luftimet është vrarë një

---

<sup>14</sup> Shih: Po aty, f. 537.

<sup>15</sup> Shih: *Skura M., Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme të shekullit XVII*, vëllimi II, Tiranë, 1965, f.239.

<sup>16</sup> Ka Shën Martini në token e quajtur Shmërtin. Motit që abaci me rente të madhe, [asht] e plotë, në gur: e cila ka dy kumbonë, disa, vneshta dhe ara për t’u mbjellë, që qesin një 25 realë vjetorë, me të cilët, dhe me ndihma të tjera, tashti mbahet një frat minor observant i Shen Franceskut: ka frymë të krishtena-1050

<sup>17</sup> Shih: K. Frashëri, *Historia e Tiranës*, Vëllimi I, Tiranë, ...

vajzë me emrin Martë. Kështu nga “*Marta u ndesh me turqit*”, mendohet se ka ardhur emri Martanesh.

Duke mos mohuar rëndësinë e vlerat patriotike e folklorike të legjendave, një shpjegim i tillë duket se nuk ka një bazë reale, për vetë faktin se Martaneshi përmendet edhe para ardhjes së pushtuesit turk. Kështu te “*E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare*” At Giuseppe (Zef) shkruan: *Marchaseos apo Marcheseos, fis? – është njëra nga popullsitë, “fiset”, sipas Shuflajit, që iu nënshtruan Kurorës së napolit me 1304 (AD). Duke supozuar një lexim të keq të emëtimit “Marthaseos”, mund të mendohet lidhja e tij me atë të Martaneshit, qendër e Malësisë së Tiranës; madje, mund të dyshohet edhe një rrjedhim i tyre në Marchesit e Sicilisë.*<sup>18</sup> Në këto kushte, duke u nisur nga mendimi më i përgjithshëm i studiuesve dhe duke bërë përqasjet dhe krahasimet e të dhënave, mbërrijmë në mendimin se emërtimi Martanesh vjen nga Shën Martini (San Martino). Nga ana tjetër, ky emërtim na çon te një pasqyrë e arbëreshëve të Italisë sipas regjistrimit të vitit 1966, ku në përbërje të krahinës së Kozencës është edhe një katund me emrin Shën – Mërtiri (San Martino di Finita), me një numër banorësh prej 1879, prej të cilëve 800 janë shqipfolës.<sup>19</sup> Ndoshta kjo do të na shtynte të mendonim se popullsia e këtij katundi, duke u nisur nga toponimi, mund të kenë ardhur nga kjo trevë. Këtë hipotezë e mbështesim edhe në rrethanën se historianët dhe studiuesit që janë marrë me studimin e prejardhjes historike të mërgimtarëve arbëreshë në Itali kanë pranuar se atje, krahas pjesës më të madhe të mërgimtarëve me origjinë nga Shqipëria e Jugut, nuk kanë munguar edhe ato nga treva të Shqipërisë Veriore<sup>20</sup> e të përfaqësuar në onomastikën e atjeshme me etnonime si, Skura, Mates, Skutari.<sup>21</sup>

Martaneshi është një trevë e banuar qysh në lashtësi. Qerim Lila në botimin e tij “*Martaneshi, histori dhe etnokulturë*” e mbështet këtë mbi disa toponime, sidomos në pjesën lindore dhe verilindore të krahinës, duke treguar në këtë mënyrë se edhe në larësi në male ka pasur vendbanime në kohë të hershme. Sipas tij në periferi të trojeve të minierës së kromit në Batërr ka edhe sot mbeturina të skories e quajtur ndryshe edhe *zgjyrë*, madje atje ndodhet një vend që quhet *Gropa e Zgjyrës*, dhe jo larg saj ndodhet *Qafa e Prushit*, më tej janë *Hurdha e Vllajt*, *Kroi i Mortullove*, *Fusha e Kishës*, *Arat e Mishteret* etj. Këto emra vendesh dëshmojnë se kjo trevë dikur ka qenë banuar, dhe, sipas Q. Lilës këta emërtime na japin të drejtë të mendojmë se “aty kanë qenë nxjerrë e punuar minerale e metale nga fisi ilir i Pirustëve, që siç dihet nga historia e lashtë, ka qenë i shtrirë në luginën e Matit, ku përfshihet edhe Martaneshi, sepse nga malet e tij buron e

<sup>18</sup> Shih: At Giuseppe Valentini, *E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare*, përktheu: Dritan Thomdari, Plejad, 2007, f.350.

<sup>19</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 280.

<sup>20</sup> Shih: E. Çabej, *Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë*, në “*Bota arbëreshe*”, Tiranë, 1987, f.61.

<sup>21</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006, f. 237-245.

dhe lumi Mat“.<sup>22</sup> Ky autor e mbështet këtë tezë duke iu referuar prof. E. Çabejt, i cili në vëllimin “*Shqiptarët dhe trojet e tyre*” shkruan: “Qafa e Prushit, që gjendet më në veri, mund të jetë vijim i emrit të Pirustëve (Pirusta, Pirustae, pas një mendimi të A.Sarasit), me një zhvillim të grupit *st* në *sh*.”<sup>23</sup> Q. Lila e vazhdon më tej arsyetimin duke pohuar se Qafa e Prushit, që kufizon Martaneshin me Klosin, nuk ndodhet larg nga Gropa e Zgjyrës.<sup>24</sup>

Martaneshi, duke u mbështetur në ndarjet krahinore në shekuj, bënte pjesë në atë të Gegërisë, e cila përfshinte territorin nga Shkumbini në Drinin e Zi, siç ishin: Mati, Dibra, Çermenika, Martaneshi, Krraba, Tomadhea, Kurbini, Fusha e Arbrit etj. Pra, Martaneshi bënte pjesë në grupin e madh të krahinave të Gegërisë dhe bazohej në normat e Kanunit të Skënderbeut<sup>25</sup>.

Në periudhën e katolicizmit Martaneshi varej nga Dioqeza e Durrësit, ndërsa në periudhën e Perandorisë Osmane (1881) bënte pjesë në sanxhakun e Elbasanit, i cili i përkiste vilajetit të Manastirit.

\*

\*     \*

Nga periudha e shpalljes së pavarësisë deri më 30 prill 1934, Martaneshi ka funksionuar si katund brenda Komunës së Çermenikës, së bashku me katundet Lunik, Prevall, Neshtë dhe Kostenjë dhe ishte qendra zyrtare e komunës.<sup>26</sup>

Pas ndryshimeve administrative të bëra nga Mbretëria e Zogut, me ligjin e 30 prillit 1934 “*Mbi disa ndryshime të ligjës së komunave*”, Martaneshi u shkëput nga fshatrat e tjerë dhe mori emrin Komuna Martanesh, si pjesë e Prefekturës Elbasan në varësi të drejtpërdrejtë.<sup>27</sup>

Martaneshi ka doke, tradita, kanune e veshje si të thuash të njëjta me Çermenikën, e pra është si të thuash na del vazhdim i kësaj krahine.<sup>28</sup>

Duke qenë një krahinë e izoluar dhe me terren të thyer malor, e banuar që në lashtësi nga banorë autoktonë, nuk është lakmuar nga zonat e tjera. Po kështu edhe lidhjet martesore deri nga mesi i shekullit XX kanë qenë bërë, përveç ndonjë rasti të rrallë, vetëm brenda

---

<sup>22</sup> Shih: Q. Lila, *Martaneshi, histori dhe etnokulturë*, Tiranë, 2000, f. 16.

<sup>23</sup> Shih: E.Çabej, *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Tiranë, 1982, f. 85.

<sup>24</sup>Shih: Q. Lila, *Martaneshi, histori dhe etnokulturë*, Tiranë, 2000, f. 16.

<sup>25</sup> Shih: Q. Lila, *Martaneshi, histori dhe etnokulturë*, Tiranë, 2000, f. 9-10 .

<sup>26</sup> A.Q.SH., Fletore Zyrtare nr. 20, *Ligja e Katundarive (komunave)*, 16 prill 1929, f. 318.

<sup>27</sup> A.Q.Sh., Fletorja Zyrtare nr. 29, 19 maj 1934, *Mbi disa ndryshime të ligjës së komunave*, f. 214

<sup>28</sup> Shih: *Q.Lila, Martaneshi, Histori dhe etnokulturë*, Tiranë, 2000, f.10

krahinës. Kjo ka bërë që popullsia të mos rritet në rrugë të tjera, përveç asaj natyrale duke bërë të mundur ruajtjet e disa veçorive të trashëguara të krahinës si: veshja, të folurit, doket etj.<sup>29</sup> Kështu Martaneshi përmendet si vend kanunesh për gjithë Malësinë e Tiranës<sup>30</sup>, si edhe për të përshtatur daoket e zakonet në përputhje me zhvillimet e ndryshimet e ndodhura në këtë krahinë, kishte edhe një kanunar, që bënte këto ndryshime. Ai quhej Selim Peshku.<sup>31</sup>

Studiuesja angleze Margaret Hasluck në librin e saj “*Kanuni shqiptar*” (*Ligji Pashkruar*) trajton se Martaneshi, ndryshe nga zonat e tjera të veriut, ku titulli i bajraktarit trashëgohej, në këtë trevë ky titull ishte i patrashëgueshëm dhe i palokalizuar, por kalonte te mbrojtësit e njëpasnjëshëm nga njëra familje te tjetra, nga lagjia në lagje, apo nga fshati në fshat. Pra në këtë zonë kërkohej aftësia e drejtimit dhe kjo nuk ishte e thënë të trashëgohej brez pas brezi si pronë e një familje apo fshati.<sup>32</sup>

\*

\* \*

Martaneshi, si ekonomi bazë, në të kaluarën ka pasur blegtorinë. Blegtoria ka qenë domosdoshmëri për banorët jo vetëm për prodhimin e bulmetit e të mishit për konsum vetiak apo për tregti, por edhe për sigurimin e leshit, nga përpunimi i të cilit bënin rrobat e veshjes e të fjetjes. Një sektor tjetër i ekonomisë që ka pasur njëfarë zhvillimi ka qenë edhe zejtaria, e diktuar kjo më tepër për plotësimin e nevojave e kërkesave vetjake e krahinore. Këtë e ka favorizuar edhe pasuria pyjore e kësaj treve. Vendodhja si një zonë e veçuar, e rrethuar nga malet, me dimër të ashpër e të gjatë, distanca nga qyteti dhe krahinat e tjera përtej maleve, mungesa e rrugëve automobilistike dhe mjeteve të komunikimit, krijonin vështirësi për jetesën. Të ndodhur në këto kushte, banorët e kësaj krahine kanë bërë jetë të mbyllur dhe për të plotësuar kërkesat e domosdoshme që u diktonte jeta në fshatrat e tyre. Kështu për ndërtimin e banesave, e sidomos për mbulimin e tyre specializoheshin disa fshatarë, që punonin kundrejt pagesës. Të tjerë ishin specializuar në përpunimin e lëndës së drurit, duke prodhuar shegja, tinarë e voza në madhësi të ndryshme për të mbajtur në to prodhimet blegtorale si: gjizë, djathë, gjalpë. Nga dërrasa e ahut, pishës e arrës bëheshin arka për nuset, rafte e kuti, djepe për fëmijët, vegjë për prodhimin e shajakut, furka e druga për tjerren e leshit etj. Disa nga këto motive bëheshin me motive zbukuruese si: rathë, trekëndësha etj. Shajaku i prodhuar shkilej në valanica, me qëllim që t’i jepej dendësi, qëndrueshmëri e bukuri. Ka pasur gjithashtu edhe zejtarë që merreshin me prerjen dhe qepjen e rrobave të leshta, sidomos për çiftet që martoheshin. Këta zejtarë quheshin terzi.

<sup>29</sup> Shih: Shih: *Q.Lila, vep. e cit., f.10.*

<sup>30</sup> Sh. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, f. 100.

<sup>31</sup> Shih: K. Frashëri, *Skënderbeu*, Tiranë, 2006, f.222.

<sup>32</sup> Shih: Margaret Hasluck, *Kanuni shqiptar*, Lisitan, 2005, f. 129.



Pazarin martaneshasit, para Luftës II Botërore, e kanë bërë kryesisht në Tiranë dhe Elbasan, ku tregtonin ato pak prodhime blegtorale dhe blinin misër, kripë, sapun, beze, këpucë etj.

Varësia administrative nga Elbasani, si dhe rrugët e tregtisë me Tiranën dhe Elbasanin kanë bërë që kjo trevë të marrë e të japë me këto treva në traditë, kulturë, gjuhë e folklor. Kjo bashkjetesë është edhe arsyeja pse Martaneshi afron në të folme e në kulturën materiale e shpirtërore me Elbasanin.

Pas Çlirimit veprimtaria tregtare është zhvilluar edhe me Burrelin dhe sot me Bulqizën.

Përsa i përket besimit fetar, Martaneshi deri në shekullin XVIII i përkiste besimit katolik. Kështu në botimet e Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, që kanë bërë objekt periudhën 1634-1650 thuhet: “Ka Shën Martini në tokën e quajtur Shmertin. Motit qe abaci e me rente të madhe, e plotë në gur; e cila ka dy kumbanë, disa vneshta dhe ara për t’u mbjellë... tashti mbahet nga një frat minor observant i Shën Françeskut: ka frymë të krishtena -1050”.<sup>33</sup> Krahas kësaj, këtë fakt e dëshmojnë edhe disa toponime që tregojnë se në këtë trevë dikur kanë ekzistuar disa kisha. Në qendër të fshatit Gjon ka qenë një tjetër kishë në vendin e quajtur *Kisha e Pepet*, në afërsi të Kroit të Shnjergjit, ndërsa lart në mal, ndërmjet Kaptinës dhe Vërvjakut, ku kufizohen fshatrat Lenë e Mëlçu, në vendin e quajtur Fushkishë, ka qenë një kishë tjetër, rrënojat e së cilës janë edhe sot.<sup>34</sup>

Në një dokument të vitit 1467 të Perandorisë Osmane, ku banorët kundërshtonin taksat dhe Sulltani u dërgon aktin e faljes së haraçit, përmenden këta emra: *Pal Rusi, Gjon Liti, Martin Dajxhi, Petër Mirneli, Peligrin Xaboli, Todor Rusi, Benk Titko, Andria Çukali, Petër Rusi, Gjon Zhaboli, Ariza Kuqi, Peter Kurpendi, Gjergj Stepiani, Gjon Skani, Andria Pisha, Lala Pisha, Ilia Manisi, Todor Polimani, Dom Lishi, Dom Todori, Gjon Todori, Todor Imboliti, Tanush Ilanizi, Gjon Skulja, Nikolla Rusi*.<sup>35</sup> Kjo listë emrash dëshmon edhe një herë se besimi në këto anë ishte katolik, sepse kryefamiljarët e familjeve të regjistruara janë me emra katolikë.

Po ashtu Dr. Johan George Von Hahn, studies gjerman, i konsideruar si dekan i studimeve shqiptare në shekullin e XIX, shkruan: “Martaneshi afër Mallogjeshit ruan edhe sot një këmbanë kisha të madhe, kjo shërben sot për të mbledh katunin.”<sup>36</sup>

---

<sup>33</sup> Shih: M. Skura, “*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII, V. II*”, Tiranë, 1965, f. 239.

<sup>34</sup> Shih: Q.Lila, *Martaneshi, histori dhe etnokulturë*, Tiranë, 2000, f.16-18.

<sup>35</sup> Shih: S. Pulaha, *Lufta Shqiptaro-Turke në shekullin XV (Burime osmane)*, Tiranë, 1968, f. 332.

<sup>36</sup> Johan George Von Hahn, “*Studime shqiptare*”, përktheu nga gjermanishtja: Veniamin Dashi dhe Afrim Koçi, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit”, f. 119.

Në mesin e shek. XIX ka filluar veprimtarinë sekti bektashian. Janë ruajtur ndër shekuj e deri në ditët e sotme një sërë besimesh e ritesh të lashta, duke u përpunuar, lehtësuar e sinkretizuar me fetë monoteiste, krishtërim e islamizim.

Në faqen e malit shkëmbor të Ballesë së Madhe ndodhet një vend i shenjtë (Vendi i Mirë) ku bektashinjtë zhvillojnë ritet e tyre të besimit bektashian. Afër është ngritur teqeja e Martaneshit që përshin zonën e Kostenjës dhe të Zerqanit. Kjo teqe edhe sot ruan traditën e bashkëpunimit me teqenë e Elbasanit e të Krujës, si edhe me të gjithë besimtarët bektashianë brenda e jashtë vendit. Dita e 22 qershorit është edhe dita e peligrinazhit botëror të bektashinjëve në vendin e shenjtë të Ballem Sulltanit.

## E folmja e Martaneshit në kuadrin e ndarjes dialektore të shqipes

Përpjekjet për ndarjen dialektore të gjuhës shqipe kanë nisur të bëhen qysh në shekullin XIX, porse shumica e këtyre studimeve janë kryer për qëllime të tjera dhe nuk kanë pasur si objekt të mirëfilltë studimi ndarjen dialektore të shqipes. Janë disa studiues shqiptarë dhe të huaj që e kanë trajtuar këtë temë, por këtu po ndalemi tek ata studiues, të cilët kanë përcaktuar edhe vendin e të folmes së Martaneshit në ndarjen dialektore të shqipes.

Jorgji Gjinari e ka trajtuar së pari këtë temë në „Dialektologjia shqiptare“ (1963)<sup>37</sup>; aty jepen karakteristikat e secilit dialekt, si dhe të çdo dege, por pa i quajtur ato si nëndialekte. Në këtë ndarje J. Gjinari thotë se e folmja e krahinës së Martaneshit bën pjesë në gegërishten jugore dhe më saktë në nëngrupin e të folmeve lindore.<sup>38</sup>

J. Gjinari dallon në gegërishten jugore tri grupe të folmesh, duke përfshirë në të edhe të folmet e pjesës qendrore të gegërisë, krahas gegërishtes jugore perendimore dhe jugore lindore.<sup>39</sup>

Më vonë Gjinari e rimerr këtë temë, me qëllim që të bëjë një ndarje dialektore të shqipes më të përcaktuar, si në drejtim të një shkallëzimi më të drejtë të njësive dialektore, duke vendosur edhe disa kriterë, po ashtu edhe në drejtim të caktimit më të përpiktë të kufijëve gjeografikë të këtyre njësive.<sup>40</sup> Në librin e tij „Dialektet e gjuhës shqipe“, e folmja e Martaneshit nuk përmendet më.

Dy nëndialektet e gegërishtes gjeografikisht ndahen te lumi i Matit; gegërishtja jugore shtrihet në të majtë të Matit: në zonat e Elbasanit, të Durrësit, të Tiranës, të Krujës, të Matit, të Lurës, të Peshkopisë e të Maqedonisë Perendimore, prej Dibre deri në Shkup e Kumanovë.<sup>41</sup>

Për gegërishten jugore theksohet se gjatë kohëve ka ecur krah për krah me mbarë të folmet e toskërishtes ose me të folmet veriore të saj; kështu grupet e vjetra *kl*, *gl* kanë përfunduar në *J* (*aj*, *Jūni*); emrat mashkullor që mbarojnë me diftong (*thua*, *krua*), kur shquhen, ndryshe nga të folmet e skait verior, nuk e nxjerrin *n*-në me të cilën ka mbaruar dikur tema (*ftue-ftoi*, *krue-kroi*); disa funksione të paskajores gege kryhen nga lidhja ose nga paskajorja e tipit *për të punuar*: *kam p r t vojt ke i mik* etj. Ashtu si në veçoritë fonetike, nëndialekti i gegërishtes jugore edhe me një numër fjalësh bashkohet me toskërishten dhe veçohet nga gegërishtja veriore.<sup>42</sup>

<sup>37</sup> Shih: J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, 1963.

<sup>38</sup> Shih: J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, 1963, f.78.

<sup>39</sup> Shih: J. Gjinari, „*Dialektologjia shqiptare*“, 1963, f. 78.

<sup>40</sup> Shih: J. Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 39-58.

<sup>41</sup> Shih: J. Gjinari, vep. e cit., f. 50.

<sup>42</sup> Shih: J. Gjinari, vep. e cit., f. 52.

Mehmet Çeliku e klasifikon të folmen e Martaneshit në grupin e të folmeve lindore të gegërishtes jugore së bashku me të folmen e Çërmenikës dhe atë të Elbasanit. Sipas tij kufiri kalon në të folmen e Shëngjergjit e të Kërrabës, të cilat gjuhësisht afrojnë më tepër me grupin perendimor.<sup>43</sup>

Ndër tiparet e përbashkëta të së folmes së Martaneshit dhe grupin e të folmeve të gegërishtes jugore po përmendim disa tipare fonetike, si ruajtja e padiftonguar e zanoreve të theksuara, ruajtjen e bashkëtingëlloreve *q, gj* dhe të grupeve *tj, dj*, si: *shtjerr, tjegull, tjetri, tunjatjeta* etj; labializimi i hundores *ā* duke përfutur variantet *ā<sup>o</sup>, ō*, si: *shullō, carā<sup>o</sup>ni* etj. Labializimi i hundores *ā* është e dëshmuar edhe në të folmen e Krugës e të Malësisë së saj, në të folmen e Matit, në të folmen e Mirditës, sidomos në pjesët qendrore e lindore të saj, në të folmen e Lumës, të Lurës, të Reç-e-Dardhës së Dibrës, të Luzinës dhe të Grykës së Madhe të Dibrës.<sup>44</sup> Bahri Beci shkruan se: “Megjithëse ka rrokur pothuajse të gjitha të folmet qendrore të gegërishtes ajo nuk është një dukuri specifike e këtyre të folmeve, meqenëse shtrihet edhe në të folmet lindore, pjesërisht edhe perendimore të gegërishtes veriore dhe në ato të grupit perendimor të gegërishtes jugore. Ajo është e përhapur edhe në të folmen e Martaneshit e të Çërmenikës të grupit lindor të gegërishtes jugore“.<sup>45</sup>

Ndër tiparet kryesore që rrokin shumicën ose të gjithë të folmet qendrore të gegërishtes janë: zberthimi i *i*-së së theksuar në diftongjet dytësore: *ai, oi, ei, ëi* etj., zhbuzorëzimi i *y*-së në *i* dhe zberthimi i kësaj të fundit në diftongje dytësore ose kalimi i saj në *ø* dhe *ø*, qiellzorizimi i grykores *g* në *gj*, qiellzorizimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *tj, dj* përkatësisht në *q* dhe në *gj*.<sup>46</sup>

Duke pasur parasysh këto përfundime, si dhe tiparet themelore të së folmes së Martaneshit, mendojmë se kjo afron më shumë me të folmen e Elbasanit dhe Çërmenikës. Gegërishtja jugore përfshin të folmen e zonave të rretheve të Tiranës, Durrësit, Elbasanit, si edhe të folmet e Çërmenikës (rrethi i Librazhdit) e të Martaneshit (rrethi i Burrelit). Të folmet më veriore të gegërishtes jugore janë të folmet e Ishmit, Prezës, Zallherit, Shuplajt, Shëngjergjit, Martaneshit, Çërmenikës.<sup>47</sup>

Natyrë tepër e larmishme e Martaneshit, me pasuri ujore, pyjore, me zhvillimin e blegtorisë, zhvillimi i industrisë së kromit si edhe emigracioni janë dëshmi që flasin për veprimtari jetësore e të shumëanshme të martaneshasve dhe për marrëdhëniet e tyre me

<sup>43</sup> Shih: M. Çeliku, “Vëzhgime mbi grupin e të folmeve të Gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre, Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1968, f. 244.

<sup>44</sup> Shih: B. Beci, “Të folmet qendrore të gegërishtes”, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987., f. 17.

<sup>45</sup> Shih: B. Beci, vepër e cit., f. 17-18.

<sup>46</sup> Shih: Bahri Beci, “Të folmet qendrore të gegërishtes”, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 10

<sup>47</sup> Shih: M. Çeliku, “Vëzhgime mbi grupin e të folmeve të Gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre, Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1968, f. 244.

popuj, kultura e gjuhë të ndryshme. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin dhe pasurimin e leksikut të kësaj të folmeje. Nga ana tjetër të qenit një krahinë malore, jeta e mbyllur në bashkësi fshatare dhe karakteri autonom i krahinës kanë bërë që në këtë të folme të mbizotërojë karakteri ruajtës dhe të vazhdojë të përdoren edhe sot trajta të vjetra.

Vështrimi ynë gjuhësor rreth kësaj të folmeje rrok fushat e fonetikës, të morfologjisë dhe të leksikut, duke synuar të japim ndihmesën tonë në përcaktimin e veçorive të saj përsa i përket ndarjes dialektore të shqipes.

## Fonetikë

Tiparet fonetike të të folmes së Martaneshit do t'i krahasojmë herë pas here edhe me të folmet përreth, që janë edhe pika të anketimit të paraqitura në ADGJSH, konkretisht me të folmet e Klosit (pika 91), Zerqanit (pika 92), Dibrës (pika 93), Shëngjinit të Madh (pika 96), Elbasanit (pika 99) dhe Belshit (pika 108).

Fjalët e huazuara nga turqishtja me theks fundor, në të folmen e Martaneshit, ashtu si në mbarë gegërishten, e zhvendosin theksin në rrokjen e parafundit: *káfe, páre, penxhére, tenxhére, qóshe, fatíme, hatíxhe, méze, séne, bákër, xhézme etj.*

Zhvendosja e theksit ka ndodhur edhe te *ba:b, baklla:v*. Këtu, zanorja *a* fundore e patheksuar, siç dihet, interpretohet si trajtë e shquar dhe, prej saj, në rrugë analogjike është krijuar e pashquara me zanoren *-ë* sipas modelit të emrave femërorë. Me zhvendosjen e theksit, *a-ja* më parë është reduktuar në *ë* e pastaj *ë-ja* ka rënë krejtësisht në pozicion fundor.

Ndryshe nga ndonjë e folme gege juglindore si ajo e Elbasanit, këtu janë paraoksitone, si në të folmen e Durrësit apo të Kërrabës, edhe këto fjalë: *xhenáze, tenéqe*. Por ndryshe nga e folmja e Durrësit këtu janë paraoksitone edhe fjalët: *zerzéle, dā'mlla* etj. Ashtu si në të gjithë gegërishten jugore edhe në Martanesh janë me theks fundor edhe fjalët *verì, njerì*, duke afruar kështu me toskërishten.

Përemri *ai* del i theksuar në elementin e parë *áj*.

Me theks fundor dalin edhe fjalët: *kaqí, gatí*, ndërsa fjala *disa* del me theks parafundor vetëm në brezin e vjetër.

Edhe në të folmen e Klosit (pika 91), të Zerqanit (pika 92), të Dibrës (pika 93), të Shëngjinit të Madh (pika 96) dhe në të folmen e Belshit (pika 108), emrat *baba, para, dajë* në trajtën e pashquar janë me theks parafundor. Edhe përemri *ai* del i theksuar në elementin e parë *aj*. Ndërsa emrat *njeri, veri, qiri* janë me theks fundor si në të folmen e Martaneshit, ashtu edhe në të folmet e tjera të zonave përreth.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 65.a/1., 65.a/2., 65.b/2, f. 198,199,202.

## Gjatësia e zanoreve

Si në të gjithë gegërishten, edhe në të folmen e krahinës së Martaneshit, zanoret e theksuara kanë tri shkallë: gjatësi, gjatësi e mesme, shkurtësi. Zanoret e gjata janë përfutur kryesisht nga këto raste:

- a. nga monoftongimi i diftongjeve *ue, ye, ie*, si: *du:l, prru:, mi:ll, di:ll, qi:ll, kry:t* etj.
- b. nga rënia e zanores fundore *ë*, si zgjatim “kompensator” dukuri kjo që vihet re në pjesë të ndryshme të ligjëratës dhe në forma të ndryshme të tyre: *bu:rr, bu:k, de:g, i gja:t, i tha:t, la:sh, pa:sh, pi:m, rri:m, pla:k, lo:p, shu:m, tha:sh, la:m, la:t, da:m, da:t* etj.

Gjatësia e zanoreve në këtë të folme është tipar edhe i dallimit të trajtave morfologjike të emrave te kategoria e numrit: *dollap – dolla:p, dyshek – dyshe:k, jatak – jata:k* (vj), *çubuk* (çibuk) – *çibu:k, oxhak – oxha:k* etj.

Gjatësia e zanoreve si tipar i dallimit të trajtave morfologjike të emrave te kategoria e numrit apo gjinisë del edhe në zonën e Klosit, Zerqanit, Dibrës, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit: *plak “plak” ~ pla:k; ve “vesh” ~ ve:sh “veshë”*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr.1.a, 1.b. f. 69-70.

Janë të gjata zakonisht rrokjet fundore të theksuara të hapura të fjalëve një a disa rrokëshe: *ka:, qe:, shi:, pa:, shpi:, tra:, tra:, ushtri:, vra:, vlla:* etj. Emrat e tipit *vlla* e ruajnë gjatësinë edhe në kallzoren e shquar ku marrin mbaresën –n, *vlla:n*. Janë të gjata zanoret e theksuara të shumë fjalëve, të cilat ndiqen nga bashkëtingëllorja –r, si: *ushta:r, fne:r, mulla:r, zinxhi:r, gu:r, beqa:r, zinxhi:r* etj., por sheqer (krahaso me *sheqe:r* në të folmen e Elbasanit)<sup>48</sup>.

### **Hundorësia e zanoreve**

Të gjitha zanoret gojore në këtë të folme dalin edhe hundore. Hundorësia përftohet nga zanoret e theksuara të cilat ndiqen nga një bashkëtingëllore hundore (*n, m,* ), si: *ha°:n, ka°:m, āmël, upe: , kërc :ni*, ose nga hundorja *nj* që ka kaluar në *j >* (më pas në gjysmëzanore *i*) *ku:j, rrā:j, dëll j* etj. Në këto raste zanorja gojore ka marrë hundorësinë e bashkëtingëllores pasuese.

Këtë zanore e ruajnë edhe atëherë kur vetë bashkëtingëlloret kanë rënë plotësisht ose kanë rënë vetëm në disa forma të caktuara fjalësh, si: *p , fr , h , kac , br , mull , z* etj.

Ka raste kur zanorja e theksuar është hundore megjithëse as nuk ka pasur, as nuk ka bashkëtingëllore hundore. Në këtë rast hundorësia është përftuar në rrugën e analogjisë. Zakonisht hundore del *i*-ja kur është fundore: *tagj , teps , kut , kac , hull* etj. Shtrirja e hundorësisë ka ndodhur në analogji me tipin *mull :ni*: Këto fjalë në disa të folme të tjera gege nuk kanë zanore të theksuara hundore si p.sh.: në Elbasan: *tagji, tepsi, kusi, kuti*.

<sup>48</sup> Mehmet Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës*, SF 2, 1966, fl. 122.

Hundorësia brenda kësaj të folmeje ka edhe vlerë fonologjike:

- *bi:n* (veta III shumës, *bijn, sjellin*) *b n* (veta e III shumës e foljes *me mbi.*)

- *shi* (emër- *sot bi shi:*) *sh* (folje, *jöm tu sh : misër*)

- *la* (folje, veta e III njëjës, *la rroba*), *lã* ( folje, me e lejuar dikë)

Fonemt zanore të theksuara /a/ *ban „bën“*, /e/ *en „end“*, /i/ *u pi „u mpi“*, /u/ *u pi „u mpi“* dalin edhe në të folmet përreth Martaneshit (Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh, Elbasan, Belsh), përjashtim bën e folmja e Dibrës, në të cilën nuk dalin këto zanore hundore.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr.2.a, 2.b., 2.c., 2.d., f. 76-80.

### **Zanoret e theksuara**

Fonema zanore e theksuar /ã/ *bãn (bën)* ashtu si në të fomen e Martaneshit, ekziston edhe në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh dhe Belshit, ndërsa në të folemn e Dibrës kjo zanore nuk ekziston.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 2.a., f. 76.

Zanorja e theksuar *a* ( hundore), në të folmen e Martaneshit ka prirje të kalojë në zanore buzore të mbyllur. Prirja kryesore e *a*-së hundore është kalimi drejt variantit *ã* (*ã* pak e buzorëzuar): *gjã°, zã°, u bã°, ã°mël, ã°nërr, e ã°ma, kã°nak, nã°n, lã°n (kishte, thã°n, kã°m, dhã°nrri, gjilpã°n, dhã°mi etj.*

Fonema zanore e theksuar /e/ *en (end)* ekziston në të folmen e Martaneshit, si dhe në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh dhe Belshit, ndërsa në të folmen e Dibrës kjo zanore nuk ekziston.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 2.b., f. 77.

Fonema zanore e theksuar /i/ *u pi (u mpi)* ekziston në të folmen e Martaneshit, si dhe në pikat 91,92,96,108, ndërsa në pikën 93 kjo zanore nuk ekziston.

Në të folmen e Martaneshit, në disa fjalë, zanorja e theksuar *i* është buzorëzuar në *y*. Kjo dukuri është e kufizuar në disa fjalë, si: *fry:k, kry:p, rryp*. Nuk vihet re buzorëzimi i zanores *i* tek fjalët *qime, shpirt, ushqim* etj.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 2.c., f. 78.



Fonemat zanore të theksuara /y/ sy “sy” ekziston në të folmen e Martaneshit, si dhe në pikat 96 dhe 108, ndërsa në pikën 91 del /ø/ sø “sy”. Për pikat 92, 93 nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 2.ç., f. 79.

Fonema zanore e theksuar /u/ hu “huri” ekziston në të folmen e Martaneshit, si dhe në pikat 91,92,96,108, ndërsa në pikën 93 kjo zanore nuk ekziston.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 2.d., f. 80.

### **Zanoret e patheksuara**

#### 1. Zanorja /ë/ e patheksuar:

- a. zanorja *ë* në pozicion fundor bie: *ba:ll, pu:n, bu:rr, i fo:rt, i dre:jt, dja:l, fa:r, dre:k, da:rk, di:t* etj.
- b. zanorja *ë* e patheksuar bie edhe para rrokjes së theksuar: *vlla, prralla, gzimi, bakti* etj.
- c. zanorja *ë* e patheksuar dëgjohet pas rrokjes së theksuar dhe para bashkëtingëlloreve *r, l, m*: *letër (letra), motër (motra), femën (femna), i vogël (i vogli), kodër (kodra)* etj.
- d. zanorja *ë* e patheksuar dëgjohet para bashkëtingëlloreve *l, r, m, t* dhe jo pas tyre: *letër, motër, i vogël, pupël* etj. Por zanorja *ë* nuk bie në pozicion pastheksor jo në fund të fjalës: *tri javësh, me krahët, shtremët, shpatëz, i prefët* (por i *pkucve*) (krahaso me të folmen e Kërrabës: *tre javsh, i kpucvet, me kraht, shpatz, i preft*)<sup>49</sup>

Në të folmen e Martaneshit shpeshherë nuk dëgjohet *ë-ja* e patheksuar edhe para mbaresave të aorsit shumë në vetën e I dhe të III: *kputn, mulln, murn, u lodhm, volm, çelm, futn, gjetm* etj.

Zanorja *ë* nuk bie kur rënia e saj do të shkaktonte formimin e një grupi bashkëtingëllor, i cili nuk mund të shqiptohet njëherësh si një rrokje e vetme me zanoren e theksuar që e paraprin: *sofër, gjarpën, hasër, i vjetër, letër, femën, motër, kodër, i vogël* etj. Por kur grupi bashkëtingëllor shqiptohet me një zanore pasuese, atëherë *ë-ja* bie: *sofra, hasra, motra, letra, e vjetra* etj.

2. Zanorja e patheksuar u. Përgjithësisht zanorja *u* në pozicion pastheksor ruhet para bashkëtingëlloreve *ll, r*: *pjergull, mashkull, kumull, sumull, akull, tjegull, sjetull,*

---

<sup>49</sup> Mehmet Çeliku, “Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës”, SF 2, 1966, f. 122.

*shugjetull, lepur, flutur* etj. Por, kur kjo zanore ndërron pozicion nga i mësipërmi atëherë ajo bie: *pjergllat, poplli, aklli, tjeglla, shpatlla* etj.

### **Togjet e zanoreve**

Në të folmen e Martaneshit, togu zanor *ue* është monoftonguar rregullisht dhe është përftuar *u*: e gjatë: *kallnu:r, punu, puntu:r, krahanu:r, qershu:r, laknu:r, tru:ll, bu:ll, gru:, thu:, patku:, ftu:, zju:, fru:r, kishë shku:, çu:, me largu:, me blu:, shku:m, du:l* etj.

Togu i zanoreve *ua* dhe variantet fonetike në përbërjen fonemore të fjalëve ku gjendet në rrokje fundore të mbyllur (*buall, duar, muaj*) është monoftonguar rregullisht dhe është përftuar *u* si në të folmen e Martaneshit, ashtu edhe në të folmet e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh dhe Belshit.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 51.a., f. 168.

Togu i zanoreve *ua* në përbërjen fonetike të fjalëve, ku gjendet në rrokje fundore të hapur, si psh.: *grua, ftua, dua*, është monoftonguar në *u* në të folmen e Martaneshit, si dhe në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh dhe Belshit, ndërsa në zonën e Dibrës del *ue*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 51.b., f.169

Po kështu është monoftonguar në *u* togu i zanoreve *ua* në përbërjen fonetike të fjalëve ku gjendet në rrokje të brendshme të hapur, përjashtim bën vetëm e folmja e Dibrës, ku shfaqen variantet *ue/u*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr.51.c., f. 170

Togu i zanoreve *ie* në përbërjen e fjalëve ku gjendet në rrokje të mbyllur fundore (*diell, miell, ziej*) është monoftonguar në *i* në të folmene Martaneshit, si dhe në pikat 91,92,93,108, ndërsa në pikën 96 dalin variantet *ie* dhe *i*. Në zonën 91 dhe 92, ku i-ja del edhe diftong, si variant fonetik, fjala *ziej* del gjithkund me *i* (*zi:j*), kurse fjala *miell* del *mee* dhe në zonën 91 del *m i*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 54.a., f. 175.

Togu i zanoreve *ie* në përbërjen fonemore të fjalëve ku gjendet në rrokje fundore të hapur (*bie, u zie*) është monoftonguar në *i* në të folmen e Martaneshit, si dhe në zonat 91, 96, 99, ndërsa në zonat 92, 93, 108 del varianti me *ie*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 54.b., f. 176.

Togu i zanoreve *ie* ku gjendet në rrokje në brendshme të hapur *di:lli* “*dielli*” është monoftonguar në *i* në zonën e Martaneshit, si dhe në zonat 91, 93,96, 99, 108, ndërsa është ruajtur në zonën 92.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 54.c/1, f. 177.

Grupi *je* (*ie*) kur ndodhet në përbërjen fonemore të formës së dëftores së tashme të vetave të njëjësit të foljes *vjel* ruhet si në zonën e Martaneshit, ashtu edhe në zonat e tjera që kemi marrë në shqyrtim. Po kështu ky grup ruhet edhe në përbërjen fonemore të formës së pjesores të kësaj folje.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 55.a., f. 179.

Togu i zanoreve *ye* gjithashtu është monoftonguar në:

- *y*, rregullisht e gjatë: *kry:t*, *fy:ll*, *dy:r*, *ly:j*, *py:s*.

Grupi *va* në përbërjen fonemore të fjalëve *vaj*, *varr*, *i vakët*, *vajta* në krahinën e Martaneshit del *vo*, *voj*, *vorr*, *i vokët*, *vojta*. Po kështu del edhe në pikat përreth Martaneshit.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 56, f. 181.

### **Bashkëtingëlloret**

Sistemi bashkëtingëllor i gjuhës standarde shqipe përbëhet prej 29 fonemash: (*p*), (*b*), (*t*), (*d*), (*c*), (*x*), (*ç*), (*xh*), (*q*), (*gj*), (*k*), (*g*), (*f*), (*v*), (*th*), (*dh*), (*s*), (*z*), (*sh*), (*zh*), (*h*), (*j*), (*m*), (*n*), (*nj*), (*l*), (*ll*), (*r*), (*rr*). Ky sistem dallohet nga sistemet e bashkëtingëlloreve të të folmeve të ndryshme të shqipes. Diku me praninë e një foneme më shumë, diku një më pak e diku tjetër me neutralizim.

Një dallim i rëndësishëm i të folmeve me gjuhën letrare në sistemin e fonemave bashkëtingëllore, është në rezultatet e grupeve bashkëtingullore: *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*. Siç do të shihen më poshtë, këto grupe kanë dhënë në të folmen e krahinës së Martaneshit përkatësisht: *m*, *n*, *d*, *ngj*. Në rastet kur këto grupe kanë dhënë *m*, *n*, *nj*, *d* si rezultat i ndryshimeve fonetike, kanë dalë fonema që ekzistonin në sistemin bashkëtingëllor të gjuhës dhe është shtuar vetëm denduria e përdorimit të këtyre fonemave dhe nuk është prekur inventari, pasi nuk ka opozicione.

Në të folmen e Martaneshit ekziston një sistem prej 30 fonemash bashkëtingullore: në këtë të folme gjendet fonema (një bashkëtingullore hundore-grykore). Kjo bashkëtingëllore ka të njëjtin përdorim në të gjitha lagjet dhe fshatrat e kësaj krahine. Pra e folmja e Martaneshit dallon nga gjuha standarde në sistemin e fonemave

bashkëtingëllore vetëm nga fonema (ka a “kënga”, ma a “mëngë”, la “lëng”, shtër oj “shtërngo” etj.

Fonema (ngushtë, kungull, trung, lëng) del edhe në të folmen e Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit, ndërsa në të folmen e Klosit dhe Dibrës kjo bashkëtingëllore nuk del.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 15.a, f. 97.

Në rrjedhë të kohës, në ligjërimin e kësaj të folmeje janë përfutur një varg ndërrimesh të fonemave me njëra-tjetrën.

1. Bashkëtingullorja /h/ ruhet mirë në fillim të fjalës dhe në trup të saj, kështu kemi: *hāna, hapi (derën), hekër, i he:r, h ni, h , huj, hudhra, vjehrra, plehni, prehën, gjuha, koha, hayat, ha* etj. Në fund të fjalës bashkëtingëllorja /h/ faringale ka pësuar ndërrimin me bashkëtingëlloren /f/ (buzëdhëmbore) në këto fjalë: *njof, shof, ref, rof, (ai) shef, (ju) shifni, kref, krifem, (ai) shifte, i prefët* etj. Kjo dukuri ka prekur edhe huazimet turke dhe siç duket “ka dalë në këtë periudhën e fundit të gjuhës shqipe, mbase duke u nisur prej krahinash qendrore të gegërisë.”<sup>50</sup> Por kjo bashkëtingëllore del edhe në pozicion fundor në fjalët *ah (ahu), krah, gjah* etj.

Kalimi i fonemës /h/ në përbërjen fonemore të fjalës *leh* në *f (lef)* ka ndodhur në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 57.a., f. 182.

Po kështu ka ndodhur edhe me fjalët *shoh, njoh, ftoh*, të cilat në këto zona dalin *shof, ftof, njof*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 57.b., f. 183.

Fonema /h/ në përbërjen fonemore të fjalës *ndihmë* në të folmen e Martaneshit nuk ekziston, pasi fjala del *ni:m*. Po kështu nuk ekziston as në zonën e Klosit, Zerqanit dhe Shëngjinit të Madh, ndërsa në zonat e Dibrës, Elbasanit dhe Belshit del /f/.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 57.c., f. 184.

Në përbërjen fonemore të fjalës *lahem*, fonema /h/ shqiptohet në zonën e Martaneshit, të Klosit, Zerqanit, Elbasanit dhe Belshit, por ajo nuk ekziston në zonën e Dibrës dhe të Shën Gjëngjini të Madh.

---

<sup>50</sup> Shih: E. Çabej, *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, BUSH, SSHSH1, 1958, f. 64-65.

Sot në të folmen e Martaneshit *h*-ja e trajtës pësore ruhet mirë, e pandryshuar: *mahesh, hāhesh, largohi, martohi, thyheshin etj.*

Fonema *h* del edhe para fjalës *eci, (heci)*, një dukuri kjo më fort toske se gege.

2. Fonema /*g*/. Kur gjendet në fillim të fjalës shqiptohet njësoj si në gjuhën standarde (*gojë, grua, gropë, grusht*) në zonën e Martaneshit, të Dibrës, të Shëngjinit të Madh, të Elbasanit dhe të Belshit, ndërsa në të folmen e Klosit del /*J*/ dhe në zonën e Zerqanit del /*gi*/. Në zonën e Zerqanit me *gi* dalin vetëm fjalët *gojë* dhe *gardh*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 58.a., f. 186.

Po kështu ndodh edhe kur fonema /*g*/ ndodhet në mes të dy zanoreve (*luga, zagar, paguaj*). Në zonën e Klosit del *J*, ndërsa në zonën e Zerqanit *gi* (por fjala *paguaj* edhe këtu del me *g*). Ndërsa në zonën e Martaneshit dhe në zonat e tjera del *g*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 58.b., f. 187.

Kur fonema /*g*/ gjendet në pozitë fundore absolute (*zog, burg*) ajo shqiptohet në /*g*/ në zonën e Martaneshit dhe në zonat e tjera, përjashtim bën e folmja e Klosit, ku kjo fonemë del *J*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 58.c, f. 188.

3. Fonema /*q*/ në përbërjen fonemore të fjalëve ku është përfundimi i grupit të vjetër *kl* (*qaj, qumësht, quhem*) del *q* në të gjitha zonat që kemi marrë në shqyrtim.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 59.a, f. 189.

Fonema /*gj*/ në përbërjen fonemore të fjalëve ku është përfundimi i grupit të vjetër *gl* (*gju, zgjua, i gjatë*) del *gj* në të gjitha zonat (por në Martanesh del *zjua*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 59.b., f. 191.

4. Ndërrimi i ndërdhëmbores së pazëshme (*th*) me buzëdhëmboren përkatëse /*f*/, dukuri që përfshin të folme gege dhe toske, ka kapur disa fjalë të caktuara. Janë shqiptime normale në të folmen e Martaneshit me *f* fjalët: *flā<sup>o</sup>nz, fell, i fell etj.*

5. kalimi i *h*-së në *f* është një ndërrim fonemash, që ndodh kur *h*-ja vjen para *t*-së (*i ftoft* <*i ftoht*), por kjo dukuri është shtirë edhe në raste të tjera, ku nuk është e pakushtëzuar fonetikisht, pra nuk lidhet me funksionin e fonemave, of “*njof*”, *nifëm* “*ndihmë*”, *shof* “*shoh*”. Kjo është një dukuri e gegërishtes jugore, ndërsa në

gegërishten veriore kalimi i *h*-së në *f* është një ndërrim fonemash, që ndodh rregullisht kur *h*-ja vjen para *t*-së (*i ftoft* < *i ftoht* ).<sup>51</sup>

6. Ndërrimi i sonantes mesgjuhore *nj* me mesoren *j*. Dikur dialektet në këtë dukuri fonetike nuk largoheshin si sot: bashkëtingëllorja *nj* në shkrimet e vjetra të shqipes ruhej kudo, gjë që tregon se ky tingull në një kohë përdorej gjerësisht në të gjitha të folmet. Në të folmen e Martaneshit sot kjo dukuri është një fenomen i zakonshëm. Përsa i përket kohëve të hershme kjo dukuri në këtë të folme nuk mund të dëshmohet për shkak të mungesës së dokumenteve të shkruara. Bashkëtingëllorja *nj*, qoftë në sistemin foljor qoftë në atë emëror, në pozicionin fundor ka kaluar gjithnjë në *-j* : *brij*, *rrāj*, *zo:j*, *ulkoj*, *thoj*, *piruj*, *shkoj*, *pastroj*, *shtroj*, *bāj*, *mshij*, *gjej*, *bluj*, (*let*) *vi:j*, *t'shkruj*, *zij*, *vuj*, *lu:j*, etj.

a. tek emrat dhe mbiemrat në shumës: *gj :j*, *ftoj*, *thoj*, *ullij*, *barij*, *mullij*, *t'mëdhej* etj.

b. te veta e parë njëjës e kohës së tashme të dëftores: *punoj*, *mbaj*, *bāj*, *gjej*, *vij* etj.

c. te vetat e së pakryerës: *punoje*, *maje* (*mbaja*), *rrije* etj.

Kalimi i fonemës */nj/* në */j/* kur gjendet në një pozitë fundore absolute (*thonj*, *të rinj*) ka ndodhur edhe në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh dhe Elbasanit, ndërsa në zonën e Dibrës kjo fonemë ruhet.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 61.b., f. 194.

Fonema */nj/* kur gjendet ndërmjet dy zanoreve (*gështenja*, *brinja*) në të folmen e Martaneshit del *j* (*gështeja*, *brija*), po kështu del edhe në zonën e Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit, ndërsa në zonën e Klosit, Zerqanit dhe Dibrës del ruhet.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 61.a., f. 193.

Bashkëtingëllorja */nj/* përgjithësisht ruhet në pozicion nistor në këto fjalë: *nja:ty*, *njatje*, *njã°ni*, , *njeri*, *njata*, *njifte* etj. Por kjo bashkëtingëllore është shndërruar në *j* në pozicion nistor në fjalët: *jõni*, *jõni me tjetrin*, sidomos në brezin e vjetër.

*Një* kur është përemër i pacaktuar, sidomos në brezin e vjetër, ka përfunduar në ( gjysmëzanore hundore): *he:r*, *njeri*, *çun*, *i gru:*, *i bu:rr* etj

I njëjti fenomen ndodh edhe në ndërtimet: *t'marr*, *t'dhãn*, *t'shku:* etj.

<sup>51</sup> Shih: J. Gjinari, *Dialektet e shqipes*, Tiranë, 1989, f. 52.

Në të gjithë krahinën e Martaneshit bashkëtingëllorja /nj/ kalon në /j/ kur është pastheksore, qoftë në trup, qoftë në fund të fjalës: *dyyjōja, zoja, rrāja, shipoja, ulkoja* etj.

6. Ndërrimi i fërkimores së shurdhët /s/ me afrikaten /c/: *acosh, aci, cipër, përcipër*. Kjo dukuri vihet re sidomos te brezi i vjetër dhe ndodh në pak fjalë.
7. Vihet re edhe ndërrimi i bashkëtingëllores njëdridhëse me më shumë dridhësen *rr* në këto fjalë: *doktorri, dhānrri, qeverria, vaporri* etj
8. Në pak fjalë ndodh ndërrimi i shtegores së zëshme *z* me afrikaten e zëshme *x* si: *xbrit, kallxoi, rrëxoi*, (edhe *xërroi* me metatezë) etj. Kjo haset kryesisht te brezi i vjetër.

Krahas këtyre ndërrimeve që trajtuam më lart në të folmen e Martaneshit vihen re edhe neutralizime:

- a. Neutralizimi i kundërvënies së zëshmërisë së fonemave bashkëtingëllore të zëshme në fund të fjalës pothuajse nuk haset. Kjo dukuri vihet re në një numër të kufizuar fjalësh si *klup* ( *klub*).
- b. Neutralizimi i kundërvënies së zëshmërisë së fonemave bashkëtingëllore të zëshme para të shurdhëtave. Nga ky fenomen preken bashkëtingëlloret *b, dh, g, gj, z* para bashkëtingëlloreve të shurdhëta *t, k*: *ropt, t'kalpta, nohte* ( *ndodhte* ), *trekti, lakte, niste* ( *ndizte* ) etj. Kjo dukuri ka ndodhur si rrjedhojë e një asimilimi të pjesshëm nga kontakti me një bashkëtingëllore të shurdhët.
- c. Neutralizimi i kundërvënies së të shurdhëtave para të zëshmeve. Janë të njohura rastet e sonorizimit të bashkëtingëlloreve *s, sh, p, f, t* me gjeçjësjet e tyre të zëshme, përkatësisht: *z, zh, v, d*: *mezi* ( *mesi* ), *çezme, z'di, z'du, voda* ( *vota* ), *sonde* etj.

### **Grupet e bashkëtingëlloreve**

Në të folmen e Martaneshit grupet e bashkëtingëlloreve kanë pësuar një varg shndërrimesh të rëndësishme duke sjellë ndonjëherë edhe lindjen e ndonjë foneme të re.

1. Grupi *mb* në të gjithë zonën e Martaneshit ka përfunduar në sonanten dybuzore *m*. Në çdo pozitë të fjalës gjejmë *m*: *mas* ( *mbas* ), *majta* ( *mbajta* ), *mlodha* ( *mbloodha* ), *musha* ( *mbusha* ), *marova* ( *mbarova* ), *mje:ll* ( *mbjell* ), *me:sa* ( *mbesa* ), *mrapa* ( *mbrapa* ), *mrã'm* ( *mbrëm* ), *mret* ( *mbret* ), *m lli* ( *mbylli* ), *musha* ( *mbusha* ), *pam k* ( *pambuk* ), *dhimja* ( *dhimbja* ), *thumi*

(*thumbi*), *dhāmi* (*dhëmbi*), *pl m* (*plumb*), *kā<sup>o</sup>:ma* (*këmba*), *kr m* (*krimb*) etj.

Grupi i bashkëtingëlloreve *mb* (*mbiell*, *kumbull*, *thumb*) nuk ekziston as në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit, në vend të tij del *m*, ndërsa në të folmen e Dibrës grupi *mb* ekziston në të gjitha kushtet fonetike.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 16, f. 99.

2. Grupi *nd* ka përfunduar në sonanten *n*, duke shtuar kështu dendurinë e sonantes *n* në përdorim:

➤ në fillim të fjalës: *ner* (*nder*), *nita* (*ndenja*), *n :m* (*ndihmë*), *i n :t* (*i ndyrë*), *nryshe* (*ndryshe*) etj. Por del edhe një rast ku grupi *nd* ka dhënë *d* në fjalën *da:j* (*ndaj*). Por nëse i drejtohem historisë së gjuhës do thoshnim që *ndaj* > *daj*, pasi *daj* është forma më e vjetër e fjalës pa protezën e *n*-së, kurse *ndaj* është më e re. *Da:j* gjendet edhe në të folmet veriperendimore<sup>52</sup>. Me këtë mund të themi se e folmaj e Martaneshit dëshmon një tipar konservator e jo inovues.

➤ në mes dhe në fund të fjalës: *h na* (*hunda*), *fun* (*fund*), *tu:n* (*tund*), *shkun* (*shkund*), *f :ni*, (*fund*), *v ni* (*vendi*) etj.

Grupi i bashkëtingëlloreve *nd* (*nder*, *këndoj*, *shkund*) nuk ekziston as në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit, në vend të tij del *n*, ndërsa në të folmen e Dibrës grupi *nd* ekziston në të gjitha kushtet fonetike.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 17, f. 100.

3. Grupi *ng* në të folmen e Martaneshit ka përfunduar në , duke sjellë kështu lindjen e një bashkëtingëlloreje të re (sonante prapagjuhore) : *arku* (*ngarkuar*) *u r t* (*u ngrit*) *i rohët* (*i ngrohët*), *kā<sup>o</sup>* (*këngë*), *lō* (*lëng*) etj. Në rastin e fjalës *ka* (*nga*) do thonim se e folmja e Martaneshit dëshmon një tipar konservator, pasi forma *ka* është më e vjetër dhe më afër origjinale (ie. q<sup>u</sup>os) se forma *nga*, e cila ka marrë protezën e një *n*-je.

Grupi i bashkëtingëlloreve *ng* (*ngushtë*, *kungull*, *trung*, *cung*) në të folmen e Klosit del *g*, ndërsa në të folmen e Zerqanit, Elbasanit dhe Belshit grupi *ng* nuk ekziston në të gjitha kushtet fonetike, në vend të tij diku ka *g* ose *k*,

---

<sup>52</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, E folmja e Kastratit, Studime filologjike 2, 1967, f.



në zonën Kala të Elbasanit del *n*. Në zonën e Shëngjinit të Madh, grupi *ng* ekziston në mes dhe në fund të fjalës, në fillim del *g* në vend të grupit *ng*. Ndërsa në të folmen e Dibrës, grupi *ng* ekziston në të gjitha kushtet fonetike.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 18, f. 101.

4. Grupi *ngj* përgjithësisht ka përfunduar në *nj*: *njit* (*ngjit*), *nj j* (*ngjyj*), *njäll* (*ngjällë*), *nj sh* (*ngjesh*). Në rastin e fjalës *gja* (*ngjan*), *i ka gja* (*i ka ngjarë*), mund të themi se kemi të bëjmë me një tipar konservator të kësaj të folmeje, pasi forma *gjaj*, pa protezën e *n*-së, është më e vjetër se *ngjaj*, e cila është më e re me protezën e një *n*-je. Ndërsa te fjala *qij* (*qinj*) kemi dy dukuri të rregullta për të folmen e Martaneshit: e para kthimin e *ngj > nj* dhe e dyta, kthimin e *nj > j*.

Grupi *ngj* (*ngjyey*, *ngjesh*, *ngjall*) nuk ekziston as në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit, në vend të tij ka ose *j*, ndërsa në të folmen e Dibrës, grupi *ngj* ekziston në të gjitha kushtet fonetike.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 19, f. 102.

5. Grupi *fsh* përgjithësisht ruhet në format e foljeve në mënyrën dëshirore, por edhe në disa emra, si: *fshat*, *fshesë*, *gëzofsh*, *rrofsh*, *vofshi e ardhshi shnosh*, *munafsh* (*mëndafsh*) etj. Grupi *fsh* më shpesh ruhet edhe në dëshirore të foljeve, si: *qofsha*, *u bōfsha*, *punofsha*, *v fsha*, *pafsha* etj. Në fjalët *fshe:s* dhe *fshi:j* dhe në fjalët që rrjedhin prej tyre, në vend të bashkëtingëllores buzëdhëmbore /f/ del bashkëtingëllorja dybuzore /m/: *mshe:s*, *mshi:j*, *t'mshime* etj.

Grupi i bashkëtingëlloreve *fsh* (*kofshë*, *lafshë*, *mëndafsh*) ruhet në të gjitha emrat edhe në zonën e Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit, ndërsa në zonën e Dibrës dhe Klosit del vetëm tek emri *mëndafsh*. Ndërsa në format e dëshirores (*punofsh*, *lafsh*, *shkofsh*) grupi *fsh* del në të gjitha rastet.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 23.a.b, f. 107-108.

6. Grupet e vjetra *kl*, *gl* në të folmen e Martaneshit ashtu si në gjuhën standarde kanë dhënë *q*, *gj*: *qan*, *qe:n*, *qoft*, *qumësht*, *kishë*, *gjunha* (*gjuha*), *ngjón* (*dëgjon*), *i gja:t*, *i gjā:n*, *gjobë* (por *gishti*, *gemi* (*gjemb*))
7. Grupi bashkëtingëllor *tj* është ruajtur: *shtje:rr*, *tjegull*, *tjetri*, *tu atjeta* etj.

8. Grupi *dj* nuk ka pësuar ndryshime: *djali, djathi, djersa, djepe, djegin* etj.

Grupet e bashkëtingëlloreve *tj* dhe *dj* (*tjerr, i djathtë*) nuk ekzistojnë në të folmen e Klosit, Zerqanit dhe Dibrës, në vend të tyre ka përkatësisht *c* dhe *J* ( - ), ( - ) etj. Ndërsa në të folmen e Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit këto grupe bashkëtingëlloresh ekzistojnë.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 20, f. 103.

9. Grupet *bl, pl* ruhen si të tilla në këtë të folme: *bleta, bleva, blova, plaçkë, plak, plasi, plaç, plōns, plep, plesht, plis, plug, pluhën, plot* etj.

Grupet *bl, pl* (*ble, plak*) ruhen edhe në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit, Belshit, ndërsa në të folmen e Dibrës del përkatësisht *bj, pj*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 22.a dhe 22.b., f. 105.

10. Grupi *fl* ruhet si i tillë: *flak, fla:k, flori, flutur, fle, fleta* etj.

Grupi i bashkëtingëlloreve *fl* (*fle*) ruhen edhe në të folmen e Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit, Belshit, ndërsa në të folmen e Dibrës del *ff*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr.22.c, f. 106.

## Morfologjia

Në këtë kapitull, do të ndalemi kryesisht në të gjitha kategoritë morfologjike, duke dhënë edhe tabelat përkatëse të lakimit të kategorive emërore dhe të zgjedhimit të foljeve. Duke qenë se dialektet shihen në prerjen e sotme kohore, si pikënisje për krahasim kemi marrë gjuhën standarde. Natyrisht, do të ndalemi në ato dukuri që janë specifike për të folmen e Martaneshit dhe paraqesin interes gjuhësor, dialektor, pa lënë mënjanë edhe dukuritë e tjera që janë të përbashkëta me gjuhën standarde. Për këtë ne mbështetemi në tekstin akademik "*Gramatika e gjuhës shqipe 1*"<sup>53</sup>.

## Emri

### Gjinia

Në të folmen e krahinës së Martaneshit krahas emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore, ka edhe emra të gjinisë asnjësore.

1. Dalin në gjininë mashkullore emrat:

- A. Emrat që mbarojnë në të pashquarën me zanore të *theksuara a, e, i, y: ka:u, va.u, be:u, shiu, njeriu, bariu, miu, s ni, etj* (por *dheja*)
- B. Emrat që mbarojnë me *-xhi, -çi: baltaxhi-u, duhanxhi-u, teneqexhi-u, sherraxhi-u, zanatçi-u, etj*
- C. Të gjinisë mashkullore janë edhe emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore dhe marrin mbaresën *-i: zall-i, gur-i, yll-i, di:ll-i, qi:ll-i, mōn-i, tl n-i, rr p-i, saç-i, kovaç-i, etj.*, (por *pylla*)

Në të folmen e Martaneshit në gjininë femërore dalin të gjithë emrat që në të pashquarën mbarojnë me *-e* të patheksuar, por në të shquarën kjo *e* bie: *xhezme - zhezmeja, shiltja, qibritja (shkrepsja), resmja (fotografi), bezja, rrezja, mezja, qimja, qyqja, penxherja etj.* Dalin në gjininë femërore edhe disa emra, të cilët mbarojnë me zanoret *a, e, i* të theksuara: *hata-ja, re-ja, tabaka-ja etj.*

Emrat që mbarojnë me grupet *ër, ël, ëll, ën*, që në të shquarën iu bie *ë-ja*, janë të gjinisë femërore: *hasë-ra, sofë-ra, sumë-lla, mjekë-ra etj.*, por *suklli*.

Janë të gjinisë femërore emrat: *pa:l-a, ba:rr-a, me:s-a, kulle:s-a, bo:ll-a etj*

Disa emra që në të folme të tjera të gegërishtes e të toskërishtes janë të gjinisë mashkullore, në Martanesh dalin të gjinisë femërore, si psh.: *tela (u kput tela), tulja (tulja*

<sup>53</sup> Shih: GA, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë 1995.

*e mishit), dru:-ja, koll-a, gjeth-ja, py:ll-a, ner:-ja (secili e ma nerjen për vete), turp-ja, shnet-ja etj.*

Ashtu si edhe në gjuhën standarde edhe në të folmen e kësaj krahine, gjinia asnjane sa vjen e po ngushtohet, është reduktuar në një numër të kufizuar fjalësh.

Disa emra që shënojnë lëndë në këtë të folme ruhen si asnjane në brezin e vjetër. Por edhe këtu nuk janë të pakta rastet kur krahas këtyre formave, të njëjtat fjalë përdoren edhe në gjininë mashkullore: *djadhët (djatht e dhenet), dyllët (dyllët e bletet), dhjomët (dhjomt e lopës), millët, ujt, tl nët (tl nt e lopës), grunët etj*, por thuhet *dhallti*. Siç e theksuam edhe më sipër këta emra dalin edhe në gjininë mashkullore: *djathi, dylli, dhjōmi, milli, tl ni, gr ni etj*. Sot në këtë të folme, me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë, në brezin e mesëm dhe të ri këta emra janë kthyer në gjininë mashkullore. Kthimi i këtyre emrave në gjininë mashkullore është dukuri e të folmeve jugore të gegërishtes, të cilët në trajtën e shquar kanë ruajtur si fundore të temës bashkëtingëlloren *t*, që ka qenë mbarese shquese e asnjanesit, p.sh.: *ujti „uji“, dhallti „dhalli“*.<sup>54</sup>

Gjinia asnjane ruhet ende:

- a. në pak emra të nyjshëm, që kanë dalë nga emërzimi i mbiemrave përkatës: *t'leshtat, t'fthtit, t'zit* (por *e verdha, e bardha*) etj.
- b. në disa emra të nyjshëm prejfoljor që kanë dalë nga emërzimi i pjesoreve, si: *t'vjelltit, t'folmit*, por këta emra hasen edhe si *e vjellmja, e folmja, e dalmja etj*.

Në gjininë e emrave vëmë re ndryshime e veçori dialektore edhe në zonat përreth Martaneshit.

Gjinia e emrit *ujë*. Ky emër ruhet si asnjane në brezin e vjetër të folësve në Martanesh. Edhe në zonat 91 (Klos), 92 (Zerqan), 93 (Dibër), 96 (Shëngjin i Madh), 99 (Elbasan), 108(Belsh) ky emër ruan gjininë asnjane.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 139, f. 209.

Emrat *mish* dhe *lesh* dalin në gjininë asnjane në zonën e Martaneshit dhe të Klosit, ndërsa në zonat 92, 93, 96, 99, 108 dalin në gjininë mashkullore.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 68/2, 68/4, f. 210, 212.

Emri *djathë* e ruan gjininë asnjane vetëm në zonën e Martaneshit, ndryshe nga zonat e tjera, ku del në gjininë mashkullore.

<sup>54</sup> Shih: J. Gjiniari, Gj. Shkurtaç, Dialektologjia, Tiranë, 2003, f. 213.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 68/3, f. 211.

Ndërsa emri *mjaltë* del në gjininë mashkullore në të gjitha zonat.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 68/6, f. 214.

Gjinia asnjëse në zonën e Martaneshit ruhet ende në emrat e veprimit prejfoljor: *të ftohtët, të nxehtët, të vjellët*. Emri *të ftohtët* del në gjininë asnjëse edhe në zonat 91, 92, 93, 96, 99, 108, ndërsa emri *të nxehtët* në zonat 96, 99 del në gjininë femërore, në zonat 91, 98, 108 ky emër nuk ekziston. Në zonën e Martaneshit dhe të Zerqanit ky emër del në gjininë asnjëse. Në zonën e Martaneshit, krahas fjalës *të nxehtët* përdoret edhe fjala *eg*, si dhe fjala *va:p*. Gjinia e emrit *të vjellët* del asnjëse në të folmen e Martaneshit, të Dibrës, të Elbasanit dhe të Belshit, ndërsa në zonën e Klosit, të Zerqanit dhe të Shëngjinit të Madh del në gjininë femërore.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 69, f. 216.

Në Martanesh emri *të vjelltit* dëgjohej te brezi i vjetër, ndërsa te brezi i mesëm dhe ai i ri kjo fjalë del në gjininë femërore (*e vjellmja*).

Gjinia e fjalës *shëndet*, ndryshe nga zonat 91, 92, 93, 96, 99, 108 ku del në gjininë mashkullore, në Martanesh del në gjininë femërore, kryesisht tek brezi i vjetër, siç dalin edhe fjalët *tela, tulja, druja, kolla, pylla, nerja, turpja, shnetja* etj.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 70.a., f. 217.

Për kategorinë e gjinës së numërorit *dy* në të gjitha zonat ka dy forma: njëra me zanoren *y* të shkurtër për gjininë mashkullore dhe një tjetër me zanoren *y* të gjatë për gjininë femërore (*dy-dy:*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 90.a., f. 270.

Ndërsa për kategorinë e gjinisë së numërorit *tre*, në zonën e Martaneshit dhe në zonat 91, 92, 93, 99, 108 ka dy forma: një për gjininë mashkullore me zanoren *e* dhe një tjetër për femëroren me *i* (*tre-tri*). Përfundim bën pika 96, ku del vetëm një formë e përbashkët si për gjininë femërore ashtu edhe për gjininë mashkullore (*tre*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 90.b., f. 271.

## Trajta

Sikurse në gjuhën standarde, edhe në të folmen e Martaneshit, emrat mashkullore, të cilëve iu mbaron tema në të pashquarën me *k, g, h* kur shquhen marrin mbaresën *-u*: *çelik-u, brisk-u, pamuk-u, mik-u, plak-u, zog-u, breg-u*, (por *krah-i* në brezin e vjetër).

Mbaresa shquese tek emrat mashkullorë që u mbaron tema me *k* ose me *g* (*miku, zogu*) del *u*, si në të folmen e Martaneshit, ashtu edhe në të folmen e Klosit, Zerqanit, Dibrës, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 87, f. 265.

Ndërsa mbaresa shquese tek emrat mashkullorë njëjës që u mbaron tema me bashkëtingëlloren *h* (*krahu*) në zonën e Martaneshit dhe në zonat 91,92,93,96,108 del *-i*, përjashtim bën zona 99, pasi mbresa del *-u*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 88, f. 266.

Emrat mashkullorë që mbarojnë me zanoret *i, u, y* hundore të theksuara, kur shquhen marrin mbaresën *-i* duke e rinxjerrë bashkëtingëlloren e temës *-n*, e cila ka shkaktuar hundorësinë dhe në të pashquarën ka rënë: *h -ni, br -ni, dr -ni, l -ni, dr -ni* (edhe *druja*) por *tl n-i, gr -ni*.

Disa emra që në të pashquarën dalin me zanoren e gjatë *-u*, që rrjedh nga monoftongimi i *ua/ue* në *u*, në të shquarën e rinxjerrin zanoren e temës *-o* nga e cila rrodhi togu *-ua/-ue*, por nuk nuk e nxjerrin bashkëtingëlloren e temës *-n*, siç ndodh përgjithësisht në të folmet e veriut: *ftu:- ftoi, kru: kroji, patku:- patkoi, sapu:- sapoi* (*capu-capoi te brezi i vjetër*), *thu:-thoi etj*

Emrat mashkullorë që mbarojnë në të pashquarën me *-ur,-ull* (*uer,uell*) kur shquhen ruajnë mirë temën e trajtës së pashquar dukë marrë mbaresën *-i*: *bu:ll-i, krāhonur-i* “*kraharori*”, *laknu:r-i, trull-i etj*.

Emrat që mbarojnë me një *-o* të patheksuar në të shquarën marrin *-ja*, duke dalë para mbaresës shquese *-a* një *j*, siç duket antihiatizuese dhe duke rënë zanorja *o*: *depo-depja, radjo-radja, koho-kohja*. Përgjithësisht në këtë të folme, emrat femëror që mbarojnë me një *e* të patheksuar, kur shquhen e humbasin *e*-në dhe marrin *-ja*: *vorbe-vorbja, nuse-nusja, xhezme-xhezma, lule-lulja etj*.

Emrat femërorë, të cilëve u mbaron tema në të shquarën marrin mbaresën *-a*, duke e humbur zanoren *-ë*: *gjuhën – gjuhë, grafëm – grafma, tavëll – tavlla, vetëll – vetlla, hasër – hasra*.

## Rasa

Lakimi i parë

trajta e pashquar

E. mal

GJ. mal-i

DH. mal-i

K. mal

Rr. mal-i

trajta e pashquar

E. mal-i

Gj. malit

Dh. malit

K. mal-n

Rr. mal-it

Siç shihet nga pasqyra e lakimit, në të folmen e Martaneshit ruhet forma e moçme e kallzores me mbaresën **-n(ë)** tek emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore. Ndërsa në të gjitha të folmet veriore dhe ato të Beratit, Myzeqesë dhe të Mallakastrës shihet një formë më e re, në të cilën ndërmjet temës së emrit dhe mbaresës del sipas rastit zanorja *i* ose *u* (*malin, detin, plakun*), në të folmet e tjera jugore (më tepër në ato fshataret) kjo formë del me mbaresën **n(ë)** të vendosur drejtpërsëdrejti pas temës së emrit (*malnë, gurnë, detnë, plaknë, fiknë*)<sup>55</sup>.

Morfema-mbaresë në formën e rasës kallëzore të shquar njëjës të emrit *mal/malin* në zonën e Martaneshit del në variantin *ma:ln*, ndërsa në zonat 91, 92, 93, 96, 99, 108 del *malin*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 83.a., f. 258.

Po kështu edhe emrat e tipit *mik, zog* në rasën kallëzore të shquar njëjës në zonën e Martaneshit dalin me variantin *-n(ë)*: *zo:g-n, mi:k-n*, ndërsa në zonat e tjera të cilave u jemi referuar del varianti *-un*: *mikun, zogun*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 83.b., f. 259.

Emri *krah/krahun* në formën e rasës kallëzore të shquar në zonën e Martaneshit del në variantin *krah-in*, ndërsa në zonat 91, 92, 93, 99, 108 del varianti me *-un*: *krahun*, përjashtim bën pika 96, ku del varianti *kran*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 83.c, f. 260.

---

<sup>55</sup> Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 216.

E.	ftu:	E.	fto:i
GJ.	fto-i	Gj.	fto-it
DH.	fto-i	Dh.	fto-it
K.	ftu:	K.	ftu:n
Rr.	fto-i	Rr.	ftoit

E.	zã	E.	zã-ni
GJ.	zãn-i	Gj.	zãn-it
DH.	zãn-i	Dh.	zãn-it
K.	zã	K.	zã:n
Rr.	zãn-i	Rr.	zãn-it

E.	pir	E.	pir n-i
GJ.	pir n- i	Gj.	pir n-it
DH.	pir n-i	Dh.	pir n-it
K.	pir	K.	pir :-n
Rr.	pir n-i	Rr.	pir n-it

E.	h	E.	h n-i
GJ.	h -ni	Gj.	h n-it
DH.	h n-i	Dh.	h n-it
K.	h	K.	h :n
Rr.	h n-i	Rr.	h n-it



Siç shihet nga pasqyra e lakimit, në të folmen e Martaneshit ruhet trajta e vjetër e kallëzores me **-n** (*ftu:n, hu:n, piru:n*) siç del në të folmet e jugut, duke dalluar nga të folmet veriore, ku midis temës së emrit dhe mbaresës **-n** del zanorja *i* (*zanin, pirunin, hunin*), siç duket për analogji me gjinore-dhanoren njëjës të trajtës së shquar.

Emrat e lakimit të parë, ashtu si edhe në gjuhën standarde, dalin në emërore dhe kallëzore të pashquar me mbaresë zero, ndërsa në rastet e tjera ka mbaresën *-i*. Në trajtën e shquar kanë mbaresat *-i, -it* përjashtuar rasën kallzore. Emrat që mbarojnë me zanore të theksuar hundore *a, u, i* e zgjerojnë temën me *-n* që në trajtën e shquar ka rënë.

Në rasën kallëzore të shquar, emrat që mbarojnë me zanore të theksuar hundore me trajtat me *-n*, shtuar pandërmjetshëm temës së rasës emërore të trajtës së pashquar, një formë kjo më e vjetër e kallëzores: *pir :n, kall :n, sap :n, ull :n, dr :n, br :n*.

Emrat të cilëve u mbaron tema, në rasën emërore të trajtës së pashquar me zanoren *-u* të gjatë, rrjedhur nga monoftongimi i *ua/ue*, në rasat e zhdrejta, qoftë në të pashquarën qoftë në të shquarën e kthejnë në *o* në të folme të tjera të Shqipërisë së Mesme.<sup>56</sup>

#### Lakimi i dytë

##### trajta e pashquar

E. fik

Gj. fik-u

Dh. fik-u

K. fik

Rr. fik-u

E. ka

Gj. ka-u

Dh. ka-u

K. ka

##### trajta e shquar

E. fik-u

Gj. fik-ut

Dh. fik-ut

K. fik-n

Rr. fik-ut

E. ka-u

Gj. ka-ut

Dh. ka-ut

K. ka:-n

<sup>56</sup> Shih: M. Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*, SF, 4, 1965, f. 105, *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës*, SF, 2, 1966, f. 138.

Rr. ka-u

Rr.. ka-ut

E. m

E. m -u

Gj. m -u

Gj. m -ut

Dh. m -u

Dh. m -ut

K. m :

K. m :n

Rr. m -u

Rr. m -ut

E. s

E. s -ni

Gj. s -ni

Gj. s -nit

Dh. s - ni

Dh. s -nit

K. s

K. s .-n

Rr. s -ni

Rr. s -nit

E. dhe

E. dhe-ja

Gj. dhe-je

Gj. dhe-s

Dh. dhe-je

Dh. dhe-s

K. dhe

K. dhe:-n

Rr. dhe-je

Rr. dhe-s

Edhe në lakimin e dytë veçori për të folmen e Martaneshit është ruajtja e trajtës së vjetër të kallzores me *-n*, shtuar pandërmjetshëm temës së rasës emërore të emrave që mbarojnë në të shquarën me zanore të theksuar.

Rasa emërore dhe kallëzore në të pashquarën nuk kanë mbaresë, kurse në rasat e tjera kanë mbaresën *-u*, në të pashquarën marrin mbaresat *-u*, *-ut*. Edhe në lakimin e dytë është ruajtur trajta e vjetër e kallzores me *-n* shtuar pandërmjetshëm temës së rasës

emërore të emrave që mbarojnë në të pashquarën me zanore të theksuar: *a, i, u, y, si mi:n, qiri-n, vlla-n etj.*

Varianti i morfemës-temë në formën e rasës kallëzore të shquar njëjës të emrit *dhe, dheun, dhenë* në zonën e Martaneshit del *ðe:n*. Po kështu del edhe në zonat e tjera që kemi në vëmendje, përveç pikës 93, për të cilën nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 82.a., f. 255.

Emrat e tipit *hu, mulli* në formën e rasës kallëzore të shquar njëjës në zonën e Martaneshit dalin *hu:n, mulli:n*, po kështu dalin në zonën 91, 96, 99 dhe 108. Ndërsa në zonat 92, 93 dalin përkatësisht *hunin, hurin*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 82.b., f. 256.

Edhe emri *sy* në zonën e Martaneshit në kallëzore del *sy:n*, po kështu edhe në zonat 96, 99, 108. Në zonën 91 del *sø:n*, në zonën 92 del *syun*, ndërsa në zonën 93 del *syrin*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 82.c., f. 257.

Lakimi i tretë

E. fu:sh	E. fush-a
Gj. fush-e	Gj. fushë-s
Dh. fush-e	Dh. fushë-s
K. fu:-sh	K. fushë-n
Rr. fush- e	Rr. fushë-s
E. dele	E. delja
Gj. del-j-e	Gj. dele-s
Dh. del-j-e	Dh. dele-s
K. dele	K. dele-n
Rr. del-j-e	Rr. dele-s

E.	motër	E.	motr-a
Gj.	motr-e	Gj.	motrë-s
Dh.	motr-e	Dh.	motrë-s
K.	motër	K.	motrë-n
Rr.	motr-e	Rr.	motrë-s

Në emëroren dhe kallëzoren e njëjësit të pashquar, emrat e lakimit të tretë dalin me mbaresë zero, ndërsa në rasën gjinore, dhanore dhe rrjedhore marrin mbaresën *-e*. Emrat femërorë që mbarojnë me *-e* të patheksuar, në rasën gjinore, dhanore, rrjedhore, në trajtën e pashquar midis temës e mbaresës marrin për lehtësi shqiptimi *-j*. Ndërsa në trajtën e shquar emrat e lakimit të tretë marrin mbaresat *-a, -s, -n*.

#### Lakimi i katërt

E.	t'ftohtë	E.	t'ftohti
Gj.	t'ftohti	Gj.	t'ftohtit
Dh.	t'ftohti	Dh.	t'ftohtit
K.	t'ftohtë	K.	t'ftohtin
Rr.	t'ftohti	Rr.	t'ftohtit

Emrat e lakimit të katërt dalin në emërore dhe kallëzore, të pashquar, me mbaresën zero, ndërsa në rastet e tjera kanë mbaresën *-i*. Në trajtën e shquar kanë mbaresat: *-i, -t, -in*.

#### Lakimi i emrave në numrin shumës

E.	miq	E.	miq-t
Gj.	miq-ve (miqe)	Gj.	miq-et
Dh.	miq-ve (miqe)	Dh.	miq-et
K.	miq	K.	miq-t
Rr.	miq-sh (miq-ve)	Rr.	miq-sh

Veçori për të folmen e Martaneshit është gjinorja-dhanorja e trajtës së shquar pa *v*-epentetike: *dhamët e pleqet, gishtat e duret, dhoma e miqet* etj. Kështu variantet e

morfemës-mbaresë në formën gjinore-dhanore shumës të emrave që në rasën emërore mbarojnë me bashkëtingëllore *dhenve, pleqve* etj., në Martanesh dalin me *-e* (pra *dhen-e, pleq-e*), por në brezin e ri nuk mungon edhe morfema-mbaresë *-ve*. Kjo formë ruhet ende në të folmet jugore, që ndodhen në jug të Osumit dhe në një masë më të kufizuar edhe në disa të folme të izoluar malore të Shqipërisë së Mesme.<sup>57</sup>

Duke e krahasuar me pikat e ADGJSH-së që kemi marrë në shqyrtim vëmë re se në edhe në pikat 91 dhe 108, varianti i morfemës-mbaresë në gjinore-dhanore del *-e*, ndërsa në zonat 92, 99 ekzistojnë të dy variantet *-e/-ve*. Në zonat 93 dhe 96 kjo morfemë-mbaresë del në variantin *-ve*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 81, f. 254.

E.	mal-e	E.	male-t
Gj.	male-ve	Gj.	male-ve
Dh.	male-ve	Dh.	male-ve
K.	mal-e	K.	male-t
Rr.	mal-esh	Rr.	mal-esh
E.	lule	E.	lule-t
Gj.	lule-ve	Gj.	lule-vet
Dh.	lule-ve	Dh.	lule-vet
K.	lule	K.	lulet
Rr.	lulesh (luleve)	Rr.	lule-sh

Rrjedhorja shumës del me trajtën e vjetër *-sh*. Në këtë të folme, trajta me *-sh* përdoret, përgjithësisht, kur emri është pa parafjalë dhe kur kryen funksion përcaktori: *erë lulesh, hije fiqsh, bari gjash, rraqe çunash, kasolle qensh* etj.

Në Martanesh vazhdon të ruhet e ashtëquajtura rasë vendore. Forma rasore e emrave të pashquar njëjës të shoqëruar me parafjalët *në, nën* etj. del *n'malt, n'kafet, n'pyll t etj*. Po

<sup>57</sup> Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 217.

kështu del edhe në zonat 91, 93, 99, 108. Ndërsa në zonat 92 dhe 96 dalin të dy variantet *n malt/n mal*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 85, f. 263.

Rasën vendore e ruajnë të folmet që ndodhen midis lumenjëve Mat dhe Vjosë (Shqipëria e Mesme dhe Toskëria Veriore).<sup>58</sup>

## Numri

E folmja e Martaneshit, ashtu si në mbarë gjuhën shqipe, njih dy numra: njëjësin dhe shumësin, por ka edhe emra që përdoren vetëm në njëjës, si: *shelqer*.

Më poshtë po japim shumësin e disa emrave në të folmen e Martaneshit duke i krahasuar me zonat përreth.

Shumësi i emrit *gardh/gardhe* në zonën e Martaneshit del *gjerdhe*, po kështu edhe në zonën e Klosit, të Elbasanit dhe të Belshit. Ndërsa në zonën e Zerqanit, të Dibrës dhe të Shëngjinit të Madh ky emër e bën shumësin *gardha*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 80.d., f. 252.

Shumësi i emrit *vëlla/vëllezër* në zonën e Martaneshit del *v az n*, po kështu edhe në zonat 91, 92, 93, 96, 99, ndërsa në zonën 108 del *v ez n*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 80.dh., f. 253.

Shumësi i emrit *jetim/jetimë* në Zonën e Martaneshit del *jetima*, po kështu edhe në zonat 91, 92, 96. Në zonën 99 shumësi i këtij emri del *jeti:m*, ndërsa në zonën 108 del *jetim* .

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 71.d/1, f. 225.

Mjetet që përdoren për të formuar shumësin në të folmen e Martaneshit janë:

- a. prapashtesat trajtëformuese.
- b. nga ndërrimi i tingujve të temës.
- c. nga ndërrimi i tingujve të temës dhe prapashtesa njëkohësisht.
- d. gjatësia e zanores së temës.

---

<sup>58</sup> Shih: J.Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 216-217.

## Shumësi i emrave mashkullorë

1. Shumë nga emrat mashkullorë e formojnë shumësin me mbaresën *-a*: *burr-a, çekiç-a, demel-a, kazôn-a, napolôn-a, çun-a, gisht-a, th m-a, msus-a (msojsa), spec-a, viç-a, jetim-a, lômsh-a, top-a, jargon-a, derr-a, çels-a, stol-a, shofer-a, oficer-a, film-a etj.*
2. E formojnë shumësin me mbaresën *-e* emrat: *pus-e, gabim-e, ushqim-e, dyqãn-e, fustãn-e, mal-e, s n-e, shtet-e, them l-e, zakôn-e, simite, peshqir-e etj*
3. Emrat që mbarojnë me zanore të theksuar hundore *e, i, u* gjatë lakimit në njëjës, nxjerrin bashkëtingëlloren *-n* para mbaresës *-i*, shumësin e formojnë me prapashtesën trajtëformuese *-j*, *kushuri – kushurij, m – m j, ull – ull j, h – h j, gj – gj :j (por p – p -na, fr – fr -na, br – br -na, ,* ku bashkëtingëllorja *-n* që del para mbaresës gjatë lakimit në njëjës ruhet në formën e shumësit.) Prapashtesën *-j* e marrin edhe emrat që dalin me zanoren *-u* të theksuar, ardhur përgjithësisht nga monoftongimi i togut *ua/ue*: *prru: - prrej, kru: - kroj, thu: - thoj, ftu: - ftoj, zgju: - zgjoj, patku: - patkoj, sapu: - sapoj, gj : - gj j.*
4. Një tip të veçantë përbën shumësi me palatalizimin e bashkëtingëlloreve prapagjuhore *k, g në q, gj*, ku dallohen këto raste:
  - a. shumësi vetëm me palatalizimin e bashkëtingëllores fundore: *mik – miq, peshk – peshq, uk – uq, zog – zogj.*
  - b. Shumësi me palatalizimin e bashkëtingëllores *k* në *q* dhe *g* në *gj* dhe me prapashtesën *-e*: *gjak – gjaqe, brisk – brisqe, dushk – dushqe, shelg – shelgje, burg – burgje, lōng – lōngje.*
  - c. me palatalizim të bashkëtingëllores fundore, me metaforizim të zanores së temës dhe me prapashtesën *-e*: *lak – leqe, shteg – shigje.*
  - d. me palatalizimin e bashkëtingëllores fundore dhe me ndërrimin e zanores së temës *a-e*: *plak – pleq*
5. emrat mashkullorë që mbarojnë me bashkëtingëlloren *ll* e bëjnë shumësin me:
  - a. vetëm palatalizim të bashkëtingëllores fundore në *j*: *mashkull – mashkuj, trull – troje, thnill – thnij*
  - b. me mbaresën *-a*: *portokall – portokalla, hamall – hamalla*

- c. palatalizimin e bashkëtingëllores *ll* në *j* dhe me prapashtesën *-e*: *pyll – pyje, yll – yje*.
6. Marrin mbaresën e shumësit *-na* emrat: *barna, brina, pena*.
7. Shumësi i formuar me ndërrimin e tingujve të temës (ka edhe raste kur shoqërohet me prapashtesa): *djal – djelm* (shumësi *djelm* del si në shqipen e moçme, ndryshe nga gegërishtja e Shqipërisë së Mesme dhe toskërishtja, ku shumësi del *djem*), *dash – desh, sjap – sjep, kulaç – kuleç, kunat – kunetën, thes – tha:s, thelb – thalb* (shumësi *thalb* është më i vjetër, *thalbe-gegërisht*, ndërsa në toskërisht del *thelpinj*). Në disa raste tema në shumësi ka pësuar ndryshime të mëdha në formën e saj tingullore, madje edhe në përbërje fonetike krejt të ndryshme. Në raste të tilla kemi metafonizim e palatalizim : *ka: - qe*; metaforizim, palatalizim dhe prapashtesë: *kopësht – qepshtije, qij (qengj) – shtjerra, dele – dhen etj*
8. E formojnë shumësin me prapashtesën *-z* emrat: *kalli – kallëz, njeri – njerëz*
9. Në disa emra shumësi me njëjës in dallohen vetëm nga gjatësia e zanores së temës se në shumësi është më e gjatë: *fishek – fishe:k, jelek – jele:k, ibrik – ibri:k, ushtar – ushta:r, japrak – japra:k, jatak – jata:k*.

### Shumësi i emrave femërorë

Në formimin e trajtave të shumësit të emrave femërorë, vendin kryesor e zë prapashtesimi. Shumica e emrave femërorë e formojnë shumësin me prapashtesën *-a*. E marrin prapashtesën *a*:

1. emrat femërorë që mbarojnë me bashkëtingëllore: *got-a, govat-a, pul-a, gjilpān-a, km sh-a, dhōm-a, set-a, cuc-a, bullic-a, tezg-a etj*.
2. emrat femërorë që mbarojnë me grupet *-ël, -ëll, -ër*: *tjegëll – tjegëlla, gogël – gogëlla, motër – motra, hudhër – hudhra etj*
3. emrat që mbarojnë me zanore të theksuar: *kusi: - kusia, tepsi: - tepsia, qershii – qershija*.
4. Shumësin e njëjtë me njëjës in e kanë emrat:
  - a. që mbarojnë me zanoren *-e* të pathksuar: *akullore – akullore, patate – patate, dele – dele, faqe – faqe, tenxhere – tenxhere, penxhere – penxhere, lule – lule, , kasolle – kasolle, qeleshe – qeleshe*



- b. disa emra që mbarojnë me bashkëtingëllore: *kām – kām, qe:p – qe:p, mo:ll – mo:ll, lo:p – lo:p, shka:ll – shka:ll* etj. në të folmen e Martaneshit ka disa emra që përdoren vetëm në njëjës ose vetëm në shumës. Të tillë janë:

1. Emra që përdoren vetëm në njëjës

- a. emra abstraktë: *trimni, dashnia*.
- b. emra përmbledhës: *grania, burrnia*.
- c. emra që tregojnë lëndë në formën e një tërësie të pandashme e të panumërueshme: *djath, qumësht, tl n, mjalt* etj.
- d. emra që shënojnë dukuri atmosferike: *shi, breshën, br m, va:p* etj.

2. Emra që përdoren vetëm në shumës

- a. emra që shënojnë veshmbathje: *shallvare, tesha, muros* etj.
- b. emra që shënojnë ushqime: *makar ne*.

## Nyja

E folmja e Martaneshit përdor nyja të caktuara dhe nyja të pacaktuara. Si nyjë e pacaktuar shërben *nj* me trajtën më të shpeshtë *i: i gu:r, i fmi, i ma:c, i go:c, i he:r, i go:t, i fshe:s, i co:p, i bu:k*, etj; me trajtën *nji* hasen përdorimet te brezi i mesëm dhe ai i ri, por nuk mungojnë rastet kur edhe tek këta të fundit haset trajta me *i*.

Si nyja të përparme e folmja e Martaneshit sikurse edhe gjuha standarde, përdor ato që qëndrojnë:

- a. para mbiemrit: *i mi:r, i keq, i drejt, i vujtshëm, e lame, e thame, e shkunme* etj.
- b. para emrave në gjinore: *i shpis, i arës, i motrës, i kat nit, i dyjës, i kōmshiut* etj.
- c. para emrave prejpjesor: *të ftohtit, të folmit*.
- d. para disa përemrave: *i at ne, i asaj, i atij* etj.
- e. para numërorëve që tregojnë tërësi: *të dy, të shtat* etj.
- f. para emrave të ditëve të javës: *e hā:n, e mku:rr, e shut:n* etj.

g. para emrave që tregojnë marrëdhënie farefisnie: *e motra, i jati, i vllaj, e kushr na etj.*

Pasqyra e lakimit të nyjave

Gj. mashkullore

E.	i mik i mir	miku i mir
Gj.	të miku t' mir	mikut t' mir
Dh.	të miku t' mir	mikut t' mir
K.	të mik i mir	mikn e mir
Rr.	të miku të mir	mikut t' mir

Gj. femërore

E.	e nuse e mir	e nusja e mir
Gj.	të nusje t' mir	së nuses së mir
Dh.	të nusje t' mir	së nuses së mir
K.	të nuse t' mir	e nusen e mir
Rr.	të nusje t' mir	së nuses së mir

Shumës

malet e nalta	fushat e vogla
maleve të nalta	fushave të vogla
valeve të nalta	fushave të vogla
malet e nalta	fushat e vogla
malesh të nalta	fushave të vogla

Në numrin njëjës të gjinisë mashkullore, në rasën kallëzore, nyja del me dy trajta, *-të* dhe *-e*. Trajta *të* del atëherë kur mbiemri vjen pandërmjetshëm pas një emri të pashquar, përndryshe del *e*. Në gjininë femërore, nyja del me dy trajta në gjinore, dhanore, rrjedhore: *të*, *së*. Edhe këtu trajta të del kur vjen pandërmjetshëm pas një emri të pashquar, përndryshe përdoret trajta *së*. Në numrin shumës të shquar nyjat e mashkullores dhe femërores janë të njëjta, emërorja dhe kallëzorja kanë të njëjtën trajtë *e*, kurse rastet e tjera *të*.

Për dallimin e gjinisë tek mbimerat e ardhur nga pjesorja e foljeve me zanore në temë (*i larë~e larë*), si në Martanesh, ashtu edhe në zonat e tjera që kemi në vëmendje, shërben nyja e përparme, si dhe mbaresa: *i la:m – e lame*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 86, f. 264.

Mbarsa shquese e emrit dhe nyja e përparme e mbiemrit përbërës në një togfjalësh të tipit *lopa e kuqe* në zonën e Martaneshit, të Zerqanit, të Dibrës del si në gjuhën standarde: *lopa e kuqe*, ndërsa në zonën e Klosit del *lopæ: kuqe*, në zonën e Shëngjinit të Madh del *lopa kuqe*, ndërsa në zonën e Belshit del *lope kuqe*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 89.a., f. 268.

Për kategorinë e gjinës së numërorit *dy* në të gjitha zonat ka dy forma: njëra me zanoren *y* të shkurtër për gjininë mashkullore dhe një tjetër me zanoren *y* të gjatë për gjininë femërore (*dy-dy:*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 90.a., f. 270.

Ndërsa për kategorinë e gjinisë së numërorit *tre*, në zonën e Martaneshit dhe në zonat 91,92,93,99,108 ka dy forma: një për gjininë mashkullore me zanoren *e* dhe një tjetër për femëroren me *i* (*tre-tri*). Përfundim bën pika 96, ku del vetëm një formë e përbashkët si për gjininë femërore ashtu edhe për gjininë mashkullore (*tre*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 90.b., f. 271.

### **Përemri**

Disa përemra dalin me forma e trajta të dallueshme nga ato të shqipes standarde dhe në disa raste kanë edhe kuptime e përdorime të tjera.

### **Përemrat vetorë**

Përemri vetor në vetën e parë numri njëjës, rasa emërore del *un: un kishje, ene un, thash un, un ishje, un kōm qe:n, un e pastrova* etj. Në rasën dhanore e kallëzore ka trajtën *mu:*,

ndërsa si trajtë të shkurtër *m (ë): m'tha mu:, mu gjin mu (mu gjend mua)*. Ndërsa në rasën rrjedhore, *meje: pri meje, para meje* etj. Në dhanore e kallzore dalin trajtat *ne na: ne na tha:n, ne na çu:n, , nuk na merrte: na majtn*. Në rasën rrjedhore del *nesh: pri nesh, cipër nesh* etj.

Përemri vetor i vetës së parë njëjës në zonën e Klosit, të Zerqanit dhe të Belshit del *un*, në zonën e Shëngjinit të Madh del në dy variante *un/une*, në zonën e Elbasanit del *una*, ndërsa për zonën e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 91.1, f. 272.

Veta e dytë njëjës, rasa emërore ka trajtën *ti: ti je, ti ke, ti e di, e bën ti* etj. Në dhanore e kallzore ka trajtn *ty* dhe trajtën e shkurtër *t(ë): ty t'tha:sh, ty t'la:sh*. Veta e dytë shumës, në rasën emërore ka trajtën *ju*. Në dhanore e kallzore *ju, ju: ju tha ju, e pr : për ju, a ju tha ju se do vonohej. Trajta e rrjedhores del jush: e tha para jush, erdh mas jush*.

Përmeri vetor i vetës së tretë njëjës, gjinia mashkullore, në të gjitha zonat del *ai*, por në zonën e Martaneshit, të Klosit, Zerqanit dhe Dibrës del i theksuar në elementin e parë *ai*. Ndërsa në zonën e Shëngjergjit të Madh, të Elbasanit dhe të Belshit del i theksuar në elementin e dytë. Përemri vetor i vetës s ë tretë njëjës i gjinisë femërore në Martanesh del *aja: aja gru:, aja cu:c* etj. Në zonat e tjera ky përemër dek *ajo*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 91/2, 91/3, f. 273- 274.

Forma e rasës emërore e përemrit vetor të vetës së parë shumës në të folmen e Martaneshit del *na*, po kështu del edhe në zonat 91, 92, 96, ndërsa në zonën 93 del *ne*, në zonën 99 dalin dy forma *na/neve* dhe në zonën 108 del *neve*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr.91.4., f. 275.

Forma e rasës emërore e përemrit vetor të vetës së dytë shumës në zonën e Martaneshit del *ju*, po kështu del edhe në zonat 91,92,96,108, në zonën 93 del *juve*, ndërsa në zonën 99 dalin dy forma *ju/juve*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 91.5, f. 276.

Tabela e lakimit të vetorëve

VI

Njëjës

Shumës

E.	un	ne: na
Dh.	mu: m(ë)	ne na
K.	mu : m(ë)	ne na
Rr.	meje	nesh

## VII

	njëjës	shumës
E.	ti	ju
Dh.	ty: të	ju: ju
K.	ty: të	ju: ju
Rr.	teje	jush

Struktura e trajtës së shkurtër të përbërë nga një përemër vetor i vetës së parë njëjës dhe nga një përemër dëftor i vetës së tretë njëjës del *ma* si në zonën e Martaneshit, ashtu edhe në zonat e tjera. Po kështu, në të gjitha zonat, struktura e trajtës së shkurtër të përbërë nga përemri vetor i vetës së dytë njëjës dhe nga përemri dëftor i vetës së tretë njëjës del *ta*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 92.a., 92.b., f. 277, 278.

### Tabela e trajtave të shkurtra të bashkuara

Dhanore e tri vetave në njëjës e shumës + kallëzore e vetës së tretë njëjës	Dhanore e tri vetave njëjës e shumës + kallëzoren e vetës së tretë shumës
$m + e = ma$	$m + i = m'i$
$t + e = ta$	$t + i = t'i$
$i + e = ja$	$i + i = ja$
$na + e = na e$	$na + i = na i$
$ju + e = jau$	$ju + i = ja u$
$i(u) + e = ja$	$i(u) + i = ja u$

Ndryshe nga e folmja e qytetit të Elbasanit, ku trajta e shkurtër e V III shumës *u* zëvendësohet me trajtën e shkurtër të vetës së tretë njëjës *i*, në të folmen e Martaneshit ky zëvendësim nuk kryhet. p.sh. *u tha at ne, u tha çunave* etj.

### **Përemrat dëftorë**

Në të folmen e krahinës së Martaneshit përdoren këta përemra dëftorë: *aj, aja, ata, njaj, njaja, (i) ky, (i) kja, (i) kta*.

Në të folmen e Martaneshit dalin përemra me pjesëzën përcaktuese *një*, e cila del në formën *i ky, njaja, njata*. Në zonën e Klosit dhe të Zerqanit përemrat dalin me pjesëzën përcaktuese *qe*, përkatësisht *cekø, t eky*. Edhe në zonën 93 dhe 96 ka përemra me pjesëzën *nje* ( *eky, iky, tky* etj). Ndërsa në zonën 99 dhe 108 nuk ekziston kjo kategori, aty ka vetëm përemra dëftorë pa pjesëza përcaktuese.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 93, f. 279.

Përemri i vetës së tretë, numri njëjës i gjinisë femërore *ajo*, në këtë të folme del *aja: aja gru.; aja nuse* etj.

Përemrat *ky, kja, kta* tregojnë persona ose sende që ndodhen afër folësit, ndërsa *aj, aja, njaj, njaja, ata* të cilët shërbejnë si përemra vectorë tregojnë persona ose sende që ndodhen larg folësit.

Në dallim nga gjuha standarde, ku të gjithë përemrat dëftorë kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit dhe rasës, e folmja e Martaneshit bën përjashtim vetëm në përemrin dëftor të V III sh., ku për të dy gjinitë përdoret përemri përemri *ata*, p.sh., *ata burra, ata gra* etj. Përemrat e tjerë kanë forma të veçanta për gjininë mashkullore dhe atë femërore.

Tabela e lakimit të dëftorëve

ky

njëjës

shumës

E. (i) ky kja

(i) kta

Gj. ktij ksaj

ktyne

Dh. ktij ksaj

ktyne

K. kët kët

kta

Rr. ktij ksaj

ktyne

ai		ata
E. aj	(nj)aja	ata
Gj. ati	(nj)asaj	atyne
Dh. (nj)ati	(nj)asaj	atyne
K. (nj)at	(nj)at	ata
Rr. (nj)atij	(nj)asaj	atyne

Shembuj: *erdh i kja plaka, i dhash i ksaj i kët trull, dil pri njasaj dere, it ha ktij, nana e i ktyne, i jep çelsin asaj, pri asaj, m'at kohe etj.*

Edhe te përemri dëftor, sigurisht nën ndikimin e lakimit emëror, format e rrjedhore, pothuajse janë zëvendësuar me format e dhanores. Por, megjithatë format më të vjetra të dëftores në rasën rrjedhore: *kci, aci* dëgjohen në brezin e vjetër: *aci burri je ti, kci pune skām pa etj.*

### **Përemrat pronorë**

Në të folmen e krahinës së Martaneshit pronorët kanë disa veçori dalluese në krahasim me të folmet e tjera të dialektit verior. Në mjaft raste trajta e një rase, zakonisht ajo e kallëzores është shtrirë në të gjithë paradigmen, përjashtuar rasën emërore, e cila në të shumtën e rasteve del si në gjuhën standarde.

Kur prona dhe pronari janë njëjës, në vetën e parë gjinia mashkullore, në të gjitha rasat përemri pronor (përjashtuar emëroren) në bashkëvajtje me emrin ka temën *t m: djalit t m, brezn t m, djalin t m, pri shokut t m, vllait t m*, (por në emërore kemi *djali im, vllai im, kali im* etj.). Përemri pronor në bashkëvajtje me emrin kur prona dhe pronari janë njëjës, në vetën e parë gjinia femërore, ka trajtën *t me* në rasën gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore, p.sh. *vllai i nānës t me, gru:s t me, , gjyshes t me, punën t me*, (por në emërore kemi *halla ime, shoqja ime, motra ime* etj.). Kur pronari është shumës dhe prona njëjës, në vetën e parë gjinia mashkullore, në të gjitha rasat (duke përjashtuar emëroren) përemri pronor në bashkëvajtje me emrin është *to:n: kryetarit to:n, pushtetit to:n, punës to:n, armikut to:n, shkollës to:n*, (ndërsa në emërore del *jo:n*, si p.sh.: *shoku jo:n, armiku jo:n* etj). Të njëjtat trajta përdoren edhe kur prona dhe pronari janë shumës: *durët tona, s t to:n* etj.

Nga veprimi i analogjisë këtu është njëzuar edhe edhe paradigma e pronarit njëjës me atë të pronarit shumës. Analogjia është shtrirë edhe në gjininë femërore, veta e parë, kur pronari është shumës dhe prona njëjës: *t'lagjes to:n, nānës to:n, t'fmis to:n* etj. Kur prona

dhe pronari janë shumë atëherë del trajta *tona: shpijat tona, arat tona, punët tona* etj. Në vetën e dytë, gjinia mashkullore e femërore, kur prona dhe pronari janë njëjës, në rasën emërore del forma *jote: shpija jote, nana jote* etj., ndërsa në rasat e tjera del *tāne*, si p.sh.: *n'shpi tāne, punën tāne* etj.

Si në mbarë të folmet e shqipes edhe në të folmen e Martaneshit përemrat pronorë mund të emërzohen vetëm kontekstualisht, do me thënë e kanë të nënkuptuar emrin. Por edhe kur emërzohen, pronarët nuk e emërtojnë sendin e dhënë, por vetëm e tregojnë atë. Përgjithësisht, si të tillë, përdoren vetëm në trajtë të shquar.

Përemri pronor i emërzuar *imi* ashtu si në të folmen e Martaneshit del pa nyjë të përparme edhe në zonën e Shëngjinit të Madh, ndërsa në zonat 91, 99, 108 del *i imi*; në zonat 92, 93 dalin dy forma *imi/i imi*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 96, f. 282.

V I	kallëzore	shumës
imi	t min	tmi:t
imja	t men	t'mijat
V II		
i joni	tonin	tonët
joti	tonin	t'tu:t
jotja	tānen	t'tu:t

Parandejimi i pronorëve me emra farefisnie është dukuri jo e rrallë. Por edhe para këtyre përemrave përdoren vetëm pronorët e dy vetave të para. Kur lakohen ndryshojnë sipas rasave si përemri ashtu edhe emri.

E.	im at	yt bir	jot bi:
Gj.	tim ati	tyt bir	sat bi
Dh.	tim ati	tyt bir	sat bi
K	tim at	tyt bir	tet bi
Rr.	tim ati	tyt bir	sat bije



Shembuj: *ime motër, im bir, yt at, sime vje:rr, sat ãm, me tèt at, me sat ãm, jot ãm* etj.

Struktura e një togu të përbërë nga një përemër pronor dhe një emër farefisnie në të folmen e Martaneshit del *im bir*, po kështu del edhe në zonat e tjera, përjashtim bën zona e Dibrës, ku ky tog del me strukturën *biri im*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 95, f. 281.

Përemri pronor i emëruar *imi* në të folmen e Martaneshit del pa nyjë të përparme, po kështu del edhe në zonën 96, në zonat 91, 99, 108 del *i imi*, ndërsa në zonat 92, 93 dalin dy forma *imi/i imi*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 96, f. 282.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore, në rasën emërore del *im*. Po kështu del edhe në zonat 91, 92, 96, 108, ndërsa në zonat 93 dhe 99 del *(t)em*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 97/1, f. 283.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore, në rasat e zhdrejta në zonën e Martaneshit del *tem*, po kështu del edhe në zonën 99, në zonën 91 del *tim*, në zonën 92, 96, 108 del *tem*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 97/2, f. 284.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia femërore, në rasën emërore në zonën e Martaneshit del *ime*, po kështu del edhe në zonat 91,92,96,108, ndërsa në zonën 93 del *teme* dhe në zonën 99 del *teme*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 98/1, f. 285.

Përemri pronor i vetës së parë me pronar dhe pronë njëjës, gjinia femërore, në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore (*sime*) në të folmen e Martaneshit del *teme*, po kështu del edhe në të folmen e Elbasanit, ndërsa në të folmen e Klosit del *time*, në të folmen e Zerqanit, të Shëngjinit të Madh dhe të Belshit del *teme*, në të folmen e Dibrës del *teme*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 98/2, f. 286.

Po me të njëjtat variante del edhe përemri pronor i vetës së parë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia femërore në rasën kallzore ( *time*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 98/3, f. 287.

Pra, numri i formave rasore në paradigmen e pronorit (*im*) del me dy forma në të folmen e Martaneshit, Klosit, Zerqanit, Shëngjinit të Madh dhe Belshit: *im*, *tim* (*tem*), ndërsa në zonën e Dibrës dhe të Elbasanit del me një formë: *tim* (*tem*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 97/1, 97/2, f. 288.

Po me dy forma del edhe paradigma e pronorit *ime*: *ime* dhe *teme* (*teme*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 98/1., 98/2., 98/3., f. 289.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia mashkullore (*ynë*), në rasën emërore del *jo:n* në Martanesh, Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh, ndërsa në Dibër del *to:n*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 99/1., f. 290.

Ndërsa në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore, ky përemër del *to:n* në të gjitha pikat, përjashtim bën pika 108, ku del varianti *jo:n*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 99/2., f. 291.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia mashkullore (*tonë*), në rasën kallëzore del *to:n* në të gjitha zonat, duke përjashtuar zonën e Belshit, ku del varianti e *jo:n*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 99/3., f. 292.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia femërore (*jonë*), në rasën emërore del *jo:n* në Martanesh, në Zerqan, në Shëngjinin e Madh dhe në Belsh, ndërsa në Dibër del *to:n*, po kështu edhe në Elbasan. Në zonën e Klosit del varianti *o:n*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 100/1, f. 293.

Pronori i vetës së parë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia femërore, në rasat gjinore, dhanore, rrjedhore (*sonë*) del *to:n* në të gjitha zonat, përjashtim bën zona e Klosit ku del varianti *o:n*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 100/2., f. 294.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë dhe pronar shumës, gjinia femërore, në rasën kallëzore (*tonë*) del *to:n* në të gjitha zonat, përjashtuar zonën e Belshit, ku del varianti e *jon*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 100/3., f. 295.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore, në rasën emërore (*yt*) del *jot* në të gjitha zonat, përjashtuar zonën e Dibrës, ku del varianti *t nd*, dhe zonën e Belshit, ku del varianti *tat*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 101/1., f. 296.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore, në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore (*tënd*) del *tan* në Martanesh, Zerqan dhe Elbasan, në zonën e Klosit, Shëngjinit të Madh dhe Belshit del *tat*, ndërsa në zonën e Dibrës del *t nd*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 100/2., f. 297.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore, në rasën kallëzore (*tënd*) del *tan* në Martanesh, në Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh dhe Belsh del *tat*, ndërsa në Dibër dhe Elbasan del *t nd*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 101/3., f. 298.

Pra, paradigma e përemrit pronor *yt* është me dy forma në Martanesh, Klos, Zerqan dhe Shëngjin i Madh (*yt, jot* etj., *t nd* etj.), ndërsa në zonat e Dibrës, Elbasanit dhe Belshit del me një formë (*t nd* ose *jot*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 101/1., 101/2., 101/3., f. 299.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia femërore, në rasën emërore (*jote*) del *jote* në Martanesh dhe Shëngjin i Madh, ndërsa në Kos del *yte*, në Zerqan del *tande*, në Dibër del *t nde*, në Elbasan dhe Belsh del *tate*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 102/1, f. 300.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë dhe pronar njëjës, gjinia femërore, në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore (*sate*) del *tane* në Martanesh dhe Zerqan, ndërsa në Klos del *yte/øte*, në Dibër del *t nde*, në Shëngjinin e Madh, në Elbasan dhe Belsh del *tate*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 102/2, f. 301.

Pëemri pronor i vetës së dytë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia femërore, në rasën kallëzore (*tënde*) del *tane* në Martanesh, Klos, Zerqan, ndërsa në Dibër del *t nde*, në Shëngjinin e Madh, në Elbasan dhe Belsh del *tate*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 102/3., f. 302.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia femërore, në rasën emërore (*juaj*) në të gjitha pikat del *juj*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 103/1., f. 303.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia mashkullore, në rasën gjinore, dhanore, rrjedhore (*tuaj*) del *tuj* në Martanesh dhe Shëngjin i Madh, ndërsa në Klos, Zerqan, Dibër, Elbasan dhe Belsh del (*t*)*juj*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 103/2., f. 304.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia mashkullore në rasën kallëzore (*tuaj*) del *tuj* në Martanesh, Zerqan dhe Shëngjin i Madh, ndërsa në Klos, Dibër, Elbasan dhe Belsh del *e juj*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 103/3., f. 305.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia femërore në rasën emërore (*juaj*) del *juj* në të gjitha zonat.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 104/1., f. 306.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia femërore në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore (*suaj*) del *tuj* në Martanesh, Zerqan, Shëngjin i Madh, dhe Belsh, ndërsa në Klos, Dibër, Elbasan del (*s*)*juj*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 104/2., f. 307.

Pronori i vetës së dytë me pronë njëjës dhe pronar shumës, gjinia femërore, në rasën kallëzore (*tuaj*) del *tuj* në Martanesh, Zerqan dhe Shëngjin i Madh, ndërsa në Klos, Dibër, Elbasan dhe Belsh del *e juj*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 104/3., f. 308.

Pronori i vetës së parë me pronë shumës dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore në rasën emërore dhe kallëzore (*e mi*) del *e mi* në të gjitha zonat, përjashtim bën zona e Elbasanit, ku ky përemër del *mij*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 105/1, f. 309.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë shumës dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore, në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore (*të mi*) del *t mi* në të gjitha zonat që kemi në shqyrtim.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 105/2., f. 310.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë shumës dhe pronar njëjës, gjinia femërore, në rasën kallëzore dhe emërore (*e mia*) del e mija në të gjitha zonat. Ndërsa në rasën gjinore, dhanore dhe rrjedhore del *t( ) mija* në të gjitha zonat.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 106/1., f. 311.

Përemri pronor i vetës së me pronë shumës dhe pronar njëjës, gjinia femërore, në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore (*të mia*) del *t mija* në të gjitha zonat, përjashtuar zonën e Dibrës, ku përmeri del pa nyje të përparme.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 106/2., f. 312.

Pronori i vetës së dytë me pronë shumës dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore, në rasën emërore dhe kallëzore (*e tu*) del *tu:j* në Martanesh dhe Belsh, ndërsa në Klos dhe Elbasan del *e tuj*, në Zerqan del *tu:*, në Dibër del *e tu*, për Shëngjinin e Madh nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 107/1., f. 313.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë shumës dhe pronar njëjës, gjinia mashkullore, në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore (*të tu*) *tu:j* në Martanesh, Klos, Elbasan dhe Shëngjinin e MADH, ndërsa në zonën e Zerqanit del *t tu*, në zondën e Dibrës del *tu:*. Ndërsa për zonën e Belshit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 107/2., f. 314.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë shumës dhe pronar njëjës, gjinia femërore, në rasat emërore dhe kallëzore (*e tua*) del *tuja* në Martanesh, Dibër, Elbasan dhe Belsh, ndërsa në Klos del *e tuja*, në Zerqan del *të tuaj*, për Shëngjinin e Madh nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 108/1., f. 315.

Ndërsa në rasën gjinore, dhanore dhe rrjedhore pronori (*të tua*) del *tuja* në të gjitha zonat, përjashtuar Zerqanin ku del varianti *tua*, ndërsa për Shëngjinin e Madh nuk ka të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 108/2, f. 316.

Vlen të theksojmë se në brezin e vjetër të folësve në Martanesh dëgjohet edhe forma *tua* në të gjitha rasat.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë shumës dhe pronar shumës, gjinia mashkullore, në të gjitha rasat (*tanë*) del *to:n* në të gjitha zonat.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 109, f. 318.

Përemri pronor i vetës së parë me pronë shumës dhe pronar shumës, gjinia femërore, në të gjitha rasat (*tona*) del *tona* në të gjitha zonat.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 110, f. 319.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë shumës dhe pronar shumës, gjinia mashkullore, në rasat emërore dhe kallëzore (*tuaj*) del *tu:j* në Martanesh, Zerqan, Shëngjergj i Madh, ndërsa në Klos, Elbasan dhe belsh del *e juj*, për Dibrën nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 111/1., f. 320.

Në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore ky përemer del *tu:j* në Martanesh, Zerqan dhe Shëngjin i Madh. Ndërsa në Klos, Elbasan dhe Belsh del *tju:j*. Për zonën e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 111/2., f. 321.

Përemri pronor i vetës së dytë me pronë shumës dhe pronë shumës, gjinia femërore, në rasat emërore dhe kallëzore (*tuaja*) del *tuja* në Martanesh, Zerqan, Shëngjin i Madh, ndërsa në Klos, Elbasan dhe Belsh del *e juja*. Për Dibrën nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 112/1., f. 322.

Ndërsa në rasat gjinore, dhanore dhe rrjedhore (*tuaja*) del *tuja* në Martanesh, Zerqan, Shëngjin i Madh, ndërsa në Klos, Elbasan del *tjuja*, në Belsh del *t juve*. Për Dibrën nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 112/2., f. 323.

Lakimi i pronorëve në bashkëvajtje me emrin:

	V I		V II	
prona	gjin. mashk.	gjin. fem.	gjin. mashk.	gjin. fem.
njëjës	djali im	motra ime	qeni jot	jeta jote
	djalit t m	motrës t me	qenit tãn	jetës tãne
	djalin t m	motrën t me	qenin tãn	jetën tãne
shumës	djemt e mi	fmit e mi	miqt e tu	rrobat tuaj
	djemve t' mi	fmivet mi	miqet tu	rrobat tuja

	djemt e mi	fmit e mi	miqt e tu	rrobat tuaj
njëjës	shteti jon	nāna jon	shoku juj	motra juj
	shtetit ton	nānēs ton	shokut tuj	motrēs tuj
	shtetin ton	nānën ton	shokun tuj	motrën tuj
shumës	njerzit ton	shpijat tona	miqt tuj	rrobat tuja
	njerzve ton	shpijat tona	miqt tuj	rrobat tuja

Përemri pronor vetvetor me dhe pa emër është ai i mbarë gegërishtes dhe përdoret vetëm për vetën e tretë njëjës dhe shumës, p.sh.: *n'vent vet, vllan e vet, me fmin e vet, ke nana e vet, mas bishtit t'vet etj.*

Përemri pronor vetvetor *i vet* gjendet në zonat përreth Martaneshit.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 94, f, 280.

### **Përemrat pyetës e lidhorë**

Në të folmen e Martaneshit si përemra pyetës përdoren këto trajta: *kush?, ç'?' çar? çare? cili? cila?*

Me përemrin *kush* pyetet vetëm për njerëzit . Ky përemër ka kategorinë gramatikore të rasës, *kush, kuj, kuj, kë, kuj*. Ky përemër përdoret në të njëjtën formë si për frymorë të gjinisë mashkullore ashtu edhe për frymorë të gjinisë mashkullore dhe ndiqet gjithnjë nga forma foljore të numrit njëjës: *kush tha, kush erdh, kush e mur, i kujt është etj.*

Përemri pyetës *ç'?', çar? çare?* qoftë kur nuk ndiqen nga një emër, qoftë kur ndiqen nga një emër përdoret për të pyetur për veprimin a tiparin e frymorëve a të sendeve, si p.sh.: *ç'ke? çar do? çare je tu thā:n? ç'tshifje? çare je t'u bō? etj.*

Format *çar? çare?* janë trajta të sinkopuara të përemrit *çfarë?* Këta përemra nuk kanë kategori gramatikore, por përdoren në forma të ngurtësuar.

Më rrallë në përdorim janë *cili? cila?* që përdoren si përemra-mbiemra që përdoren për të pyetur për frymorë a sende të një grupi të caktuar: *cila cuc erdh? Cilën shpi ble:n? cili çun qe? etj.*

Si përemra lidhorë përdoren *kush, që*.

### **Përemrat e pacaktuar**

Përemrat që tregojnë frymorë a sende në mënyrë të pacaktuar, në të folmen e Martaneshit, janë: *kush, dikush, tjetërkush, gjithsekush, gjithsecili, nj, nenjōni, asnjō, kurrjā, hiçgjā, hiçfare*. Përemri *kush* si i pacaktuar, përdoret në kuptimin e përemrave *ndonjë, njëri, dikush*. Zakonisht qëndron në fund të fjalës. Ka kategorinë gramatikore të rasës: *s'erdh kush, s'i tha kuj*. Përemrat *askush, kurrkush, asnjō, asnjōni* kanë kuptimin mohor, mohojnë një frymor a send të pacaktuar në pjesëmarrjen e një veprimi: *s'erdh kurrkush, s'ka ardh asnjō* etj.

Përemrat *asigjō, hiçgjō* etj., në një fjali mohuese momojnë në mënyrë absolute sendin e treguar në mënyrë të pacaktuar: *s'm'tha asigjō, s'th asigjō, s'hō:r hiç* etj.

Përemrat *gjithfar, gjithfarloj* etj. tregojnë frymorë a sende të çdo lloji; emri që bashkohet me ta është i rasës rrjedhore: *gjithfar njerzish, gjithfar gjōje* etj.

## Folja

### A. Zgjedhimi vepror

### Mënyra dëftore

Koha e tashme. Foljet e zgjedhimit të parë (foljet e të dy klasave) d.m.th. foljet që dalin me temë në zanore ose togzanorsh, kanë mbaresat e gjuhës standarde, në vetat e kohës së tashme, me përjashtim të V II dhe V III njëjës ku mbaresa *-n* nuk del dhe mungesës së zanores – *ë* fundore në vetat e shumësit, veçori për të gjithë të folmet e gegerishtes.

pastroj	kthe-j	shkru:-j	ly:-j
pastro	kthe	shkru:	ly:
pastro	kthe	shkru:	ly:
pastro-jm	kthe-jm	shkru-jm	ly-jm
pastro-ni	kthe-ni	shkru-jn	ly-jn
pastro-jn	kthe-jn	shkru-jn	ly-jn
la-j	msh -j	gj -j	bā-j



la	msh	gj	bã
la	msh	gj	bã
la-jm	msh -jm	gj -jm	bã-jm
la-ni	msh -ni	gj -ni	bã-ni
la-jn	msh -jn	gj -jn	bã-jn

Siç shihet nga pasqyra e zgjedhimit, V II dhe V III njëjës dalin pa mbaresën **-n**, ndryshe nga gegërishtja, toskërishtja dhe standardi. Duke i krahasuar edhe me hartat e ADGJSh-së rezulton se edhe në të folmen e Klosit, Zerqanit dhe Shëngjinit të Madh këto veta dalin pa mbaresën **-n**. Ndërsa në të folmen e Dibrës, Elbasanit dhe Belshit dalin me mbaresën **-n**.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 115., f.334.

Klasa e parë e zgjedhimit të dytë, d.m.th. ato folje që dalin me të njëjtën temë në të tashmen, në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore, kanë pothuajse të njëjtën paradigme si në mbarë shqipen standarde, me disa ndryshime të vogla:

hap	mas	qep	pys	fus
hap	mat	qep	pyt	fut
hap	mat	qep	pyt	fut
hap-im	mas-im	qep-im	pys-im	fus-im
hap-ni	mas-ni	qep-ni	pys-ni	fus-ni
hap-in	mas-in	qep-in	pys-in	fus-in

ses	nez	myll
set	nez	myll
set	nez	myll
ses-im	nez-im	myll-im
set-ni	nez-ni	myll-ni

ses-in                  nez-in                  myll-in

Siç shihet nga pasqyra e zgjedhimit, foljet që pësojnë ndryshimin *-t/-s*, në të folmen e Martaneshit, ashtu si shumëkund në veri, dalin me *-s*, prirje kjo edhe e shqipes standarde, ku për këto folje mbetet normative vetëm forma me *-s*.

Pra foljet e kësaj klase në të tri vetat e njëjësit nuk kanë mbaresë, ndërsa në vetat e shumësit kanë mbaresat: *-im, -ni, -in*.

Foljet *hyp* dhe *hec (ec)* ndryshojnë nga foljet e tjera të po kësaj klase në të tri vetat e njëjësit. Zgjedhimi i tyre është ky:

hyp-i	hec-i
hyp-ën	hec-ën
hyp-ën	hec-ën
hyp-im	hec-im
hyp-ni	hec-ni
hyp-in	hec-in

Nënklasa e parë e klasës së dytë të zgjedhimit të dytë, në të tri vetat e njëjësit nuk ka mbaresë, ndërsa në vetat e shumësit merr mbaresat: *-im, -ni, -in*:

marr	dal	djeg	vjel	vjedh
merr	del	djeg	vjel	vjedh
merr	del	djeg	vjel	vjedh
marr-im	dal-im	djeg-im	vjel-in	vjedh-in
merr-ni	dil-ni	digj-ni	vil-ni	vidh-ni
marr-in	dal-in	djeg-in	vjel-in	vjedh-in

Në vërtetë e dytë shumë foljet e lartpërmendura (përfshirë foljen *marr*) e këmbëjnë zanoren e temës *-e/-je* në *-i*, veçori kjo kryesisht e brezit të vjetër.

Nënklasa e dytë e klasës së dytë të zgjedhimit të dytë del:

bërtas                  shes                  gërfas (gërhas)

bërtet	shet	gërfet
bërtet	shet	gërfet
bërtas-im	shes-im	gërfas-im
bërtit-ni	shit-ni	gërfit-ni
bërtas-in	shes-in	gërfas-in

Foljet e nënklasës së tretë të klasës së dytë të zgjedhimit të dytë, zgjedhohen njësoj si të lartpërmendurat

as	vras
et	vret
et	vret
as-im	vras-im
it-ni	vrit-ni
as-in	vras-in

Në vetën e dytë numri shumësi, ndodh alternimi i zanores përkatëse në *-i* dhe tema përgjithësisht mbaron me *-t*.

Foljet e të tria klasave të zgjedhimit të tretë, zgjedhohen si më poshtë:

klasa I		klasa II		klasa III	
v :	zã:	di:	fl :	pi:	shti:
v :	z :	di	fl :	pi	shti:
v :	z :	di	fl :	pi	shti:
v :-m	zã:-m	di:-m	fl :-m	pi:-m	shti-m
v -ni	zi-ni	di-ni	fli-ni	pi-ni	shti:-ni
v :-n	zã:-n	di:-n	fl :-n	pi:-n	shti:-n

Siç shihet nga tabelat, në këtë të folme ndeshen format pa mbaresën *-n*, siç dalin edhe në gegërishten veriore dhe verilindore. Vetat e shumësit kanë mbaresat: *-m*, *-ni*, *-n*, ndërsa veta e dytë dhe e tretë njëjës dallohen nga veta e parë njëjës nga gjatësia e zanores.

Foljet e parregullta supletive në kohën e tashme zgjedhohen kështu:

kam	jam	bi: (pruna)	bi: (rashë)
ke:	je:	bi:	bi:
ka:	āsht	bi:	bi:
kemi	jemi	bi:-m	bi:-m
keni	jeni	bi:-ni	bi:-ni
kan	ja:n	bi:-n	bi:-n

ha:	jap	rri:	shof	vi
ha:	jep	rri	shef	vje
ha:	jep	rri	shef	vje
ha:-m	jap-im	rri:-m	shof-im	vi-m
ha:-ni	jep-ni	rri:-ni	shif-ni	vi-ni
ha:-n	jap-in	rri:-n	shof-in	vi-n

Foljet e e parregullta josupletive zgjedhohen në këtë mënyrë:

them	du:	lã:	vdes
thu:	do	l	vdes
tho:t	do	l	vdes
the-mi	du:-m	lã:-m	vdes-im
tho-ni	do-ni	l -ni	vdis-ni

tho:-n                      du:-n                      lã:-n                      vdes-in

Koha e pakryer: Karakteristikë e së pakryerës së dëftores në të folmen e Martaneshit është trajta e sajuar me mbaresat *-je, -je, -(n)te* për njëjësin dhe *-jim, -jit, -jin* për shumësin. Shumica e të folmeve të gegërishtes janë larguar prej kohësh duke formuar tipin e së pakryerës me *-sh*.<sup>59</sup> Ja paradigma e zgjedhimit të foljeve në të pakryerën për të folmen e Martaneshit sot. Të gjitha foljet e zgjedhimit të parë, të dy klasave kanë mbaresat *-je, -je, -nte, -jim, -jit, -jin*

shko-je	ble-je	pagu-je	ly-je
shko-je	ble-je	pagu-je	ly-je
shko-nte	ble-nte	pagu-nte	ly-nte
shko-jim	ble-jim	pagu-jim	ly-jim
shko-jit	ble-jit	pagu-jit	ly-jit
shko-jin	ble-jin	pagu-jin	ly-jin
msh -je	la-je	ma-je	bã-je
msh -je	la-je	ma-je	bã-je
msh -nte	la-nte	ma-nte	bã-nte
msh -jim	la-jim	ma-jim	bã-jim
msh -jit	laj-it	ma-jit	bã-jit
msh -jin	la-jin	ma-jin	bã-jin

Klasa e parë e zgjedhimit të dytë ka këtë paradigmë.

hap-je	qep-je	pys-je	mat-je
hap-je	qep-je	pys-je	mat-je
hap-te	qep-te	pys-te	mat-te
hap-jim	qep-jim	pys-jim	mat-jim

<sup>59</sup> Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 228.

hap-jit	qep-jit	pys-jit	mat-jit
hap-jin	qep-jin	pys-jin	mat-jin

Të gjitha foljet e klasës së dytë të zgjedhimit të dytë, d.m.th. foljet që pësojnë ndërrim zanorësh në të tashmen ose në të kryerën e thjeshtë, në të pakryerën e dëftores e këmbejnë zanoren e temës në *-i* dhe marrin mbaresat e të folmes së Martaneshit: *-je, -je, -te, -jim, -jit, -jin*

dil-je	mil-je	tirr-je	bërtis-je
dil-je	mil-je	tirr-je	bërtis-je
dil-te	mil-te	tirr-te	bërtis-te
dil-jim	mil-jim	tirr-jim	bërtis-jim
dil-jit	mil-jit	tirr-jit	bërtis-jit
dil-jin	mil-jin	tirr-jin	bërtis-jin

Foljet e nënklasës së parë të klasës së dytë të zgjedhimit të dytë. *marr; dal; mjel*; në përgjithësi; siç u tha edhe më lart e këmbejnë zanoren e temës në *-i*; por nganjëherë, sipas subjekteve, mund të dëgjohen edhe pa një alternim të tillë: *merrje, delje, vjelje, vjelshin*.

Edhe në zgjedhimin e tretë përdoren po ato mbaresa: *-je, -je, -(n)te, -jim, -jit, -jin*. Kështu klasa e parë ka këtë paradigmë:

ve-je	z -je
ve-je	z -je
ve-nte	z -nte
ve-jim	z -jim
ve-jit	z -jit
vej-in	z -jin

Klasa e dytë dhe e tretë nuk kanë ndryshim në mbaresa me klasën e parë:

di-je	fli-je	pi-je
-------	--------	-------

di-je	fli-je	pi-je
di-nte	fli-nte	pi-nte
di-jim	fli-jim	pi-jim
di-jit	fli-jit	pi-jit
di-jin	fli-jin	pi-jin

Në foljet e parregullta supletive gjenden po të njëjtat mbaresa, vetëm ndryshojnë zanoren e temës së foljes. Ja paradigma e plotë:

kish-je	ish-je	jep-je	rri-je
kish-je	ish-je	jep-je	rri-je
kish-te	ish-te	jep-te	rri-nte
kish-jim	ish-jim	jep-jim	rri-jim
kish-jit	ish-jit	jep-jit	rri-jit
kish-jin	ish-jin	jep-jin	rri-jin

shif-je	vi-je
shif-je	vi-je
shif-te	vi-nte
shif-jim	vi-jim
shif-jit	vi-jit
shif-jin	vij-in

Foljet e parregullta josupletive zgjedhohen si më poshtë:

thosh-je	do-je	li-je	vdis-je	v -je
thosh-je	do-je	li-je	vdis-je	v -je
thosh-te	do-nte	li-nte	vdis-te	v -nte

thosh-jim	do-jim	li-jim	vdis-jim	v -jim
thosh-jit	do-jit	li-jit	vdis-jit	v -jit
thosh-jin	do-jin	li-jin	vdis-jin	v -jin

Folja *jam* në formën e vetës së parë njëjës të dëftores së pakryer (*isha*) del *i je* në të folmen e Martaneshit, të Elbasanit dhe Belshit. Ndërsa në zonën e Klosit dhe dhe Shëngjinit të Madh del varianti *i e*, në zonën e Zerqanit, të Dibrës del varianti *i e*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 117/1., f. 339.

Ndërsa kjo folje në vetën e dytë njëjës të dëftores së pakryer (*ishe*) del *i je* në Martanesh, Elbasan dhe Belsh, ndërsa në Klos dhe Shëngjin i Madh del *i e*, në Zerqan dhe Dibër del *i e*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 117/2., f. 340.

Forma e vetës së tretë njëjës e foljes *jam* në të pakryerën e dëftores (*ishte*) del *i te* në të gjitha zonat.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 117/3, f. 341.

Forma e vetës së parë shumës e foljes *jam* në dëftore të së pakryerës del *i jim* vetëm në Martanesh, ndërsa në zoant e tjera del *i im*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 117/4, f. 342.

Veta e dytë shumës del *i jit* vetëm në të folmen e Martaneshit, ndërsa në zonat e tjera del *i it*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 117/5., f. 343.

Po kështu edhe veta e tretë shumës vetëm në të folmen e Martaneshit del *i jin*, ndërsa në zonat e tjera del *i in*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 117/6., f. 344.

Siç vihet re nga paradigma e foljes *jam* në kohën e pakryer, e folmja e Martaneshit në ndryshim nga e folmja e Klosit, Zerqanit, Dibrës, Shëngjinit të Madh, Elbasanit e Belshit për të tri vetat e shumësit ruan mbaresat e vjetra *-jim, -jit, -jin* (në këto të folme dalin mbaresat: *-shim, -shit, -shin*).

Koha e kryer e thjeshtë. Klasa e parë e zgjedhimit të parë, në të dy vetat e para të njëjësit



merr bashkëtingëlloren antihiatizuese –v- midis temës dhe mbaresës vetore –a, –e në vetën e tretë njëjës, foljet me –oj marrin mbaresën gjysmëzanore –i, por duke u zgjatur zanorja –o- e temës, ndërsa foljet me –ej, –iej, –ij, – uaj, –yej, –as marrin mbaresën –u. Në vetat e shumësit të gjitha foljet e zgjedhimit të parë kanë mbaresën –m, –t, –n:

fillo-v-a	puno-v-a	blo-v-a
fillo-v-e	puno-v-e	blo-v-e
fillo-	puno-	blo-
fillu:-m	punu:-m	blu:-m
fillu:-t	punu:-t	blu:-t
fillu:-n	punu:-n	blu:-n
shkro-v-a	le-v-a	zi:-v-a
shkro-v-e	le-v-e	zi:-v-e
shkro-	le-u	zi:-u
shkru:-m	ly:-m	zi:-m
shkru:-t	ly:-t	zi:-t
shkru:-n	ly:-n	zi:-n

la-v-a

la-v-e

la-u

la:-m

la:-t

la:-n

Siç shihet grupet e foljeve me temë në *oj, uaj, yej, iej* vetat e shumësit i monoftongojnë

në -y, - i.

Nënklasa e parë e klasës së dytë të zgjedhimit të parë ka këtë paradigmë zgjedhimi:

ba-jta	gju-jta	gjet-a	rroj-ta
ba-jte	gju-jte	gjet-e	rroj-te
ba-jti	gju-jti	gje-i	rroj-ti
ba-jtëm	gju-jtëm	gjet-ëm	rroj-tëm
ba-jtët	gju-jtët	gjet-ët	rroj-tët
ba-jtën	gju-jtën	gjet-ën	rroj-tën

Nënklasa e dytë e klasës së dytë të zgjedhimit të parë del kështu:

bã-na	h -na
bã-ne	h -ne
bã-ni	h -ni
bã-m	h -m
bã-t	h -t
bã-n	h -n

Nënklasa e parë e klasës së dytë, në numrin njëjës del me mbaresat *-a, -e, -i*, kurse në shumës të gjitha foljet e zgjedhimit të dytë kanë mbaresat *-m, t, -n*.

hap-a	hyp-a	mush-a	pyt-a
hap-e	hyp-e	mush-e	pyt-e
hap-i	hyp-i	mush-i	pyt-i
hap-m	hyp-m	mush-m	pyt-m
hap-t	hyp-t	mush-t	pyt-t
hap-n	hyp-n	mush-n	pyt-n

myll-a	nez-a	fut-a	ik-a
myll-e	nez-e	fut-e	ik-e
myll-i	nez-i	fut-i	ik-u
myll-m	nez-m	fut-m	ik-m
myll-t	nez-t	fut-t	ik-t
myll-n	nez-n	fut-n	ik-n

Nënklasa e parë e klasës së dytë të zgjedhimit të dytë, d.m.th., foljet që në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimin *-e/-o* ose *je/o* del me apofoninë e zanores së temës në *o* dhe me mbaresat *-a*, *-e* në të dy vetat e para të njëjësit, kurse në vetën e tretë nuk ka mbaresë:

mor-a	dol-a	soll-a
mor-e	dol-e	soll-e
mu:r	du:l	su:ll
mur-m	du:l-m	su:ll-m
mur-t	dul-t	sull-t
mur-n	dul-n	sull-n

Forma e vetës së tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë të foljeve *marr*, *dal*, *vjel* (*mori*, *doli*, *voli*) dalin pa mbaresë *mu:r*, *du:l*, *vol* në të folmen e Martaneshit, Klosit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit. Në zonën e Zerqanit këto folje dalin me mbaresë në vetën e tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë: *mori*, *doli*, *voli*. Po kështu dalin edhe në zonën e Belshit. Ndërsa në zonën e Dibrës foljet *marr* dhe *vjel* dalin me mbaresë, përkatësisht *mori* dhe *veli*, ndërsa folja *dal* del pa mbaresë, pra *dul*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 119.a., f. 366.

dogj-a	vodh-a	mshtoll-a
dogj-e	vodh-e	mshtoll-e
dogj	vodh	mshtull

do:gj-m	vodh-m	mshtull-m
dogj-t	vodh-t	mshtull-t
dogj-n	vodh-n	mshtull-n

Foljet që në të kryerën e thjeshtë bëjnë apofoninë e zanores *a* në *o* në vetën e tretë njëjës e kanë formën me zanoren *-u* të gjatë në temë, me përjashtim të foljeve *djeg*, *vjedh*, *dul*, *mur*, *sull*, *vull*, *mshtull*.

Foljet e nënklasës së dytë të kësaj klase në të kryerën e thjeshtë, e këmbëjnë zanoren e temës në i duke marrë mbaresat *-a*, *-e*, *-i*, *-m*, *-t*, *-n*:

bërtit-a	shit-a	fol-a
bërtit-e	shit-e	fol-e
bërtit-i	shit-i	fol-i
bërtit-m	shit-m	fol-m
bërtit-t	shit-t	fol-t
bërtit-n	shit-n	fol-n

Nënklasa e tretë e klasës së dytë të zgjedhimit të dytë ka të njëjtën paradigmë zgjedhimi sikurse foljet e nënklasës së dytë të klasës së parë të zgjedhimit të parë:

vrav-a	dav-a
vrav-e	dav-e
vra-u	da-u
vra-m	da-m
vra-t	da-t
vra-n	da-n

Klasa e parë e zgjedhimit të tretë ka mbaresat: *-na*, *-ne*, *0 (zero)*, *-m*, *-t*, *-n*:

*v -na*, *v -ne*, *v ;*, *v -m*, *v -t*, *v -n*; *z -na*, *z -ne*, *z ;*, *z -m*, *z -t*, *z -n*.

Klasa e dytë e këtij zgjedhimi ka këto mbaresat:

dit-a	flet-a
dit-e	flet-e
dit-i	flet-i
dit-m	flet-m
dit-t	flet-t
dit-n	flet-n

Klasa e dytë e zgjedhimit të tretë në të kryerën e thjeshtë:

pi-v-a	shti-v-a
pi-v-e	shti-v-e
pi-u	shti-u
pi-m	shti-m
pi-t	shti-t
pi-n	shti-n

Foljet e parregullta supletive dalin:

pat-a	qe:-sh	pr -na	ra:-sh
pat-e	qe:	pr -ne	re:
pat	qe	pr :	ra
pat-m	qe-m	pr -m	ra:-m
pat-t	qe-t	pr -t	ra:-t
pat-n	qe-n	pr -n	ra:-n
hâr-a	dha:-sh	pa:sh	erdh-a
hâr-e	dhe	pe	erdh-e

hār	dha	pa	erdh
hār-m	dha-m	pa-m	erdh-m
hār-t	dha-t	pa-t	erdh-t
hār-n	dha-n	pa-n	erdh-n

Foljet e parregullta josupletive zgjedhohen:

tha:sh	desh-a	lash	vojt-a
the:	desh-e	le	vojt-e
tha	desh	la	vojt
tha:-m	desh-m	la:-m	vojt-m
tha:-t	desh-t	la:-t	vojt-t
tha:-n	desh-n	la:-n	vojt-n

Kohët e përbëra

Në të folmen e krahinës së Martaneshit përdoren këto kohë të përbëra:

- A. E kryera: formohet duke i paravendosur pjesores së foljes themelore format vetore të kohës së tashme të foljeve ndihmëse *kam* për diatezën veprore: *kām shku:*, *kan bā:*, *i kan thā:n*, *kan qe:n*, *nuk ka qe:n*, *kan thā:n*, *kemi da:l*, *kemi vojt*, *kan vjel*, *ke ik*, *kan harru:*, *e keni ma:rr*, *kemi punu:*, *e ka kry:* etj.
- B. E kryera e dytë: Ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format e së kryerës të foljes ndihmëse *kam*: *ka pas qe:n* i *he:r*, *na kan pas thā:n*, *s'kan pas qe:n*, *s'kemi pas ble* etj.

Paradigma e së kryerës së dytë: *kam pasë dalë* del si në të folmen e Martaneshit (*kam pas da:l*), ashtu edhe në të folmet e tjera përreth.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 123, f. 372.

Po kështu ekziston edhe paradigma e së kryerës së plotë të dytë (*kisha pas dalë*).

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 124. F. 373.

- C. Më se e kryera: Ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes themelore format vetore të kohës së pakryer të foljes ndihmëse *kam* për diatezën veprorë: *e kishite ble:; e kishite ma:rr; kishite q :n; kishim le:; kishite ardh; kishite da:l; e kishite zgjedh; s'kishim le: etj*
- D. Më se e kryera e dytë, formohet duke i paravendosur pjesores së foljes format e më së të kryerës së foljes ndihmëse *kam*: *i kishite pas thã:n; e kishite pas msu:; e kishite pas kërku; kishite pas vdek etj.*
- E. E kryer e tejshkuar: Kjo kohë formohet duke i paravendosur pjesores së foljes themelore format vetore të së kryerës së thjeshtë të foljes ndihmëse *kam* për diatezën veprorë: *e pat lã:n menja; e pat vra; e pat punu: etj.* Në brezin e vjetër, por në disa raste edhe në brezin e mesëm dalin trajtat: *e paçe harru:; e paçe lã:n; e paçe m ll etj*
- F. E ardhmja: Si në mbarë gjuhën shqipe edhe në të folmen e Martaneshit, e ardhmja formohet nga pjesëza prejfoljore *do* dhe lidhorja. Zanojta ë nuk shqiptohet në pjesëzën *-t*: *do t' shkoj; do t' laj; do t' punoj; do t' pastroj; do t' korr; do t' lyj etj.* Dendur përdoret edhe trajta pa pjesëzën *-t*: *do vim; do lajm; do rri:m; do iki etj.* Një e ardhme tjetër që përdoret në këtë të folme është edhe trajta e formuar nga folja *kam* + *paskajorja e tipit për të punuar*: *s'kam për t' shku:; ke për ta marr n' shpi; nalo se kãm për t' ma:rr i gjã etj.*

Struktura e formës të së ardhmes së tashme ndërtohet me dy forma *do* + *lidhore* dhe *kam* + *për të* + *pjesore*, pra *do t' koj* dhe *kam p r t' ku:*, si në të folmen e Martaneshit, ashtu edhe në të folmet e tjera përreth.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 126, f. 376.

- G. E ardhmja e përparme ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes themelore format vetore të së ardhmes së ndihmëses *kam*: *do të kem pa; do të ke:sh pa; do të ke:t pa; do të kemi pa; do të keni pa; do të ke:n pa etj.*
- H. E ardhmja e së shkuarës, që ndërtohet duke i paravendosur pjesëzën *do* formave vetore të kohës së pakryer të mënyrës lidhore të foljeve themelore: *(un) do t' çoje; (ti) do t' çoje; (aj) do t' çonte etj.*
- I. E ardhmja e përparme e së shkuarës që formohet duke i paravendosur pjesores së foljes themelore format vetore të së ardhmes të së shkuarës ndihmësen *kam*: *do t' kishje lyp; do t' kishje lyp; do t' kishit lyp etj.*

## Mënyra lidhore

Interes dialektor paraqesin veta e dytë dhe e tretë njëjës të kësaj mënyre, sepse vetat e tjera janë të njëjta me ato të kohës së tashme të mënyrës dëftore. Veçori e kësaj mënyre, ashtu si edhe në të folme të tjera të shqipes, është pjesëza *të* e paravendosur.

Koha e tashme. Të gjithë foljet e zgjedhimit të parë dhe të tretë, dmth të gjithë foljet që mbarojnë me temë në zanore, në vetën e dytë dhe të tretë njëjës kanë mbaresat *-sh, -j*:

të shko-j	të ble-j	të bā-j
të shko-sh	të ble:-sh	të bā-sh
të shko:-j	të ble:-j	të bā:-j
të shko-jm	të ble-jm	të bā-jm
të shko-ni	të ble-ni	të bā-ni
të shko-jn	të ble-jn	të bā-jn
të pi:	të zā	të dī:
të pi:-sh	të zā-sh	të dī-sh
të pi:-j	të zā:-j	të dī:-j
të pi:-jm	të zā:-m	të dī:-m
të pi-ni	të z -ni	të dī:-ni
të pi:-n	të zā-n	të dī:-n

Foljet e zgjedhimit të dytë, dmth foljet me temë në bashkëtingëllore, në vetën e dytë njëjës dalin me dy variante mbaresash *-ish/tsh*, kurse në vetën e tretë dalin pa mbaresë. Mbaresa *-tsh* del vetëm te brezi i vjetër i folësve.

të pys	të pres	të vras
të pys-ish	të presi-ish	të vras-ish
të py:s	të pre:s	të vra:s



të pys-im	të pres-im	të vras-im
të pyt-ni	të prit-ni	të vris-ni
të pys-in	të pres-in	të vras-in

Vetat e tjera të kohës së tashme të mënyrës lidhore janë ato të gjuhës standarde

Forma e vetës së dytë njëjës e lidhores së tashme të foljeve që u mbaron tema me bashkëtingëllore (*të presësh*) del me dy variante *t presi /t pretsh* në zonën e Martaneshit, Zerqanit dhe Dibrës, ndërsa në Klos del *të presi* , në Shëngjinit del *të pre:* , në Elbasan dhe Belshit del *të pret* .

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 127.a/1.. f. 377.

Veta e tretë njëjës del *t pre:s* në Martanesh, në Klos del *t presin*, në Zerqan del *t prese*, në Dibër del *t pret*, në Shëngjergjin e Madh, në Elbasan dhe Belsh del *të presi*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 127.a/2., f. 378.

Foljet e parregullta supletive kanë këtë zgjedhim në të tashmen e dëftores:

të kem	të je-m	të bi:
të kesh	të je:-sh	të bi:-sh
të ke:t	të je:t	të bje:-r
të ke-mi	të je-mi	të bi-m
të ke-ni	të je-ni	të bi-ni
të ke-n	të je-n	të bi:-n
të jap	të rri:	të shof
të jap-ish	të rri:-sh	të shof-ish
të ja:p	të rri:j	të sho:f
të jap-im	të rri:-m	të shof-im

të jep-ni	të rri:-ni	të shif-ni
të jap-in	të rri:-n	të shof-in
të vi		
të vi-sh		
të vi:j		
të vi:-m		
të vi-ni		
të vi:-n		

Foljet e parregullta josupletive dalin kështu:

të them	të de:m
të thu:sh	të du:sh
të tho:t	të de.t
të the-mi	të du:m
të tho-ni	të do-ni
të tho:n	të du:n (të de:n)

Në përgjithësi në të folmen e krahinës së Martaneshit pjesëza të e mënyrës lidhore shqiptohet *t'*, ku *ë-ja* është eliduar.

Kohët e shkuara të mënyrës lidhore:

- E pakryera. Të gjitha foljet në këtë kohë të mënyrës lidhore dalin me të njëjtat mbaresa vetore si në të pakryerën e dëftores, duke u dalluar vetëm nga pjesëza të: *(unë) të laje (ti) të laje, (ai) të lante, (na) të lajim, (ju) të lajit, (ata) të lajin; (unë) të bleje, (ti) të bleje, (aj) të blente, (na) të blejim, (ju) të blejit, (ata) të blejin*.
- E kryera. Ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të kohës së tashme lidhore, të ndihmëses *kam: t'kem punu:, t'kesh punu:,*

*t'ket punu:, t'kemi punu:, t'keni punu:, t'ken punu:* (kjo kohë folje përdoret mjaft rrallë)

- c. Më se e kryera. Formohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të kohës së pakryer lidhore të foljes ndihmëse *kam:* (*unë*) *t'kishje pr ;*, (*ti*) *t'kishje pr ;*, (*aj*) *t'kishte pr ;*, (*na*) *t'kishjim pr ;*, (*ju*) *t'kishjit pr ;*, (*ata*) *t'kishjin pr ;*; *t'kishje punu:, t'kishje punu:, t'kishte punu:, t'kishjim punu:, t'kishjit punu:, t'kishjin punu:* etj.

### **Mënyra habitore**

E pakryera. Edhe kjo kohë e habitores del me format sintetike të përfuara duke i prapangjitur pjesores së shkurtuar të foljes ndajshitesat: *-kshe, -ke, ka, -kishim, -kishit, -kan*.

punukshe

punuke

punuka

punukshim

punukshit

punukan

### **Mënyra kushtore**

E tashmja e kësaj mënyre ndërtohet me anë të pjesëzës *do* ndjekur nga e pakryera e lidhores. Është homonime me atë të së ardhmes së të shkuarës të mënyrës dëftore: *do t'laje, do t'ikje, do t'shkonte, do t'diljin etj.*

E kryera e mënyrës kushtore është krejt homonime me formën e së ardhmes së përparme të të shkuarës: *do t'kishje ardh, do t'kishje çu, do t'kishje da:l etj.*

### **Mënyra dëshirore**

Koha e tashme e kësaj mënyre ka temë të veçantë që ndërtohet me anë të prapashtesës trajtëformuese *-fsh*, ndërsa për vetën e tretë njëjës *-f*. Mbaresat janë: *-a, zero, -t, -m, -it, -in:*

marr-sh-a

fito-fsh-a

b ã-fsh-a

marr-sh	fito-fsh	bã-fsh
marr-t	fito-f-t	bã-f-t
marr-sh-im	fito-fsh-im	bã-fsh-im
marr-sh-it	fito-fsh-it	bã-fsh-it
marr-sh-in	fito-fsh-in	bã-fsh-in

Përgjithësisht foljet me temë në zanore marrin prapashtesën trajtëformuese *-fsh*, kurse ato me temë në bashkëtingëllore variantin *-sh*.

E kryera e mënyrës dëshirorës e ndërtuar nga format vetore të së tashmes së dëshirores të foljes ndihmëse *kam (paça)* dhe pjesores së foljes themelore është e rrallë.

Foljet e parregullta supletive e bëjnë kështu dëshiroren:

kam	paça
jam	qofsha
bi	prufsha
jap	dhãnshta
ha	hãrsha
shoh	pafsha
vij	ardhsha

Foljet e parregullta josupletive dalin në këto forma:

them	thãnshta
lã	lãnshta

### **Mënyra urdhërore**

Foljet me temë në zanore *-o*, në vetën e dytë numri njëjës të mënyrës urdhërore dalin pa mbaresë: *ço, kallzo, shtro, kno, shko etj.*

Foljet me temë me *-iej, -yej, -ej, -uaj, -aj* në vetën e dytë numri njëjës të mënyrës urdhërore dalin në një trajtë homonime me vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore: *zi:j, përzi:, ly:j, thy:j, gjej, blej, blu:j, ly:j, la:j etj.*

Foljet *h, pi, di, b j* dalin pa mbaresë, por me zanore të temës së shkurtër: *h, p, b*, ndërsa folja *dëftej* nën *dëfte*.

Foljet e klasës së parë të zgjedhimit të dytë dalin në një trajtë homonime me vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore duke dalluar vetëm nga gjatësia e zanores, ku në mënyrën urdhërore është më e shkurtër: *h p, m t, k, lyp etj.*

Klasa e e dytë e zgjedhimit të dytë, dmth foljet që në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrim zanorësh të temës, në vetën e dytë njëjës të mënyrës urdhërore e këmbëjnë zanoren e temës në *i: dil, fli, mill, vil, prit, shit, zbrit etj.*

Në vetën e dytë shumës të gjitha foljet formën e urdhërores e formojnë si në mbarë shqipen me mbaresën *-ni: shkoni, bleni, shkruni, lani, korri, lyni, sht ni, pastroni, shkunni etj.*

Trajtat e shkurtra u prapangjiten formave të njëjësit, po qe se nuk është pjesëza *mos* para foljes: *msoj-e, laj-e, qeroj-e, vrit-e, shtyp-e, kap-e, vil-i*. Kur pjesëza mohuese *mos* qëndron para foljes, trajtat e shkurtra e paraprijnë foljen, një ndërtim i tillë shpreh ndalimin e një veprimi: *mos e lsho, mos e ço, mos ja trego, mos e pyt etj.*

Foljet e parregullta supletive në mënyrën urdhërore

kām – ki!

jām – ji!

bi (rashë) – bjeri!

jap – jep

shof – shif

Foljet e parregullta josupletive

them - thu:j - thoni

dua - du:j - doni

vdes - vdis - vdisni

## Përcjellorja

Kjo formë e pashtjelluar sot në të folmen e krahinës së Martaneshit ndërtohet me pjesëzën *tu + pjesorja e foljes: tu msu., tu la., tu ly., tu punu., tu çu., tu ec, tu marr etj.*

Forma foljore e përcjellores në të folmen e Klosit, Zerqanit dhe Dibërës del me pjesëzën *tue*, në Elbasan dalin dy forma *tue/tyke*, në Belsh del pjesëza *tye*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 128, f. 385.

## Paskajorja

Në këtë të folme paskajorja e ndërtuar nga pjesëza *për* dhe emri prejfoljor asnjëherë i pashquar është trajta më e përdorur: *për t'shku, për t'punu, për t'la, për t'mledh, për t'pastru etj.* Por njihet edhe një rast tjetër i paskajores, ajo e ndërtuar nga pjesëza parfyalore *me* dhe *pjesorja e foljes përkatëse*, si p.sh.: *u nis me ik, fī oi me ce etj.* Në zonën e Klosit dhe Belshit paskajorja formohet nga pjesëza *me + pjesore*, po kështu edhe në Zerqan. Në Dibër mungon forma e paskajores, në vend të saj përdoret lidhorja. Në zonën e Shëngjinit të Madh dhe të Elbasanit paskajorja del me dy forma: *për të + pjesore/ për me + pjesore*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 130, f.390.

## B. Zgjedhimi jovepror

Format foljore të zgjedhimit jovepror në të folmen e Martaneshit ndërtohen me këto mjete gjuhësore:

1. me anë të mbaresave
2. me anë të pjesëzës *-u*
3. me anë të foljes ndihmëse *jam*

A. Format foljore të zgjedhimit jovepror të ndërtuara me anë të mbaresave:

Me anë të mbaresave ndërtohen këto forma foljore:

a. Format e kohës së tashme. Foljet me temë në zanore kanë mbaresat: *-hem, -he, -het, -hemi, -hi, -hen*.

la-hem

kthe-hem

mso-hem

la-he

kthe-he

mso-he

la-het	kthe-het	mso-het
la-hemi	kthe-hemi	mso-hemi
la-hi	kthe-hi	mso-hi
la-hen	kthe-hen	mso-hen

Veta e dytë njëjës e dëftores së tashme, diateza pësore, në foljet që u del tema me zanore në zonën e Martaneshit del me trajtën *-he (lahe)*. Po kështu del edhe në zonën e Klosit dhe Elbasanit. Në zonën e Zerqanit dhe Belshit del *-he (lahe)*, në Dibër del *-e (lae)* dhe në zonën e Shëngjinit të Madh del *-e (lae)*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 132.c/2., f. 399.

Veçori dialektore paraqet edhe veta e dytë shumës e dëftores së tashme diateza pësore. Veta e dytë shumës e foljeve që u mbaron tema me zanore (*laheni*) në Martanesh del me trajtën *-hi (lahi)*. Po kështu del edhe në zonën 91, 92, 99, 108 në zonën 96 del *lai*, në zonën 93 del *lahni*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 132.c/5., f. 402.

Foljet me temë në bashkëtingëllore kanë këto mbaresa : *-em, -e, -et, -emi, -ni, -en*.

myll-em	nis-em	fut-em
myll-e	nis-e	fut-e
myll-et	nis-et	fut-et
myll-emi	nis-emi	fut-emi
myll-eni	nis-eni	fut-eni
myll-en	nis-en	fut-en
qell-em	digj-em	vrit-em
qell-e	digj-e	vrit-e
qell-et	digj-et	vrit-et
qell-emi	digj-emi	vrit-emi

qell-eni	digj-eni	vrit-eni
qell-en	digj-en	vrit-en

Siç shihet veta II njëjës e kohës së tashme të mënyrës dëftore në diatezën pësore, vetvetore, mesore ka trajtën me *-he* te foljet me temë në zanore dhe me e te foljet me temë në bashkëtingëllore.

Mbaresat *-(h)em, (h)e, (h)mi, (h)ni, h(en)* i shtohen temës së foljes në kohën e tashme, në zgjedhimin vepror.

Foljet që pësojnë monoftongizim të grupeve të zanoreve në zgjedhimin vepror dhe në zgjedhimin jovepror i kanë të monoftongizuara *thyhem, lyhem, zihem*.

b. Format e kohës së pakryer. Foljet me temë në zanore, në të pakryerën e dëftores në zgjedhimin jovepror, kanë këto mbaresa: *-heshe, -hesh, -hej, -heshim, -heshit, -heshin*.

ço- heshe	kthe-heshe	dahe-she
ço-heshe	kthe-heshe	da-heshe
ço-hej	kthe-hej	da-hej
ço-heshim	kthe-heshim	da-heshim
ço-heshit	kthe-heshit	da-heshit
ço-heshin	kthe-heshin	da-heshin
ly-heshe	përzi-heshe	
ly-heshe	përzi-heshe	
ly-hej	përzi-hej	
ly-heshim	përzi-heshim	
ly-heshit	përzi-heshit	
ly-heshin	përzi-heshin	

Foljet me temë në bashkëtingëllore në të pakryerën e dëftores në zgjedhimin jovepror, marrin mbaresat *-eshe, -eshe, -ej, -eshim, -eshit, -eshin*



piq-eshe	çudit-eshe	njif-eshe
piq-eshe	çudit-eshe	njif-eshe
piq-ej	çudit-ej	njif-ej
piq-eshim	çudit-eshim	njif-eshim
piq-eshit	çudit-eshin	njif-eshit
piq-eshin	çudit-eshin	njif-eshin

Veta e parë njëjës e dëftores së pakryer, pësore, e fojeve që u mbaron tema me bashkëtingëllore (*lodhesha*) në të folmen e Martaneshit del *lođe e*, po kështu del edhe në Zerqan, në Klos del *u lođ e*, në Diber del *lođ a*, në Belsh del *u lođ je*, në Elbasan del *lođe*, në Belsh del *lođ em*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 133.a/1, 133.b/1., f. 404.

B. Format foljore të zgjedhimit jovepror të ndërtuara me pjesëzën *-u*. Me këtë pjesëz i ndërtojnë format gramatikore të zgjedhimit jovepror. Një veçori karakteristike e kësaj të folmeje që e dallon nga të folmet e tjera të gegërishtes dhe që e afron me të folmet e Shqipërisë së Mesme është përdorimi i zakonshëm i formës sigmatike të vetës së parë njëjës të kohës së kryer të thjeshtë të diatezës pësore, mesore dhe vetvetore: *u caktush*, *u mulush*, *u kthysh etj.* Kjo formë ruhet në të folmet e Jugut dhe të folmet e Shqipërisë së Mesme.<sup>60</sup>

Forma sigmatike i përket sot vetëm brezit të vjetër, sepse brezi i ri dhe i mesëm përdor trajtën e formuar nga pjesëza *u* paravendosur së kryerës së thjeshtë të mënyrës dëftore të zgjedhimit vepror.

u msova	u lava	u ktheva
u msove	u lave	u ktheve
u msu:	u la:	u kthy
u msu:m	u la:m	u kthym
u msu:t	u la:t	u kthy :t

<sup>60</sup> Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 240.

u msu:n

u la:n

u kthy :n

u nisa

u rrita

u nise

u rrite

u nis

u rrit

u nisëm

u rritëm

u nisët

u rritët

u nisën

u rritën

Siç shihet në vetën e tretë njëjës, qoftë foljet në bashkëtingëllore qoftë foljet më zanore kanë mbaresën zero.

Mbaresa e formës së vetës së parë njëjës të së kryerës së thjeshtë të diatezës pësore të foljeve që u mbaron tema me zanore (*u lava*) del si në gjuhën standarde në Martanesh, Klos, Dibër dhe Belsh, ndërsa në Shëngjinin e Madh dhe Elbasan del *u la* .

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 134.b., 134.c.. f. 419.

- a. E tashmja e mënyrës habitore që përdoret më tepër në vetën e tretë njëjës : *u thyka, u zika etj.*
- b. E tashmja e mënyrës dëshirore, në të cilën pjesëza *u* u paravendoset formave vetore përgjegjëse të zgjedhimit vepror : *u lafsh, u msofsha etj.*
- c. Formate mënyrës urdhërore në diatezën pësore, mesore dhe vetvetore, ndërtohen duke shtuar pjesëzën *u* formave përgjegjëse të diatezës veprore. Në vetën e dytë njëjës pjesëza *u* i prapangjitet temës së foljes : *marto-h-u, la-h-u, dahu, mçifu, vishu*, ndërsa në vetën e dytë shumës del *lahi, dahi, vishi, mçifi* etj. Të gjithë foljet me temë në zanore, para pjesëzës *u* marrin një *h* antihiatizuese. Në ndërtimet mohuese pjesëza – *u* vendoset midis pjesëzës mohuese *mos* dhe formës veprore të urdhërores : *mos u kthe, mos u nxe, mos u trem etj.*

Forma e vetës së dytë shumës e urdhërores, diateza pësore, të foljeve që u mbaron tema me zanore (*lahuni*) del *lahi* në Martanesh, Klos, Zerqan dhe Elbasan. Në Dibër del *launi*, në Belsh dalin dy forma *lahni/lahi*.

Shih: ADGJSH, Vëllimi I, harta nr. 135.b, f. 421.

dh. Format e së ardhmjes së tipit *kam për t'u msu, kan për t'u marr vesh*. Me këtë pjesëz formohet edhe e ardhmja e së shkuarës e tipit *kishte për t'u nis*.

e. Format e pashtjelluara përcjellore dhe paskajore: *t 'u u djeg, për t'u nis* etj.

4. Format foljore të përbëra të zgjedhimit pësor – vetvetor të formuara me anë të foljes ndihmëse *jam*. E formojnë zgjedhimin jovepror me anë të foljes ndihmëse *jam* :

a. E kryera : *jam la, je la, āsht la, jemi la, jeni la, jān la ; jān rrit, je rrit, āsht rrit, jemi rrit, jeni rrit, jān rrit*.

b. Më se e kryera: *ishje feju :, ishje feju :, ishte feju :, ishim feju:;, ishit feju:;, ishin feju:*

c. E kryera e tejshkuar : *qesh lodh, qe: lodh, qe: lodh, qe:m lodh, qe:t lodh, qe:n lodh; qe:sh nis, qe: nis, qe: nis, qe:m nis, qe:t nis, qe:n nis*.

d. E ardhmja e përparme : *do t'jem la, do t'jesh la, do t'je:t la, do t'jemi la, do t'jeni la, do t'je:n la*.

e. E ardhmja e përparme e së shkuarës: *do t'ishje çmen, do t'ishje çmen, do t'ishte çmen, do t'ishjim çmen, do t'ishjit çmen, do t'ishjin çmen*

f. E kryera e lidhores: *t'jem la, t'jesh la, t'jet la, t'jemi la, t'jeni la, t'jen la*.

g. E kryera e habitores: *qekam hutu:;, qeke hutu:;, qeka hutu:;, qekim hutu:;, qekit hutu:;, qekan hutu:* (për vetën e parë dhe të dytë shumës hasen edhe format *qekshim hutu:;, qekshit hutu*)

## Format foljore aspektive

Është fjala për trajtat foljore jo të thjeshta që tregojnë se veprimi vërtet është i zgjatur, por që kufizohet brenda një kohe, pra nuk zgjatet në mënyrë të pacaktuar. Trajta foljore e thjeshtë e dëftores, që është e kufizuar vetëm për kohën e tashme dhe të pakryerën e dëftores, u përket të gjithë të folmeve të shqipes, por, përdorim më të madh ajo ka në të folmet e Jugut.<sup>61</sup>

Për të dhënë në mënyrë të theksuar vazhdimësinë e një veprimi, në të folmen e Martaneshit përdoren, përkatësisht, trajtat e së tashmes, e të së pakryerës të foljes *jam*, bashkë me përcjelloren e foljes themelore: *jām tu shku.*, *jām tu punu.*, *je tu shku.*, *āsht tu la.*, *ishin tu msu.*, *ishje tu punu etj.*

Kjo trajtë foljore me vlerë aspektive, krahas aspektit durativ mund të tregojë edhe një veprim që kemi ndërmend të bëjmë në të ardhmen: *s'jām tu shku.* etj. Folja *jam* në ndërtime të tilla zgjedhohet në vetë dhe në numër, ndërsa folja themelore mbetet e pandryshuar: *jām tu punu.*, *je tu punu.*, *ā tu punu.*, *jemi tu punu.*, *jān tu punu etj.*

Kjo trajtë foljore, e përbërë nga trajta e shtjelluar e foljes “*jam*” dhe nga e pashtjella e përcjellores, është më e përhapur në të folmet e Veriut, sidomos në ato që ndodhen midis Matit dhe Shkumbinit. Në Shqipërinë e Mesme kjo trajtë del edhe më e shkurtër, del vetëm me formën e përcjellores (*tuj punu*), kur është si përgjigje e një pyetje.<sup>62</sup>

Mund të ndeshet edhe trajta e ndërtuar nga e kryera e thjeshtë e foljes *jam* dhe nga përcjellorja e foljes themelore: *qe:sh tu flet.*, *qe:sh tu qep.*, *qe:m tu shit.*, *qe:m tu vjel.*, *qe:m tu prashit etj.* Ndërtimi *qe:sh + tu + pjesore* përveç një veprimi durativ, në të shkuarën sipas rrethanave, mund të shprehë edhe një veprim që u mendua të bëhet menjëherë ose ishte gati të kryhet, po nuk u krye: *qe:sh tu xërri (desh u rrëzova)*, *qe:sh tu hār.*, *qe:sh tu ju thān (por nuk iu thashë).*

## Ndajfoljet

1. Si ndajfolje përcaktore që emërtojnë tiparin e një veprimi të shprehur nga folja, si dhe shkallën e intensitetit të këtij veprimi ose të një tipari, përmendim ndajfoljet e mënyrës dhe sasisë:
  - a. Ndajfoljet e mënyrës: *mi:r.*, *keq.*, *likisht.*, *vokët.*, *idhët.*, *ftohët* tregojnë cilësinë e veprimit ose të gjendjes: *jām likisht.*, *ishte vesh mi:r etj.* Shumë ndajfolje të tjera mënyre shënojnë ecurunë e procesit të veprimit ose mënyrën e

<sup>61</sup> Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 243.

<sup>62</sup> Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 243.

kryerjes së tij: *përmys, përpsepre, sheshit, hazër, kastile, karrabeç: e kām lān hazër, e bajta karrabeç etj.*

- b. Ndajfoljet e sasisë, *shu:m, pak, fort, njaqi, kaqi* tregojnë masën e realizimit të një veprimi ose shkallën e një cilësie a të një rrethane, sidomos shkallën realizimit të veprimit e shprehin ndajfoljet: *shu:m, tepër, fort.*

2. Në ndajfoljet rrethanore, të cilat emërtojnë rrethanat në të cilat kryhet veprimi i shprehur nga folja hyjnë:

a. Ndajfoljet e kohës, *nashti, jini, nesër, n'mjest, n'mrōmt* tregojnë:

- kohën e saktë të kryerjes së veprimit: *nesër do t'shkoj n'shpi, jini do t'nisem etj.*
- zgjatjen e një veprimi ose të një gjendje a dendurie të tij: *shpesh, prap, përdi:t, përna:t, gjithnjë etj.*
- veprimi i shprehur nga foljet është momentar, i çastit: *prihe:r.*

b. Ndajfoljet e vendit tregojnë:

- vendin e afërt ku kryhet një veprim ose ku ndodhet një ngjarje: *khō, iktu, ikhō, njāty etj.*
- një rrethanë vendore të papërcaktuar saktë, pa u saktësuar në mënyrë të përpiktë vendi ku ndodh një veprim ose ngjarje: *përyashta, përm , cipër, përcipër, nalt, matān, an j, kn j etj.*

## **Lidhëzat**

1. Lidhëzat bashkërenditëse këpujore karakteristike për të folmen e Martaneshit janë këto: *ene, ene...ene, hem...hem, as...as, ene ktu ene atje, as me pu:n e as pa pu:n etj.*
2. Lidhëza bashkërenditëse veçuese janë: *ja...ja, o...o, ose...ose: o hajde o ik, ja gja:ll ja vdek etj.*
3. Të larmishme janë lidhëzat nënrënditëse. Një lidhëz nënrënditëse shpreh disa lloje marrëdhëniesh nënrënditëse si: *se, sikur, si, sa, qi, kur, masi, sadoqi, në , po etj.*

## Pjesëza

Pjesëzat më karakteristike që gjenden në këtë të folme janë:

- pjesëzat e mohimit *nuk, s' (sun), mo (mos), jo: sun eci, na nuk ngjo:jm*  
*s'ma mur menja etj.*
- pjesëza dëftuese *nj*, e cila shërben për të treguar diçka që gjendet zakonisht në afërsi: *nj ku e ke..*
- pjesëza përcaktuese-saktësuese *m*, *tamām, po: mu n'lule t'ballit, ā vesh tamām si nuse* etj. Pjesëza *m* përdoret përgjithësisht para fjalëve që shërbejnë në fjali si rrethanor vendi, mënyre e krahasimi.
- ka edhe pjesëza modale si: *dru., nejse, gjōja etj.: tha se gjōja e ka ble, dru: nuk vje etj.*

## Pasthirrmat

Pasthirrmat që dalin më shpesh në të folmen e përditshme.

- a. Pasthirrma që shprehin ndjenja të tilla, si: *gëzim, kënaqësi, entuziazëm: t'lumt, aferim t'qoft, ohoho etj.*
- b. Pasthirrma që shprehin thirrje, si: *ore, or, ori, mori; moj cu.c, ku qe ori? or çuna etj.*
- c. Pasthirrma që shprehin çudi, habi: *bre, ou, u etj*
- d. Pasthirrma që shprehin dhimbje, dëshpërim, keqardhje: *of!, mjer etj.*

## Onomatopetë

Të përdorura gjerësisht janë onomatopetë që shërbejnë për të riprodhuar tingujt, zërat, zhurmat, britmat, klithmat etj., të sendeve, frymorëve ose edhe të fenomeneve.

Përgjithësisht riprodhohen zëra, zhurma, klithma:

- a. të njerëzve: *e psht na tri he:r n'surrat ptu! ptu! ptu!*  
*op! sa e pa u çu op n'kōm!*

*fet! e mur fet e fet!*

*apqu! teshtini apqu me sa fuqi pat!*

b. të shpendëve e të kafshëve:

*ke knōgjeli kikikō un hapa penxheren prihe:r*

*pula kakaka!*

c. të sendeve e të fenomeneve të natyrës: *e përplasi derën brrau:!* *ra dera bam bam! ra mu n'muçilët bërrdau!*

### **Fjalëformimi**

Gjuha shqipe ka mundësi të mëdha fjalëformuese, gjë që lidhet me prodhimtarinë e mënyrave, të gjedheve dhe të mjeteve fjalëformuese. Studimet kanë nxjerrë në dritë edhe dukuri të lidhura me veçantitë e shqipes, siç janë forca vepruese e gjedhes fjalëformuese, kufiri midis përbërjes e përngjitjes, mundësitë e gjera të ndajshtesimit, kushtëzimi i kuptimit të njësisë së re nga kuptimet e morfemave fjalëformuese, prejardhja kuptimore gjatë formimit të fjalëve etj<sup>63</sup>. Pasuria e shqipes në fjalëformim dëshmohet si në gjuhën e shkruar, ashtu edhe në shqipen popullore. Këtu do të vëmë në dukje disa mënyra të formimit të fjalëve me parashtesa e prapashtesa që dalin shpesh dhe janë veçori për të folmen e Martaneshit.

1. Formimi parashtesor. Si në të gjithë gjuhën shqipe formimi parashtesor në këtë të folme ka një përdorim më të kufizuar se formimi prapashtesor. Më të përdorura janë parashtesat: *pa-*, *për-*, *sh-*, *shpër-*, *stër-*.

Parashtesa *pa-*, duke u bashkuar me mbiemra, ose emra tregon mungesën e një tipari: *lesh i padredh*, *i pala:*, *i pashpla*, *i papjek*, *e paknaqme*, *i papu:n*, *i pashko:ll*, *i pakujdesshëm*, *i pada:l*, *i parru:*, *i pakref* etj. Kjo parashtesë përdoret edhe në formimin e emrave, si *papunsi*, *padrejtsi* etj., të cilët kanë hyrë nga gjuha standarde.

Prapashtesa *për-* u jep fjalëve të prejardhura nga foljet një kuptim intensiv: *përzã*, *përplas*, *përdredh*, *përla:j*, *përdaj* etj. Kjo parashtesë mund të dalë edhe në formimin e ndajfoljeve *përdhe*, *përba:ll*, ku në bazë të formimit kemi përngjitjen e një togu parafjalë + emër.

Parashtesa *shpër-* është prodhimtare në sistemin foljor; ajo nuk i ndërron kategorinë leksiko-gramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj një kuptim të ri plotësues:

---

<sup>63</sup> Shih: Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 169-170.

*shpërdaj, shplaj* (kjo fjalë ka gjasa që vjen nga *shpërlaj*, si një formë e sinkopuar), *shpërdredh, shpërvjel* etj.

Parashtesat *sh-*, *shp-* u japin foljeve kuptim të kundërt: *shkjep (shqep), shplodhem* etj.

Parashtesa *stër-* formon emra, folje si: *stërgjysh, stërnip, stërholloj, stërkis (stërpik)* etj.

## 2. Formimet prapashtesore

Kjo formë formimi është më prodhimtare dhe më e larmishme. Me anë të prapashtesave të ndryshme formohen emra, mbiemra, folje dhe ndajfolje prej po asaj pjese të ligjëratës apo edhe nga pjesë të ligjëratës.

### 2.1. Formimi i emrave

Prapashtesat që formojnë emrat dallohen për pasuri dhe shumllojshmëri kuptimesh. Më kryesoret janë: prapashtesa *-je* formon emra nga tema emërore: *thek-je (lloj qilimi), kām-je (këmbjet)* etj. Nga tema foljore me anë të kësaj prapashtese formohen emra abstraktë që tregojnë veprim ose gjendje: *dhim-je, lodh-je, prish-je, qeth-je, rrojt-je, smun-je* etj.

Prapashtesa *-im* duke u bashkuar me temën e kohës së tashme të foljeve që mbarojnë me *-oj, -ej* formon emra veprimi të gjinisë mashkullore: *mallkim, bekim, jodhnim* etj.

Me prapashtesën *-es* janë formuar, nga tema foljesh të zgjedhimit të parë:

a. emra që tregojnë rezultatin e veprimit ose të një gjendje: *feje:s, marte:s, shpre:s, vone:s, fite:s* etj.

b. emra konkretë që tregojnë një send ose një vegël: *kulle:s, mule:s* etj.

Me anë të prapashtesës (*ë*)s formohen nga tema foljore dhe emërore:

a. emra njerzish të karakterizuar sipas profesionit a punës që bëjnë: *shits, vjedhs, lyps, gryks* etj.

b. emra që tregojnë një vegël: *çelës, matës, haps* etj. Varianti i prapashtesës *-ës* është prapashtesa: *-(u)s*, i cili u prapangjitet pjesores së foljeve me togzanore të monoftongizuara: *msu:s, shkru.s, hetu:s, banu:s* etj.

Prapashtesa *-tar* formon emra që tregojnë njerëz të karakterizuar sipas një veprimi që kryejnë: *kujdestar, tregtar, krytar* etj

Prapashtesa *-a:r* formon kryesisht emra profesioni prej temash emërore: *kpucar, shkollar, lypsar* si edhe emra të banorëve të një vendi: *qytetar, korçar, kosovar* etj.



Me prapashtesën –*tur* (-*tor*) janë formuar emra vepruesish: *puntu:r*, *shërbtu:r* etj.

Me prapashtesën –*i*, –*ni* si formohen:

a. emra femëror, kryesisht prej mbiemrash e emrash që tregojnë veçori a cilësi abstrakte: *trimni*, *vllazni*, *dashni*, *miqsi* etj.

b. emra që tregojnë një periudhë të caktuar nga jeta e një njeriu: *pleqni*, *burrni*, *djelmni* etj.

Prapashtesa –*e.sh* formon emra mocioni, d.m.th. emra femërorë: *doktorresh*, *mretresh*, *trimnesh* etj.

Me anë të prapashtesës –*isht* formohen emra që tregojnë përgjithësisht vendin ku gjendet me shumicë sendi i emërtuar nga tema fjalëformuese: *ahi:sht*, *guri:sht* etj.

Prapashtesat –*xhi*, –*çi* të burimit turk formojnë emra profesionesh si: *sahatçi*, *sharrxhi*, *dyqanxhi*, *dyfekxhi* si edhe emra banorësh të një vendi: *krastaxhi*, *jabanxhi* etj.

Prapashtesat që shërbejnë për të formuar një emër me kuptim keqësues janë: –*acak*, –*ash*, –*osh*: *morracak*, *frikacak*, *rrenacak*, *qurrac*, *gjumash*, *kuqalosh* etj.

Prapashtesa –*oj* formon emra gjallesash: *mickoj*, *ulkoj*, *shipoj* etj.

Me prapashtesën –*as*, –*ak*, –*ar*, –*an* formohen emrat e njerëzve sipas vendit ku jetojnë ose prejardhja që ata kanë: *durrsak*, *bulqizak*, *beratas*, *korçar*, *burrels*, *tirānsa*, *matjan*, *dibran*, *shkodran* etj.

## 2.2 Formimi i mbiemrave

Në këtë kategori më prodhimtar është formimi i mbiemrave me anë të paranyjzimit e prapashtezimit e prapashtezimit njëkohësisht.

Prapashtesa (ë)t u prapangjitet temave

a. foljore: *i hapët*, *i prefët*, *i mçefët*, *i ordhët* etj.

b. ndajfoljore: *i kthi:llët*, *i ftohët*, *i vokët* etj.

Prapashtesa –*shëm* u prapangjitet temave: emërore: *i menshëm*, *i djeshëm*, *i simjetshëm* etj.

## 2.3 Formimi i foljeve

Formimi prapashtesor është më prodhimtari. Prapashtesa –o që, siç dihet është më prodhimtarja në sistemin foljor të shqipes, formohen një numër i madh foljesh nga tema:

a. emërore: *punoj, jetoj, fluturoj, sharroj* etj.

b. mbiemërore: *holloj, pastroj, rralloj* etj.

c. ndajfoljore: *teproj, afroj, bashkoj, shkurtoj, kthjelloj* etj.

f. foljore: *naloj*

Prapashtesa –to, formon folje kryesisht nga emra, si: *dëmtoj, pushkatoj*.

Prapashtesa –ro, –no formojnë folje nga tema emërore. *lavdroj, mretroj*.

Prapashtesa –so: *paksoj, egërsoj*.

Prapashtesa –zo: *lulztoj, kufizoj*.

Prapashtesa –os me të cilën janë formuar disa folje të zgjedhimitII:

nga tema emërore: *vendos, vulos, plagos, burgos, njollos* etj.

Në të folmen e Martaneshit gjenden disa lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e një emri: *llokna – llokna, feta – feta, cop – cop, topa – topa, si p.sh.: e dau llokna-llokna, e preu feta – feta, e bāni cop-cop, ishte bā hallma topa – topa* etj.

### Fjalët e përbëra (kompozitat)

Formimi i emrave. Pas prapashtesimit kompozimi është mënyra më prodhimtare në fjalëformim. Plotësuese janë kompozitat përcaktore. Më prodhimtar janë mbiemrat, si *zemërgur, shpirmir, fatzi, ditzi, jetgjat, zemërbardh, shpirtze:z* etj.

Gjatë krahasimit të tipareve kryesore fonetike dhe morfologjike të të fomes së Martaneshit me zonat përreth (Klosi, Zerqani, Dibra, Shëngjini i Madh, Elbasani, Belshi) vëmë re se këto të fome karakterizohen nga disa dukuri specifike që rrokin shumicën e tyre. Afria gjeografike e Martaneshit me këto zona ka sjellë edhe afrimin në tiparet gjuhësore herë me njërin pikë e herë me tjetrën. Rezulton se e folmja e Martaneshit, në tiparet kryesore të saj, shkon më afër të folmes së Elbasanit, të Belshit dhe Shëngjinit të Madh.

## **Ndikimi dhe depërtimi i gjuhës standarde në të folmen e Martaneshit**

Zhvillimi i sotëm i të folmeve popullore dhe përgjithësisht i dialekteve të shqipes nuk mund të shihet i shkëputur nga rrjedhat e zhvillimit dhe kaheve të përgjithshme, kulturore dhe mendore të bashkësisë shoqërore shqiptare shtetërore e më gjerë. Në mënyrë të veçantë ka luajtur rol arsimimi masiv, shtimi i peshës së mjeteve të informimit masiv (shtypit, radio-televizionit) dhe i lirisë së fjalës publike.<sup>64</sup>

Veprimi i gjuhës standarde mbi të folmet e ndryshme të shqipes asnjëherë nuk ka qenë më i madh se në periudhën që jetojmë. Është kjo një epokë e transformimeve të thella në të gjitha sferat e jetës sonë: ekonomike, politike, shoqërore, kulturore.<sup>65</sup>

Të gjitha të folmet janë vënë nën peshën e ndikimit të gjuhës standarde. Qoftë brezi i vjetër, qoftë brezi i ri në shkallë të ndryshme janë nën ndikimin e saj, sepse drejtimi i përgjithshëm i ndryshimeve dialektore, që vihet re kudo në truallin e Shqipërisë, është afrimi me gjuhën standarde. Ky proces ndikohet nga fakti se prirjet e sotme të zhvillimit të gjuhës shqipe në përgjithësi mëshërohen në gjuhën standarde shqipe. “Gjuha shqipe ka krijuar tashmë një sistem të vetëm që i takon një rrafshi më të lartë se ish-variantet letrare e dialektore dhe funksionon si një sistem i pavarur e tërësor i një tipi të ri”.<sup>66</sup>

Krahina e Martaneshit është një krahinë me traditat e saj të lashta me një popullsi të përzierë, sidomos pas viteve 70, për shkak të hapjes së minierës së kromit, që mbledhi në Martanesh njerëz nga qytete e fshatra të shumta të Shqipërisë.

Duhet theksuar se pjesa më e madhe e popullsisë së kësaj krahine, ashtu sikundër në të gjithë vendin tonë, e ka bërë e po e bën formimin arsimor, gjuhësor pikërisht në periudhën e kristalizimit të gjuhës standarde shqipe, se lëvizjet e kontaktet e popullsisë midis rretheve e qyteteve “u kanë shkukur rrënjët veçimit krahinor... i kanë shpërthyer grupimet e mbyllura etnografike-historike”.<sup>67</sup>

Veprimi i gjuhës standarde në të folmen e Martaneshit e ndihmon edhe fakti i kontakteve të vazhdueshme të popullsisë vendase me ardhasit e shumtë, duke filluar nga punëtorët e thjeshtë në minierë e deri tek kuadrot, që e kanë bërë edhe më të lehtë depërtimin e gjuhës standarde.

---

<sup>64</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, “*Sociolinguistikë e shqipes*”, Tiranë, Morava, 2009, f. 163.

<sup>65</sup> Shih: Xh. Gosturani, “*Struktura gramatikore e së folmes së qytetit të Elbasanit dhe leksiku i saj*”, Dialektologjia shqiptare VII, Tiranë, 2005, f.124

<sup>66</sup> Shih: A. Kostallari, “*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa problem themelore të Drejtshkrimit të saj*”, Tiranë, 1973, f. 33.

<sup>67</sup>Shih: A. Kostallari, vep.cit. f. 30

Me gjithë ndikimin intensiv të gjuhës standarde nuk ndodh zëvendësimi i thjeshtë i sistemit dialektor me sistemin e gjuhës standarde.<sup>68</sup>

Në Martanesh dallohet një e folme me fizionomi të qartë, karakteristike për popullsinë vendase, pak elemente nga të folmet e ardhësve nga zona të ndryshme të Shqipërisë, të përfaqësuar nga punëtorët e minierës, por edhe të familjarëve të tyre, sepse çdo individ mbart me vete në një shkallë apo në një tjetër, edhe të folmen nga ka ardhur.

Por qoftë e folmja e vendasve, qoftë e folmja e ardhëve, janë nën ndikimin e gjuhës standarde me anë të mjeteve të shumta të informacionit masiv me shkrim e më gojë.

Zhvillimi i dialekteve dhe ndikimi i gjuhës standarde mbi ligjërimet krahinore kryhet duke u dhënë shtysë dy proceseve të rëndësishme në lëmin e komunikimit, që janë: a) zgjerimi i funksioneve shoqërore të komunikimit me gojë dhe me shkrim dhe b) shtimi i numrit të bartësve të gjuhës standarde ose i variantëve “hibride” që synojnë të jenë të tilla.<sup>69</sup>

Gjuha standarde depërton sidomos tek brezi i ri, sepse është më së pari nën veprimin e vazhdueshëm të zhvillimit të arsimit, të kulturës e të shkencës.

Ndikimi i gjuhës standarde mbi të folmet e dialektet tek ne është edhe një proces i ndërgjegjshëm që buron nga politika gjuhësore e organizuar, në saj të së cilës kudo është bërë e qartë epërsia e gjuhës standarde. Tregues i qartë për këtë është shtresëzimi llojor stilistikor i së folmes dhe, veçanërisht, përpjekjet e ndërgjegjshme të folësve që, në situata e nivele të caktuara formale dhe jo, të flasin “më bukur” ose, siç thonë të moshuarit, “*me fo:l zyrtarçe*”.<sup>70</sup>

Duke shfrytëzuar materialet e vjela në terren nga martaneshasit, si dhe duke u bazuar në shqyrtime sociolinguistike, kemi parë marrëdhëniet midis dy varieteteve: gjuhës standarde dhe varietetit dialektor të së folmes së Martaneshit. Të dhënat i kemi mbledhur nga folës dhe breza të ndryshëm, përkatësisht: folës të brezit të vjetër (individë që i përkasin afërsisht moshës mbi 65 vjeç), folës të brezit të mesëm (individë që i përkasin moshës 40 vjeç e lart) dhe folës të brezit të ri (individë që i përkasin afërsisht moshave të reja mbi 15 vjeç).

Kahu ynë i kërkimeve është mbështetur mbi faktorët sociolinguistikë, si pasojë e ndikimit të faktorëve jashtëgjuhësor. Përfundimet tona janë fryt i mbështetjeve të herëpashershme

---

<sup>68</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes”, Tiranë, Morava, 2009, f.167.

<sup>69</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes”, Tiranë, Morava, 2009, f. 170.

<sup>70</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes”, Tiranë, Morava, 2009, f. 165.

në boshtin e trajtimeve që shkojnë sipas formulës së Fishmanit: “*Kush flet, me kë, kur, për çfarë dhe në cilin varietet?*”<sup>71</sup>

Ndikimi i gjuhës standarde ndihet në të folmen e Martaneshit gjithnjë e më tepër në ligjërimin e organizuar mirë, në mbledhje, biseda e takime zyrtare, ku njerëzit mundohen të flasin “*mirë*”.

Gjurmët e ndikimit e depërtimit të gjuhës standarde i takojnë jo vetëm brezit të ri, por edhe brezit të mesëm dhe të vjetër dhe jo vetëm në elemente të reja leksikore që hyjnë çdo ditë, por edhe me dukuri fonetike: krahas *t’nalta* dëgjojmë edhe *të larta*, krahas *mu:r* dëgjojmë edhe *mori*, krahas *karrvati* dëgjojmë edhe *krevati* etj.

Tani do të trajtojmë ndikimin e depërtimit të gjuhës standarde në të gjitha nënsistemet e së folmes së krahinës së Martaneshit.

1. Ndikimet më të dukshme të gjuhës standarde duken në leksik. Kjo shpjegohet me faktin se nga të gjithë nënsistemet e gjuhës, leksiku është më i lëvizshëm; ai pasqyron të gjitha ndryshimet që bëhen në jetën politike e shoqërore, ekonomike e kulturore të një populli: shfaqen fjalë të reja që emërojnë sende e dukuri e raporte të reja, dalin jashtë përdorimit fjalë të vjetra, që lidhen me emërtimin e sendeve e të fenomeneve që nuk përdoren më.<sup>72</sup>

Gjuha synon t’u përshtatet përherë e më mirë nevojave kumtuese të folësve. Mirëpo, këto nevoja kumtuese janë të lidhura me shkollimin, me arsimimin, me kulturën dhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë, të cilët, veç e veç e së toku, i shtrojnë njeriut nevoja më të mëdha kumtuese, për plotësimin e të cilave atij i lypset një sasi më e madhe mjetesh për t’u shprehur.<sup>73</sup>

Që të dilet në një përfundim të saktë, duhet njohur gjithashtu pasuria leksikore e së folmes. Duhet dalluar mirë leksiku i përbashkët me atë të gjuhës standarde, që përbën sasinë më të madhe të leksikut të së folmes, sepse, në strukturën fjalëformuese e leksikore të shqipes standarde, afria e dialekteve është më e madhe se në fonetikë.<sup>74</sup>

Zakonisht, ka dallim të dukshëm midis folësve të një brezi më të moshuar, folësve të një brezi të mesëm dhe atij të ri. Sigurisht nuk mund të bëhet fjalë për dallime rrënjësore, pasi pjesa më e madhe e fjalëve që përdoren janë të njëjta. Fjalë të tilla si: *ha, fle, punoj, këndoj, shoh, flas, dëgjoj, qesh, qaj, lind, vdes, derë, orë, valixhe, filxhan, kalendar* etj., kanë mbetur të pandryshueshme njësoj si në fjalorin e mbarë shqipes. Edhe emërtimet e

---

<sup>71</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistika, SHBLU, Tiranë 2003, f. 13.

<sup>72</sup> Shih: Xh. Gosturani, “Struktura gramatikore e së folmes së qytetit të Elbasanit dhe leksiku i saj”, Dialektologjia shqiptare VII, Tiranë, 2005, f.130.

<sup>73</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 16*

<sup>74</sup> Shih: Xh. Gosturani, vepër e cit. f. 130.

pjesëve të trupit të njeriut, si: *kokë, flokë, qime, qafë, zverk, hundë, faqe, ballë, buzë, vesh, fytyrë, gojë, sy, qerpik, qepallë, vetull, sqetull, fyt, gurmaz, grykë, gjoks, kraharor, zemër, plënc, dorë, gisht etj.*, kanë mbetur të pandryshuara në aspektin leksikor, por janë shoqëruar me ndryshimet fonetike përkatëse, duke përfutuar në këtë rast vetëm forma fonetike dialektore. Për emërtimet *kokë dhe kry*: mund të themi se i pari gjen përdorim më të shpeshtë në qytetin e Krastës, duke përfshirë këtu edhe brezin e vjetër (në disa raste), ndryshe nga emërtimi *kry*: që ndeshet kryesisht në fshatrat e Martaneshit, shpesh edhe te brezi i ri. Megjithatë fjala *kry*: në kontekste të caktuara si te: *ko:m e kry:*, *krylop etj.*, shfaqet edhe te të rinjtë e qytetit.

Dimë se në leksik ka dy lëvizje kryesore: krijohen dhe hyjnë fjalë të reja dhe dalin nga përdorimi fjalë të vjetëruara. Edhe në trevën e Martaneshit shohim se në brezin e vjetër, ndonjëherë edhe në atë të mesëm, gjejmë shumë fjalë dhe shprehje të cilat brezi i ri nuk i përdor, por i ka zëvendësuar ato me fjalë të tjera që janë më pranë shqipes së sotme standarde. P.sh.: në leksikun e tyre përfshihen turqizma të tilla si: *sebeq, (bo) gajret, (boni) selôm, (i ra) qarit, vallahin, defter, kalem, hyzmeqar, xhevap, mhyr, qitap etj.*, të cilave u përgjigjen fjalët: *shkak, rast, mos u mërzit, boi t'fala, fitim, për Zotin / vallahin, fletore, laps, nimës / shërbëtor, lajm, unazë, libër / qitap etj.*, që ndeshen te brezi i ri dhe më pak tek ai i mesëm, meqenëse këto fjalë të fundit kanë qenë më të gjalla dhe jetësore (është rasti kur sendi a dukuria që shprehin ato, kanë rëndësi për gjithë shoqërinë dhe kanë përdorim më të shpeshtë). Po kështu ndeshen dhe fjalë e shprehje të tjera, të cilat janë zëvendësuar nga brezi i ri. Ky kalim nuk është i menjëhershëm, pasi në fillim ato kalojnë në shtresën pasive dhe me kalimin e kohës kjo ua ngushton përdorimin dhe i kthen më fjalë të vjetëruara. Ndaj, më poshtë po paraqesim disa nga to duke u pranëvënë fjalët përkatëse për secilin nga tri brezat e folësve, përkatësisht i vjetër, i mesëm dhe i ri:

Brezi i vjetër	Brezi i mesëm	Brezi i ri
Kalem	Laps	Laps, stilolaps
Xhins	Rracë	Rracë
ri:c	ricë	Acar
Yzër	me ba:rr	shtatzo:n
Mide	Oreks	Nuk kam uri
Setër	Xhaket	Xhaketë
Çini	Pjatë	Pjatë

Shpirtse	Shkrepse	Shkrepse
Jatike	Pagure e vogël	Bidon i vogël
Mxhëvij	Kalamoj	Fmij
Fraq	Fraq	Ftohët
Befi	Erdh	Erdh
Kërkos	ifet	shet men
Tra:js	Tra:js, qese	Qese
Tesha	Rraqe	Rroba
Flõçk	E xehët	E xehët (e nxehtë)
Mathere	Athere	Athere
Llagap	Mbiemër	Mbiemër
Jodhnu	I kishte el hatri	Zemru:
Mitõn	Jelek	Jelek

Por, përveç fjalëve të mësipërme, theksojmë gjithashtu se, në brezin e vjetër ndeshin edhe shprehje të caktuara, të cilat kanë rezultuar disa herë të padëgjura dhe disa herë të papërdorura nga të rinjtë, edhe pse disa prej tyre i njihnin. Vlen të përmendim disa prej tyre në kontekste sintaksore ashtu siç janë ndeshur, duke i shoqëruar me kuptimet përkatëse:

*Ja ka p̄kut kryt t'et – i ngjan shumë babait të tij.*

*Aja që nisi, i du:l me kry: - ia doli mbanë.*

*S'kām pi:k takatje – s'kam fuqi, mundësi.*

*U munu mjaft po s'qiti gjõ me kry: - bëri çbëri, nuk ia doli dot.*

*Bõfsh hajër, ta bõfshin kalamojt e tu – të shërbefshin fëmijët e tu kështu.*

*Kshtu si ma bo ti mu, ta bõfshin fmit e tu – këtë të keqe që po më bën mua, ta*

*kthefshin fëmitë nesër.*

*Ç't'bōjsh ta bōjn e ta teprojn – atë që bën sot, më keq do ta kthejnë nesër.*

*Aj s'ka i kryq n'xhep – nuk ka para.*

*Aj hiqet se ka, po se ka i dysh n'xhep – s'ka lekë.*

*Çna e pru: Zoti i ktu n'de:r, ta kishje larg e mo larg – në kuptimin të mos e kem afër.*

*Qoft larg ships, mos e paçim afër – në kuptimin që njeriun e keq ta keshë sa më larg.*

*M'ka vojt menja për x ( diçka për të ngrënë), që mo sa m'ka plas buza – kam neps*

*për x.*

*Aj bërtet sa m'kry. ka – thërret me zë të madh dhe të lartë.*

*Atë që kërkoi, atë gjet – mori atë që meritonte.*

*Bōi hyzmet kalit tāt – mos u merr me punët e tjetrit.*

*Bō hyzmet njasaj qi ke – merru me punët e tuaja.*

*S'ke faj ti, se at' shpull e ha un – faji bie mbi mua.*

*Aja gru rri grenëz - e mban veten, vishet bukur.*

*Aja ishte gjōja për t'u pa – ishte shumë e bukur.*

*Kishte thi:rr n'darsm tuli farsoj – lloj- lloj njerzish.*

*Ka shku: n'shumlli<sup>75</sup>- ka vdekur.*

*Njeri pa hatikat – njeri i pabesë.*

*Aj punon si nallbōn<sub>1</sub> - punon shumë.*

*Aj punon si nallbōn<sub>2</sub> – bën punë shkel e shko.*

Gjithashtu, fjalë të urta si: *Zakon e adet, shpi e marifet; Ka s'i shko çorapi s'i shko ope a; Atë që ke për ta ba nesër, baje sot; Iqin hile, i trimni: Ç'i shef s ni ja ba dora etj.,* ndeshen shpesh në gojën e më të mëdhenjve dhe shumë rrallë në brezin e ri, kryesisht te

---

<sup>75</sup> Shumlli quhet vendi ku ndodhen varrezat dhe, për këtë arsye, përdoret shprehja „ka shku n'shumlli“ në kuptimin që ka vdekur.



ata të rinj, të cilët janë rritur pranë gjyshërve të tyre. Madje, përveç këtyre, ata njohin dhe përdorin edhe fjalë karakteristike të brezit më të vjetër, disa nga të cilat ne i paraqitëm në tabelën më lart.

Në leksikun e përbashkët që e ka e gjithë shqipja, në të folmen e Martaneshit, ashtu sikur edhe në të folme të tjera, në anën tingullore të fjalës, degëzimi dialektor ka lënë gjurmë fonetike, si: rënia e ë-së së patheksuar, asimilimi i grupeve *mb, nd, ng, ngj*, ruajtja e *n*-së intervokalike, shurdhimi etj. P.sh., po të krahasojmë fjalët: *bu:k, flo:k, fu:sh, lo:p, mo:ll, shi:*, etj., që i kemi regjistruar në të folmen e Martaneshit, me përgjegjëset e tyre në gjuhën letrare, përkatësisht, *bukë, flokë, lopë, mollë, shi* etj. shohim dallime thjesht fonetike që nuk kanë vlerë fonologjike.

Në të folmen e Martaneshit vihet re edhe një leksik specifik dialektor, ku hyjnë fjalët që i përkasin vetëm kësaj të folmeje ose mbarë grupit ku bën pjesë ajo. Ky leksik lidhet me karakterin ekonomik dhe veçori të tjera të zonës. Janë veçori për të folmen që kemi objekt studimi fjalë të tilla: *āni (s'ka problem), amëz (shija e një ushqimi), òmëlshtiq (që ka një shije disi të ëmbël), òrdhò et (bymeht), jarrina (erdha), qellem (vonohem), buxhaku (qoshja e dhomës), bardaku (gotë uji,) buzul (ortek bore)* etj.

E folmja e Martaneshit ka thithur vazhdimisht fjalë e mënyra të reja të thëni nga gjuha standarde për nevoja të reja që lindin në të. Sigurisht këto fjalë nuk kanë një denduri përdorimi të njëjtë në të gjithë brezat. Brezi i ri i ka përqaftuar ashtu siç janë në gjuhën letrare, ndërsa në brezin e vjetër nuk kanë mbetur pa ndonjë ndryshim të trajtës fonetike, sidomos mostheksimi i ë-së së patheksuar: *mledhje, kshi:ll, veni etj.*

Ka raste të shumta ku fjalë spspecifike për këtë të folme ia kanë lënë vendin fjalëve të leksikut letrar si psh: *i afishëm- i dobët, i thatë; amza-shija; bardak-gotë; bgò-infektoj; bigorri-pisllëk; blòj-pollgë; çini-pjatë; cyt-ngacmoj; elvedi-leverdi; fullkat-vetëm; jarrina-erdha; jataku-dysheku; namuzi-nderi; palit-palos; qellem-vonohem; shafis-zhduk; shpirtëse-shkrepëse; sira-radhë; varde-shpërda; yrnek-nazeli; zidòn –siklet* etj.

Në brezin e ri, por edhe në atë të mesëm, paralelet e para dëgjohej rrallë; vendin e tyre e kanë zënë paralelet e dyta, të cilat nuk mungojnë as në brezin e vjetër. Pra faktorët jashtëgjuhësor (shkolla, arsimit, kultura, botimet, media), çojnë peshë në procesin gjuhësor.

2. Ndikimi më i dukshëm i gjuhës standarde në leksik është bërë përçues i fuqishëm për integrimin e veçorive fonetike. Fjalët dhe termat e reja që hyjnë nëpërmjet gjuhës standarde, dallohen ndonjëherë nga një ngjyrim dialektor.

Kjo shpejgohet me faktin se fuqia ndikuese e gjuhës standarde në fonetikë është më pak e ndjeshme se në leksik.

E folmja e Martneshit karakterizohet nga gjatësia dhe hundorësia e zanoreve. Në rastet me *ā* hundore, së cilës në gjuhën standarde i përgjigjet zanorja *ë*, depërtimi i gjuhës standarde është më i ngadalshëm. Megjithatë shtresëzimi leksikor prek më shumë ato fjalë që kanë përdorim më të dendur si: *bāj-běj, zāni-zëri* etj.

Shtresëzimi dialektor vepron edhe për zanoret e tjera hundore , *ō*, , . Nën ndikimin e gjuhës standarde, sidomos në brezin e ri, ka raste të tëra pa hundorësi, duke u zëvendësuar trajtat dialektore me ato letrare si: *kall -kalliri, fr ma-fryma, sōnte-sonte* etj.

Janë mënjanuar në brezin e ri e të mesëm, nën ndikimin e gjuhës standarde, rastet e kalimit të zanores *u* të patheksuar në *ë* dhe të reduktimit të saj deri në zero. Kështu, krahas trajtave të brezit të vjetër, *flutër-flutur, popëll-poplli, vetëll-vetlla* kemi edhe trajtat e brezit aktiv: *akull-i, flutur-a, vetull-a* etj.

Në ato fjalë ku zanorja *i* është buzorëzuar në *y*, *si rryp, qylym, kry:p, fry:k*, në brezin aktiv, në rininë shkollore, shqiptohet me *i*: *rrip, frikë, kripë* etj.

Sistemi i bashkëtingëlloreve është pothuajse identik me sistemin e fonemave bashkëtingëllore të gjuhës standarde. Ndryshim ka vetëm në përfitimet e grupeve *ng* që ka dhënë . Për t'u rrafshuar, nëpërmjet proceseve të ndryshme, me gjuhën standarde mbeten përveç shqiptimit të plotë të grupeve të bashkëtingëlloreve, edhe rastet e neutralizimeve të *h* në *f*, *nj* në *j* etj. Akoma më pak ka depërtuar rotacizmi.

Përgjithësisht ndikimi i gjuhës standarde sjell rrafshime, në radhë të parë, mbi fjalët që kanë denduri përdorimi.

3. Dialektet e gjuhës shqipe nuk kanë dallime të shumta thelbësore në strukturën gramatikore. Evoluimi në strukturën gramatikore është më i ngadalshëm dhe më pak i shtrirë se në sistemin leksikor:
  - a. Nën ndikimin e gjuhës standarde nuk dëgjohen më në gjininë femërore emrat: *tulja, shnetja, pylla, nerja* etj., që në brezin e ri dhe të mesëm dalin në gjininë mashkullore: *tuli, shneti, pylli, neri*.
  - b. Gjithnjë e më tepër po dalin nga përdorimi emrat asnjëse, që në brezin e ri dhe të mesëm dalin përkatësisht në gjininë mashkullore dhe në atë femërore: *djathët, dhjomët, millët, ujt, grunët* etj.
  - c. Kanë dalë nga përdorimi te brezi i mesëm dhe i ri trajta e gjinore-dhanores pa *v* epentetike: *gishtat e duret*, si dhe përdorimi i së ashtuquajturës rasë vendore, si: *n'kafet, n'shpit* etj.
  - d. Po ndihen gjithnjë e më pak në brezin e mesëm përdorimi i mbaresave të vjetra të së pakryerës të foljeve të zgjedhimit vepron (*-jim, -jit, -jin-shkojim, shkojit, shkojin*).

- e. Nuk ndihet më as në brezin e mesëm dhe as në atë të ri forma sigmatike e së kryerës së thjeshtë të vetës së parë, njëjës, pësore: *u msush, u kujtush, u martush* etj. Këto trajta janë zëvendësuar me normat letrare: *u martova, u mësova, u kujtova*.

Ndikimi i gjuhës standarde mbi dialektet dhe të folmet bëhet çdo ditë e më i fuqishëm.

## **Shqyrtime sociolinguistike rreth etnografisë së të folurit në krahinën e Martaneshit**

Për herë të parë dhe në plan të gjerë shqyrtime sociolinguistike në vendin tonë janë zbatuar në studimin e së folmes së qytetit të Lezhës, duke dalluar aty pranëvënien e disa të folmeve të ndryshme.<sup>76</sup>

Gjuha, si kod apo sistem historiko-natyror, nuk është një bllok monolit. Ajo pëson ndryshime gjatë rrjedhës së kohës (diakronikisht), po ajo ndryshon dukshëm edhe në sinkroni, sepse, në fakt, një gjuhë nuk është tjetër veçse tërësia e varieteteve gjuhësore në të cilat ajo na shfaqet.<sup>77</sup>

Bashkësia shoqërore është e formuar nga shumë grupe shoqërore, që, ndonëse e ndiejnë veten si pjesë të së njëjtës bashkësi shoqërore, janë, shpesh, në kundërshtim apo dhe në antagonizëm me njëri-tjetrin.<sup>78</sup> Një nga grupimet është edhe ai gjeografik. Për të folmen e Martaneshit me rëndësi është studimi i të folmes në qytetin e Krastës, si qendër urbane, ku mblidhen e grumbullohen banorë vendas dhe të ardhur nga rrethinat, shpesh edhe nga vise të largëta (miniera e kromit ka mbledhur shumë banorë të ardhur nga vise të ndryshme, të cilët jetojnë dhe punojnë në këtë qytet prej vitesh). Këtu, natyrisht, kanë vendin dhe peshën e tyre shtresat e ndryshme sipas profesioneve, që kanë element gjuhësorë të caktuara, po kështu gjuha e shtypit dhe e mendiave, që marrin përditë e më shumë vend e forcë ndikuese; gjuha e shkollarëve, e atyre që punojnë me librat dhe shumë të tjerë.

### **1. Grupimi i njerëzve sipas moshës dhe varacionet gjuhësore përkatëse**

Në kërkimet empirike që janë bërë rreth gjuhës së qyteteve dhe qendrave të mëdha urbane, po, edhe në përgjithësi, qysh nga anketimet gjeolinguistike ka dalë në pah pak a shumë qartë se ligjërimi i bashkësive shoqërore, etnikisht homogjene, paraqet variaione sipas brezave.<sup>79</sup>

Mosha është konsideruar si një nga faktorët natyrorë të diferencimit dhe diversitetit të sjelljes gjuhësore të individëve. Brenda një bashkësie shoqërore ekzistojnë edhe dallime midis brezave. Me këtë faktor të rëndësishëm sociolinguistik janë marrë studiues të huaj si Ruth Rajshtajni, i cili, më 1960 në Paris, analizoi përdorimin e tri kundërvënieve fonematike, përkatësisht: /a:/ - /a/; /e/ - /é/; /i/ - /î/ që duhej të përbënin një tregues të ndryshimeve nga njëri brez në tjetrin. Po kështu edhe Labovi, i cili, në bazë të përvojës së mjedisve anglofone, ka nxjerrë përfundimin se “të rriturit zotërojnë një numër më të

---

<sup>76</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës, në “*Studime Filologjike*”, 1981, 3, f. 155-163 dhe “Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës”, në “*Sudime Filologjike*”, 1984, 2, f. 75-93.

<sup>77</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “*Sociolinguistikë e shqipes*”, Morava, Tiranë, 2009, f.105.

<sup>78</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “*Sociolinguistikë e shqipes*”, Morava, Tiranë, 2009, f. 113.

<sup>79</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “*Sociolinguistikë e shqipes*”, Morava, Tiranë, 2009, f. 117.

vogël variantesh të stigmatizuara sesa të rinjtë”. Gjithashtu, ai vuri re se të rriturit e shtresës së mesme e përdorin standardin në mënyrë relativisht të rregullt (...). Të rriturit e klasës punëtore pjesërisht u përshtaten normave standarde, pjesërisht priren të përdorin anglishten e folur të zezakëve, kurse të rinjtë flasin në mënyrë sistematike dhe kategorike standardin.<sup>80</sup>

Edhe në vendin tonë, janë bërë një numër i konsiderueshëm studimesh për dallimet midis brezave të folësve duke filluar nga disa trajtime të përgjithshme të marrëdhënieve dialekt – gjuhë standarde të bëra nga Jorgji Gjinari e deri në disa hetime e rezultate më të qarta (për këtë çështje) në studimet për të folmen e Lezhës nga Gj. Shkurtaç dhe të qytetit të Elbasanit nga Xh. Gosturani.

Gjuha standarde, si një gjuhë mbikrahinore, ngihet mbi dialektet për të formuar një sistem të vetin me normë të njësuar për mbarë kombin. Pasi lind e formohet gjuha standarde, dialektet futen në marrëdhënie me këtë variant të ri të gjuhës së përbashkët. Këto marrëdhënie janë të ndryshme dhe dialtike, në maasë dhe drejtim veprimi të ndryshëm në periudha të ndryshme. Në periudhën kur është duke u formuar gjuha standarde kahu kryesor i drejtimit të veprimit shkon nga dialektet në gjuhën standarde, sepse kjo në këtë kohë mbruhet duke e marrë lëndën nga dialektet. Pas formimit të gjuhës standarde veprimi kalon me forcë të madhe nga gjuha standarde mbi dialektet për afrimin e tyre, megjithatë edhe në këtë kohë dialektet mbeten përsëri si një burim për pasurimin e mëtejshëm të gjuhës standarde.<sup>81</sup>

Nga studimet e bëra është vënë re se “ligjërimi i bashkësive shoqërore etnikisht homogjene, paraqet variacione sipas brezave. Zakonisht të rinjtë flasin në mënyrë të tillë që dallohen nga të moshuarit, ndonjëherë edhe duke përdorur kode apo nënkode të tyre, të huaj për brezin më të moshuar...”.<sup>82</sup>

Në punimin tonë na është dukur me interes të hetojmë për këtë faktor, duke e parë këtë të shtrirë dhe veprues në gjuhën e folësve të krahinës së Martaneshit.

Duke vijuar dhe duke u mbështetur në ato pak studime të bëra për të folmen e Martaneshit dhe duke e ballafaquar atë me të folmen e sotme të kësaj krahine, në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se nuk kanë ndodhur shumë ndryshime këta dhjetëvjetëshat e fundit. Megjithatë, duke marrë parasyshë karakterin gjithnjë inovues të gjuhës, si dhe një sërë faktorësh të tjerë që kanë ndikuar në gjuhë (p.sh. flukset e dukshme dhe të padukshme), jemi përpjekur të parashtrijmë disa nga ndryshimet më kryesore në të folmen e Martaneshit në aspektin fonetik, morfologjik, sintaksor dhe leksikor ndërmjet brezash të moshave të ndryshme. Duhet të theksojmë se, ndryshimet

---

<sup>80</sup>Shih: Gj. Shkurtaç, “*Sociolinguistikë e shqipes*”, Morava, Tiranë, 2009, f. 118.

<sup>81</sup> Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 248-249.

<sup>82</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003, f. 154.

më të mëdha midis brezave i vëmë re më shumë në leksik, fonetikë, morfologji dhe më pak në sintaksë.

Shqyrtime rreth risive dhe situatës leksikore i kemi trajtuar më lart në sythin “*Veprimi dhe depërtimi i gjuhës standarde në të folmen e Martaneshit*”, ku kemi trajtuar dallimin midis brezave.

### **Grupimi i njerëzve sipas gjinisë**

Dallimi i njerëzve sipas seksit është një nga variabilet e rëndësishme në sociolinguistikë. Nga kërkimet e derisotme del se gratë flasin në mënyrë të ndryshme nga burrat. Dendur ato kanë edhe një leksematikë të tyren, e cila, në përgjithësi, sidomos për dukuri e pjesë intime të jetës femërore, po edhe në përgjithësi në të folmen e përditshme, dallohen nga meshkujt, qoftë edhe nga bashkëshorti apo bijtë e rritur.<sup>83</sup>

Gjinia është një nga faktorët natyrorë me vlera socio dhe etnolinguistike. Ajo është bërë objekt studimi për gjuhësinë duke filluar nga Fisheri, i cili qysh më 1958 ka përmendur dhe argumentuar praninë e një varieteti gjuhësor të lidhur me situatën dhe seksin (sipas tij, mbaresa *-ing* është karakteristike e ligjërimit femëror dhe *-in* e ligjërimit të meshkujve në analizën e tij gjuhësore që bëri në një fshat të Nju Englandit). Vlerësime mbi gjininë kanë dhënë edhe Lebovi, Shui dhe Fasold, pohimet e të cilëve përkojnë me ato të Fisherit.

Edhe në vendin tonë nuk mungojnë studimet për faktorin sociolinguistik të gjinisë, ku janë shtruar disa hipoteza se shqiptimi i fonemës /rr/ si një dridhëse /r/ është më e dendur në seksin femër, sesa në meshkuj dhe se fonemat me /r/ janë më të shpeshta në gjuhën standarde, dhe, ndoshta një farë treguesi i të qenit nga kryeqyteti e nga qytete të tjera të Shqipërisë Jugore, ndërsa /rr/ shumë dridhëse tërheq më përpjetë nga në trevat veriore.<sup>84</sup>

Edhe për këtë ndryshor të rëndësishëm sociolinguistik, në punimin tonë, do të përpiqemi të realizojmë një studim për të folmen e Martaneshit, që besojmë se do të shfaqë interes për studimet e mëvonshme sociolinguistike në vendin tonë.

Faktorë të ndryshëm shoqërorë kanë bërë që niveli i punësimit të grave të bjerë, pasi ndryshimet demokratike në vendin tonë sollën edhe mbylljen e fabrikave, ku ishin punësuar një numër i konsiderueshëm i grave, pjesa më e madhe e të cilave sot janë shtëpiake. Në fakt, dashur pa dashur, ky fenomen shoqëror ka ndikuar edhe në të folmen e qytetarëve të Krastës, por edhe të fshatrave përreth, pasi gratë, ndryshe nga më parë, i janë mënjeluar vetvetiu kontaktit të tyre të përditshëm. Kjo çon në atë dukuri që në

---

<sup>83</sup> Shih: Shih: Gj. Shkurtaç, “*Sociolinguistikë e shqipes*”, Morava, Tiranë, 2009, f.115-116

<sup>84</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003, f. 240.

gjuhësi merr emrin „ konservatorizëm“. Pra, “besohet se, në përgjithësi, gratë janë më konservative se burrat, por, kjo nuk është dëshmuar shkencërisht,,<sup>85</sup> Nisur nga ky përfundim, ne vëmë re se edhe në Martanesh, kryesisht në qytetin e Krastës, një qytet relativisht i vogël dhe jo shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimeve shoqërore, në përgjithësi gjen zbatim ky lloj përkufizimi.

Kështu, këtë dukuri e kemi vënë re te gratë e moshës mbi dyzet vjeç, në leksikon e të cilave mbizotërojnë ende fjalë, forma fjalësh a shprehje të një të folmeje më pak inovuese të qytetit. Dhe, duke i’u përmbajtur formave apo varieteteve të të folurit<sup>86</sup>, themi se gratë në këtë qytet ruajnë varietetin tradicional ku spikat ruajtja e elementëve të qëndrueshëm të sistemit të vjetër. Theksojmë se, këtu bëhet fjalë kryesisht për femra me nivel arsimimi 8- vjeçar dhe të mesëm që nuk janë „rrahur“ aq shumë me situata të ligjërimin standard

Duke vënë në dukje edhe rolin e rëndësishëm që luan komunikimi masiv, media e shkruar dhe ajo televizive në modelimin e së folurës së grave në qytet.

Ndryshe me brezin e ri të po kësaj gjinie, duket se në këtë aspekt gratë dalin më konservatore se vajzat në gjuhën që flasin dhe përdorin. Këto të fundit janë më të ndjeshme ndaj ndryshimeve shoqërore e gjuhësore. Ata arrijnë të përshtaten me situatën dhe gjuhën që përdor bashkëbiseduesi. Këtu dalim te ideja e At Justin Rrotës rreth mundësisë që ka njeriu për ta “*dredh gjuhën*” sipas rastit të bashkëbiseduesit . Edhe te ky brez i ri vëmë re se pa dashur kanë hyrë në fjalorin e tyre fjalë të huaja të tilla si: *ok, ciao, bye, see you, thanks, grazie, sorry* etj. Në këtë fenomen kanë ndikuar mjaft edhe flukset e padukshme, që në një mënyrë a tjetër, çojnë shpeshherë në përdorime të gabuara të fjalëve të caktuara.

Këtë dukuri e kemi vënë re në një sprovë që kemi bërë duke improvizuar një intervistë si të ishim gazetarë të një stacioni radiofonik.<sup>87</sup> Nga ana tjetër me anë të këtij improvizimi, jemi përpjekur t’i qasemi një nga katër pikave që sociolinguistë të ndryshëm mendojnë se lidhet me larminë a varietetet të ndryshme të së njëjtës gjuhë<sup>88</sup>. Nga kjo rezultoi se gratë e moshës 40-vjeçare e kishin më të vështirë të arrinin shprehshmërinë në intervistë duke mos pasur rrjedhshmërinë e duhur. Madje, tek ato janë shfaqur më shumë elementë të nrytimit ligjërimor të tipit nënstandard, si: *ë....., mm*, si edhe ndalesa relativisht të gjata në krahasim me vajzat që i përkasin brezit të ri.

Ndryshe ndodh në folës të seksit tjetër, pra të meshkujve. Këta janë shumë më të aftë për të dalë nga situata të tilla. Sidomos mesoburrat arrijnë të artikulojnë më së miri fjalë në formën e tyre të njësuar brenda fjalive. Megjithatë, nuk mund të themi se ajo arrihet

<sup>85</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003, f. 239.

<sup>86</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003, f. 239

<sup>87</sup> Tekstet i kemi paraqitur të shkruara në fund të punimit tonë.

<sup>88</sup> Sih: Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003, f. 239

plotësisht, pasi ka edhe përdorim të fjalëve të gjuhës jostandarde, por në një masë më të vogël krahasuar me dendurinë e përdorimit të tyre te femrat. Lidhur me djemtë e brezit të ri, themi se këta, më pak se femrat e së njëjtës moshë, nuk arrijnë të flasin shumë mirë gjuhën standarde. Ata nuk arrijnë të krijojnë një ligjërim të rrjedhshëm dhe gjatë intervistës ndreqin fjalët siç duhet t'i thonin në fillim.

Për të arritur në një vështrim sintetizues të së folmes së femrave në ndryshim nga ajo e meshkujve në qytetin e Krastës por edhe në fshatrate e tjerë të Martaneshit, duke mos u mjaftuar me ato çka thamë më lart, më parë do të na duhej të ecnim në gjurmët teorike të lëna nga studiuesit e sociolinguistikës në vendin tonë kohët e sotme.

Për nga sasia e të folurit gratë janë cilësuar si “më të pakursyera në të folur, dhe kjo, me kohë, bëhet edhe si një tipar i tyre dallues, ndërsa meshkujt bëjnë më shumë punë që kërkojnë mund, përqëndrim... janë më fjalëpакë, më të heshtur në punë, për pasojë edhe më të kursyer në fjalë edhe jashtë punës”<sup>89</sup> si edhe “burrat e vërtetë, si rregull nuk janë shquar për fjalë të tepërta, nuk merren më me “*më the e të thashë*”. Thashethemet apo thashethuqet kanë pasur si autorë kryesorë gratë.”<sup>90</sup> Përkrahë këtij përfundimi shkon edhe një shprehje popullore për gratë, e njohur në Martanesh: “*Dy gra prishin i katun*”; në kuptimin që ato flasin shumë e merren me thashetheme dhe nuk reshtin së foluri gjatë gjithë kohës. Si vazhdim i kësaj ideje, pritet të arrijmë në përfundimin se e folmja e grave duhet të paraqitet më inovuese, mirëpo, nga disa anketa tonat që i kemi shpërndarë kryesisht te gratë me nivel të mesëm arsimit, del se pjesa dërrmuese e tyre e kalojnë kohën e lirë duke llafosur me njëra – tjetrën për punët e shtëpisë, për telenovelat që ndjekin, duke lënë mënjanë edicionet informative të lajmeve, dokumentarët historikë e kulturorë që do të përbënin një lloj ndikimi për prirje më tepër inovuese drejt standardit në të folmet e tyre.

Tipike për gjuhën e grave edhe frazologjizmat që ato përdorin. Me denduri të madhe janë mallkimet si p.sh.: *T'çaft uku! T'shtifsha n'dhe! T'plaçin sy:t e ballit! T'dalshin sy:t kallup, T'dalshin tomthat! Lonsh o:jn gjith ka shkofsh! Mos u bofsh, T'u thafshin durët n'rronzët! T'lshofsha Zotn! T'zon rrylën! T'hort mortja! T'pift gërdeci! Mos gdhifsh për dri:t jarebi! T'shplaft panuklla! T'qi:t Zoti ment! T'shplaft mortja! T'vraft Zoti! Mos gdhifsh nor nesër etj., që te meshkujt nuk ndeshen aspak. Këto mallkime i kemi dëgjuar edhe nga goja e nënës për fëmijën e saj kur është e nxehur me këtë të fundit. Pasi është qetësuar, nëna përsërit shpesh: *Tebestefkulla*, si për ta kthyer mbrapsht mallkimin. Në fakt nga kjo shprehje përftojmë idenë se gratë mallkojnë më shumë se burrat dhe se mallkimi i tyre nuk mund të ketë dalë nga nëna meqënëse ajo e do shumë fëmijën e saj, por që i „qëllon“ të nxehet ngaqë merret më shumë me fëmijën.*

<sup>89</sup> Sih: Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003, f. 14.

<sup>90</sup> Sih: Gj. Shkurtaç, *Emografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 255.



Me denduri të madhe janë edhe sharje<sup>91</sup> të tilla te femrat si: *Aj ishte surrat njeri (që është i shëmtuar); Mos rri njashtu si huti (që rri e hutuar, që nuk orientohet dot); Njaja cu:c është tri gisht m bisht (mendjelehtë); I ka s t si boçe kanari (i ka sytë e dalë); Ka da:l durësh (nuk sillet mirë); Veç hiqet kot, se i kryq n'çep se ka (nuk ka dy lekë në xhep); Kishte pas kismete t'madhe (kishte pas shumë fat); Kishte pas fat t'zi (pa fat); Õ çmen pri c'majtmi (çmendet nga e mira); I ka hy vetja n'qef (shet mend); O bo si nuse katuni; Qeka vesh si arixhije (është veshur ngjyra – ngjyra); I kishte ra i vrug n'fyty:r; Ishte zgrap ka sy:t etj. Po t'i vëmë re këto lloj sharjesh të femrave dhe t'i krahasojmë me ato të burrave, do të dallojmë një dukuri mjaft interesante: përgjithësisht femrat shajnë për pamjen e jashtme (fizike) të njetëzve, për mendjemprehtësinë dhe fatin e tyre, ndërsa meshkujt bashkë me disa nga këto sharje, përdorin edhe sharje të tjera me fjalë të rënda, duke anashkaluar pamjen fizike dhe duke i kushtuar rëndësi nderit, trimërisë e mendjemprehtësisë. Sharje të tipit: I ka marr menja e:r (nuk di se ç'bën); Menja e madhe, havalja e kokës (koka bën, koka pëson); E kërkofsh me mu, e gjtsh me t'tje:r (mos sot me mua, nesër do ta pësosh me të tjerë); Çar t'bojsh ta bojn, ene pak ta teprojn; Mos u ma se je, mos u ma se ke (ka kuptimin se sot ke dhe je dikushi, nesër mund të mos keshë asgjë); Mo shu:m t'ngjosh, sesa t'kallzosh (dëgjo shumë, e fol pak); Co:p kumlli (e trashë); Co:p mishi me dy s : t'i dërrmoj kocet; Shumtaro:j (e shëmtuar) etj., janë tipike për meshkujt, pa përmendur të tjera, të cilat, në vetvete, qëndrojnë jashtë ligjërimit të lejuar.*

Por nuk mund të lëmë pa përmendur edhe eufemizmat e tabutë që shoqërojnë bestynitë e ndryshme ku drejtohen gratë. Në të tilla raste ato përdorin fjalë të tilla si: *Syni i kuq da:lt duq; i pla:st syni i keq* etj., për një fëmijë që mendohet se mund ta kenë marrë mësysh të tjerët. Për emërtimin *djall* përdoren eufemizmat: *qoft largu; shejtani*; për fjalën *xhindët* (në krahinë njihen me emrin *xhini:t*) përdoret: *ata që ju shto:ft Zoti vallet*; për *gjarpri i shtëpisë* përdoret: *resi i shpi:s*: për *nëpërka* përdoret: *përdhesi, dhemthati, laroshi* etj. ; për *ujku* përdoret: *gojmyllmi, gojlidhmi, shpenja* etj. Përgjithësisht femrat e moshës mbi 40 vjeç, kur dëgjojnë për një sëmundje si: kanceri, tumore etj., ato thonë: *ka smunjen e keqe, tobestefkurulla*, emër ky që nënkupton *larg o Zot*.

Ndërkaq, nga femrat, në sferën e seksualitetit dhe të emërtimeve të ndryshme lidhur me të, vihen re përdorime të eufemizmeve a perifrimeve që përdoren p.sh. për procesin e kryerjs së marrëdhënieve seksuale: *maroi pu:n; boni qef, ra:sh me bu:rr* etj. Në vijim mund të përmendim edhe disa eufemizma që përdoren për të zëvendësuar emërtimet përkatëse për organet gjenitale të fëmijëve: për organin gjenital të meshkujve: *bibilush, cili, miku* etj.; për organin gjenital femëror përdoren: *veni i keq, veni që nuk kallzohet, zogu, foleza ime* etj.

<sup>91</sup> Këto po i shënojmë ashtu siç janë ndeshur në ligjërimitin e përditshëm.

Për fjalën *gji/-ri*, në prani të burrave, gratë përdorin fjalën *gji* ose *gjoks* ( p.sh.: *i jap fmi:s gji*), ndërsa në një mjedis shoqëror ato japin emërtime të tilla si: *si:s, cica, sumlla* etj. Po për këtë emërtim , ndeshet edhe eufemizmi *kumlla* që gratë e përdorin për të ngacmuar vajzat që janë në pubertet. Për ato femra që nuk kanë gjinj të dukshëm përdoret shprehja: *aja isht dërra:s*; për recipetat ndeshen emërtimet: *kupa, sytjena*, përkatësisht nga brezi i vjetër dhe ai i ri.

Gratë kur flasin për të përmuajshmet, thonë: *zakonet, periodat, m'kan ardh ato, jom smu:n* etj. Për një grua shtatzënë ato përdorin: *arku:, me yzër* etj.

Për fjalën *vdiq* përdorin: *nërroi je:t, iku m'at dyjo, iku ke t'shumtit* etj., madje, kur mallkojnë, gratë në vend të ngushëllimit për vdekjen e një njeriu, përdorin shprehjen *i shkofsh mrapa* ( vdeksh edhe ti pas atij) etj. Për fjalën *varroset* përdoren shprehje të tilla si: *iku n'od t'vet, iku n'ven t'vet, Zoti e dha, Zoti e mu:r* etj.

Për elipsinë përdoren: *smunja e tokës, prondheu* etj. Për *ndërzohet* për kafshët përdoren: *kërko, ka valigën* etj. Për *ËC* përdoren: *banjo, hale, n'zyr t'mretit, me kry nevojën* etj.

Vizitat për urim në raste të lindjes së një fëmije në Martanesh, ashtu si edhe në qytete e krahina të tjera bëhen kryesisht nga femrat, dhe këto të martuara, të cilat bëjnë urime të tilla si: *Me je:t t'gja:t! E paç me je:t! U boft 100 vjeç! u boft plak me mjekër! shyqyr qi t'ka pshtu gruja! U rri:t me ba:b e me no:n e u boft plak me mjekër* etj. Kur lindte vajzë, në përshtatje me mendësinë e kohëve të mëparshme<sup>92</sup> nuk ishte ndonjë gëzim e martaneshasit kishin dëshirë për djem që të bëheshin zot të shtëpisë e të mbanin derën hapur, po edhe pse koncepti është: *kur le vajz kja:jn dhe trent e shpis* ( kur lind vajza qajnë edhe trarët e shtëpisë). Urimet kur pihet kafeja në këtë rast janë më të përmbajtura dhe menjëherë pas urimit „*Me je:t t'gja:t!*“ shtojnë një formulë që shpreh dëshirën për të pasur djem: „*Ho se aja si bo: cu:c, bo: ene çun* etj. Gjithashtu, për të festuar lindjen e fëmijës, bëhet festa e përgimit, pas disa ditësh pas lindjes së fëmijës, qoftë i pari, apo i vogli.

Në rastet e dasmave, kur martohet vajza, disa ditë para ditës së martesës, u tregohet paja grave apo vajzave që vijnë për ta uruar.

Në trevën e Martaneshit, ashtu si edhe në treva të tjera të vendit tonë, është për traditë që nusja (e reja) e djalit t'u drejtohet vjehrrit dhe vjehrrës njëlloj siç u thërret atyre bashkëshorti i saj ( pra, sipas rastit, mund t'i thërrasë *mami, nana* vjehrrës dhe *ba:b, babi* apo *la:l* vjehrrit). Ndërsa djali u thërret vjehrrës dhe vjehrrit në emër në të shumtën e rasteve. Mirëpo, në disa raste kemi vënë re se, kur nusja nuk është pranë vjehrrit e

---

<sup>92</sup> Shih: GJ. Shkurtaç, *Emografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 53.

vjehrrës së saj dhe flet për to, ajo shqipton emrin e tyre ose u referohet me *ai* ose *plaku* për vjehrrin dhe *ajo*, *plaka* për vjehrrën.

Me interes janë edhe disa fjalë e shprehje karakteristike të grave të qytetit të Krastës, fjalë të cilat nuk ndeshen në të folmen e burrave dhe djemve, si: *T'marrsha t'ligat!* (përgjithësisht ndeshet te brezi i vjetër i femrave). Gjithashtu na bën përshtypje se si një pjesë e konsiderushme e femrave u drejtohen njëra – tjetrës me fjalë të tilla si: *motër, zemër, shpirte, yll. ho:n* etj., pavarësisht nga shkalla e afrimitetit të tyre, thjesht për të qenë më pranë: *ho moj zemër a u lodhe sot; oj lum motra ime* etj. Kur gratë marrin vesh ndonjë lajm që u duket i çuditshëm, ato përdorin pasthirrat: *qyqja, e zeza, e shkreta* etj.

Te djemtë vëmë re se ata i drejtohen njëri – tjetrit, përgjithësisht atyre me të njëjtën moshë, me *vlla, lal, bu:rr* (*jo mor vlla, s'ishte ashtu; hë mor lal paske da:l për qe:f apo, mos mor bu:rr* etj.).

### **Zbunimi dhe përkëdhelia në të folmen e Martaneshit**

Zbunoj dhe zbunimi, siç dihet, kanë si rrënjë mbiemrin *butë* (i, e), prej nga dalin foljet *zbut, zbunoj* (<zbutnoj) me kuptimin “*marr me të mirë, përkëdhel*”. E zbunojmë dikë për ta afruar, për ta mikluar, për t'i shprehur afërsinë, dashurinë, adhurimin etj. Dhe, në bazë të të gjitha këtyrë, është “thelbi” apo pragmatika gjuhësore: për të mënjeluar emrin e tij shumë të gjatë (apo, sidoqoftë, të padëshiruar për ndonjë rrethanë shoqërore. Porse një gjë të tillë (shkurtimin a zbunimin e emrit të një personi) nuk mund ta bëjmë në rrethana mirëfilli zyrtare e formale.<sup>93</sup> Pra, qoftë shkurtimi për shkak zbunimi, qoftë përkëdhelia apo zbunimi i mirfilltë duhet të jenë kurdoherë të përligjuara nga rrethanat jashtëgjuhësore: shoqërore, miqësore, familjare, intime, si dhe nga çasti i ligjërit.<sup>94</sup>

Një nga arësyet e lindjes së zbunimeve në Martanesh është për të mënjeluar dy emra të njëjtë në një familje. P.sh., në një familje ku tezja dhe mbesa kishin emrin e njëjtë *Leme*, tezja quhej *Lemja e madhe*, ndërsa mbesa *Lemja e vogël*. Po kështu, në një familje ku ishin dy kunata me emrin *Merita*, njëri i thërrisnin *Meri*, ndërsa tjetrës *Rita*.

Mjaft dendur zbunimet përdoren për të shmangur emrat e gjatë ose të vështirë, si: *Ada/Alda* (<*Esmeralda*), *Rrema* (<*Muharrem*), *Xheva* (<*Xhevahiri*), *Shaqe* (<*Manushaqe*), *Emilia/Lana* (<*Emiliana*), *Marbi/Bona* (<*Marbona*) etj.

Disa emra kanë më shumë se një trajtë të dytë si shkurtim apo zbunim, si: *Mara, Jeta nga Marjeta; Marbi, Bona nga Marbona; Enka, Kela nga Enkeleda* etj.

<sup>93</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 209.

<sup>94</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 209.

Për arsyet të “modernizimit” të emrave të vjetër, si p.sh., një fëmijë që e kishte emrin *Sulë*, për ta modernizuar i thërrasin *Juli*, një tjetër nga *Mine* e bëjnë *Mina* apo nga *Sabrie* e bëjnë *Sabi*, nga *Halil* e thërrasin *Lilo* etj.

Në të vërtetë, tek shkurtimi apo zbulimet e emrave vepron mjaft fuqishëm parimi i njohur “*Kush flet, me kë, ku, kur, për çfarë dhe në cilin varietet*”.<sup>95</sup> Për shkak të rrethanave të ndryshme në të cilat mund të gjendet personi gjatë jetës së tij, ndodh që ai të ketë jo vetëm një formë të shkurtër të emrit të tij, por edhe më shumë dhe, sidomos, të dallueshëm nëpërmjet tyre pikërisht nga faktorët shoqëror, miqësorë e familjarë etj.

Zbulimi është shprehje apo realizim konkret i një taktike ligjërimore, e cila buron prej një strategjie të ligjëritimit dhe është pjesë e etnografisë së të folurit.<sup>96</sup>

### **Zbulime sipas shqiptimit fëminor të emrit**

Si në mbarë vendin tonë, edhe në Martanesh ndeshim një numër të mirë zbulimesh që mbeten qysh prej periudhës së gjuhës fëminore: *Mona* (<*Bona*), *Lema* (<*Rrema*), *Kaki* (<*Klajdi*), *Cakucel* (*Xhaferr*) etj. Një vajzë që e ka emrin *Bona*, e thërrasin *Mona*, pasi kur ishte e vogël kështu e shqiptonte emrin e saj. Po kështu, një djalë që e kishte emrin *Xhaferr*, kur ishin fëmijë, motra e tij e thërriste *Cakucel* dhe mbeti si tipar miklues për të.

### **Mashkullorizimi i emrave të vajzave për zbulim (përkëdheli)**

Mjaft dendur ndodh që familjet që nuk kanë djem dhe, në një farë mënyre dëshirojnë ta plotësojnë atë mungesë, mashkullarizojnë emrat e vajzave, si p.sh., *Keti* (<*Enriketa*), *Liku* (<*Vasilika*), *Sandri* (<*Aleksandra*).<sup>97</sup> Në Martanesh kjo dëshirë nuk shprehej në mashkullorizimin e emrit, por prindi i drejtohej vajzës që kishte dashur të lindte djalë me fjalët: *t’ka baba çun* apo *t’ka baba për shtat çuna* etj. Megjithatë, nuk mungojnë rastet kur emri i vajzave është mashkullorizuar, por kjo jo nga dëshira për të plotësuar mungesën e një djali. Kështu kemi *Blero* (<*Blerina*), *Ardi* (<*Adriana*), *Boni* (<*Bona*) etj.

### **Sharja dashamirëse**

Ka edhe sharje dashamirëse apo përkëdheli si nofkë zbuluese<sup>98</sup>. Një vajzë me emrin *Marbona* ka disa emra të tjerë dhe, madje, emri i saj i vërtetë përdoret vetëm nga të huajt ose kur bën ndonjë gabim. Gjyshi i saj e thërriste *Mara*, sepse pas saj lindi djali i shumëpritur në atë familje dhe ajo cilësohej si vajza që solli mbarësi; babi i saj e thërriste *Flutur*, sepse ishte e vogël dhe e lehtë si flutur; xhaxhai i saj e thërriste *Kukull*, sepse ishte e bukur dhe e imët në fytyrë; familjarë të tjerë e thërrisnin *Bokacub*, sepse ajo ishte

<sup>95</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 210.

<sup>96</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 210.

<sup>97</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 212.

<sup>98</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 212.

vajzë e përkëdhelur dhe kërkonte t'i plotësoheshin të gjitha tekat, madje për një farë kohe e thërrisnin edhe *Sandokan*, pasi ishte koha kur në ekranin e Televizionit Shqiptar shfaqej filmi "*Sandokan*" dhe personazhi kryesori këtij filmi adhurohej kaq shumë sa me këtë emër thirreshin edhe njerëzit që vlerësoheshin më shumë.

Natyrisht, nofkat jo gjithmonë janë të pëlqyeshme nga ata të cilëve u vihen. Një vajzë me emrin *Arta* thërritej nga nusja e xhaxhait të saj *Lluçe*, pasi ishte pak e shëndoshë dhe e ndrojtur. Një djalë me emrin *Sandri* thërritej *Shishman*, pasi kur ishte i vogël ishte i shkurtër dhe pak i dobët.

Në qerthullin e sharjeve përkëdhelëse mund të përfshihen edhe pseudomallkimet e sharjet dashamirëse nga ana e grave me qëllim që të largohet "syri i keq".<sup>99</sup> Kështu sipas një anketimi të bërë në Martanesh, gratë u bëjnë fëmijëve mjaft sharje apo pseudomallkime përkëdhelëse, si: *ti qeke gjo i keqi, ti hecke shtremët, ti nuk qeke i bukur hiç, or xha:f çe:l* (emri i ndonjë njeriu të shëmtuar ose budalla), *or xha:f dokërr* (duke e krahasur me një njeri që e ka emrin Xhaferr, i cili i ka sytë e mëdhenj dhe të shëmtuar), *or Bajrom Çela* (njeri i shkurtër dhe i shëmtuar dhe pak i rëndë) etj.

### **Antroponimet eufemistike**

Shpesh në të kaluarën, po edhe sot, nëpër krahina të ndryshme, fëmijëve u viheshin emra të përcundshëm apo eufemistikë, nëpërmjet të cilëve mendohej se largohej e keqja dhe fëmijët do të kenë jetë të gjatë, fat etj. (...).<sup>100</sup> Kjo dukuri nuk mungon as në krahinën e Martaneshit. Nga anketimet që kemi bërë rezultojnë emrat: *Fatmir, Jeton, Jetmir, Jetmira, Fatbardha, Bukurie, Fatjon* etj.

Në rastet kur djemt ishin të vetëm, apo siç quhen në krahina të ndryshme: *djem dëshirit, djem hazretit*<sup>101</sup>, prindërit u vinin emra të tillë: *Gëzim, Shyqyr, Lumturi* etj.

Nga dëshira për të mos pasur vajza ose për t'u pakësuar vargu i tyre në Martanesh, ashtu si shumëkund, ka edhe emra, si: *Hike* "që të ikë", *Hume* "që të humbin vajzat", *Marime* "që të mbarojnë vajzat", *Marie* "që të mbarohen vajzat", *Mjaftënie, Flora* "që të flërojnë gocat, që të ikin" etj.

### **Përtëritja apo rigjallërimi i emrit**

Vënia e emrit të gjyshit a gjyshes nipit apo mbesës është një traditë edhe në Martanesh. Kjo njihet si vënia e "*emnit të vjetër*". Kur gjyshërit janë ende gjallë, por edhe në përgjithësi, shkaktohet ndërrimi i emrit të nipit apo mbesës nëpërmjet formave zbuluese,

<sup>99</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, "Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 213.

<sup>100</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, "Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 213.

<sup>101</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, "Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 213.

si: gjyshi *Sulejman*, nipi *Juli*; gjyshi *Xhaferr*, nipi *Caku*; gjyshi *Halil*, nipi *Lilo*; gjyshi *Ali*, nipi *Liu*; gjyshja *Sajme*, mbesa *Sajmira* etj. Në fakt, kjo formë e dytë bëhet mbizotëruese dhe kështu kemi të bëjmë me riemërim nën petkun e zbulimit. Me këtë mënyrë mjaft emra të vjetër, sidomos të fesë myslimane janë kthyer në forma të dyta moderne.<sup>102</sup>

### **Emri i bashkëshortit „tabu“**

Në traditën e vjetër shqiptare ka qenë e ndaluar që gruaja dhe burri t'i thërrasin njëri – tjetrit në emër... prandaj, sipas krahinave, por gati kudo në të njëjtën mënyrë emri i bashkëshortit jepej me fjalëza zëvendësuese ku zotërojnë përemrat *ky, kjo, ai, ajo*, apo togfjalësha që nisin me to<sup>103</sup>, si: *aj burri, aja gruaja* etj.

Në të gjithë trevën e Martaneshit është traditë që gruaja thërritet me emrin e bashkëshortit plus prapashtesën *-e*, si p.sh.: *Agime, Gëzime, Nevruze, Hamite, Agrone, Alberte*, etj. Për brezin e vjetër (jo në të gjitha rastet) që të mos përmendej emri i bashkëshortit, burri (gruaja) e thërriste gruan (burrin) me përemrat *aj, ky, (aja, kja)*, si p.sh.: *aj burri, aja gruaja, or ti, oj ti* etj. Duke i folur djalit të vet burri i thoshte *aja nāna jote*, kurse gratë për burrat thonë *ky, aj, vllaj jot* (duke i'u drejtuar kunatit) etj. Në Martanesh vjehri e vjehrra por edhe të afërm të tjerë nuk e thërrasin me emër nusen e djalit, por me togun *nusja e x* (emri i të birit), p.sh. *bzōj nuses Sokolit* (thirri nuses së Sokolit). Ndodhte që kur gruaja e thërriste burrin e saj nga një distancë thoshte *or ti; a nuk merr vesht ore: or ti a je atje ti* ose burri në raste të rralla e thërriste gruan me emrin e tij, si p.sh.: *oj Avdiqe*.

---

<sup>102</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, “Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, Morava, 2009, f. 114.

<sup>103</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Etnografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 266.

## Onomastika e Martaneshit

Emrat e njerëzve dhe të vendeve shfaqen njëherazi me lindjen e gjuhës dhe shtohen, zhvillohen, ndryshojnë apo bien në harresë e dalin jashtë përdorimit sipas rrethanave historiko-shoqërore dhe kulturore që përjeton popullsia përkatëse e çdo vendi. Jo më kot thuhet se mosha e emrave të vendeve dhe të njerëzve është aq e vjetër sa edhe vetë gjuha.<sup>104</sup>

Toponimet dhe antroponimet janë emra të përveçëm dhe, si të tillë, kanë burimin e tyre kryesisht nga emra të përgjithshëm (apelativa).<sup>105</sup> Kjo dukuri është universale, dhe si e tillë vihet re edhe në Martanesh, ku shihet qartë se sa të ndërliqura dhe të mpleksura me njëra-tjetrën janë toponimet dhe antroponimet me emrat e përgjithshëm. Po nisemi nga një shembull i thjeshtë: nga emri i përgjithshëm *peshk*, -u kanë dalë edhe emra vendesh si *Peshku* (fshat në krahinën e Martaneshit). Po kështu, emri *blet/ë,-a* ka shërbyer si toporrënjë e emrit të vendit *Nërbletëz*. Toponimi *Gjon* (fshat në Martanesh) na shpie tek emri vetjak *Gjon-i*, po kështu toponimi *Lena* (fshat në Martanesh) na shpie tek emri vetjak *Lena*. Ndërkalime të tilla, nga emrat e përgjithshëm në të përveçëm dhe, së andejmi në toponime, vëmë re edhe në raste të tjera qoftë kur rrënja është një emër kafshe, shpendi apo edhe me apelativa të tjerë të çfarëdoshëm. Përmendim, ndër të tjerë, emrin *than/ë,-a*, prej tij është formuar emri i vendit *Thanëz*. Po kështu nga emri *lop/ë,-a* kemi emrin e vendit *Lopsi*.

Edhe ndryshimet historiko-ekonomike të trevave të caktuara, sidomos si pasojë e tërmeteve, përmytjeve ose nga braktisja e shkatërrimet me kohë luftrash, epidemish etj., kanë qenë e mbeten kurdoherë me rëndësi për lëvizjet në rrethin e makrotoponimisë. Ka ndodhur që qytete e krahina të mëdha e dikur të përmëna, të rrafshohen me tokën e të mbetet vetëm ndonjë rrënojë dhe emri i tyre i dikurshëm.<sup>106</sup> Një rast i ngjashëm njihet edhe në Martanesh. Në fshatin *Val* ekziston një vend i njohur me emrin *Qytetza*, për të cilin në dokumentet e hershme thuhet se ka qenë qytet i hershëm ilir. Në këtë vend janë gjetur edhe rrënoja të qytetërimit të hershëm.

Emrat që shënojnë pika të caktuara (qafa, gryka, shkëmbinj, udhë, rrugë, shtigje e deri dhiare, fusha, lëndina, kullota, pyje etj.) kanë rëndësi ekonomike të dorës së parë për banorët e Martaneshit. Në të vërtetë mikrotoponimia e Martaneshit, e parë në tërësinë e saj, na jep një pasqyrë të historisë ekonomike-shoqërore dhe kulturore të kësaj krahine. Aty ndeshim shumë emra trojesh që quhen “*Kroi i Kishës*”, “*Fusha e Kishës*” etj., dhe kjo tregon se aty dikur do të ketë pasur ndonjë ngrehinë kulturi. Në Martanesh, ndonëse

<sup>104</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, Onomastikë dhe Etnolinguistikë, Tiranë, 2001, f. 13.

<sup>105</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, Onomastikë dhe Etnolinguistikë, Tiranë, 2001, f. 14.

<sup>106</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, Onomastikë dhe Etnolinguistikë, Tiranë, 2001, f. 17.

prej disa shekujsh banorët kanë ndërruar besimin dhe janë kthyer në bektashinj, ndeshen mikrotoponime me emra shenjtorësh, si: *Shëmtrina* (<*Shën Trinia*), *Snoi* (*Shën Ndoi*).

Çdo pikë e vendit ku ka pasur një gjë të shënuar, ku është bërë një betejë, ku ka ndodhur një histori, ku është fiksuar një përjetim me interes njohjeje për kohën, zakonisht është fiksuar në toponimi<sup>107</sup>. Kjo ka bërë që, në rrjedhë të moteve, bashkë me emrin e vendit të fiksohen edhe emrat e personave që kanë qenë protagonistë apo pronarë të këtyre vendeve: *Ara e Dishet*, *Ara e Gjinjet*, *Ara e Kadijet*, *Ara e Përkolës*, *Ara e Balet*, *Ara e Canet*, *Fushat e Skojet*, *Gurrat e Cuket*, *Kroi i Caket*, *Kroi i Kurtet*, *Kroi i Lilet*, *Livadhet e Ke et*, *Prroi i Alhaset*, *Prroi i Meçet*, *Prroi i Rruset*, *Shpella e Isufet*, *Zhuri i Hasliket*, *Ara e Aliut*, *Ara e Sul Afmetit*, *Furra e Sul Hasballës*, *Guri i Likës*, *Gurra e Nezirit*, *Kodra e Halilit*, *Prroi i Veliut etj.*

“Ja pse, duke u marrë me onomastikën e një vendi, studiuesit të interesuar i duket sikur lexon “një libër historie”, të pashkruar por aq të njohur prej vendasve, të pavërtetuar por aq të besueshëm prej tyre, të çuditshëm, por edhe aq të thjeshtë e të dashur”<sup>108</sup>.

### **Ndërtimi i toponimeve**

Gjatë shqyrtimit të toponimeve është vënë re se ato janë formuar duke mbajtur parasyshtë dy aspekte bazë të apelativit: aspektin kuptimor dhe aspektin ndërtimor. Mbi bazë të aspektit kuptimor, në inventarin toponimik të Martaneshit dallohen disa grupe emërtimeve.. Kurse mbi bazën e aspektit ndërtimor dallohen vetëm dy grupe:

1. Emërtime të tipit njëfjalësh, të cilat mund të jenë fjalë të parme, të prejardhura ose të përbëra, që shkurt do t'i quajmë emërtime të thjeshta.
2. Emërtime të tipit togfjalësh me dy ose tri gjymtyrë, që shkurt do t'i quajmë emërtime të përbëra.

Emërtimet sipas ndërtimit trajtohen të ndërthurura me emërtimet sipas kuptimit të tyre, dhe ndahen në:

1. Emërtime vendesh sipas formës, ngjyrës, materialit përbërës të truallit a funksionit të tij. Këtu dallohen:
  - a. Emërtime të thjeshta: *Ardhast*, *Bushi*, *Fnari*, *Gurzakët*, *Hullishtër*, *Hurdhat*, *Korroconi*, *Krasta*, *lama*, *Lamthi*, *Loçi*, *Lopsi*, *Lyçona*, *Midhrisht*, *Mullijas*, *Nërbal*, *Nërkru*, *Pajet*, *Planaseku*, *Pleta*, *Prroja*, *Rrinat*, *Rrypa*, *Shkoza*, *Shkumel*, *Shullo*, *Shumlli*, *Suqet*, *Thanëz*, *Varosh*, *Vërvjak*, *Vgjeshta*, *Nërbletaz etj.*

<sup>107</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe Etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f. 19.

<sup>108</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe Etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f. 19.



- b. Emërtime të përbëra të shprehura me një togfjalësh të përfutur nga një emër konfiguracioni + një mbiemër që shënon një karakteristikë të tij: *Ara e Madhe, Fusha e ashpër, Fusha e Gja:t, Guri i Madh, Gurra e Madhe, Gurrat e Zeza, Kodra e Butë, Liqeni i Bardhë, Liqeni i Zi, Livadhi i Butë, Livadhi i Madh, Livadhi i Vogël, Lugu i Gjatë, Lugu i Zi, Prroi i Thatë, Pylli i Madh, Rrasa e Madhe, Shkomi i kuq, Snoi i Madh, Snoi i Vogël, Ujt e Humët, Ura e poshtër, Xona e Keqe, Zabeli i Madh, Zona e Re etj.*
- c. Emërtime të përbëra nga një emër konfiguracioni + një emër në gjinore që shënon funksion ose përbërjen e truallit të emërtuar: *Guri i Kuvenit* (vend ku burrat e Martaneshit mblidheshin për të vendosur rreth një çështjeje, si: hasmëritë, organizimin e luftës kundër armikut, ndarjen e tokave, madje ky vend në dokumentet e kohës përmendet si vendi ku kuvendonte Selim Peshku, kanunar), *Gropa e Ahit* (një ëgropë e pyllëzuar nga druri i ahut), *Gropa e Dullenjës* (gropë e mbushur me dëllinë), *Gryka e Mullijazve* (një lagje e vendosur në dy anët e lumit në formë gryke, ku kishte shumë mullinj), *Guri i Kalthit* (në këtë vend gjenden gjurmë kali, dhe sipas gojdhënave aty ka kaluar Skëndërbeu në luftrat e Dibrës dhe Elbasanit), *Kodra e Barive* (kodër ku mblidheshin barinjët), *Kuveni i Gocave* (një shkëmb në majën e të cilit, sipas gojdhënave, u mblodhën disa vajza, të cilat për të mos rënë në dorën e turkut vendosën të hidheshin nga maja e tij), *Liqeni i Luleve* (liqen në sipërfaqen e të cilit ka lule shumëgjyreshe), *Liqeni i Zi* (liqen i cili duket i zi), *Lugu i Ahishtës* (lug i mbushur me dru ahu të vegjël), *Lugu i Dardhës* (lug i mbushur me dardha të egra), *Lugu i Mollës* (lug me pemë molle), *Lugu i Qershis* (lug me qershia të egra), *Qafa e Fikut, Shkomi i kuq* (shkëmb me ngjyrë të kuqe), *Shpella e Elezit* (shpellë ku është strehuar një banor i fshat Peshk me emrin Elez), *Shpella e Isufet, Shpella e Met Logos, Shpella e Skiles* (shpellë ku rrinin dhelpra).
- d. Emërtime vendesh të formuara nga një emër konfiguracioni + një emër tjetër që tregon përkatësinë në mënyrë të përgjithshme ndaj një emërtimi më të gjerë. Pra këto janë mikrotoponime brenda një makrotoponimi, janë emërtime të vogla që përbëjnë një emërtim më të gjerë. Për këtë arsye, emrin në gjinore ka edhe ekzistencë të pavarur: *Kodra e Shullonit, Shullo, Kulmi i Rrypzës, Rrypza, Livadhet e Platurnit, Platurnit, Mali i Vërvjakut, Vërvjak, Gryka e Mullijazve, mullijaz, Pylli i Kaptinës, Kaptinë, Shkomi i Shëmtrinės, Shëmtrina, Kodra e Zabelit, Zabel, Maja e Rrypzës, Rrypza, Pylla e Kaptinës, Kaptina, etj.* Por ka raste që emërtimi i përbërë shërben si gjymtyrë e dytë e një emërtimi tjetër dhe ndihmon kështu për të formuar një emërtim të përbërë me tri gjymtyrë: *Rronz Shkomit t'Kuq, Buzë Shkomit t'Shomtrinės, shpella e Majës Breut, Kodra e Butë e lajthis etj.*

2. Emërtime vendesh me anën e një emri që tregon konfiguracion + një emër kafshe në rasën gjinore p.sh.: *Guri Kal, Kroi i Sorrës, lugu i Qyqes, Qoshi i Bletës, Shpella e Skiles, Kroi i Sorrës* (burim i rregulluar në formë çesmeje ku uleshin sorrat për të pirë ujë), lugu i qyqes (vend ku dëgjohej të këndonte gjithnjë qyqja, *Qoshi i Bletës* (vendth i thepisur ku rrinin shumë bletë dhe kishte sasi të mëdha mjalti), *Shpella e Skiles* (shpellë në shkëmb ku shiheshin të qëndronin dhelprat).
3. Emërtime vendesh me emra bimësh, që rriten apo janë rritur dikur në atë vend. Këtu dallohen:
  - a. Emërtime të thjeshta me një emër bime, p.sh.: *Bushi* (vend në formën e një faqeje të pjerrët që kishte shumë shkurre bushi), *Shkoza* (vend i veshur me shkurre apo dru shkoze), *Thanëz* (vend që dikur ka pasur shumë thana), *Vgjeshta* (mal i veshur me drurë vgjeri), *Maja e Breut* (pyll i dendur, ku pjesa më e madhe e drurëve janë prej bredhi).
  - b. Emërtime të përbëra me emra konfiguracioni + një emër bime në rasën gjinore (rrallë përcaktori shprehet me një emër + mbiemër): *Gropa e Ahut, Gropa e Dullejës, Kroi i Ahut, Kroi i Bushit, Liqeni i Luleve, Lugu i Ahishtës, Lugu i Dardhave, Lugu i Mollës, Lugu i Qershis, Pruçi i Lajthis, Qafa e Fikut, Qafa e Qershis, etj.*

Siç shihet, mikrotoponimet e Martaneshit pasqyrojnë një florë të pasur që vende – vende nuk është më. Megjithatë emrat e saj kanë mbetur, duke pasqyruar kështu kulturën tradicionale bujqësore të fshatrave të Martaneshit. Pikërisht këtu qëndron rëndësia jashtëgjuhësore të toponimeve.

4. Emërtime vendesh me emra njerëzish. Këtu dallohen një mori nëngrupesh:
  - a. Emërtime vendesh thjeshtë me emrat e vëllazërive që ka pasur fshati, ose emra që tregojnë konfiguracion + një emër vëllazërie në gjinore, si p.sh.: *Cukaj, Ke aj, Dukaj, Lugu i Gurabardhajve, Lama e Koket, Grrona e Alhaset, Lama e Koket, Kshtjella e Zhabolet, Kroi i Zguret, Kodrat e ke et, Guri i Likës etj.*
  - b. Emërtime me emra konfiguracioni + emra fisesh a familjesh që kanë qenë pronarë të truallit, si: *Ara e Dishet, Ara e Gjinet, Ara e Kadijet, Ara e Përkolës, Ara e Balet, Ara e Canet, Fushat e Skojet, Gurrat e Cuket, Kroi i Caket, Kroi i Kurtet, Kroi i Lilet, Livadhet e Ke et, Prroi i Alhaset, Prroi i Meçet, Prroi i Rrushet, Shpella e Isufet, Zhuri i Hasliket etj.* Në ndonjë rast emërtohet me emrin e fisit apo të familjes edhe ndonjë vend që nuk bën pjesë në territorin në fjalë, por që është pronë e tij. Në këtë rast emërtimi ka tri gjymtyrë: *Rronz Livadhet t'Ke et, Bu:z grronës Alhaset, Rronz shpellës Isufit etj.*

c. Emërtime me emra konfiguracioni + emra të personave që kanë qenë pronarë të truallit (ndonjëherë emër + mbiemër): *Ara e Aliut, Ara e Sul Afmetit, Furra e Sul hasballës, Guri i Likës, Gurra e Nezirit, Kodra e Halilit, Prroi i Veliut etj.*

d. Emërtime vendesh me një emër konfiguracioni + një emër njeriu në gjinore, me të cilin e lidh një ngjarje e caktuar: *Guri i Likës, Guri i Plakës, Kodra e halilit, Shpella e Elezit, Shpella e Met logës, Vorri i Kaurrit etj..*

5. Emërtime vendesh me emrin e ndonjë objekti të ndërtuar në to:

a. i përbërë nga një emër objekti i ndërtuar + toponimi i vendit të ndërtimit e më shpesh emri i ndërtuesit ose i familjes që është pronare e tij. Ky emër është përgjithësisht në gjinore shumës, por ka raste që është edhe në gjinore njëjës: *Kroi i Alhaset, Kroi i Biçaket, Kroi i Canet, Kroi i Çikës, Kroi i Krypet, Kroi i liçit, Kroi i Lilet, Kroi i Mortulloset, Kroi i Plloçet, Kroi i Shpellës, Kroi ke Guri n'prrut, Kroi i Zguret, Mnullini i Gjikolet etj.*

b. i përbërë nga një emër objekti të ndërtuar + një mbiemër: *Zona e Re etj*

6. Emërtime vendesh me emra shenjtoreësh dhe institucionesh fetare të krishtërimit. Në këtë grup dallojmë:

a. Emërtime të përbëra: *Fusha e Kishës, Kroi i Kishës, Kisha e Pepet etj.*

b. Emërtime të thjeshta të përfuara si rrjedhojë e reduktimeve fonetike: *Shëmtrina* (mendohet se vjen nga *Shën Trinia*)<sup>109</sup>, *Snoi (Shën Ndoi)*.

Këto toponime me emra shenjtoreësh apo institucionesh fetare dëshmojnë se Martaneshi ka qenë një krahinë e krishterë.

7. Emërtime vendesh me emra shenjtoreësh dhe institucionesh fetare të myslimanizmit janë të paktë në numër: *Kroi i Xhamis, Pylli i Dritës Teqes*<sup>110</sup>, *Shkoza e Teqes, Ballem Sulltani*<sup>111</sup>.

Në toponiminë e Martaneshit ndeshim tri tipe kryesore të fjalëformimit: prapashtesim, kompozim dhe emërzimin e mbiemrave. Gjithashtu nga shqyrtimi i lëndës del se toponimet e krahinës së Martaneshit janë të thjeshta ose të përbëra, d.m.th. mund të kenë trajtën e një fjale të vetme ose trajtën e një togfjalëshi. Kjo

---

<sup>109</sup> Qerim Lila në librin e tij “*Martaneshi, histori dhe etnokulturë*” e lidh Kishën e Shëntrinisë, ku është shruar formula e pagëzimit, si dokumenti i parë i gjuhës shqipe, me Kishën e Shën Martinit në Martanesh, e cila ndodhet pranë shkëmbit të Shën Trinisë. (f. 18)

<sup>110</sup> Ky vend njihet edhe me emrin Dritas e Balles, Dritat e Teqes.

<sup>111</sup> Vend i shenjtë i besimit bektashinj. Sipas gojëdhënave ky emërtim lidhet me emrin e një shenjtori nga Bullgaria, eshtrat e të cilit janë gjetur në këtë vend të shenjtë të besimtarëve bektashinj.

shpjegohet me faktin se togfjalëshi toponimik jep mundësi më të mëdha , sidomos për mikrotoponimet. Këtë mënyrë formimi banorët e Martaneshit e kanë shfrytëzuar me efikasitet, duke u shtuar emrave të konfiguracionit një emër tjetër në rasën gjinore ose një mbiemër. Për këtë të fundit janë përdorur më dendur mbiemrat e nyjshëm, si : *i madh* , *i vogël*, *i gjatë*, *i shkurtër*, *i thellë*, si edhe mbiemrat e ngjyrave: *i bardhë*, *i zi*, *i kuq* etj. Në këto përdorime vihet re prirja e banorëve për të krijuar një emërtim të ri me anë të antonimisë ose sinonimisë. Kështu krahas *Liqeni i Zi* kemi *Liqeni i Bardhë*, *Snoi i Madh- Snoi i Vogël*, *Balleja e Madhe – Balleja e Vogël* etj.

Së fundi, duam të theksojmë se nuk ka pasur ndërrim të detyruar emërtime. Emërtimet që kanë zëvendësuar njëra - tjetrën ose që kanë bashkëjetuar, kanë qenë pasojë e trysnisë së të folmes, e cila është më e ndjeshme se toponimia ndaj ndryshimeve ekonomike, shoqërore e politike. Për pasojë, toponimia e Martaneshit, së bashku me të folmen e saj tepër ruajtëse, përbëjnë një pasuri dokumentare me interesa shumplanësh.

### **Emrat e njerëzve (antroponimet) dhe bigëzimi i tyre në forma zyrtare dhe jozyrtare**

Njerëzit pagëzohen me një emër, i cili është emri zyrtar apo emri i parë i personit, porse gjithandej është vënë re se, zakonisht, çdo person krahas atij emri a forme zyrtare, gjatë jetës së tij do të ketë edhe ndonjë formë të dytë. Madje ndodh shpesh që njerëzit njihen, thërriten dhe rrojnë gjithë jetën kryesisht nën quajtjen e dytë, ndërsa emri i parë mbetet në “letër”, mbart kurdoherë karakter zyrtar.<sup>112</sup>

Përkëdhelia apo zbulimi i emrave vetiakë ka përhapje të gjerë anekand trevave shqiptare, qoftë me anën e prapashtesave të zvogëlimit e të përkëdhelisë, qoftë edhe me mënyra të tjera, sidomos me anën e sinkopimeve, apokopimeve apo të procedurave të përziera.<sup>113</sup> Kjo temë na ka tërhequr prej shumë vjetësh për të bërë një trajtim edhe për krahinën e Martaneshit, sepse aty i kemi edhe njohjet më të mëdha dhe shembujt janë më të sigurt. Nga lënda konkrete, që lidhet me hulumtime të shumta që kemi bërë në mjedise të shumta, por edhe në Zyrën e Gjendjes Civile në Martanesh, kemi vënë re se një dukuri e tillë si zbulimi dhe përkëdhelia tek emrat vetjakë në këtë zonë është e vonë. Brezi i vjetër i folësve në Martanesh, përgjithësisht, nuk i ka përdorur trajtat e dyta të emrave të njerëzve, qoftë me prapashtesa të zvogëlimit e të përkëdhelisë, qoftë edhe me mënyra të tjera. Emrat e njerëzve, qoftë në moshë të vogël, qoftë në moshë madhore, shqiptohen të plotë nga brezi i vjetër. Një zonjë që quhet Hike (53 vjeç), tregon se prindërit e saj në çdo rast i thërrisnin të plotë emrat e fëmijëve të tyre. Kështu ajo tregon: “Dy vëllezërve të mi, që i kanë emrat *Selaudin* dhe *Shaban*, të dy prindërit ua thërrisnin të plotë emrat në çdo rast, ndërsa unë iu thërras, përkatësisht, *Selë* dhe *Shabë*.” Këtë fakt e hasim pothuajse në

<sup>112</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, Onomastikë dhe Etnolinguistikë, Tiranë, 2001, f. 117.

<sup>113</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, Onomastikë dhe Etnolinguistikë, Tiranë, 2001, f. 117.

të gjithë brezin e vjetër. Madje shpesh ata i kritikojnë të rinjtë kur nuk i thërrasin të plotë emrat e fëmijëve të tyre, duke argumentuar se emri duhet shqiptuar i plotë, sepse edhe individi që e mban është i tillë, pa të meta. Por ndryshe ndodh me brezin e mesëm dhe atë të ri, të cilët i përdorin dendur përkëdhelitë apo zbulimet, sidomos me anën e shkurtimit të emrave me anën e sinkopimeve, apokopimeve apo procedurave të përziera.

Trajtat e dyta, të cilat, tek brezi i mesëm dhe sidomos ai i ri, krijohen pa mbarim në të gjitha mjediset, kryesisht në ato familjare e shoqërore, krahas trajtave të para apo zyrtare përkatëse.

### 1. Emrat vetjakë të mirëfilltë

Në një vështrim mbi emrat vetjakë të mirëfilltë (në trajtën e parë apo zyrtare) do të nxirrnin këto grupime:

- a. Emra të vjetër vendas, të vënë mbi bazën e emrave të përgjithshëm të kafshëve, pemëve, por nuk mungojnë edhe emra njerëzish nga emra vendesh (toponime): *Rihana* (<*Hana*), *Peme*, (<*Pemë*), *Pllum-i*, *Korb-i*, *Sokol-i*, *Petrit-i*, *Shkëlzen-i*, *Shqip/e-ja*, *Shqipoj/ë-a*, *Tomorr-i*, *Korab-i* etj.
- b. *Emra fetarë, përgjithësisht të hershëm, të futur nga ndikimi i besimit muhamedan: Ibrahim, Sulejman, Ramazan, Bajram, Nevruz, Muharrem, Haxhi, Ali, Islam, Hamdi, Beqir, Myrteza, Hasan, Ramadan, Myslym, Xhemal Muhamed, Fatime, Merjeme, Rabie, Sybe, Hava, Tixhe etj.*

Nga hulumtimet e kryera në Zyrën e Gjendjes Civile në Martanesh, fondi i përgjithshëm i emrave të njerëzve, duke përfshirë gjithë sa dëshmohen në regjistrin themeltar, rezulton të jetë i përbërë nga këto grupe:

- a. Emra me burim vendas (ilirë dhe shqiptarë).
- b. Emra me burim të huaj (fetarë dhe jo fetarë).

Emrat vetjakë deri në vitet '50 rezultojnë të jenë kryesisht me burim fetar muhamedan, ndërsa emrat vendas (ilirë) nuk janë të shumtë. Prof. Gjovalin Shkurtaj shkruan se: "Emrat ilirë nuk janë të shumtë, arsyeja është e lidhur me një pragmatikë historike të mirënjohur: nuk kemi dëshmi të shkruara prej asaj gjuhe."<sup>114</sup> Kështu deri në vitet '50 mbizotërojnë keto emra: *Selman, Allaman, Mafmut, Rrahman, Riza, Hajdar, Beqir, Hasan, Kapllan, Ibrahim, Sulejman, Ramazan, Bajram, Nevruz, Muharrem, Shyqyri, Baftiar, Hysen, Mehmet, Zenel, Salë, Latif, Xheladin, Rexhep, Jaho, Haxhi, Ali, Selamet, Afmet, Dalip, Vath, Shefqet, Dylë, Islam, Shahin, Korr, Merjeme, Fatime, Farie, Zyra,*

<sup>114</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe Etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f. 24.

*Zelfie, Zelig, Hanife, Hume, Sajme, Xhemile, Sybe, Hatije, Aishe, Xhike, Qamile, Dylberie, Rabie, Qamile, Minushe, Zenepe, Gjyle* etj.

Vitet '60 sollën një prirje të re në vendosjen e emrave vetiakë edhe në Martanesh. Prof. Gjovalin Shkurtaj shkruan se: “Zbulimet arkeologjike dhe botimi i shumë emrave ilirë sipas gjetjeve në vendbanimet ilire, në vitet '60, siç ka theksuar me të drejtë P. Daka, përkoi edhe më kërkesën gjithnjë në rritje të asaj periudhe për emra njerëzish që t'u përgjigjeshin bindjeve të reja, gjë që shkaktoi një kult për këta emra”.<sup>115</sup> Edhe në Martanesh qindra fëmijë u quajtën me emrat ilirë: *Artan, Albana, Enkelejda* etj. Krahas këtyre, lexohet qartë prirja për të vendosur emra shqiptarë dhe dëshira për t'u shmatur nga emrat e huaj me burim fetar. Kështu, gjatë këtyre viteve, na rezulton të jenë vënë këto emra: *Festim, Gëzim, Fitim, Petrit, Besnik, Behar, Bujar, Ndriçim, Bashkim, Shkëlqim, Shpëtim, Kujtim, Besim, Afrim, Xhevahir, Mentor, Afërdita, Afrime, Fitime, Besnike, Shpresa, Kujtime, Selvie, Valbona, Blerime* etj.

Gjatë viteve '70, për shndërrimin e fytyrës së antroponimisë shqiptare, pati rëndësi edhe botimi i listave me emra vetjakë ilirë dhe shqiptarë, që mund të përdroreshin pranë zyrave të gjendjes civile nga prindët për t'u vënë fëmijëve emra të bukur dhe shqiptarë.<sup>116</sup> Kjo listë u përpunua më tej nga P. Daka dhe më pas u përpunua nga një grup pune, duke u botuar si libër më vete me titullin “*Fjalor me emra njerëzish*”.<sup>117</sup> Këtë libër e gjejmë edhe sot në Zyrën e Gjendjes Civile në Martanesh. Nëpunësi i kësaj zyre, Hike Cuka, na tregon që “gjatë viteve '80 kemi bërë një punë tepër këmbëngulëse me banorët për t'i bindur të vinin emra të bukur dhe shqiptarë, duke u sugjeruar të zgjidhnin emra nga “*Fjalori me emra njerëzish*” që kishim në zyrë. E gjithë kjo bëhej me dëshirën e mirë për të shmangur vendosjen e emrave të huaj me burim fetar, pasi në zonën tonë ishte shumë e theksuar dëshira për të vendosur emra të vjetër.” Znj. Hike kujton edhe mjaft raste kur i është dashur të përplasat me vendasit, të cilët këmbëngulnin në dëshirën e tyre për të vendosur emra të huaj me burim fetar muhamedan. Madje, ajo na tregon se ka pasur raste kur prindët largoheshin pa e regjistruar fëmijën e tyre, duke mos dashur të tërhiqen nga bindja e tyre për të vendosur emra të vjetër.

Regjistri themeltar i kësaj periudhe na dëshmon për një kthesë të dukshme në shtimin e emrave ilirë e shqiptarë të brezit të ri, si: *Ermal, Erblin, Ermir, Besmir, Arlind, Çlirim, Durim, Ermira, Arjeta, Dhurata, Enkeleda, Sidorela, Besmira, Besarta, Arlinda, Flutura, Florina, Tefta, Teuta, Sajmira, Ejona, Flori, Florina, Sibora, Sidrita, Erjon, Art, Rezarta, Albana* etj.

<sup>115</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe Etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f.24.

<sup>116</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe Etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f. 25

<sup>117</sup> Shih: GA, *Fjalor me emra njerëzish*, Tiranë, 1982.

Kjo periudhë duket se ka lënë gjurmën e vet të bukur në shqiptarinë e emrave të njerëzve. Por kjo rrugë e nisur mirë, duket se nuk e ka gjetur dëshirën për të vazhduar më tej.

Për arsye historie tashmë të ditura, në emrat vetiakë të shqiptarëve kanë mbizotëruar emrat me prejardhje të huaj: greke, romake, sllave, orientale, hebraike, italiane, franceze, gjermane e, tashti së fundi edhe anglo-amerikane.<sup>118</sup> Kuptohet se kjo mori emrash u përket periudhave dhe epokave të ndryshme historike.

Si anekënd vendit, edhe në Martanesh, në ditët e sotme po ndihet më së shumti etja e për të vënë emra italianë, francezë, anglo-amerikanë etj., si: *Klinti, Xhejson, Martis, Klevis, Sara, Xhoi, Xhesika, Fjona, Dario, Alfi* etj.

Çfarë ndodh me shqipen nga prania e tyre? Prof. Gjovalin Shkurtaj shkruan: “Një gjë shumë e keqe, e cila sa vjen e po thellohet nga ndikimi i emrave të huaj: **humbi e gati po tretet dallimi morfologjik i shqipes: shquarsia dhe pashquarsia formale e emrave të njerëzve**”.<sup>119</sup>

## 2. Bigëzimi i emrave në forma jozyrtare

Një pjesë e madhe e emrave vetjakë kanë një osë më shumë se një trajtë për zbulim. Kjo dukuri vihet re edhe në Martanesh, por siç e theksuam edhe me lart, vetëm tek brezi i mesëm dhe ai i ri. Shkurtime apo përkëdhelitë janë disa farëshe:

- a. Trajta të dyta të dala vetëm nga pjesa e parë e trajtës së parë që është shkurtuar: *Marbi* nga Marbona, *Edi* nga Eduard, *Gazi* nga Gazmend, *Bledi* nga Bledar, *Jona* nga Jonarta, *Eli* nga Elisabeta, *Lili* nga Lilijana, *Luli* nga Lulzim, *Meri* nga Merjeme, *Xhema* nga Xhemal, *Sela* nga Selaudin, *Shaba* nga Shaban, *Xheva* nga Xhevahir etj.
- b. Trajta të dyta që kanë dalë nga pjesa fundore e trajtës së parë që është shkurtuar: *Blini* nga Erblin, *Lana* nga Emiljana, *Lida* nga Alida, *Poja* nga Shqiponja, *Jeta* nga Arjeta, *Ardi* nga Eduard, *Çimi* nga Ndriçim, *Berti* nga Albert, *Ola* nga Manjola, *Joti* nga Kastriot, *Tila* nga Entila, *Lami* nga Islam, *Leta* nga Luljeta, *Tani* nga Artan, *Jani* nga Arjan, *Vera* nga Pranvera, *Mondi* nga Edmond etj.
- c. Trajta e dytë e përfutur nëpërmjet prapashtesimit të trajtave zyrtare apo nëpërmjet shkurtimeve a cungimeve zbuluese+prapashtesim a ndonjë ndërrim tingullor me vlerën e fonisë përkëdhelëse: Nga hulumtimet që kemi kryer rezulton se prapashtesa zbuluese e emrave vetjakë është **-ush-**

<sup>118</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, Onomastikë dhe Etnolinguistikë, Tiranë, 2001, f. 25.

<sup>119</sup> Shih: Gj. Shkurtaj, Onomastikë dhe Etnolinguistikë, Tiranë, 2001, f. 27.

e (*Adush* nga Ada < Esmeralda, *Bonush* nga Bona < Marbona, *Jetush* nga Jeta < Arjeta, *Tilush* nga Tila < Entila, *Gentush* nga Genta < Gentiana, *Lanush* nga Lana < Emiliana, *Lidushe* nga Lida < Alida, *Mirush* nga Mira < Ermira etj. Kjo trajtë përdoret më së shumti për vajzat, ndërsa zbulimi i emrave vetjakë të djemtë në Martanesh haset më rrallë.

Nga hulumtimet na rezulton se emrat vetjakë që dalin si zbulime pa asnjë lidhje fonetike me emrin e parë pothuajse mungojnë në Martanesh. Kemi gjetur shumë pak raste, si: *Pulica* emri i parë *Zelie* (Lenë, Martanesh), *Xog-u* emri i parë *Mustafa* (Krastë, Martanesh). Në të dy këto raste arsyeja e mosthirrjes së emrit të parë lidhet me faktin se personat mbajnë emra të të afërmëve të tyre, të cilët janë ndarë nga jeta në moshë të re. Familjarët e kanë pasur shumë të vështirë ta thërrasin emrin përkatës dhe kështu kanë gjetur emra të tjerë miklues për ta.

Rastet e tjera të përdorimit të trajtave të dyta zbuluese i kemi trajtuar më sipër në kapitullin “*Shqyrtime sociolinguistike rreth etnografisë së të folurit në krahinën e Martaneshit*”.

Të gjitha këto dukuri që trajtuam më lart tregojnë se trajtat e dyta të emrave vetjakë janë një nga pikat më interesante ku gjuhësorja mplekset me jogjuhësoren. Në mënyrë të veçantë, kur trajtat zyrtare ndërkëmbehen me trajtat e dyta të përkëdhelisë i vlejné zbulimit të mëtejshëm të dyzimit shpirtëror e mendësor të njeriut.



## Dysorët dilalektorë në hartat e ADGJSH-së

Për të krahasuar leksikun e të folmes së Martaneshit me pikat më të afërta të tij, i jemi referuar modelit që Prof. Gjovalin Shkurtaj ka ndjekur në librin e tij “*Dialektet e shqipes. Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore sipas hartave të ADGJSH-së*.”

Gegërishtja dhe toskërishtja kanë dallime në leksik e në frazeologji ose, po ta themi ndryshe, kanë fjalë të ndryshme për të emërtuar objekte ose veprime të njëjta. Por, duhet theksuar se kjo dukuri nuk është e shtrirë gjerë në dialektet e shqipes dhe, sikundër ka qenë vënë re qysh herët në studimet rreth dialekteve të shqipes, rrok një numër të kufizuar fjalësh.<sup>120</sup>

Ajo që përbën dallimin e vërtetë ndërmjet krahinave shqiptare nuk janë fjalët që ndryshe thuhet në gegërisht e ndryshe në toskërisht, sepse ashtu do të kishim jo dialekt por gjuhë të ndryshme; dallimi i vërtetë përbëhet nga fjalë, kuptime, frazeologjizma, togje të lira a të qëndrueshme, mënyra të thëni që janë karakteristike për zona herë më të gjera herë më të ngushta të gegërishtes, por që mungojnë tërësisht (ose pjesërisht) në krahinat e toskërishtes (dhe anasjelltas)

Më poshtë, sa për ilustrim, po japim disa prej fjalëve dhe varianteve fonetike ose fjalëformuese të tyre në pikat më të afërta të Martaneshit, të nxjerra nga hartat leksikore të Atlasit.

Folja në shqipen standarde: **lind** (*dielli*)

**Lind** (*dielli*), që ka në të folmen e Martaneshit si dysorë: **lini** (*dielli*), **ra** (*dielli*), **du:l** (*dielli*), por në zonën e Klosit, Zerqanit dhe Dibrës, për këtë veprim përdoret **len** (*dielli*) me variantin fonetik (*le*), kurse në zonën e Shëngjergjit të Madh përdoren dy leksema: **len/bie** (*dielli*). Në të folmen e Elbasanit krahas **len** (*dielli*), ndeshet edhe **del** (*dielli*). Ndërkaq, në zonën e Belshit krahas **len** (*dielli*), deshet edhe **lin** (*dielli*)

Shih: ADGJSH, V II, harta nr 146, f. 10.

Folja në shqipen standarde: **perëndon** (*dielli*)

**Perëndon** (*dielli*) ka në të folmen e Martaneshit si dysor: **preno**, **mu:r** (*dielli*), porse në zonën e Klosit për këtë veprim përdoret **u fal** (*dielli*), ndërsa në zonën e Zerqanit përdoret **prenoi**, në zonën e Dibrës del **perëndon** (*dielli*); në zonën e Shëngjinit të Madh del **preno** (*dielli*), kurse në Elbasan ndeshen dy variante **prenoi/preroi**, ndërsa në zonën e Belshit përdoret **përnon** (*dielli*).

---

<sup>120</sup> Gj. Shkurtaj, “Dialektet e shqipes. Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore sipas hartave të ADGJSH-së”, Tiranë, Morava 2012, fl. 105.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr 147, f. 12.

Fjala në shqipen standarde: **ves/ë,-a**

Në të folmen e Martaneshit përdoret fjala **ves/ë-a** me variantet fonetike (*ve:s - vesa*) kur bulat e ujit janë formuar mbi barë, porse kur është dimër dhe bulat e ujit, për shkak të temperaturave të ulëta janë ngrirë, përdoret fjala **bry:m**.

**Ves/ë-a** dhe variantet e saj fontike (*ve:s - vesa, ue:s-uesa, vo:s - vosa, vo: - voza*) mbizotërojnë edhe në të folmen e Shëngjinit të Madh, Elbasanit, Belshit, Zerqanit, Klosit dhe Dibrës.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr 149, f. 16.

Fjala në shqipen standarde: **ylber, -i**

**Ylber - i** ka në të folmen e Martaneshit, Shëngjinit të Madh dhe Elbasanit si dysor fjalën **dylber**, porse në zonën e Klosit dhe Zerqanit përdoret **ilber**, ndërsa në Dibër për këtë dukuri përdoret **breza**, kurse në zonën e Belshit përdoret **brezi kuq**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr 150, f. 18.

Fjala në shqipen standarde: **shpell/ë, - a**

**Shpell/ë-a** me variantet fonetike (*shpe:ll - shpella, shpe:ll - shpella*) zotëron në të folmen e Martaneshit, Zerqanit, Dibrës, Shëngjinit të Madh, Elbasanit, Klosit, ndërsa për të folmen e Belshit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr 151, f. 22.

Dysorë kryesorë: **trup-i, trung-u, kurmi, stup-i, kërcur-i, bythë e pemës** etj.

**Trung-u** ka në të folmen e Martaneshit si dysorë: **tru -u, kërcu**, porse në zonën e Klosit, Zerqanit, Dibrës, Elbasanit dhe Belshit përdoret fjala **trup-i**, ndërsa në Shëngjergjin e Madh del **tru -u**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr 153, f. 24.

Fjala në shqipen standarde: **syth,-i**

**Sythi-i** me variantet fonetike (*sy:th-sythi, søth-i*) përdoret në Martanesh, Shëngjinin e Madh dhe Zerqan; **syz-i** me variantin (*sis-i*) del në Klos; **sy-ri** me variantet (*sěj-ni*) del në Dibër; **thum-i** me variantin (*thum-i*) përdoret në Elbasan; **burbuçe-ja** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr 153, f. 26.

Fjala në shqipen standarde: **zgavër,-ra**.

**Zgavër-a** ka në Martanesh si dysorë: **zgaur, bry:m**, porse, në Klos përdoret **zgaul**, në Zerqan dhe Shëngjergjin e Madh del **zgavër**, në Dibër del **bi:r**, ndërsa në Elbasan zotëron **shpe:ll druje**, kurse në Belsh mbizotëron **zgërbo:l**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr 154, f. 28.

Fjala në shqipen standarde: **nyj/ë,-a**.

**Nyj/ë-a** ka në të folmen e Martaneshit si dysorë **ny:j/ nyç; nyç-i** del edhe në Shëngjinin e Madh; **nyj-a** me variantet fonetike (*ny:-nyja, no-u, nejn-a, nø:r-nøri*) zotërojnë në Belsh, Elbasan, Klos, Dibër dhe Zerqan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 155, f. 30.

Fjala në shqipen standarde: **bërtham/ë,-a**.

**Bërtham/ë-a** ka në Martanesh si dysor **koc-i; bërtham/ë-a** me variantet fonetike (*bërtham-a, bërtham-bërtham, bërthan/k-ga*) zotëron në Belsh, Zerqan, Shëngjin i Madh, Elbasan, Klos dhe Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 156, f. 32.

Fjala në shqipen standarde: **vesh** (*rrushi*)

**Vesh** (*rrushi*) ka në Martanesh si dysorë: **vesh** (*rrushi*)/ **grec** (*rrushi*), që përdoret në rastet kur është i vogël; **vesh-i** përdoret edhe në Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh dhe Elbasan, porse në Zerqan krahas **vesh-i**, përdoret edhe **trup-i**. Edhe në Dibër përdoret **trup-i**, ndërsa në Belsh del **krep-i**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 157.a., f. 34.

Fjala në shqipen standarde: **pjergull,-a**

**Pjergull/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **pjerg/ëll-lla, tana; pjergull-a** me variantet fonetike (*pjergull-a, pjerg/ëll-lla*) zotëron në Klos, Zerqan, Dibër, Shëngjin i Madh, Elbasan; **hardhi-a** me variantin (*hardhi-ja*) del në Belsh.

Në Martanesh përdoret fjala *tana* në rastet kur pjergullat janë zgjatur dhe lidhur me njëra-tjetrën, duke krijuar një lloj strehe.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 158, f. 38.

Fjala në shqipen standarde: **mis/ër,-ri**.

**Mis/ër-ri** me variantet fonetike (*mis/ër-ri, mëjs/ër-ri*) zotëron në Martanesh, Shëngjin i Madh, Elbasan, Belsh, Dibër; në zonën e Klosit dhe Zerqanit zotëron edhe leksema **drith-i**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 160, f. 40.

Fjala në shqipen standarde: **lëvor/e,-ja**.

**Lëvor/e-ja** në Martanesh del me variantin *livor/e-ja* (por *livozhg/a arre; gzhole misri*); **gzhol/e-t** del në Klos; **gëzhut-a** me variantin (*gzhu:t-gzhuta*) përdoret në Zerqan; **shush/ël-la** me variantet (*shush/ul-la*) përdoret në Dibër; **zhbulic/e-ja** del në Shëngjinin e Madh; **lëpushk/ë-a** me variantin (*lëpu:sh-lëpusha*) zotëron në Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 161, f. 42.

Fjala në shqipen standarde: **kalli-ri** (*misri*)

**Kalli-ri** me variantet fonetike (*kalli-ni, kallëj-ni*) zotëron në Martanesh dhe në të gjithë pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 162, f. 44.

Fjala në shqipen standarde: **koçan,-i**

**Kolaçan-i** ka në të folmen e Martaneshit si dysor **çaru:k**, porse në Klos përdoret **kali:sht**, në Zerqan del **çerupk**; **ka:çup** përdoret në Shëngjinin e Madh; **kasharum** del në Elbasan; **macur** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 163, f. 46.

Fjala në shqipen standarde: **hala,-t**.

**Hala-t** dhe variantet fonetike (*ha:l-hala, hala-t*) zotërojnë në Shëngjinin e Madh, Elbasan, Martanesh dhe Zerqan; **mustaqe-t** me variantet fonetike (*mësteçe-t*) del në Klos; **thera gruni** zotëron në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 164, f. 48.

Fjala në shqipen standarde: **gjemb,-i**.

**Gjemb-i** në Martanesh del në variantin **ge:m-i**; përdoret edhe **murriz-i** (kur është gjemb më i madh); **gjemb-i** me variantet fonetike (*gjem-i, gjêm-i, gem-i, gjem-i*) zotërojnë në të folmen e Elbasanit, Klosit, Shëngjinit të Madh dhe Zerqanit; **ferr-a** me varaintet (*fe:rr-a, fe:rr-ferra*) përdoren në Dibër dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 166, f. 52.

Fjala në shqipen standarde: **fasul/e-ja**.

**Fasul/e-ja** ka në Martanesh si dysorë: *gro:sh- grosha*; **grosh/ë-a** me variantet fonetike (*grosh-a, gro:sh-grosha*) zotëron në Klos, Zerqan, Dibër, Shëngjin i Madh dhe Belsh; **frashu:ll-frashulli** del në të folmen e Elbasanit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 167, f. 54.

Fjala në shqipen standarde: **qepujk/ë,-a**.

**Qepujk/ë-a** në Martanesh del në variantin **qepul-ja**; **qepujk/ë-a** me variantet fonetike (*qepujk-a, epu:lk-a*) zotërojnë në Shëngjinin e Madh, Belsh dhe Zerqan; **t ep pule** përdoret në Klos; **arpaxhik-u** me variantet fonetike (*arpaxhik-u, arbaxhik/e-ja*) zotërojnë në Dibër dhe Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 168, f. 56.

Fjala në shqipen standarde: **patat/e-ja**.

**Patat/e-ja** ka në Martanesh si dysorë: **mo:ll dheje**; **patat/e-ja** del në Klos, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **shallagjao:-shallagjaoni** përdoret në zonën e Zerqanit;

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 169, f. 58.

Fjala në shqipen standarde: **presh-i**.

**Presh-i** në Martanesh del me variantin **pras-i**; **pras-i** përdoret edhe në Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh, porse në të folmen e Dibrës del **presh-i**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 170, f. 60.

Fjala në shqipen standarde: **kastravec,-i**.

**Kastravec-i** ka në Martanesh si dysorë: **pjep/ën-ni**; **kastravec-i** me variantet fonetike (*kastravec-i, kastravejc-i, kastravejc/e-ja*) zotërojnë në Elbasan, Dibër dhe Klos; **pjep/ën-ni** përdoret në të folmen e Zerqanit dhe të Shëngjinit të Madh; **trangull-i** me variantin (**tra /ëll-lli**) del në të folmen e Belshit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 171, f. 62.

Fjala në shqipen standarde: **qen,-i**.

**Qen-i** me variantet fonetike (*qen-i, qen-i, tɛn-i, tɛn-i,*) zotëron në të folmen e Martaneshit, Elbasanit, Belshit, Shëngjinit të Madh, Zerqanit dhe Klosit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 172, f. 64.

Fjala në shqipen standarde: **busht/ër,-ra**.

**Busht/ër-ra** ka në Martanesh si dysor: **bu:ç-buça, gor/e-ja** (quhet qeni femër i vogël (një lloj rrace e veçantë); **buç/e-ja** me variantet fonetike (*buç-a, bu:ç-buça*) zotëron në Belsh, Elbasan, Klos dhe Zerqan; **meç-a** me variantet (*meç/e-a*) del në Dibër; **gor/e-ja** del në Shëngjinin e Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 173, f. 66.

Fjala në shqipen standarde: **këlysh,-i**.

**Këlysh-i** del në Martanesh me variantin **klysh-i**; **këlysh-i** me variantet fonetike (**këlysh-i, klysh-i, , klish-i, kilish-i**) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 174, f. 68.

Fjala në shqipen standarde: **mac/e,-ja**.

**Mac/e-ja** me variantet fonetike (*mac-a, ma:c-maca*) zotëron në të folmen e Martaneshit dhe të zonave më të afërta të tij.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 175, f. 70.

Fjala në shqipen standarde: **maçok,-u**.

**Maçok-u** ka në Martanesh si dysorë: **dac-i**, po kështu del edhe në të folmen e Klosit, Zerqanit, Dibrës dhe Shëngjinit të Madh; **maçok-u** përdoret në zonën e Belshit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 176, f. 72.

Fjala në shqipen standarde: **ujk,-u**.

**Ujk-u** del në të folmen e Martaneshit në variantin **u:k-u**; **ujk-u** me variantet fonetike (**uk-u**) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 177, f. 74.

Fjala në shqipen standarde: **ujkonj/ë,-a**.

**Ujkonj/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **ulko:j-ulkoja; ulkonj/ë-a** me variantet fonetike (*ulko;j-ulkoja*) përdoret në Elbasan dhe Belsh; **ujk femër** del në Dibër; për pikat e tjera nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 178, f. 76.

Fjala në shqipen standarde: **dhelb/ër-ra**.

**Dhelb/ër-ra** ka në të folmen e Martaneshit si dysorë: **skil/e-ja**, po kështu del edhe në Klos, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **dhelb/ër-ra** me variantet fonetike (*dhelb/ën-na*) del në Zerqan dhe Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 179, f. 78.

Fjala në shqipen standarde: **urith,-i**.

**Urith-i** me variantet fonetike (*urith-i, urëjth-i*) zotëron në të folmen e Martaneshit, Shëngjergjit të Madh, Elbasanit, Klosit dhe Zerqanit; për të folmen e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 1181, f. 82.

Fjala në shqipen standarde: **gomar,-i**.

**Gomar-i** me variantet fonetike (*gomar-i, goma:r-gomari*) zotëron në të folmen e Martaneshit, Belshit, Zerqanit dhe Elbasanit; **magar-i** me variantet fonetike (*magar-i, magja:r-magjari*) përdoret në të folmen e Dibrës dhe Klosit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 1182, f. 84.

Fjala në shqipen standarde: **gomar/e-ja**.

**Gomar/e-ja** zotëron në Martanesh, Zerqan, Shëngjin i Madh dhe Belsh; **magari:c-a** del në Dibër; **gomari:ck/gomaricka** del në Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 183, f. 86.

Fjala në shqipen standarde: **kërriç,-i**.

**Kërriç-i** ka në Martanesh si dysorë: **visk-u**, **pulisht-i**, **krriç-i**; **visk-u** me variantet fonetike (*vëjšk-u*) del në Klos; **kërriç-i** përdoret në Belsh; **gomar i vogël** del në Zerqan; **maz i magarit** përdoret në Dibër; **polisht-i** del në Elbasan;

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 184, f. 88.

Fjala në shqipen standarde: **kal/ë,-i**.

**Kal/ë-i** me variantet fonetike (*kal/ë-i*, *ka:l-kali*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 185, f. 90.

Fjala në shqipen standarde: **pel/ë-a**.

**Pel/ë-a** me variantet (*pe:l-pela*) zotëron në të folmen e Martaneshit dhe të pikave të tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 186, f. 92.

Fjala në shqipen standarde: **mëz,-i**.

**Mëz-i** del në Martanesh me variantin **maz-i**; **maz-i** me variantet fonetike (*maz-i*, *maz-i*, *ma/s-zi*, *mas-i*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 187, f. 94.

Fjala në shqipen standarde: **mushk/ë,-a**.

**Mushk/ë-a** me variantet (*mushk-a*, *mushk-a*) zotërojnë në të gjitha pikat, por në të folmen e Belshit del **mushk-u**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 188, f. 96.

Fjala në shqipen standarde: **del/e-ja**.

**Del/e-ja**, kjo fjalë zotëron në mbarë pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 189.a., f. 98.

Fjala në shqipen standarde: **dhen,-të**.

**Dhen/të** me variantet (*dhen-t*, *dhwn-t*) zotëron në të folmen e Martaneshit dhe të pikave të tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 189.b., f. 100.



Fjala në shqipen standarde: **dash,-i**.

**Dash-i** është një fjalë që mbulon të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 190.b., f. 102.

Fjala në shqipen standarde: **qengj,-i**.

**Qingj-i** del në të folmen e Martaneshit me variantin **qij-i; shtjerra-t** përdoret në numrin shumë, ndërsa **shelek-u** ka kuptimin e qengjit që ka mbushur vitin; **qengj-i** me variantet fonetike (*qin/q-gji, qiq-qinjgi, qiq-qunjci, in -i, kinxh-i, ki/ -xhi*) zotëron në të folmen e Elbasanit, Belshit, Shëngjtit të Madh, Zerqanit, Dibrës dhe Klosit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 191.b., f. 104.

Fjala në shqipen standarde: **kërrut/ë-a**.

**Kërrut/ë-a** me variantet fonetike ( *krru:t-krruta*) përdoret në Martanesh, Shëngjin i Madh dhe Belsh, ndërsa në pikat e tjera nuk ka të dhëna për këtë fjalë.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 194.b., f. 110.

Fjala në shqipen standarde: **dhi,-a**.

**Dhi-a** është një fjalë që zotëron si në të folmen e Martaneshit edhe në të folmet e tjera me variantet fonetike (*dhi:- dhija, dhi:-dhia, dh j-a*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 195.b., f. 112.

Fjala në shqipen standarde: **cjap,-i**.

**Cjap-i** është një fjalë që në të folmen e Martaneshit del me variantin **sjap-i; cjap-i** me variantet fonetike (**sap-i, sqapi**, ) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 196, f. 114.

Fjala në shqipen standarde: **kec,-i**.

**Kec-i** del në të folmen e Martaneshit me variantin **keç-i; kec-i** zotëron në të gjitha pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 197, f. 116.

Fjala në shqipen standarde: **ftuj/ë,-a**.

**Ftuj/ë-a** me variantet fonetike (*ftu:j- ftuja, ftuj/ëz/za*) zotërojnë në të gjitha pikat; për zonën e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 198, f. 118.

Fjala në shqipen standarde: **ftujak,-u.**

**Ftujak-u** ka në Martanesh si dysorë: **ptuk-u; ftujak-u** me variantet fonetike (*ftujak-u*) zotëron në të folmen e Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit; **batuk-u** me variantin (*betuk-u*) zotëron në të folmen e Zerqanit; për të folmen e Dibrës dhe Klosit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 199., f. 120.

Fjala në shqipen standarde: **shyt/ë,-a.**

**Shyt/ë-a** është një fjalë që mbulon të gjitha pikat dhe ka vetëm variantet fonetike (*shy:t-shyta*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 200, f. 122.

Fjala në shqipen standarde: **lop/ë-a.**

**Lop/ë-a** është një fjalë që del në të gjitha pikat dhe ka vetëm dallime fonetike (*lo:p-lopa*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 201, f. 124.

Fjala në shqipen standarde: **ka,-u.**

**Ka-u** me është një fjalë që zotëron në të gjitha pikat dhe ka vetëm dallime fonetike (*ka-u, ka:-kau, ka- kau*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 202, f. 126.

Fjala në shqipen standarde: **viç-i, viçok-u.**

**Viç-i** është një fjalë që zotëron në të gjitha pikat dhe ka vetëm dallime fonetike (*viç-i, vejç-i, vëjç-i*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 203, f. 128.

Fjala në shqipen standarde: **mështjerr/ë,-a.**

**Mështjerr/ë-a** del në të folmen e Martaneshit me variantin **mshtje:rr-mshtjerra;** **mështjerr/ë-a** me variantet fonetike (*mështjerr-a, mështje:rr-mështjerra, mëshje:rr-*

*mëshjerra, mshtje:rr-mshtjerra, shterr/e-ja*) përdoret në të folmen e Shëngjinit të Madh, Belshit, Elbasanit, Zerqanit dhe Klosit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 204, f. 130.

Fjala në shqipen standarde: **mëzat,-i**.

**Mëzat-i** del në të folmen e Martaneshit me variantin **mzat-i**; **mëzat-i** me variantet foentike (*mëzat-i, muzat-i*) zotëron në të folmen e Klosit, Zerqanit, Dibrës dhe Elbasanit; **mazato:r-mazatori** del në të folmen e Belshit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 205, f. 132.

Fjala në shqipen standarde: **sorr/ë-a**.

**Sorr/ë-a** me variantet foentike (*so:rr-sorra*) zotëron në të folmen e Martaneshit, të Klosit, Shëngjinit të Madh, dhe Belshit; **korb-i** përdoret në Zerqan; **çafk/ë-a** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 210, f. 142.

Fjala në shqipen standarde: **qukapik,-u**.

**Qukapik-u** me variantet fonetike (*qukapik-u, ukapejk*) zotëron në të folmen e Shëngjinit të Madh, Elbasanit, Belshit, Klosit dhe Zerqanit; **çukalen-i** del në të folmen e Dibrës.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 211, f. 144.

Fjala në shqipen standarde: **dallëndysh/e,-ja**.

**Dallëndysh/e-ja** zotëron në mbarë pikat, por me dallime kryesisht në variantet fonetike (*dallanysh/e-ja, dallnysh-a, dallni:sh-dallnisha, dallandi:sh-dallëndisha*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 212, f. 146.

Fjala në shqipen standarde: **larask/ë-a**.

**Larask/ë-a** është një fjalë që zotëron si në të folmen e Martaneshit (*lara:sk-laraska*), ashtu edhe në pikat e tjera dhe ka vetëm dallime fonetike (*larask-a, lara:sk-laraska, lalask/ë-a*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 213, f. 148.

Fjala në shqipen standarde: **gushëkuq,-i**.

**Gushëkuq-i** me variantet përgjithësisht fonetike (*gushkuq-i, gushakuq-i, gushkuç-i, gushkuç/e-ja*) përdoret në të folmen e Martaneshit, të Elbasanit, Belshit, Zerqanit dhe Dibrës; **grykakuq-i** del në Shëngjergjin e Madh; për të folmen e Klosit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 214, f. 150.

Fjala në shqipen standarde: **buf,-i**.

**Buf-i** ka në Martanesh si dysorë: **huti:: hut-i** me variantet fonetike (*hut-i, hutej-ni, hut-i*) përdoret në Dibër, Klos dhe Elbasan; **bun-i** del në Shëngjinin e Madh; **buf-i** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 215, f. 152.

Fjala në shqipen standarde: **qyq/e,-ja**.

**Qyq/e-ja** me variantet (*qyq/e-ja, çiqç/e-ja, i /e-ja*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 216, f. 154.

Fjala në shqipen standarde: **mëllenj/ë,-a**.

**Mëllenj/ë-a** del në Martanesh me variantin fonetik **mulle:j-mulleja**; **mëllenj-a** me variantet fonetike (*mullënj-a, mulle-mulleja*) përdoret në të gjitha pikat; për pikën 93 nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 219, f. 160.

Fjala në shqipen standarde: **çerdh/e,-ja**.

**Çerdh/e-ja** ka në Martanesh si dysorë: **gra:d-grad**, po kështu del edhe në zonën e Klosit dhe Dibrës përkatësisht me variantet fonetike (*gra:d, grad/e-ja*); **çerdh/e-ja** del në të folmen e Zerqanit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 220, f. 162.

Fjala në shqipen standarde: **pend/ë-a**.

**Pend/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **pup/ël-la**, po kështu del edhe në pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 221, f. 164.

Fjala në shqipen standarde: **gjel,-i**.

**Gjel-i** me variantet fonetike (*gjel-i, gjel-i, el-i, xhel-i*) mbizotëron në të folmen e Shëngjinit të Madh, Elbasanit, Klosit, Belshit, Zerqanit dhe Dibrës.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 222, f. 166.

Fjala në shqipen standarde: **gjel deti**.

**Gjel deti** me variantet fonetike (*gjel deti, el de:ti*) del në Belsh dhe Shëngjinin e Madh; **misarak-u** del në Dibër; **xhel misroke** përdoret në Klos; **gjel rike** del në Zerqan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 223, f. 168.

Fjala në shqipen standarde: **pulë deti**.

**Pulë deti** përdoret në Martanesh dhe Shëngjin; **rik-a** përdoret në Zerqan, Elbasan dhe Belsh; **misrok/e-ja** del në Klos; **misk-a** përdoret në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 224, f. 170.

Fjala në shqipen standarde: **klloçk/ë,-a**.

**Klloçk/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **llu:k-lluka**, po kështu del edhe në Klos dhe Zerqan; **squ:k** me variantet fonetike (*squ:k, sju:k, qo:k-qoka*) përdoret në Elbasan, Dibër, Shëngjin i Madh dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 225, f. 172.

Fjala në shqipen standarde: **ros/ë,-a**.

**Ros/ë-a** me variantet fonetike (*ro:s-rosa*) zotërojnë në të gjitha pikat. Për të folmen e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 226, f. 174.

Fjala në shqipen standarde: **bretkos/ë,-a**.

**Bretkos/ë-a** me variantet fonetike (*bretko:s-bretkosa*) përdoren në Martanesh, Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **zha:b-zhaba** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 227, f. 176.

Fjala në shqipen standarde: **thithëlop/ë,-a**.

**Thithëlop/ë-a** me variantet (*thithlo:p-thithlopa*, *thithlop/e-ja*, *thethlo:p*, *theithlop-a*) zotëron në të folmen e Martaneshit, Shëngjinit të Madh, Elbasanit, Belshit, Klosit dhe Zerqanit; për zonën e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 228, f. 178.

Fjala në shqipen standarde: **shushunj/ë,-a**.

**Shushunj/ë-a** del në Martanesh me variantin fonetik *ushujz-a*; **shushunj/ë-a** me variantet foentike (*ushujz-a*, *shushujz-a*) përdoret në Klos, Shëngjin i Madh, Belsh dhe Elbasan; **pijanec/e-ja** del në Zerqan; **pijavi:c-piajvica** përdoret në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 229, f. 180.

Fjala në shqipen standarde: **milington/ë-a**.

**Milington/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **micko;j-mickoja**; **miza toke** përdoret në zonën e Klosit; **miz trolli** në Zerqan dhe Dibër; **miza d vogla** në Shëngjinin e Madh; **miz dheu** me variantet foentike (*miz dheu*, *miza dheu*) përdoret në Elbasan dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 230, f. 182.

Fjala në shqipen standarde: **zekth-i**.

**Zekth-i** përdoret në Martanesh, Klos dhe Zerqan; **zeg/ël-li** me variantet (*zagal-i*, *za al-i*, *zakal-a*) mbizotëron në zonën e Elbasanit, Belshit dhe Shëngjinit të Madh; për zonën e Dibrës nuk jepen të dhëna për këtë fjalë.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 231, f. 184.

Fjala në shqipen standarde: **këpush/ë,-a**.

**Këpush/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **rriq/ën-na**; **rriq/ër-ra** me variantet (*rriq/ën-na*, *rri /ën-na*) mbizotërojnë në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 232, f. 186.

Fjala në shqipen standarde: **arëz,-a**.

**Arëz-a** ka në Martanesh si dysorë: **gren/ëz-za**; **ar/ëz-za** me variantin (*anz:-anza*) përdoret në Elbasan; **grer/ëz-za** me variantet foentike (*gren/ëz-za*, *grenz-a*, *grenx-a*) zotëron në Shëngjinin e Madh, Belsh, Klos dhe Zerqan; **greth-i** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 233, f. 188.

Fjala në shqipen standarde: **çimk/ë,-a**.

**Çimk-a** me variantet foentike (*çimk-a, çimk, çemk, çejmka*) del në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 235, f. 192.

Fjala në shqipen standarde: **gjinkall/ë,-a**.

**Gjinkall/ë-a** me variantet foentike (*gjinka:ll, gjjuga:ll, gjigjika:ll, xhi ga:ll, xhika:ll*) shtrihet duke mbuluar të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 236, f. 194.

Fjala në shqipen standarde: **xixëllonj/ë,-a**.

**Xixëllonj/ë,-a** me variantet fonetike (*xixilloj-a, xixilloj-ka*) përdoret në Martanesh, Elbasan dhe Belsh; **xixëllim-a** përdoret në Klos; **xix/ël-la** përdoret në Zerqan dhe Shëngjin i Madh; **svitk-a** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 237, f. 196.

Fjala në shqipen standarde: **akrep,-i**.

**Akrep-i** ka në Martanesh si dysorë **skrapth-i**; **akrep-i** me variantet foentike (*akrep-i, agrep-i, akrap-i*) mbizotëron në Belsh, Dibër, Shëngjin i Madh, Klos, dhe Elbasan; **skrap-i** me variantin (*shkrapth-i*) del në Zerqan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 238, f. 198.

Fjala në shqipen standarde: **kërmill,-i**.

**Kërmill-i** ka në Martanesh si dysorë **kaçamill-i** me variantin (*kaçmill-i*); **kërmill-i** me variantet fonetike (*kërme:ll, kmejll-i, kithmill-i, kërthemill-i*) përdoret në Klos, Zerqan Elbasan dhe Belsh; **kaçamill-i** me variantin (*kiçmill-i*) del në Shëngjinin e Madh; **pollxha:f-pollxhafa** me variantet fonetike (*spollzha-i*) del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 239, f. 200.

Fjala në shqipen standarde: **shtatëzën,-a**.

**Shtatëzën-a** ka si dysorë në Martanesh: (*gru*) **me ba:rr, me yzër** (përdoret nga njerëzit që praktikojnë fenë bejtashiane), **ark-u; shtatëzën-a** me variantet fonetike (**shtatzan-a, shtatxa:n-shtatxani, shtatzan/e-ja**) mbizotëron në Klos, Zerqan dhe Elbasan; **grua me**

**barrë** me variantet (*grua me barr, grue me ba:rr*) përdoret në Dibër, Belsh dhe Elbasan); **gru me bark** del në të folmen e Shëngjinit të Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 240, f. 202.

Fjala në shqipen standarde: **lehon/ë,-a**.

**Lehon/ë-a** me variantet fonetike (*lahon-a, lëho:n, liho:n, luhan-a*) mbizotëron në Martanesh, Zerqan, Elbasan, Belsh, Klos dhe Shëngjin i Madh; **llaus-a** përdoret në Dibër.

Fjala në shqipen standarde: **foshnj/ë,-a**.

**Foshnj/ë-a** ka si dysor në Martanesh **fmi:-ja, kalamo-ni; fëmij/ë-a** me variantet fonetike (*fëmi:j-a, fëmi-ja, fmi:fmia, fmëj, fëmi:j-fëmija*) mbizotërojnë në Shëngjinin e Madh, Elbasan, Klos, Belsh, Zerqan; **coull-i** del në Dibër; në Zerqan krahas **fëmi:j** përdoret edhe **kalamani**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 242, f. 206.

Fjala në shqipen standarde: **djal/ë,-i**.

**Djal/ë-i** ka në Martanesh si dysorë: **çun-i**, po kështu del edhe në Belsh; **djal/ë-i** me variantet fonetike (*djal-i, gjal-i*) përdoret në Shëngjinin e Madh, Elbasan, Klos, Zerqan dhe Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 244, f. 210.

Fjala në shqipen standarde: **vajz/ë,-a**.

**Vajz/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **cu:c-cuca; vajz/ë-a** me variantet fonetike (*vajz-a, va:jz-vajza*) përdoret në Klos dhe Shëngjin i Madh; **cu:c-cuca** me variantet (*c :c-c ca, co:ç-a*) del në Zerqan dhe Dibër; **go:c-goca** del në Elbasan dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 245, f. 212.

Fjala në shqipen standarde: **shkues,-i**.

**Shkues-i** me variantet fonetike (*shku:s-shkusi, shke:s-shkesi, shkez-i, shk z-shkozi, shke:s-shkesa*) mbizotërojnë në Klos, Martanesh, Zerqan, Shëngjin i Madh, Dibër dhe Elbasan; **lajmës-i** me variantet (*lajms-i, lajs/ëm-mi*) del në Belsh dhe Elbasan. Siç shihet, në Elbasan dalin dy leksema: **shke:s-shkesa dhe lajms-i**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 246, f. 214.



Fjala në shqipen standarde: **fejoj**.

**Fejoj** me variantet fonetike (*fejoj, fijoj, fjojet*) përdoren në Martanesh, Klos, Shëngjin i Madh, Zerqan dhe Elbasan; **fërtsoj** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 247, f. 216.

Fjala në shqipen standarde: **baba,-i**.

**Baba-i** ka në Martanesh si dysorë **la:l-lala, ba:b-baba**. Në Martanesh përdoret **la:l-lala** nga brezi i vjetër dhe i mesëm, ndërsa brezi i ri përdor **ba:b-baba**. **baba-i** me variantet fonetike (**ba:b-baba**) ka një shtrirje në të gjitha pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 248, f. 218.

Fjala në shqipen standarde: **nën/ë-a**.

**Nën/ë-a** ka në Martanesh si dysorë **ta:t-tata; nën/ë-a** është një fjalë që mbulon të gjitha pikat dhe ka vetëm variante fonetike (*na:n- nana, nan-nana, nan-nana*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 249, f. 220.

Fjala në shqipen standarde: **mot/ër-ra**.

**Mot/ër-ra** është një fjalë që mbulon të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 250, f. 222.

Fjala në shqipen standarde: **vëlla-i**.

Në Martanesh, vëllait të madh i thuhet **la:l**. **Vëlla-i** me variantet fonetike (*vëlla-i, vlla-i, vlla:-vllaj, vlla:-vllau*) përdoret në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 251, f. 224.

Fjala në shqipen standarde: **vjeh/ërr,-rri** “*babai i burrit*”.

**Vjeh/ërr,-rri** ka në Martanesh si dysorë **ba:b-baba** (kështu i drejtohet nusja babait të burrit, por edhe kur flet me njerëz të afërt apo të njohur, ndërsa kur i referohet “*babait të burrit*” me njerëz të panjohur thotë **vjehrr-i**); **vjeh/ërr-rri** me variantet fonetike (*vjeh/ërr-rri, vjerr-i, veh/ërr-rri, vjer-i*) mbizotërojnë në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 252.a/1., f. 226.

Fjala në shqipen standarde: **vjeh/ërr,-rra** “*nëna e burrit*”

**Vjeh/ërr-rra** ka në Martanesh si dysorë: **na:n-nana** (*vjehërr* përdoret kur flet për të me një rrez të panjohur); **vjeh/ërr-rra** me variantet fonetike (*vjeh/ërr/rra, vje:rr-vjerra, vjer-a*) përdoret në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 252.a/2., f. 228.

Fjala në shqipen standarde: **gjysh/e,-ja** “*nëna e babait*”.

**Gjysh/e-ja** ka në Martanesh si dysorë: **nana; gjysh/e-ja** me variantet (*gjysh/e-ja, xhysh/e-ja, xhish/e-ja*) përdoret në të gjitha pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 253.a/1., f. 234.

Fjala në shqipen standarde: **gjysh,-i** “*babai i babait*”.

**Gjysh-i** me variantet fonetike (*gjysh-i, hysh-i, xhish-i, ish*) përdoret në Martanesh dhe në pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 253.a/2., f. 236.

Fjala në shqipen standarde: **gjysh/e,-ja** “*nëna e nënës*”.

**Gjysh/e-ja** ka në të folmen e Martaneshit si dysorë: **nangjysh/e-ja** dhe **na:n-nana; gjush/e-ja** me variantet fonetike (**gjush/e-ja, ysh/e-ja, ish/e-ja**) përdoren në Shëngjnin e Madh, Elbasan, Belsh, Klos, Dibër dhe Zerqan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 253.b/1, f. 238.

Fjala në shqipen standarde: **gjysh,-i** “*babai i nënës*”.

**Gjysh,-i** “*babai i nënës*” ka në Martanesh si dysorë: **babgjysh-i, gjysh-i; gjysh-i** me variantet fonetike (*gjysh-i, xhish-i*) përdoret si në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 253.b/2., f. 240.

Fjala në shqipen standarde: **xhaxha,-i**.

**Xhaxha-i** në Martanesh ka si dysorë **da:j-daja** (brezi i ri thotë *xhaxha-i*); **xhaja** me variantet fonetike (*zha:j-xhaja, xha-j*) përdoret në Belsh dhe Shëngjnin e Madh; **mixh/ë-a** me variantet fonetike (*mixh/ë-a*) përdoret në Klos dhe Dibër; **da:j-daja** del në Zerqan dhe Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 254, f. 242.

Fjala në shqipen standarde: **daj/ë,-a**.

**Daj/ë-a** me variantet fonetike (*da:j-daja*) përdoret si në Martanesh, ashtu edhe në pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 255, f. 244.

Fjala në shqipen standarde: **baçanak,-u**.

**Baxhanak-u** me variantet fonetike (*baçanak-u, baxhanak-u*) përdoret në Martanesh dhe në pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 257, f. 250.

Fjala në gjuhën shqipe: **njerk/ë,-a**.

Në Martanesh, kur burri ishte i martuar me dy gra njëkohësisht, gratë e quanin njëra-tjetrën *shemra*, po kështu thërrisnin edhe fëmijët gruan tjetër të babit. **Njerk/ë-a** mbulon të gjitha pikat duke u dalluar vetëm nga variantet fonetike (*nje:rkm njerk-a, nierk-a. nie:rk-nierka*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 258, f. 252.

Fjala në shqipen standarde: **thjesht/ër-ri**.

**Thjesht/ër-ri** ka në Martanesh si dysorë: **çuni i burrit**; në Klos dhe Zerqan përdoret togefjalëshi i qëndrueshëm **djali i burrit** me variantet fonetike (*gjal burri, gjali burrit*); në të folmën e Shëngjinit të Madh dhe të Belshit del **fëmija e burrit** me variantet (*fëmija e burrit, fëmij e burrit*); në Dibër krahas **gjal i xhetun** përdoret edhe **vëjtërk-u**; **thjesht/ër-ri** del në Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 259, f. 254.

Fjala në shqipen standarde: **binjak,-u**.

**Binjak-u** me variantet fonetike (*bijak-u, bija:k*) përdoret në Belsh, Martanesh dhe Elbasan; **fdins-i** del në Klos; **vdinarak-u** përdoret në Zerqan; **bliznak-u** përdoret në Dibër; **dyja:r** përdoret në Shëngjinitin e Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 260, f. 256.

Fjala në shqipen standarde: **fqinj,-i**.

**Fqinj-i** ka në Martanesh si dysorë **mhalleli-u**; **shoq-i** me variantet fonetike (*shoç-i*) del në Klos, **komshi-u** me variantet (*komshi-u, komshi:-komshiu, kamshi-ja, kajshej-a*)

zotëron në të folmen e Belshit, Shëngjinit të Madh, Dibrës, Zerqanit, Dibrës dhe Zerqanit; **fqin-i** me variantet (*fqi:-fqi ja*) del në Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 261, f. 258.

Fjala në shqipen standarde: **nip,-i**.

**Nip-i** dhe variantet fonetike (*nip-i, nëjp-i*) del si leksemë zotëruese në të gjitha pikat, përjashtim bën zona e Klosit, ku del dysori **gjal vllaj**. Aty-këtu, në të folmen e Martaneshit përdoret edhe **çun vllaj**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 262, f. 260.

Fjala në shqipen standarde: **mbes/ë-a** “*vajza e vëllait*” ose “*vajza e motrës*”.

**Mbes/ë-a** ka si dysorë në Martanesh: **me:s-mesa** dhe **cu:c vllaj**; **mbes/ë-a** dhe variantet fonetike (*mbe:s-mbesa, me:s-mesa*) përdoret në të folmen e Zerqanit, Dibrës, Shëngjinit të Madh dhe Elbasanit; **mesoll/e-ja** del në Belsh; **vajz e vllait** del në Klos.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 262.b., f. 262.

Fjala në shqipen standarde: **vëllam,-i**.

**Vëllam-i** ka në Martanesh si dysorë: **byrazer-i**; **byrazer** me variantet fonetike (*burazer-i, birazer-i, bilezer*) përdoret në Belsh, Klos, Zerqan, Dibër e Shëngjin i Madh; **vëlla-i** me variantin (*vlla:-vlla-u*) del në Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 265, f. 268.

Fjala në shqipen standarde: **i ve**.

**I ve** me variantet fonetike (*i ve, i ve:*) përdoret në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 266, f. 270.

Fjala në shqipen standarde: **e ve**.

**E ve** me variantet fonetike (*e ve, e ve:j*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 2271, f. 272.

Me interes në aspektin dialektologjik të dallimeve leksikore janë edhe emërtimet e pjesëve të trupit të njeriut, përkatësisht të kafshëve. Po japim më poshtë pamjen që na del nga fjalët e paraqitura në ADGJSH:

Fjala në shqipen standarde: **Trup,-i**

**Trup-i** ka në Martanesh si dysorë: **shtat-i; trup-i** del pa variante fonetike dhe zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 267, f. 274.

Fjala në shqipen standarde: **kock/ë-a.**

**Kock/ë-a** del në Martanesh me variantin **koc-i; rrasht-i** përdoret për lëkurën e kokës; **koc-i** del pa variante fonetike në Klos, Zerqan, Dibër e Shëngjin i Madh; **rrasht-i** me variantet fonetike (*rresht/ën-na*) del në Elbasan; **kock/ë-a** me variantin fonetik (*kock-a*) del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 268, f. 276.

Fjala në shqipen standarde: **eshtra,-t.**

**Eshtra-t** kanë në Martanesh si dysorë: **koce-t; koca-t** me variantet (*koci-jt, kuci-jt, koce-t*) mbizotëron në Zerqan, Dibër dhe Klos; **eshtra-t** me variantin (*eshtna-t*) del në Shëngjinin e Madh; **reshtna-t** në Elbasan; **kocka-t** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 269, f. 278.

Fjala në shqipen standarde: **kok/ë,-a.**

**Kok/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **kry:t; kaptin-a** me variantet (*kaptejn-a*) në Klos; **krye-t** me variantet (*krø:-krøi,krëj-t*) përdoret në Zerqan dhe Dibër; **kok/ë-a** me variantet (*ko:k-koka*) del në Shëngjinin e Madh, Elbasan dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 270, f. 280.

Fjala në shqipen standarde: **stërdhëmb-i.**

**Stërdhëmb-i** ka në Martanesh si dysorë: **stërlik-u; nërlik-u** me variantet (**stërlik-u**) del edhe në Klos dhe Zerqan; **stërdhëm/p-bi** me variantet (*stërdham-i*) del në Dibër dhe Elbasan; **dham i huj** me variantet (*dhem i hu:j*) del në Shëngjin të Madh; **katarosh-i** në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 271, f. 282.

Fjala në shqipen standarde: **dhëmball/ë,-a.**

**Dhëmball/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **ema:ll-emalla** dhe **tma:ll-tmalla**; **dhëmball/ë-a** me variantet fonetike (*dhëmball-a*, *dhma:ll*, *dhëma:ll*) përdoret në Dibër, Klos, Zerqan dhe Belsh; **tëma:ll** me variantin (*tma:ll*) del në Shëngjin të Madh dhe Elbasan; në Shëngjin të Madh krahas **tëma:ll** përdoret edhe **ema:ll**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 273, f. 284.

Fjala në shqipen standarde: **gërshet,-i**.

**Gërshet-i** me variantet (**kshet-i**, **gërshet-i**, **gëshet-i**) përdoret në Martanesh, Belsh, Klos dhe Shëngjin i Madh; **bisht-i** me variantet fonetike (*bisht-i*, *bishta-t*) zotërojnë në Zerqan, Dibër e Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 274, f. 288.

Fjala në shqipen standarde: **ije-t**

**Ije,-t** me variantet fonetike (*ij-a*, *i:j-ija*) në Martanesh, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **të hollë-t** me variantet (*t hollz-a*, *t hollze-t*) në Klos dhe Zerqan; **mjedis-i** me variantin (*midis-i*) përdoret në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 275, f. 290.

Fjala në shqipen standarde: **kyç-i** (*i dorës*).

**Kyç-i** (*i dorës*) përdoret në Martanesh dhe Shëngjinin e Madh; **rezia e dorës** në Klos, **byzylyku i dorës** me variantet fonetike (*byzylyk-u*, *belezik-u*, *bilizik*) përdoret në Elbasan, Zerqan dhe Dibër; **nyj/e-a** (*e dorës*) në Belsh;

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 277, f. 292.

Fjala në shqipen standarde: **kyç-i** (*i këmbës*)

**Kyç-i** (*i këmbës*) përdoret në Martanesh dhe Shëngjinin e Madh; **rrezia e kamës** në Klos; **qafa e këmbës** me variantet (*çaf/ëz-za*) përdoret në Zerqan; **koci kams** del në Elbasan; **nyja** (*e kamës*) në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 277, f. 294.

Fjala në shqipen standarde: **pëllëmb/ë,-a**.

**Pëllëmb/ë-a** ka në të folmen e Martaneshit si dysorë: **plo:m-a**, **shpu:ll-a**; **pëllëmb/ë-a** me variantet (*pllam-a*, *pollamb-a*, *pëlla /k-ga*) zotëron në të folmen e Zerqanit, Elbasanit, Belshit, Dibërës dhe Klosit; **pëllu:shk-pëllushka** në Shëngjinin e Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 278, f. 296.

Fjala në shqipen standarde: **kërçi,-ri**.

**Kërçi,-ri** del në Martanesh me variantin (*kërsi:-ja*); **kërçi-ri** me variantet fonetike (*kërçi/e-ja*) përdoret në Shëngjinin e Madh dhe Belsh; **koci kamës** me variatet (*koci kambës, koci kamës*) përdoret në Zerqan dhe Dibër; **kallam-i** del në Elbasan; **föllli kamës** përdoret në Klos.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 279, f. 298.

Fjala në shqipen standarde: **qerpik,-u**.

**Qerpik-u** ka në Martanesh si dysorë: **qift-e, qepalla; qifte-t** përdoret edhe në Klos dhe Zerqan; **qerpik-u** me variantet (**qerpik-u, qerpëjk-u, qerrpik-t**) del në Elbasan, Dibër, Shëngjin i Madh dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 280, f. 300.

Me vlerë për dallimin, dhe për të parë larminë e gërshetimin e tyre në pikat më të afërta me Martaneshin, janë emërtimet e disa prej veprimeve kryesore, si:

Fjala në shqipen standarde: **afrohem**.

**Afrohem** ka në Martanesh si dysorë: **avitem; afrohem** me variantet foentike (*afrohem, afroem*) zotërojnë në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 281, f. 302.

Fjala në shqipen standarde: *largohem*.

**Largohem** ka në Martanesh si dyssorë: *qasem, prapohem; largohem* me variantet foentike (*largohem, largjohem, largoem, largojem*) zotërojnë në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 282, f. 304.

Fjala në shqipen standarde: **hap** (derën)

Hap ka në Martanesh si dysorë: **çel; çel** del edhe në pikat e tjera, përjashtuar zonën e Belshi, ku del **hap**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 283, f. 306.

Fjal në shqipen standarde: **mbyll**.

**Mbyll** ka dy leksema të dallueshme: **mbyll** me variantet (*myll, myll*) del në Martanesh. Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **mshel** me variantet (*mshel, mbshel*) zotëron në Klos, Zërqa dhe Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 284, f. 308.

Fjala në shqipen standarde: **vrapoj**.

**Vrapoj** ka në Martanesh si dysorë: **hovi**; përdoret edhe **e kam me ren** (kur nxiton), si dhe **turrem** (iki me vrap për të aritur dikë apo diçka); **vërdhoj** në Klos; **vulloj** në Zërqa; **nxitoj** në Dibër; **zajren** del në Shëngjin të Madh; **turrem** del në Elbasan; në Belsh përdoret **vrapoj**;

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 285, f. 310.

Fjala në shqipen standarde: **shuaj** (*zjarrin*).

**Shuaj** (*zjarrin*) ka në Martanesh si dysorë: **naloj** (*zjarmin*); **fik** (*zjarrin*) me variantet (*fëjk-i*) zotëron në Klos, Zërqa dhe Dibër; **shuaj** me variantet (*shu:j*) zotëron në zonën e Shëngjinit të Madh, Elbasanit dhe Belshit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 286, f. 312.

Fjala në shqipen standarde: **ndez** (*zjarrin*).

**Ndez** (*zjarrin*) mbizotëron në të gjitha pikat dhe ka vetëm variante fonetike (*ndez, nez, nes*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 287, f. 314.

Fjala në shqipen standarde: **ngrohem**.

**Ngrohem** del në Martanesh me variantin **rofem**; **ngrohem** me variantet fonetike (*rofem, grofem*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 288, f. 316.

Fjala në shqipen standarde: **zbres**.

**Zbres** me variantet fonetike (*zbres, xbres*) përdoret në Martanesh, Klos, Shëngjin i Madh, Belsh dhe Elbasan; **zdryp** me variantet (*zdrip*) zotëron në Zërqa dhe Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 288, f. 318.

Fjala në shqipen standarde: **plagosem**.



**Plagosem** me variantet fonetike (*plagosem, plagjosem, plagohena*) mbizotëron në Martanesh dhe në pikat më të afërta të tij.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 290, f. 320.

Fjala në shqipen standarde: **qëlloj** (*me pushkë*).

**Qëlloj** (*me pushkë*) ka në Martanesh si dysorë **shti** (*me pu:shk*); **shtie** me variantet foentike (*shti.;* *shtej,* *shtëj*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 21, f. 322.

Fjala në shqipen standarde: **ngacmoj** (*një njeri*).

**Ngacmoj** ka në Martanesh si dysorë: **cys** dhe **as**; **ngacmoj** del në të folmen e Shëngjinit të Madh; **gas** me variantet fonetike (*gas,* *as*) mbizotëron në të folmen e Dibrës dhe Zerqanit; **cys** përdoret në Elbasan dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 292.a., f. 324.

Fjala në shqipen standarde: **shpurrit** (*zjarrin*).

**Shpurrit** (*zjarrin*) del në Martanesh me variantin fonetik **shporis** (*zjarmin*); **gas** (*zjarrin*) përdoret në Dibër; **ngacmoj** me variantin (*acmoj*) del në zonën e Shëngjinit të Madh; **cys** përdoret në Elbasan dhe Belsh; **gëlkoj** përdoret në Klos.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 292.a., f. 326.

Fjala në shqipen standarde: **gudulis**.

Dysorët kryesorë: **gudulis, digëlisënj, giciloj, xhugulit, kilikoj/kilikos**.

**Gudulis** ka Martanesh si dysorë: **kilkoj; gilikiçi** me variantin (*giligiç*) del në Dibër dhe Zerqan; **kilikoj** del në Shëngjinin e Madh; **kilikos** me varaintin (*kilikis, kilikos*) del në Belsh dhe Elbasan; **gas** përdoret në Klos.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 293, f. 328.

Fjala në shqipen standarde: **përzë**.

**Përzë** del në Martanesh me variantin fonetik **përza.;** **përzë** me varaintet fonetike (*përza.;* *pëza,* *përza*) zotërojnë në zonën e Klosit, Zerqanit, Dibrës, Elbasanit dhe Belshit; **qes jasht** me variantin (*qis jasht*) del në Shëngjinin e Madh dhe Elbasan. Pra në Elbasan dalin dy leksema: **përza:** dhe **qis jasht**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 294, f. 330.

Fjala në shqipen standarde: **gënjej**.

**Gënjej** ka në Martanesh si dysorë: **rre:j; rrej** me varaintet fonetike (*rre:j, rre:j*) mbizotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 295, f. 332.

Fjala në shqipen standarde: **tregoj** (*përralla*).

**Tregoj** (*përralla*) ka në të folmen e Martaneshit si dysorë: **kallzoj, dëftej; kallzoj** me variantet fonetike (*kallzoj, kallxoj*) zotërojnë në të folmen e Shëngjinit të Madh dhe Klosit; **rrëfej** me variantin (*rrfej*) del në Zerqan; **dëftej** me variantet fonetike (*dëftoj, ftej*) zotërojnë në Dibër, Belsh dhe Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 296, f. 334.

Fjala në shqipen standarde: **kërkoj** (*gjellën për kripë*).

**Kërkoj** (*gjellën për kripë*) ka në Martanesh si dysorë: **zhgoj** (*gjellën për kry:p*); **kërkoj** me variantin (*gërk j*) del në zonën e Klosit; **shoh** me variantin (*shof*) në Zerqan dhe Dibër; **shikoj** me variantin (*shëkoj*) në Elbasan dhe Belsh; **zaj fill** përdoret në Shëngjinin e Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 297, f. 336.

Fjala në shqipen standarde: **këmbej**

**Këmbej** ka në Martanesh si dysorë: **nërroj; ndërroj** me variantet fonetike (*ndrroj, nrroj*) zotëron në të gjitha pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 298, f. 338.

Fjala në shqipen standarde: **koj** (*fëmijën*)

**Koj** përdoret në Martanesh, Klos, Zerqan, Shëngjinin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **ushqej** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 299, f. 340.

Fjala në shqipen standarde: **ngopem**.

**Ngopem** ka në Martanesh si dysorë: **fryhem, ihem; jam fre** në Klos; **jam frø:** në Zerqan; **u frëjna** në Dibër; **fryjem** në Shëngjin të Madh; **jam fa** në Elbasan; **fahem** në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 300, f. 342.

Fjala në shqipen standarde: **rënkoj.**

**Rënkoj** del në Martanesh me varaintin **mkoj; rë koj** me variantet (*nëkoj, nkoj, nukoj, urkoj*) shtrihet në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 301, f. 344.

Fjala në shqipen standarde: **fshehurazi.**

**Fshehurazi** ka në Martanesh si dysorë: **mçeftas, tinëz; fshehurazi** me variantet (*mçeftas, çefas, mshefët*) përdoret në Dibër, Belsh dhe Klos; **tinëz** me variantin (*tnëz*) del në Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 202, f. 346.

Fjala në shqipen standarde: **dritar/e,-ja.**

**Dritar/e-ja** ka në Martanesh si dysorë: **dollap-i, penxher-ja; dollap-i** me variantet fonetike (*dollap-i, dëllap-i*) zotëron në Dibër, Klos, Zerqan dhe Elbasan; **penxher/e-ja** me variantet (*penxher/e-ja, pe er/e-ja*) zotëron në Zerqan, Belsh dhe Shëngjin i Madh; Pra, edhe në të folmen e Zerqanit ekzistojnë dy leksema: **penxher/e-ja** dhe **dëllap-i.**

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 303, f. 348.

Fjala në shqipen standarde: **qilar,-i.**

**Qilar-i** ka në Martanesh si dysorë: **shpi: e bukës; burg-u** me variantet (*burg-u, bur/k-gu, burgj-i*) mbizotëron në zonën e Klosit, Zerqanit dhe Belshit; **murfak-u** del në Dibër; **quer-i** me varaintet (*qu:r-quri, qu:r-qori*) zotërojnë në Elbasan dhe Shëngjin i Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 304, f. 350.

Fjala në shqipen standarde: **kazoll/e-ja.**

**Kasoll/e-ja** me varaintet fonetike (*kasoll/e-ja, kacoll/e-ja, kaso:ll-kasolla*) mbizotëron në Martanesh, Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **qu:r-quri** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 305, f. 352.

Fjala në shqipen standarde: **ndërtoj** (*shtëpi*).

**Ndërtoj** (*shtëpi*) ka në Martanesh si dysorë: **baj shpi; bëj** (*shtëpi*) me variantet (*baj shpi*;) del në zonën e Shëngjinit të Madh; **ndreq shtëpi** me variantet (*ndreq shtëpëj*) përdoret në Dibër; në Elbasan dalin dy leksema: **godis shpi**: dhe **ndreq shtëpi**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 306, f. 354.

Fjala në shqipen standarde: **tjegull,-a**.

**Tjegull-a** me variantet fonetike (*tjeg/ëll-lla, qeg/ëll-lla*) zotëron në Martanesh, Elbasan, Belsh, Klos dhe Zerqan; **jaramid/e-ja** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 307, f. 356.

Fjal në shqipen standarde: **çati-i**.

**Çati-ja** ka në Martanesh si dysorë: **kulm-i; çati-ja** me variantet fonetike (*çati:-çatiija, çatej-a, çatej-a, çatëj*) mbizotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 308, f. 358.

Fjala në shqipen standarde: **mash/ë-a**.

**Mash/ë-a** me variantet fonetike (*ma:sh-masha, ma:sh-a, ma:sh-masha*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 309, f. 360.

Fjala në shqipen standarde: **kaci,-a**.

**Kaci-ja** me variantet fonetike (*kaci-ja, kaci:-kaciija, kacej, kacëj*) mbizotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 310, f. 362.

Fjala në shqipen standarde: **këmbje,-t**.

**Këmbje-t** me variantet fonetike (*kamje-t, kamj/e-a*) përdoren në të gjitha pikat, përjashtim nën zona e Dibrës, ku del leksema **puruste-ja**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 311, f. 364.

Fjala në shqipen standarde: **bloz/ë,-a**.

**Bloz/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **shkors-a** (pluhur i zi që mbetet nga tymi në oxhak), ndërsa **bloz/ë-a** përdoret për strehën që ndodhet mes çatisë dhe tavanit, e cila përdoret për të mbajtur drithrat dhe frutat e dimrit); **bloz/ë-a** me variantet fonetike (*bloz-a*, *blo:z-bloza*) përdoret në Zerqan, Elbasan dhe Belsh; **thir-i** me variantet (*thir-i*, *the:r-thera*) del në Dibër dhe Klos; **shkrumi** përdoret në Shëngjinin e Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 212, f. 366.

Fjala në shqipen standarde: **shkarpa,-t**.

**Shkarpa-t** kanë në Martanesh si dysorë: **kranet**; **krandet** me variantet fonetike (*krandet*, *krane-t*) përdoret në zonën e Dibrës, Klosit dhe Zerqanit; **karthija-t** del në Shëngjinin e Madh; **shkarpa-t** me variantin (*shka:rb-shkaraba*) zotëron në Elbasan; **lëmishtet** me variantin (*ëlmyshte-t*) del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 313, f. 368.

Fjala në shqipen standarde: **krunde,-t**.

**Krunde-t** kanë në Martanesh si dysorë: **hime-t**; **krunde-t** me variantet fonetike (*krunde-t*, *krune-t*) përdoren në Dibër, Zerqan dhe Elbasan; **hime-t** me variantet fonetike (*hejme-t*, *hume-t*, *humte-t*) përdoret në Klos, Shëngjinin e Madh dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 315, f. 372.

Fjala në shqipen standarde: **brum/ë,-i** “*farë brumi*”.

**Brumë,-i** “*farë brumi*” ka në Martanesh si dysorë: **fa:r buke**; **farë brumi** del edhe në zonën e Klosit, Zerqanit, Dibrës dhe Shëngjinin e Madh me variantet fonetike (*fa:r buke*, *far bukmrumje*, *fa:r-fara*); **brum-i** del në Elbasan; **maja-ja** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 316, f. 374.

Fjala në shqipen standarde: **kor/e-ja**.

**Kor/e-ja** ka në Martanesh si dysorë: **kuj/e-a**; **kore/e-ja** del në Dibër, Elbasan dhe Belsh; **kuj/e-za** me variantet (*kuje-kuja*, *kuje-a*, *ku:j-kuja*) përdoret në Zerqan, Klos dhe Shëngjinin e Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 317, f. 376.

Fjala në shqipen standarde: **saç,-i**.

**Saç-i** del si fjalë mbizotëruese në të gjitha pikat. Përjashtim bën zona e Belshit ku përdoret **çerjep-i**. Në Martanesh fjala **çerjep** përdoret për të emërtuar një enë balte si tepsi e thellë, në të cilën piqej buka, ndërsa **saç-i** është një fletë hekuri e rumbullakët, që mbulohej me shpuzë dhe prush dhe i vihej përsipër bukës ose lakrorit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 19, f. 380.

Fjala në shqipen standarde: **shtëmb/ë-a**.

**Shtëmb/ë-a** ka larmi leksemash dhe variantesh; në Martanesh varianti **shto:m** përdoret për një enë të vogël prej dheje; përdoret edhe fjala **buli:r**, enë e madhe prej druri; **shtëmb/ë-a** me variantet (*shta:m-shtama*, *shta:m-shtama*) del në Shëngjinin e Madh, Elbasan, Klos dhe Zerqan; **vorb-a** përdoret në Dibër; **kotruve-ja** me variantin fonetik (*kotruj/e-ja*) del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 322, f. 382.

Fjala në shqipen standarde: **petës,-i**.

**Petës-i** ka larmi leksemash dhe variantesh; në Martanesh ka si dysorë: **kallm-i**; **okllai-ja** me variantet (*okllagija*, *okllaj-okllai*, *akllaj-akllai*) zotëron në të folmen e Dibrës, Belshit, Elbasanit; **kall/ëm-mi** përdoret në Zerqan dhe Shëngjinin i Madh; **shkop-i** del në Klos.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 323, f. 384.

Fjala në dhqipen standarde: **fërgoj**.

Në Martanesh, Klos, Zerqan, Dibër, Elbasan përdoret fjala **fërgoj**, porse në zonën e Belshit del **kuc**; ndërsa për Shëngjinin e Madh nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 324, f. 386.

Fjala në shqipen standarde: **qumësht,-i**.

**Qumësht-i** ka në Martanesh si dysorë: **tamël**; **qumësht** me variantet (*qum/ësh-shi*, *qum/është-shi*) zotërojnë në të folmen e Elbasanit, Belshit dhe Shëngjinit të Madh; **tamël-i** me variantet (*tamb/ël-li*, *tam/ël-li*) përdoren në Klos, Zerqan dhe Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 327, f. 392.

Fjala në shqipen standarde: **ajk/ë,-a**.

**Ajk/ë-a** me variantet fonetike (*ajk-a*, *aj:k-ajka*) përdoret në Martanesh, Klos, Belsh dhe Elbasan; **kajmak-u** del në Dibër; **kre:j-kreja** me variantin (*krenaj-a*) përdoret në

Zerqan; në Elbasan krahas **aj:k-ajka** përdoret edhe **kajmak**; po kështu edhe në Belsh, krahas **ajk-a** përdoret edhe **gryk/ëz-za**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 328, f. 394.

Fjala në shqipen standarde: **gjalp/ë,-i**.

**Gjalp/ë-i** ka në Martanesh si dysorë: **tlyn-i; tëlyen-i** me variantet fonetike (tëlyn-i, tëlien-i, tleen-i, tlin-i) mbizotëron në Shëngjinin e Madh, Elbasan, Dibër, Zerqan dhe Klos; gjalp-i del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 329, f. 396.

Fjala në shqipen standarde: **gjiz/ë,-a**.

**Gjiz/ë-a** është një fjalë që mbizotëron në Martanesh, Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh dhe Belsh pa dallim leksematik, por thjesht me variante fonetike (*gji:z-gjiza*); në Elbasan përdoret leksema tjetër **tërvok-u**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 330, f. 398.

Fjala në shqipen standarde: **shakull,-i**.

**Shakull-i** ka në Martanesh si dysorë: **calik-u**. Përdoret edhe fjala **torbe**, e cila është më e vogël se caliku dhe përdorej nga barinjët për të marrë ushqim me vete; **shakull-i** del me larmi leksemash në pikat ku jemi referuar: **shakull-i** me variantin fonetik (*shak/ëll-lli*) del në Elbasan; **lëkur/ë-a** me variantet (*liku:r-likura, lku:r-lkura*) del në Dibër dhe Klos. Në Martanesh përdoret edhe fjala **likur milli**, e cila bëhej nga lëkura e dhisë, që pasi regjej përdorej për të dërguar drithrat në mulli, por edhe për të mbajtur miellin. Ndryshe nga **torb-ja, likura e millit** dhe **calik-u** nxirreshin nga dhia pa e prerë lëkurën, ndërsa **torb-ja** qepej me dorë; **calik-u** përdoret në Shëngjinin e Madh; **tarkaç-i** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 332, f. 402.

Fjala në shqipen standarde: **tundës,-i**.

**Tundës-i** ka në Martanesh si dysorë: **fti-ni; mëti:-mëtni** me variantet (*mëtëj-ni, muti-mutini, mut j:-ni, mtej-ni*) zotërojnë në zonën e Dibrës, Shëngjinit të Madh, Klosit dhe Zerqanit; **tunës-i** me variantet (*tun/ës-si, tu /ës-si*) del në zonën e Belshit dhe Elbasanit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 333, f. 404.

Fjala në shqipen standarde: **filiç,-i**.

**Filiç-i** ka në Martanesh si dysorë: **tuns-i**; **filiç-i** del me leksema dhe variante të ndryshme në pikat që kemi në shqyrtim: **shkop-i** del në Klos, Zerqan, Dibër, Elbasan; në Zerqan krahas **shkop-i** përdoret edhe **tuns-i** me variantin (*tunsi mtëjnit*); me këtë variant del edhe në Shëngjinin e Madh; **rotull-a** me variantin fonetik (*rot/ëll-lla*) përdoret në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 334, f. 406.

Nga fusha e veshmbathjes, natyrisht, duke qenë se shumë nga veshjet kanë karakter të theksuar etnografik e kryesisht krahinor, edhe emërtimet e tyre janë jo lehtësisht të paraqitshme në harta diferencuese.<sup>121</sup>

Fjala në shqipen standarde: **këpuc/ë,-a**.

**Këpuc-a** ka në Martanesh si dysorë **kpu:c ope a**; **këpuc-a** me variantet fonetike (*kpu:c-kpuca*) përdoret në Klos, Zerqan, Elbasan dhe Belsh; në Elbasan krahas **kpu:c** përdoret edhe **kund/ër-ra** me variantin (*kunër-ra*), po me këtë variant del edhe në Shëngjinin e Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 335, f. 408.

Fjala në shqipen standarde: **rroba,-t**.

**Rroba-t** kanë në Martanesh si dysorë disa leksema: **tesha-t**, **petka-t**, **rrobe-t**; **rroba-t** me variantet (*rrobe-t*) mbizotëron në Zerqan, Shëngjinin e Madh dhe Elbasan; **petka-t** përdoret në Klos dhe Dibër; **tesha-t** përdoret në Belsh; në Zerqan krahas **rrobe-t** përdoret edhe **raçe-t**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 336, f. 410.

Fjala në shqipen standarde: **brekë,-t**.

**Brekë-t** me variantet (*brek-ët, brek-t*) përdoren në Elbasan, Klos, Zerqan, Dibër, Shëngjinin e Madh dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 337, f. 412.

Fjala në shqipen standarde: **gun/ë,-a**.

**Gun/ë-a** me variantin (*gu:n-guna*) mbizotëron në Martanesh, Klos, Shëngjinin e Madh, Elbasan dhe Belsh; **zhguli-u** përdoret në Zerqan; **tallagan-i** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 338, f. 414.

---

<sup>121</sup> Gj. Shkurtaç, *Dialektet e shqipes*, Tiranë 2012, Morava, fl.148.



Fjala në shqipen standarde: **kops/ë-a**.

**Kops/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **pafte, sum/ull-lla; sum/ull-lla** përdoret për kopsat e vogla si rruzull, kopsë e rumbullakët; **sum/ëll-lla** me variantin (sum/ull-lla) del në Belsh; **koc-i** del në Klos; **ruz-a** me variantin (*roz-a*) del në Zerqan; **to:k-toka** del në Dibër; **sedef-ja** del në Shëngjinin e Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 339, f. 416.

Fjala në shqipen standarde: **stan,-i**.

**Stan-i** me variantet fonetike (**stan-i, stan-i, stan-i**) zotërojnë në të gjitha pikat, përjashtim bën zona e Zerqanit, ku del leksema **kali:b-kalibar**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 340, f. 418.

Fjala në shqipen standarde: **vath/ë-a**.

**Vath/ë-a** me variantet (*va:th-vatha, vath-i*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 341, f. 420.

Fjala në shqipen standarde: **shtrung/ë-a**.

**Shtrung/ë-a** del në Martanesh me variantin **stru: ; shtru g/ë-a** me variantet (*shtru , shtrungj/e-ja*) zotëron në Klos, Shëngjin dhe Belsh; për zonën e Zerqanit, Dibërës dhe Elbasanit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 342, f. 422.

Fjala në shqipen standarde: **tërkuz/ë,-a**.

**Tërkuz/ë-a** del në Martanesh me variantin fonetik **tërku:z-tërkuza** (litar i bërë në formë gërsheti me lesh dhie; përdoret edhe **gjalm**, por është më i hollë dhe më i shkurtër); **tërkuz/ë-a** me variantet (*tërku:z-tërkuza*) zotëron në Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh dhe Elbasan; **litar-i** del në Dibër; **gjalm-i** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 343, f. 424.

Fjala në shqipen standarde: **litar-i**.

**Litar-i** me variantet (*litar-i, lita:r-litari*) mbizotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 344, f. 426.

Fjala në shqipen standarde: **oping/ë-a**.

**Oping/ë-a** del në Martanesh me variantin **ope a**; **opi g/ë-a** me variantet foentike (*jopi - a, jepi -a, ope -a, ape: -ape a*) mbizotëron në të gjitha pikat. Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 345, f. 428.

Fjala në shqipen standarde: **kopan,-i**.

**Kopan-i** ka në Martanesh si dysorë: **la:s-lasa**; **la:s-lasa** del në Zerqan; **budk/ë-a** del në Dibër; **pa:ll-palla** del në Shëngjinin e Madh dhe Elbasan; **kopan-i** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 346, f. 430.

Fjala në shqipen standarde: **të fshira,-t**.

**Të fshira-t** ka në Martanesh si dysorë: **bylqyna-t, t pshime-t**; **të fshira-t** del me disa leksema në pikat që u jemi referuar: **plehra-t** me variantet (*plehna*) del në Elbasan; **llom-i** me variantin (*llome-t*) del në Zerqan dhe Dibër; **kalmuq-i** me variantet (*kalmuq-i, kalmu:ç-e - kallmuçet*) përdoret në Shëngjin të Madh dhe Klos; **bëzhdila-t** me variantet (*bëzhdile-t*) del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 347, f. 432.

Fjala në shqipen standarde: **çel (tokë të re)**.

**Çel (tokë të re)** ka në Martanesh si dysorë: **hap (tokë t re)**; **hap (tokë)** me variantet (*hap tok t re*) del në Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh; **çel (rrah)** me variantin (*çel rraha*) del në Elbasan dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 348, f. 434.

Fjala në shqipen standarde: **shpor,-i**.

**Shpor-i** ka në Martanesh si dysorë: **pri:-prija**; **shpor-i** me variantin (*spu:r-spura*) përdoret në Klos; **pre:s-presa** me variantin (*pre:j-preja*) del në Zerqan; **leh/e-ja** me variantet (*leh//e-a, leh/ën-na*) del në Shëngjinin e Madh dhe Elbasan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 350, f. 438.

Fjala në shqipen standarde: **djerr,-i**.

**Djerr-i** del në Martanesh, Shëngjin i Madh, Elbasan e Belsh; **e vjerme** del në Dibër; **kujre-i** del në Klos; në Belsh krahas **djerr-i** del edhe leksema tjetër **orman (tokë orman)**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 351, f. 440.

Fjala në shqipen standarde: **parmend/ë-a**.

**Parmend/ë-a** me variantet fonetike (*parme:na, parmend-a, përme:n-përmena*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 353, f. 444.

Fjala në shqipen standarde: **zgjedh/ë,-a**.

**Zgjedh/ë-a** del në të gjitha pikat dhe ka vetëm variante fonetike (*zgje:dh-zgjedha, zgjedh-a, ze:dh-zedha*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 354, f. 446.

Fjala në shqipen standarde: **les/ë,-a**.

**Les/ë-a** me variantet fonetike (*le:s-lesa*) del në Martanesh, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **bran/ë-a** me variantet (*bre:n-a*) del në Klos dhe Zerqan; në Elbasan krahas **le:s-lesa** përdoret edhe **tri:n-trina**; për zonën e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 357, f. 452.

Fjala në shqipen standarde: **hulli,-a**.

**Hulli-a** me variantet (*hullej, hulli-ni*) del në Zerqan, Shëngjin të Madh dhe Martanesh; **vij/ë-a** me variantet (*vi:j-vija*) del në Klos; **brazd/ë-a** me variantet (*bra:z-braza*) del në Elbasan dhe Belsh; për Dibrën nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 356, f. 450.

Fjala në shqipen standarde: **lëroj** “*punoj tokën*”.

**Lëroj** “*punoj tokën*” del në Martanesh del me variantin **liroj**; **lëroj** me variantet (*lëroj, laroj*) del në Elbasan dhe Dibër; **gas** me variantin (*ngas tokën*) del në Shëngjinin e Madh; **shkejs** del në Klos; **punoj** del në Zerqan; **çaj** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 358, f. 454.

Fjala në shqipen standarde: **lopat/ë-a**.

**Lopat/ë,-a** me variantet fonetike (*lopa:t-lopata, lopat/e-ja*) del në të gjitha pikat, përjashtuar zonën e Zerqanit, ku del leksema **qyrek-u** me variantin (*çerek-u*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 359, f. 460.

Fjala në shqipen standarde: **bel,-i**.

**Bel-i** mbizotëron në Martanesh, Klos, Zerqan, Belsh; **qyrek-u** del në Elbasan; për Dibrën nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 360, f. 462.

Fjala në shqipen standarde: **shat,-i**.

**Shat-i** me variantet fonetike (*shat-i*, *sha:t-shat-i*) mbizotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 361, f. 464.

Fjala në shqipen standarde: **mbre** (*qetë*).

**Mbre** (*qetë*) ka si dysorë në Martanesh **za** (*qe:t*); **zë** (*qetë*) me variantet fonetike (*za kiet*, *qet*) del në Klos, Zerqan dhe Shëngjin; **mbre** (*qetë*) me variantin (*mrej qet*) del në Belsh; për zonën e Dibrës dhe Klosit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 362, f. 466.

Fjala në shqipen standarde: **ngas** (*qetë*)

**ngas** (*qetë*) me variantet fonetike (*as*, *gas*) përdoren në Martanesh, Shëngjinin e Madh, Elbasan, Belsh; **punoj me qe** del në Zerqan; për zonën e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 363, f. 468.

Fjala në shqipen standarde: **polis,-i**.

**Plis-i** është një fjalë që del në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 364, f. 470.

Fjala në shqipen standarde: **prashit**.

**Prashit** me variantet fonetike (*prashis*, *prashëjs*) zotëron në të folmen e Martaneshit, Dibrës, Shëngjinit të Madh, Elbasanit, Belshit; **mih** me variantet fonetike (*m f*, *mëjff*) del në Klos dhe Zerqan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 365, f. 472.

Fjala në shqipen standarde: **ujit**.

**Ujit** del në Martanesh me variantin **u:q; ujit** me variantet (**uis, uç, u** ) përdoret në Dibër, Shëngjin i Madh, Klos dhe Zerqan; **vadit** me variantet (*vadis*) del në Elbasan dhe Belsh; por në Elbasan përdoret edhe **bjom**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 366, f. 474.

Fjala në shqipen standarde: **korr** (*grurë*).

**Korr** (*grurë*) është një fjalë që del në mbarë shqipen. Në Martanesh, Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh del **korr**, porse në Dibër del varianti fonetik **kor**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 367.a., f. 476.

Fjala në shqipen standarde: **korr** (*misër*).

**Korr** (*misër*) ka si dysor në Martanesh: **pres** (*misër*); **korr** (*misër*) me variantet fonetike (*korr, kora*) përdoret në Elbasan dhe Dibër; **pres** zotëron në Klos, Zerqan, Shëngjin i Madh dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 367.b., f. 478.

Fjala në shqipen standarde: **drap/ër,-ri**.

**Drap/ër-ri** është një fjalë që mbulon mbarë të folmet; në pikat që kemi në shqyrtim del me variantet (*drap/ën-ni*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 368, f. 480.

Fjala në shqipen standarde: **kosor/e,-ja**.

Në Martanesh krahas **kos/ë-a** (vegël bujqësore, me një presë të gjatë pak të harkuar e me bisht druri, që përdoret për të kositur barin) përdoret edhe **kadh/ë-a** (kizë me bisht të gjatë që përdoret për të prerë ferra, driza dhe degët e ahut e dushkut për të ushqyer bagëtitë); gjithashtu përdoret edhe **kiz/ë-a** (thikë e madhe me majë të kthyer si drapër dhe me bisht prej druri, që përdoret për të korrur barë apo ferra me dorë).

**Kosor/e-ja** në zonën e Klosit dhe Dibrës ka si dysorë **kiz-a** me variantet fonetike (*ki:z-kiza*); **ka:dh-kadha** me variantet (*ka:dh, ka:th*) përdoret në Zerqan dhe Elbasan; **kosor/e-ja** me varaintin (*kost/ër-ra*) përdoret në zonën e Belshit.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 369, f. 482.

Fjala në shqipen standarde: **shij** (*grurë*).

**Shij** (*grurë*) me variantet (*shi:j, shej, shij*) zotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 370, f. 484.

Fjala në shqipen standarde: **shij** (*misër*).

**Shij** (*misër*) ka në Martanesh si dysorë: **shkoq** (*misër*); shij me variantet (*shej, shij*) përdoret në Klos, Zerqan dhe Elbasan; **shkoq** përdoret në Belsh; për zonën e Dibrës dhe Shëngjinit të Madh nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 370, f. 486.

Fjala në shqipen standarde: **kashtë,-a** (*misri*).

**Kashtë** përdoret në Martanesh, Klos, Zerqan, Dibër, Shëngjin i Madh; **de:g** del në Elbasan dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 371, f. 488.

Fjala në shqipen standarde: **dorëz,-a** (*misri*).

**Dorëz-a** ka në Martanesh si dysorë: **du:j** (*kashte*); **duaj-t** me variantet (*duj-t, du:j-du:j*) përdoren në Elbasan dhe Zerqan; **demet-i** me variantet (*demet-i, demek-u*) zotëron në Elbasan, Belsh dhe Shëngjin i Madh; **kunor-a** përdoret në Dibër; **kamar/e-ja** del në Klos; në Belsh krahas **demet-i** përdoret edhe edhe **lidhj/e-a**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 372, f. 490.

Fjala në shqipen standarde: **zhvesh** (*misër*)

**Zhvesh** (*misër*) ka në Martanesh si dysorë **xhvoshk** (*misër*); **zhvesh** me variantet fonetike (*xhvesh*) mbizotëron në Zerqan, Shëngjin i Madh dhe Elbasan; **xhvoshk** del në Klos; **qëroj** me variantin (*çëroj*) del në Dibër; për zonën e Belshit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 373, f. 492.

Fjala në shqipen standarde: **mullar,-i**.

**Mullar-i** (*kashte*) me variantet fonetike (*mulla:r-mullari*) del si në Martanesh, ashtu edhe në pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 374, f. 494.

Fjala në shqipen standarde: **krëhër,-i** (*bari*).

**Krëhër-i** me variantet fonetike (*krah/ën-ni, kran-i*) zotëron në Martanesh, Klos, Zerqan, Elbasan; **grabu:j** me variantin (*grib/ën-ni*) del në Dibër; **dhamës-i** përdoret në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 375, f. 496.

Fjala në shqipen standarde: **cfurk,-u**.

**Cfurk-u** ka në Martanesh si dysorë: **fu:rk-a**; **cfurk-u** përdoret në Shëngjinin e Madh, Elbasan, Belsh; **fu:rk-a** del në Klos dhe Zerqan; **tfurk-u** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 376, f. 498.

Fjala në shqipen standarde: **sëpat/ë,-a**.

**Sëpat/ë-a** me variantet (*sëpat-a, spa:t-spata*) zotëron në Martanesh dhe në të gjitha pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 377.a., f. 500.

Fjala në shqipen standarde: **naxhak/e,-ja**.

**Naxhak/e-ja** ka në Martanesh si dysorë: **sakor/e-ja** me variantin fonetik (*cakorr/e-ja*); **naxhak/e-ja** me variantet (*naxhak/e-ja, nazhak/e-ja*) zotëron në Elbasan dhe Belsh; **sakic-a** me variantet (*sakajc-a*) del në Klos; **sakor/e-ja** del në Zerqan; **sëpatë e vogël** me variantin (*spat e vogël*) del në Shëngjinin e Madh; për zonën e Dibrës nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 377.b., f. 502.

Fjala në shqipen standarde: **brisk,-u**.

**Brisk-u** del në Martanesh, Zerqan, Dibër, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh; **thik/ë-a** me variantin fonetik (*thejk-a*) del në Klos.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 378, f. 504.

Fjal në shqipen standarde: **teh,-u**.

**Teh-u** ka në Martanesh si dysorë: **e prena**; **teh-u** me variantin (*t f-i*) del në Klos dhe Zerqan; **prefm/e-ja (e)** del në Dibër; **pres/ë-a** me variantin (*pre:s-pressa*) del në Shëngjinin e Madh; **le:l-a** del në Elbasan; **eh-a** me variantin (*eh/e-ja*) del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 379, f. 506.

Fjala në shqipen standarde: **grih/ë,-a**.

**Grih/ë-a** del në Martanesh me variantin **grih/ën-na**; **grih/ë-a** me variantet (*grih/ën-na*, *gri:n-grina*, *gri:z-a*) mbizotëron në Klos, Zerqan dhe Belsh; **qost/ër-ra** del në Shëngjinin e Madh; për zonën e Dibrës dhe Elbasanit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 381, f. 510.

Fjala në shqipen standarde: **avlëmend,-i**.

**Avëlmend-i** ka në Martanesh si dysorë: **vegj-ë** me variantin fonetik (*ve:gj*); **avëlmend-i** del me disa leksema dhe variante fonetike në pikat që ndodhen më afër Martaneshit: **tezgjah-u** me variantet fonetike (*tezgjah-u*, *tezja-u*) përdoret në Elbasan dhe Belsh; **vek-u** me variantin (*vegj-i*) del në Zerqan dhe Shëngjinin i Madh; **razboj-i** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 382, f. 512.

Fjala në shqipen standarde: **furk/ë-a** është leksemë e vetme në mbarë shqipen dhe ka variantet fonetike (*fu:rk-a*) në Martanesh, Klos, Zerqan, Shëngjinin i Madh, Elbasan dhe Belsh, porse në Dibër del varianti (*ftu:rk-a*).

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 383, f. 514.

Fjala në shqipen standarde: **bosht,-i**.

**Bosht-i** ka në Martanesh si dysorë: **drug/ë-a**; **bosht-i** del në të gjitha pikat dhe paraqitet si leksemë mbizotëruese në mbarë shqipen.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 384, f. 516.

Fjala në shqipen standarde: **krëhër,-i** (*leshi*).

**Krëhër-i** (*leshi*) del në Martanesh me variantin fonetik (*kërha:j*); **krëh/r-i** me variantet (*krahn-i*, *kran-i*, *kraha:n-a*, *kror-i*) zotëron në Zerqan, Shëngjinin i Madh, Klos dhe Belsh; **shutër-a** përdoret në Elbasan; **grebe /ë-a** përdoret në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 385, f. 518.

Fjala në shqipen standarde: **shtiz/ë,-a** (*çorapesh*).

**Shtiz/ë-a** me variantin fonetik (*shtiz-a*) zotëron në Martanesh, Klos, Zerqan, Shëngjinin i Madh dhe Elbasan; **gjilpër/ë-a** me variantin (*gjilpan-a*) përdoret në Dibër; **krab/ëz-za** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 386, f. 520.



Fjala në shqipen standarde: **shkrif** (*lesh*).

**Shkrif** (*lesh*) në Martanesh ka si dysorë **shti:**; **shkrif** me variantin (*shkref*) del në Dibër; **shtie** me variantet (*shtej*, *shtie*) del në Klos, Zerqan dhe Belsh; në Shëngjinin e Madh del **tjek me do:r leshin**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 388, f. 524.

Fjala në shqipen standarde: **kreh** (*lesh*).

**Kreh** (*lesh*) ka në Martanesh si dysorë **lnu:r** (*lesh*); **kreh** me variantin foentik (*kref*) del në Dibër, Elbasan dhe Belsh; **lënu:r** me variantin (*lnu:r*) përdoret në Klos, Zerqan dhe Shëngjin i Madh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 389, f. 526.

Fjala në shqipen standarde: **zgj/ua,-oi**.

**Zgj/ua-oi** me variantet (*zgj/u-zgjo:j*) përdoret në Martanesh, Shëngjinin e Madh dhe Elbasan; **kosh-i** del në Zerqan dhe Dibër; **kosher/e-ja** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 393, f. 534.

Fjala në shqipen standarde: **shem/ë-a**.

**Shem-a** del në Martanesh me varaintin foentik **mshenëz**; **shem-a** me variantet fonetike (*shem/ëz-za*) del edhe në Klos; **klysh-i** me variantet (*klish/e-ja*) del në Zerqan; **miz e re** përdoret në Belsh; për zonën e Dibrës, Shëngjinit të Madh dhe Elbasanit nuk jepen të dhëna.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 394, f. 536.

Fjala në shqipen standarde: **am/ë-a**.

**Am/ë-a** ka në Martanesh si dysorë: **mretne:sh-a**; **mbretëresh/ë-a** me variantet fonetike (*mretnesh-a*, *mretnesh-a*, *mretne:shk-a*) zotëron në Zerqan, Klos, Dibër, Shëngjin i Madh, Belsh dhe Elbasan; në Belsh krahas **mretne:shk-a** përdoret edhe **ma:m-a**.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 395, f. 538.

Fjala në shqipen standarde: **huall,-i**.

**Huall-i** ka në Martanesh si dysor: **hoje-t; hoj/ë-a** me variantet (*ho:j-a, huhoi, hoj-t, hojt*) zotërojnë në Elbasan, Shëngjin i Madh, Zerqan, Klos; **sotk/ë-a** del në Dibër; **zjoje blete** del në Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 396, f. 540.

Fjala në shqipen standarde: **çark,-u.**

Në Martanesh **lak-u** është ai që ngrihet në pyll për të zënë kafshë të egra; **çark-u** është ai që ngrihet në shtëpi për të zënë minj; **kurth-i** është term i përgjithshëm; **çark-u** me variantet fonetike (*çark-u, çarg-u*) përdoret në Elbasan, Belsh dhe Shëngjin i Madh; **hekura-t** me variantin (*hekra-t*) përdoret në Zerqan; **klapejck/ë-a** del në Dibër.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 397, f. 542.

Fjala në shqipen standarde: **sqepar,-i.**

**Sqepar-i** me variantet fonetike (*sqepa:r-sqepari, sjepa:r-sjepari, sipar-i*) zotëron në Martanesh, Elbasan, Belsh, Zerqan, Shëngjin i Madh; **tesk-a** del në Dibër; **tesk-a** del në Klos.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 398, f. 544.

Fjala në shqipen standarde: **numëroj.**

Numëroj me variantet fonetike (*numroj, nërmoj*) përdoren në Martanesh, Elbasan, Belsh dhe Shëngjin; **njuh** me variantet (*njof*) zotëron në Klos dhe Dibër;

Fjala në shqipen standarde: **dyzet.**

**Dyzet** me variantet (**dyzet, dizet**) mbizotëron në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 400, f. 548.

Fjala në shqipen standarde: **bërxhik,-u.**

**Bërxhik-u** me variantet (*përxhik-u, bërxhik-u, bërçejk-u, puxhik-u*) zotërojnë në Martanesh, Shëngjin i Mdh, Dibër, Elbasan, Klos dhe Zerqan.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 401, f. 550.

Fjala në shqipen standarde: **tjetërpasnesër.**

**Tjetërpasnesër** me variantet (*tjetërpasnesër, qetërpasnesër, qetërmbasnesër, tjetërpasnesri, tjetërnpasnesër*) mbizotëron në Martanesh, Zerqan, Dibër, Klos, Shëngjin i Madh; **mbipasnesër** me variantin (*përmipasnesër*) dalin në Elbasan dhe Belsh.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 402, f. 552.

Fjala në shqipen standarde: **pardje**.

**Pardje** me variantet (*pardje, pargje*) del në të gjitha pikat.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 403, f. 554.

Fjala në shqipen standarde: **mëngjes,-i**.

**Mëngjes-i** ka në Martanesh si dysorë: **sabah-u; mëngjes-i** me variantet (*mënxhes-i, m es-i, mje/s-zi*) zotëron në të gjitha pikat e tjera.

Shih: ADGJSH, V II, harta nr. 405, f. 558.

Gjatë krahasimit të leksikut të Martaneshit me zonat të cilave u jemi referuar vëmë re se këto të fome karakterizohen nga disa dukuri specifike që rrokin shumicën e tyre. Afria gjeografike e Martaneshit me këto zona ka sjellë edhe afrimin në leksik herë me njëren pikë e herë me tjetrën. Rezulton se e folmja e Martaneshit shkon më afër të folmes së Elbasanit, të Belshit dhe Shëngjinit të Madh.

## Leksiku

Gjatë ekspeditave në Martanesh jemi përqendruar në disa sfera që na janë dukur më kryesore për përfaqësimin e së folmes. Si të tilla kemi zgjedhur: 1. emra kafshësh shtëpiake; 2. Emra bimësh e pemësh të buta e të egra që rriten a kultivohen në zonë; 3. Emra veglash, mjetesh e orendishë; 4. Emra sëmundjesh (të njerëzve a kafshëve); 5. Fjalë onomatopeike dhe pasthirrma; 6. Fjalë pejorative; 7. Emra ushqimesh, gjellësh; 8. Fjalë që paraqiten me kuptime, që s'i ka fjalori i gjuhës shqipe dhe që ne na janë dukur me vlerë; 9. Fjalë që paraqesin interes për trajtat fonetike të dallueshme nga ato të mbarë gjuhës, herë falë një konservacioni të fortë, herë për arsye këmbimesh e risish të pjesshme të pavëna re në kreun e fonetikës.

1. **Emrat e kafshëve** në të folmen e Martaneshit janë të shumtë. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë ata që janë vendosur sipas ngjyrës ose shenjave me ngjyrë që kanë kafshët e ndryshme: *kuqe, lara, murra* etj. Po përpos ngjyrës për vënien e emrave në të folmen e Martaneshit shërbejnë tipare e cilësi të tjera si p.sh.: prania apo mungesa e brirëve, forma e këmbëve, mënyra e të ecurit, trajta dhe madhësia e trupit, veshëve etj.

Përpara se të ndalemi në ndonjërin nga këto grupe emrash, na duket e nevojshme të vëmë në dukje se emrat e kafshëve zënë një vend të ndërmjetmë midis emrave të përveçëm (me të cilët janë shumë afër) dhe emrave të përgjithshëm (nga të cilët nuk janë shkëputur plotësisht). Emrat e kafshëve, të vënë sipas ngjyrës (*balisku* = ka me shenjë të bardhë në ballë), si dhe emrat e vënë mbi bazën e ndonjë tipari tjetër (*shytë* = dhi pa brirë), për bariun janë emra të përveçëm<sup>122</sup>. Emrat e kafshëve janë të përveçëm jo vetëm për vetë bariun, por edhe për pjesëtarët e tjerë të familjes së tij. Vihet re se bariu, në shtëpinë e vet, nuk thotë p.sh. “më ka humbur një dhi” ose më ka humbur një dele”, por përmend emrin e kafshës p.sh: *liska* (= dhi e bardhë), ose *sharra* (= dele me trup të zi). Ndërsa, një njeriu që nuk bën pjesë në familjen e tij (një bashkëfshahtari, një kaimtari të rastit etj.), të cilin do ta pyesë p.sh se mos ia ka parë gjëkund kafshën që kërkon, bariu e pyet me perifrazë p.sh “*a ma ke i dhi t'kuqe?*”. Pra gjendja paraqitet si tek emrat e njerëzve, ku, siç dihet kur duam të pyesim p.sh. “*A kaloi Gëzimi kënde?*”, një njeriu që nuk e njeh Gëzimin, jemi të detyruar t'i drejtohem në një mënyrë tjetër, pa e përmendur fare emrin e përveçëm p.sh.: “*A kaloi një djalë i gjatë i veshur me të zeza?*”

Po megjithëkëtë emrat e kafshëve nuk janë kurrësi identikë me emrat e përveçëm të njerëzve për këto arsye:

- a. Emrat e përveçëm të njerëzve vihen pa pasur asnjë lloj lidhjeje me tiparet e njeriut, p.sh. qëllon që burri që mban emrin *Besnik* apop gruaja që quhet *Besnike* të mos jenë aspak besnikë, ndërsa lopës së cilës i vihet emri *murra* duhet të jetë

<sup>122</sup> Shih: Gj. Shkurtaç, *Emrat e kafshëve sipas ngjyrës*, SF, I, 1971, f. 95.

patjetër e murrmë, ose dhisë që i vihet emri *shytë* duhet të jetë patjetër pa brirë ose me brirë shumë të vegjël.

- b. Shumica e emrave të kafshëve janë të zbërthyeshme në togje: emër i llojit + mbiemër që tregon cilësinë e kafshës p.sh. *arapi = kalë i zi, murrash = ka i murrmë, briçe = lopë me brirë të mëdhenj, balldre = ka i fuqishëm* etj. Është fare e qartë se një gjë e tillë nuk mund të gjejë zbatim tek emrat e përveçëm të njerëzve.
- c. Disa nga emrat e kafshëve, veçanërisht ata që vendosen sipas ngjyrës a shenjave me ngjyrë, janë shumë të afërt, herë-herë krejt të barazvlefshëm me mbiemrat e substantivuar të një rrënje: *lara = lopë e larme = e larmja*. Provë për këtë vlerë të barabartë është mundësia e këmbimit të tyre, pa u prishur aspak kuptimi i fjalisë: *kuqi asht i fuqishëm = kali i kuq është i fuqishëm = i kuqi është i fuqishëm*.
- d. Emrat e kafshëve, me pak përjashtime, vihen jo veçe veç, por në grupe kafshësh, që kanë një ngjyrë, një lloj brirësh, një lloj trupi, një trajtë të ecuri etj. Kështu *lara* quhet çdo lopë me ngjyra, *shytë* quhet çdo dhi pa brirë etj.

Nga emrat e kafshëve, në të folmen e Martaneshit, më të shumtët janë ata që vihen sipas ngjyrës a shenjave me ngjyrë: *sharra = dele me turinj të bardhë dhe trup të zi, sharraku = dash me turinj të bardhë dhe trup të zi, balisku = ka me shenjë të bardhë në ballë dhe trup të kuq ose të zi, sorra = dele me shenjë të bardhë në ballë, liska = dhi e bardhë, lisku = cjan a kec i bardhë, bardhosh = ka i bardhë, bardhoshe = lopë e bardhë, zeka = dele e zezë, xebe = dhie e zezë, kuqe = lopë e kuqe, qali = ka i kuq, liska = dhi e larme, larisku = cjan i larmë, laramane = lopë e larme, bala = lopë me lara, murgashe = dhi e murrme, murgash = cjan i murrmë, kaziu = ka i zi, murra - lopë e murrme, murrashi = ka i murrmë, kuqi = kalë me ngjyrë të kuqe të errët, dhishka = dele e bardhë, çili = kalë në ngjyrë hiri, arapi = kalë i zi, rosa = pelë e bardhë, qali = ka i verdhë.*

Një varg emrash të kafshëve kanë buruar nga veçori të ndryshme të individëve, në sajë të cilave ato veçohen disi nga mbarë lloji.

- a. Sipas brirëve, pranisë ose mungesës së tyre, formës së tyre etj., janë formuar emrat dhe mbiemrat e mëposhtëm: *briçe-ja = lopë me brinj të shtrembër ose të thyer, krruta = dele me brirë të mëdhenj si të dashit, capore = dhi me brirë të mëdhenj, shyta = lopë a dhi pa brirë ose me brirë shumë të vegjël, krrut-i = dash me bri të dredhur, kacerre = lopë me brirë të mëdhenj etj.*
- b. Nga madhësia dhe forma e veshëve: *curra = dhi me veshë të vegjël, llapore = dhi me veshë të mëdhenj e të gjerë, llapusha = dhi me veshë të gjatë.*
- c. Nga mosha dhe seksi në lidhje edhe me pjellorinë ose aftësinë e fertilitetit etj :

**për delet:** *qij < qinjgj = qingji nga lindja der sa mbush një vit; zheleg = qengji nga 1-2 vjeç, rrunëz-a = qengji nga 2-3 vjeç, plle (dele) = dele që ka pjellë, e:j =*

dele që i ka ngordhur qengji ose që e ka nxjerrë atë para kohe, por që i mirret qumështi; *shterp-a* = dele që nuk ka pjellë një vit ose që nuk pjell fare, *korthij* = qengj që lind vonë dhe lihet të pijë qumështin e së ëmës deri vonë në verë.

**për dhinë:** *keç-i* = nga lindja deri në 1 vit, *ftuj-a* = nga 1 deri në dy vjeç, mashkulli quhet ftujak, *ptuk-u* = nga dy deri në tre vjeç, por që nuk kanë lindur ende, pas kësaj moshe quhet *sjap*, *dhi*.

**për lopët:** *viç-i*, *viçe-ja* = nga lindja deri një vjeç, mshtjerr-a (për femrën) nga një deri tre vjeç, *muzat-i* (për mashkullin) nga një deri në tre vjeç, *tredhak* = mëzat i cili e ka humbur krejtësisht aftësinë e fertilitetit nga tredhja.

2. Emrat e bimëve dhe të pemëve (të buta dhe të egra) janë të shumta në këtë të folme, po ne këtu do të japim disa prej tyre:
  - a. Nga emrat e bimëve, që kultivohen në arë mund të përmendim: *misër larosh* = misër me disa ngjyra, *misër kokeve:rdh*, *misër i ba:rdh*, *molladheje* = patate, *molladheje t'kuqe* = patate me lëkurë të errët, *pjepën* = kastravec, *kumull stamolli* = kungull me lëkurë të hollë, *kumull veni* = kungull me lëkurë të trashë, *lakmishta* = sallatë jeshile, foragjere = lakër që nuk mbledhte kokë dhe përdorej për bagëtitë etj.
  - b. Nga emrat e bimëve, që mbijnë në arë mund të përmendim: *gramth-i* = bimë me rrënjë të thella në tokë, që pengon rritjen e misrit apo bimëve të tjera që kultivohen në ara, *bushllu:z - a* = bimë që kacavirret në misër, *qumushtor-i*, bimë jeshile që përmban një lëndë të bardhë si qumësht, *nena* = bimë jeshile e gjatë që pengon rritjen e misrit, *egjer - a* = bimë e dëmshme që kacavirret në grurë, *vgjeth-a* bimë jeshile që rritet në vende me lagështirë, *plaçk - a* = të gjitha bimët e dëmshme quhen plaçka.
  - c. Nga drurët frutorë mund të përmendim: *kumlla t'egra*, *kumlla vardari*, *monaferra*, *arra gu a* = që nuk iu del thelbi etj.
  - d. Nga emrat e drurëve jofrutorë: *ahu*, *dushku*, *vgjeni*, *vidhi*, *shkoza*, *plepi* etj.
3. Emrat e veglave të punës bujqësore, të punimit të bulmetit, të orendive shtëpiake janë të shumta. Këtu po japim disa nga emërtimet më përfaqësimitarë të krahinës së Martaneshit: *she:gj-a* = enë e vogël prej druri, që përdoret për të mjelur qumështin; *mti/ftu* = enë druri e gjatë dhe e ngushtë në të cilën rrihet qumështi ose kosi për të nxjerrë gjalpin; *tuns-i* = shkopi me të cilin rrihet qumështi në enën e përshkruar më lat; *tinar-i* = enë prej druri që përdorej për të mbajtur gjizën; *stru - a* = enë e vogël prej druri, e cila përdorej për të mbajtur gjalpin; *to:rb-a* = enë prej lëkurës së kecit, e cila shërbente për të mbajtur ushqimin e barinjve; *ku:p-a* = enë

e vogël prej druri me kapak, në të cilën bariu merrte me vete gjizën ose gjalpin; *calik-u* = enë e bërë me lëkurën e kecit, më e madhe se torba, e cila shërbente për të mbajtur bylmetin; *krra:b-a* - shkop që e mbate bariu për të kotrolluar bagëtinë; *bulir-a/bucel-a* = enë prej druri, që shërbente për të mbajtur ujë; *binte-ja* = enë qelqi për të mbajtur rakinë; *saç-i* = fletë hekuri e rrumbullakët, e ngritur si gungë dhe me dorezë sipër, që nxehet mbi zjarr dhe mbulohet me prush dhe shërbente për të pjekur mishin; *gorrik-u* - ishte i ngjashëm me saçin, por prej balte dhe shërbente për të pjekur bukën; *çerjep-i* - enë prej balte në formën e tepsisë, e cila shërbente për të pjekur bukën; *kamje* = kambjeprej hekuri, të cialt shërbenin për të mbajtur enë të ndryshme mbi zjarr; *varg-u* - shërbente për të mbajtur mbi zjarr një enë me ujë të ngrohtë; *gjym-i* = enë që shërbente për të mbajtur ujë të ngrohtë; *çirak-u* = shërbente për të mbajtur pishën për ndriçim; *vo:rb-e* - enë prej balte, që shërbente për të zierë fasulet; *hamar-i* = arkë e ndëtuar me dërrasa, që shërbente për të mbajtur misrin e shirë ose grurin; *magje-ja* = ishte një dollap me funksion të dyfishtë: në pjesën e poshtme mbareshin enët e kuzhinës, ndërsa në pjesën e sipërme ngjishej brupi për të bërë bukë; *shpia e bukës* = vendi ku gatuhet; *likur milli* = thes i bërë me lëkurën e dhisë, që shërbente për të dërguar drithrat në mulli dhe për të mbajtur më pas miellin e bluar; *gjalm-i* = lidhëse e bërë me lëkurën e bagëtive, që shërbente për të lidhur *likurën e miellit*; *lugë gjelle* = garuzhdë; *gëzhdar-i* = arkë e ndëtuar me thupra me çati dërrase, që shërbente për të mbajtur misrin e pashirë; *trin-a* = thupra të thurura, që shërbenin për shirë misrin; *parmen-a* - vegël bujqësore prej druri, që përdoret për të lëruar tokën; *dorëz-a* = mbahej nga bujku dhe shërbente për të drejtuar parmendën; *vig-u* = lidhte dorëzën me zgjedhën; *kularët* = rathë hekuri, që viheshin në qafën e qeve; *shpatza* = bashkonte vigun dhe dorëzën dhe përdorej për të shkrifur tokën; *plug-u* = vegël bujqësore prej hekuri, që tërhiqet nga kafshët për të lëruar tokën; *hekrat* = lidhnin parmendën me zgjedhën; *hosten-i* = thupër që e mbate bujku për të drejtuar qetë;

4. Emrat e sëmundjeve (të njerëzve dhe të kafshëve) nuk janë të paktë, po mbledhja e tyre nuk është e lehtë për arsye se shumica e tyre janë zhdukur ose zëvendësuar me emërtimet e reja të marra nga gjuha standarde. Kësioj, duhet thënë që edhe ato pak emra sëmundjesh që kemi mundur të qëmtojmë nuk janë në përdorim të gjerë, po hasen kryesisht në të folurit e brezit të vjetër:

*T'shkullik* = gripi; *zaiçët* = gjendje këputjeje, dobësim; *li im* = përdoret në përgjithësi për sëmundjet kronike; *plevita* = ftofje, sëmundje e mushkrive; *kolla e bardhë* = kolla e mirë; *smunie e keqe* = kancer; *tifa* = sëmundje e zorrëve; *alosa* = sëmundje e kafshëve, që shkaktonte dëmtimin e këmbëve; *i ka zënë dheu* = sëmundje e kafshëve kur i zë gjaku; *e nërkryme* = tërbimi i kafshëve, që shkaktonte humbje të ekujlibrit. Në raste të tilla, kafshës nuk i konsumohej koka; *vneri* = helmim; *sakaria* = sëmundje e kuajve; *ligata* = sëmundje e kafshëve, që

kullosin në kënetë, e cila prek mushkëritë dhe zorrët; *plasja* = sëmundje që prek kryesisht lopët, shkakton fryrje; *flama* = sëmundje që prek pulat; *rriqna* = sëmundje e bagëtive (dhive), në trupin e të cilave zhvillohen krimba; *teja* = sëmundje e bletëve.

5. Fjalët onomatopeike nuk mungojnë në të folmen e Martaneshit. Më tepër ato u përkasin botës shtazore, emërtojnë veprimet e përditshme të njeriut, sidomos ato, gjatë kryerjes së të cilave shkaktohet ndonjë zhurmë, tingull a pasthirmë karakteristike:

*hi llon* = imitim i zërit *hi hi hi* që lëshon kali, *hi llon<hingllin<hi hi hi* etj.; *gugulesh* = zjarr i madh me shumë flakë; *kumon* = këmborë e dhive ose lopëve, e cila jep tinguj të lartë; *trokje* = ecja e kalit *trok trok*; *guga* = bën *gu gu* foshnja që nis të belbëzojë; *kakaris* = bën *ka ka ka* pula kur përgatitet të bëjë vezë; *gërrfet* = lëshoj zhurmë *gërr-gërr* duke fjetur; *gropsin* = gromësim; *lluka* = pula që bën lluk-lluk; *e teshmja* = teshtij, fjalë onomatopeike ndërtuar mbi bazën e asaj si teho që dëgjohej kur teshtin njeriu a kafsha.<sup>123</sup>

6. Emërtime që lidhen me ushqimet, gjellët në krahinën e Martaneshit, përgjithësisht, janë të fondit të përbashkët të shqipes, kështu po japim një pjesë të tyre:

*batërko* = qull me miell misri të bardhë dhe gjalp; *kulloshtër* = qumështi i parë i bagëtive pas lindjes; *shullin gjize* = gjizë me shumë kripë; *brom* = pjesa e mbetur në fundin e enës pas tretjes së gjalp; *drocka* = pjesa që mbetet pa u tretur gjate shkrirjes së dhjavit; *mullza* = gatim me gjakun e bagëtive, me dhjamë dhe miell misri, që futen në zorrët e bagëtive dhe zihet; *do:llm* = përgatitet me miell, qumësht dhe kungull; *kafarma* = mish i zierë, i pastruar nga kockat dhe i dyllosur me dhjamë të shkrirë; *dhalltur* = lloj lakrori i përgatitur me brumë të hollë të ardhur, që shoqërohet me dhallë; *qu:ll* = gjellë me mish pastërma dhe miell misri; *zhivë buke* = thuhej në ato raste kur banorët kishin shumë punë për të bërë dhe nuk u dilte koha të ushqeheshin “*hara i çik zhi:v buke*”, si për të thënë që humba kohën;

7. Në të folmen e Martaneshit gjejnë përdorim një sasi fjalësh pejorative:

*I nrakalit* = përdoret për të cilësuar një burrë ose një grua me të meta mendore, *njashtu ka qe:n aja përhe:r*, e *nrakalitme ka tru:t*; *buzëpërvesh* = që ka buzë të shëmtuara; *syda:l* = thuhet për një njeri që i ka sytë e mëdhenj dhe e disi të dalë; *bythmadh* = njeri shumë i shëndetshëm; *i përxxhik* = njeri me trup të vogël; *pribret/ibret* = i shëmtuar, *ku e kishte gjet njat nuse, aja ishte pribret*; *çinimaçin* =

<sup>123</sup> Shih: E. Çabej, Studime për etimologjinë shqiptare, BUSHT, 1962, f. 68.



je si kinez (përdorej si sharje); *ordhalaq* = njeri i dobët, pa shëndet dhe i pafuqishëm; *i lig* = njeri i pafuqishëm, i sëmurë, *atij i ka hy e liga*; *kastli* = inatçor, me smirë, kasti i *atij asht për pu:shk*; *gënuq* = njeri i kërrusur; *xinxar* = ngatërrestar; *shumtarq* = burrë i shëmtuar; *shumtaro:j* = grua e shëmtuar; *hileqa:r* = burrë që bën hile; *morracak* = njeri i papastër; *i bëtymët* = njeri me të meta mendore; *i pahafishëm* = i metë, që nuk merr vesh nga bota; *murr i zi* = njeri me lëkurë të zezë, i shëmtuar, *ishte i murr i zi, nuk shifi me sy*; *refs* = njeri që mban veten; *syba:rdh* = që ka sy të keq, të prish me sy, *ishte i syba:rdh aja, qi tremte*;

8. Në të folmen e Martaneshit kemi mbledhur edhe një sasi fjalësh të cialt paraqiten me kuptime që nuk i ka Fjalori i gjuhës shqipe ose që nuk figurojnë aspak në të, si dhe fjalë që paraqesin interes për trajtat fonetike të dallueshme nga ato të mbarë gjuhës, herë falë një konservacioni të fortë, herë për arsye këmbimesh e risishë të pjesshme të pavëna re në kreun e fonetikës. Nga to, në trajtë fjalorthi po rendisim ato që na janë dukur më me vlerë

## FJALORTH

### A

**ã:ni** *pjes.* – nuk ka gjë, s'ka problem; **ãni ãni**.

**aç**, *ndajf.* – bosh; pa gjë; ishim *aç* – ishim pa gjë, pa pasuri **jam aç** – nuk kam asgjë fare.

**afishëm (i)** *mb.* – i dobët, i thatë; njeri i afishëm.

**amëz-a** *f.* – shija e një ushqimi; *ka amëz t'mi:r.*

**ani** *ndajf.* – pastaj, më vonë; do vij ani.

**ark-a** *f.* – dollap dërrase që mban rrobat e nuses.

**arn-a** *f.* – një copë stofi, bezeje ose lëkure që përdoret për ta vënë në vendin e grisur të rrobave ose të plaçkave të ndryshme.

**avlli-ja** *f.* – oborr i rrethuar.

### B

**Babaxhan-i** *m.* – njeri i dashur.

**baj** *f.* – transportoj diçka nga një vend në një tjetër.

**bardak-u** *m.* gotë uji.

**barrë (grua)** *f.* – shtatzënë: *gru: me ba:rr.*

**barrë (me)** *f.* – ngarkesë që mbahet mbi shpinë.

**batërkõ- ja** *f.* – miell misri i zierë dalëngadalë në ujë të valuar, trazohet derisa të trashet.

**befi** *f.* – erdhi; *veç ke befi* – erdhi pa pritur.

**bgõ** *f.* – infekton.

**bigorr-i** *m.* – pisllek; *ishte mledh bigorr i madh.*

**bina – ja** *f.* – ndërtesë, shtëpi e madhe.

**biskoj** *mb.* – e vogël.

**bistak-u** *m.* – bimë e vogël në fazën e rritjes.

**bitin-a** *f.* – dërrasë apo rrasë guri që përdoret për të zënë shpendë të egër.

**blõj** *f.* – pollgë me ujë, vend ku qëndron ujë apo mbetjet e shiut.

**brom-** *i m.* – mbeturinat e gjalpfit që mbeten gjatë shkrirjes.

**buç – a** *f.* – qeni femër.

**bula (uji)** *f.* – pika uji.

**bulqim** *mb.* – i babzitur.

**buxhak – u** *m.* qoshja e dhomës; nusja rrinte *n'buxhakt.*

**byzylek-u** *m.* – një lloj bime që mban aromë të mirë dhe mbahet në rroba.

### C

**cakorre** *f.* – sëpatë e vogël

**cakorre-ja** *f.* – sëpatë e vogël.

**cap** – *i m.* – cjap, sjap.

**çapraze** *ndajf.* - bën shumë muhabet, **aja është çapraze e mirë.**

**capu** *m.* – sapun.

**carõ** *mb.* – e enjtur.

## Ç

**çerjep** – *i m.* – çerep.

**çidik-u** *m.* – pantallona shajaku.

**çil** *ndajf.* – i zbardh me thinja; qeka bā *çil.*

**çini** – *ja f.* – pjatë prej metali.

**çi rron** *f.* – zhurmë; fryn era; *çi rron era.*

**çipllak** *ndajf.* – **lakuriq**

**çitjane sh.** – mbathje të gjera grashë, të cilat vijnë duke u ngushtuar nga këmbët.

**çubuk-u** . – çibuk, llullë.

**çun-** *i m.* – djalë.

**cyt, (cys)** – ngacmoj, nuk *cyt* njeri – nuk ngacmon njeri; **mos m'cyt** – mos më ngacmo.

## D

**dac** – *i m.* – maçok

**daha** *ndajf.* – akoma; *daha* mǎ keq.

**daha-daha** *ndajf.* – shumë e madhe.

**dallkauk -u** *m.* - njeri i vështirë.

**dëftej** *f.* – tregoj, kallzoi.

**dëmi** *sh.* – çitjane

**demiroxhak-** *u m.* – gllaniku i oxhakut.

## DH

**dhallt-i** *m* – dhallë.

**dhalltur-i** *m.* – dhallëtori, bukë misri e zënë me dhallë e me kos.

**Dhanti-ja** *f.* - dhuratë (dash) që çohet në raste dasmash.

**divanhân** – *ja f.* – korridor, sallon.

**dollap** – *i m.* – dritare me kapakë dërrase; sa *dolla:p* ka oda jote.

**duvak-** *u m.* – copë pëlhure me të cilën mbulonin nusen në fytyrë.

**dystoj** *f.* – sheshoj , rrafshoj, e bāj *dyst; e dystojm* arën.

## E

**elvedi** –*ja f.* – leverdi

**elvedi** *mb.* – specialist, zanatçi që e njeh mirë punën.  
**emall-a f.** – dhëmballë; *tmalla*

## F

**flõ:çk** *ndajf.* – e nxehtë; ishte fõçk buka.  
**fner- i m.** – fener.  
**frasholl- i m.** – fasule.  
**ft** *m.* – rrahësi i qumështit, tundësi i qumështit.  
**fullkat** *ndajf.* – vetëm, *rri fullkat e vetëm.*  
**fyqyr-i m.** – mendja; *i ka ik fyqyri krejt.*

## G

**gëdis** *f.* – ndërtoj, rregulloj; e kan gëdit shpi:n.  
**gëdit** *f.* – rregullon.  
**gëdit** *f.* – shijuar; *m'ka gëdit rõn.*  
**gënuq** *mb.* – njeri i kthyer në kurriz.  
**gërdhic** *f.* – kafshoj, gërvisht; *m'gërdhici maca, gërdhica nurët.*  
**gërrmaz** – *i m.* – fyti, gurmazi.

## Gj

**gjalm- a f.** – pe i trashë dhe i përdredhur.  
**gjerb** *f.* – merr me lugë, ha; *gjerb thallë.*  
**gjeris- i m.** – vijë në formë tubi, e bërë me gurë dhe llaç dhe e mbuluar, nëpër të cilat sillej uji i pijshëm.  
**gjol** – *i m.* – liqë.  
**gjuhën** – *a f.* – gjuhë.  
**gozhdar- i m.** – kosh drithi.  
**grad** – *a f.* – çerdhe e shpendëve në të cilën bëjnë vezët apo çelin zogj.  
**grafm** – *a f.* – erë e keqe, kundërmim ere, frymë e gojë.  
**grihën** – *a f.* – një lloj lime guri që shërben për të mprehur thika, brisqe, kosën etj.  
**gropos** *f.* -1. bëj gropë, hap gropë, thelloj një vend; 2. varros.

## H

**hajër** *ndajf.* - mirësi.  
**halldup** *mb.* - njeri i rëndë.  
**harbut** *mb.* - njeri i vrazhdë.  
**harita**

**hasër** – *a f.* – shtresë prej kashte, që vihej poshtë dyshekut.

**hatëll** – *a f.* – hatull.

**hazër** *ndajf.* – gati.

**hepe** - vend ku vihen vegla.

**hithën**- *a f.* – hithër

**hokë**-*a f.* – pasqyrë.

**hovi** *f.* – vrapoj, eci shpejt.

## I

**i vjefshëm** *mb.* – i dobishëm; *aj është i vjefshëm; atij nuk i vjefshëm fmija.*

**imambajëlli** – *a f.* – një lloj gjelle e bërë me patëllxhan, qepë, domate dhe hudhra.

## J

**ja** *f.* – eja; *ja ka un.*

**japarak** – *u m.* – një lloj gjelle e gatuar me oriz dhe mbështjellë me gjethe rrushi.

**jarrina** *f.* – erdha, mbërrita.

**jatak** – *u m.* – dyshek.

**jazik** – turp, jazik t'qoftë.

**jibrik** – *u m.* – ibrik.

**jini** *ndajf.* – më vonë, pastaj, *jini* hajde.

**jinithën** *ndajf.* - më vonë.

**jodhnu** *f.* – zemëruar, mërzitur.

## K

**kalem-i** *m.* – stilolaps.

**kallm-i** *m.* – një shkop me përmasa të caktuara që shërben për të bërë petë.

**kam-je** *f.* - kambje.

**kana** – *ja f.* – këna; një lloj boje që përdorin gratë për t'u lyer.

**karrabeç** *ndajf.* – kalaqafë, shaluar, e baj karrabeç.

**karrvat** – *i m.* – shtrat, krevat.

**kashtis** *f.* – përziej, i kashtis bashkë.

**katik** – *u m.* – ushqim i punëtorit.

**kërkoset** *f.* – ngrifet, kapërdiset.

**kohë-ja** *f.* - koha.

**kollonris** *f.* – drejtoj, komandoj; *kollonris veten* – *urdhnoj veten*- i shërbej vetë vetes time, mbahem.

**krru:t** -*a f.* -dele me brirë.

**krac-i m.** - i vështirë.

**kulesë-a f.** – një lloj kullojëse, si lugë e madhe, me vrime, që shërben për t'i hequr shkumën gjellës; përdoret edhe për ndarjen e orizit dhe të makaronave.

**kuplec-i m.** – tas i vogël prej kauçuku.

## L

**lagon – i m.** – legen.

**lal-a** – emër me të cilin thirret vëllai i madh ose babai.

**li – ja** – këmishë grash prej mëndafshi

## LL

**llagap-i m.** – gjuha që flet një krahinë tjetër.

**llagap-i m.** – mbiemër.

**llam – a f.** – llambë me korent

**llokëm –a f.** – copë mishi.

## M

**manall – i m.** – i madh

**manzërr-a f.** – lloj arme.

**mathere ndajf.** – atëherë.

**mazëlla ndajf.** – kurrë; *mazëlla që e bënë i pu:n.*

**mazu f.** – mërzhitur, zemëruar.

**m f.** – pushon, pakësohet; s'ka *m* ; prihe:r *m ni* ujt.

**mejtova f.** – kujtova.

**melhem - ilaç.**

**mërdhif f.** – kam të ftohtë.

**mërdhiz - ka të ftohtë, morinca.**

**mide-ja f.** – gusto, shije; *mide mide kjo dyjō.*

**mide-ja f.** – uri; *s'ma ka mideja* – nuk më hahet.

**miner – a f.** – minder, ndenjësë dërrase.

**miqiruf mb.** - hileqar.

**mllef- i m.** - inatë.

**mshtjell f.** – mbuloj, mbledh;

**mullis-i m.** – njeri që drejton bluarjen e drithërave në mulli.

**mullō m.** – nishan i madh.

**murriz-i m.** – lloj gjembi, *gem.*

**musa'ner f.** - dollap në mur.

**mykaraq** *mb.* - kërrnac, dorështërnguar.  
**myti**: *mb.* - i metë; *nja:j* *ã* *krejt myti*·.

## N

**namu:z-i** *m.* - nderi.  
**nibet - i** *m.* - radhë.  
**Netull,-a** *f.* - fshesë.

## NJ

**njit** *ndajf.* - ngjit, afër.

**allmo** *f.* - qep me gozhdë.  
**arko** *f.* - ngarko.  
**rica-a** *f.* - acar, ngrica.

## O

**od-a** *f.* - dhomë.  
**okolle-ja** *f.*-dhomë ku rrinë burrat; okollja e burrave.  
**õrdhõ et** *f.* - bymehet.

## P

**palit** *f.* - palos.  
**pen -a** *f.* - pupël, pendë.  
**penar-i** *m.* - ai që nget pendët e qeve.  
**penxhere-ja** *f.*- dritare.  
**përtërmales** *ndajf.* - lart, përpjetë; *ishte dik përtërmales*.  
**picir**: (*ia boni picir*) - e shtërngoi, ia mblodhi.  
**pile**:-ja *f.* - mjet në formën e një shkopi që shërben për kapjen e shpendëve të egër.  
**pilivrom** *mb.* - e hidhur.  
**pilivrom** *mb.* - e mavijosur.  
**poterexhi** *m.* - shamataxhi, zhurmaxhi, njeri që bën zhurmë shumë.  
**prasi** -*m.* - preshi.  
**pustiqe-ja** *f.* - postiqe; lëkurë bagëtie me gjithë lesh, e regjur, që përdoret për shtroje.

**putõ** *m.* – pollgë uji; zakonisht njihet me këtë emër një pengesë e ngritur në lumë apo zallë.

## Q

**qasu** *f.* – largohu; *qasu tutje.*

**qellem** *f.* – vonohem; *u qella; u qell goca; pse u qelle?*

**qepena** *f.* - mbajtëse prej druri, që shërbenin për të mbajtur pjesën e dalë të çatisë.

**qifte** *sh.* – qerpikë.

**qile-ja** *f.* – kilogramë.

**qipshtije** *sh.* – kopshte; dy- tre kopshte përbëjnë *qepshtije.*

**qullpule** *sh.* – një lloj gjelle me mish pule, vezë dhe miell.

**qymez-i** *m.* – kotec, kasolle e vogël për pula.

**qytyk** *ndajf.* – fodull.

## R

**rep.** *f.* – u rop lëkura, u hoq cifla- cifla.

**resme-ja** *f.* – fotografi

**reze-ja** *f.* – shërben për të mbyllur derën, *shuli i derës, rezja e derës.*

**r** *f.* – çel, rritet; *kanë r gjethet.*

**rize** *f.* – shami që mbajnë gratë në kokë; një pëlhurë e veçantë në të cilën vënë djathin për të kulluar hirrën.

## Rr

**rrapacin** *ndajf.* – e bëri një punë copë – copë; *aja ã pu:n me rrapacina.*

**rraqe** *sh.* – rroba.

**rrasht-a** *f.* – zverku, koka; *më dhem rrashta e kre:s.*

**rreshtën-a** *f.* – kafka e kokës.

**rrufi-ja** *f.* – grua qeflie.

## S

**sabër** – bëhet i fortë; *gajret; i shtift Zoti sabër.*

**sahan-i** *m.* – tas prej alumini.

**salem** – e shëndetshme, e saktë.

**sapu** – **sapoi** *m.* – sapun.

**sene-ja** *f.* – vit; *sene për sene* – vit për vit.

**ses** *f.* – sit; po ses millin, po e *sesin*, po e *setni.*



**set-a f.** – sitë shumë e shpeshtë që lëshon vetëm miellin.  
**sylm/e-ja f.** - e dalë mbi oxhak, ku vendoseshin sende të ndryshme

## SH

**shafis f.** – shuaj, shkatërroj.  
**shallvare-t. sh.** – një lloj pantallonash të gjera.  
**shefa f.** – lehtësim nga dhimbjet, shërim; *a ke gjet sheaf pri atyne hilaçesh?*  
**shefku m.** – agimi i ditës, pak para se të zbardhëë dita; *pa dhân shefku.*  
**shint mb.** – njeri i mirë; *shint gruje.*  
**shkërçi f.** – lodhje fizike; *mu shkërçin kocet.*  
**shkreptin-a f.** – vetëtimë.  
**shllung-a f.** – një tufë leshi.  
**shpëris f.** – me trazuar diçka; shpërit si pu:l.  
**shpirtëse-ja f.** – shkrepëse.  
**shte:r f.** – mbarohet; shteret ujë që ka një pus ose një përrua.  
**shtypkë-a f.** – vend i errët.  
**sira-ja f.** – radhë; me *sira*, rrijnë me *sira*.  
**snuk-u. m.** – sënduk.  
**sob-a f.** – stufë.  
**stela f.** – rrobat e fjetjes.  
**sukëll-i m.** – leckë, rreckë për fshirje.  
**sultjash-i. m.** – një ëmbëlsirë e bërë me qumësht, oriz, sheqer (ose kripë).  
**sumëll-a m.** kopsë e rrumbullakët, komçë.

## T

**tabëll-a f.** – enë e vogël për hi të duhanit.  
**temin-a f.** – mjet zbukurimi në rrobat e qendisura, është në formë të petizuar. me vrimë në mes, me ngjyra të ndryshme.  
**teveqel mb.** - njeri i metë, *i bëtymët.*  
**tëposht ndajf.** – nga lart poshtë; tatëpjetë.

## TH

**thekje-ja f.** – një lloj qilimi me fije anash.  
**thërrmi-ja f.** – thërrime.  
**thni:ll-i m.** – thëngjilli.  
**thnill-i m.** – thëngjill.  
**thull f.-** holloj, bëj petë bakllavaje; *thulla i byrek.*

**tlyn-i** *m.* – gjalpë.  
**tmall-a** *f.* – dhëmballë; *emalla*.  
**trajs-a** *f.* – një lloj çante prej bezeje.

## U

**uk-u** *m.* – ujk.  
**urof-i** *m.* – një lloj tagjie me kokër rtë vogël dhe të rrumbullakët; rritet nëpër ara dhe shërben si ushqim i kafshëve.  
**ushujz-a** *f.* – shushujë.

## V

**varde** *ndajf.* – shpërndarë, jo në vendin e duhur.  
**vath-i** *m.* – vëth.  
**vesha** *f.* – veshjet, rrobat.  
**vi:-ja** *f.* – kanal i vogël uji.  
**videll-i** *m.* – lëkurë viçi për opinga.  
**vrulloj** *f.* – eci shpejt, eci me vrap, turrem, sulem.

## XH

**xhezme-ja** *f.* – xhezve.  
**xhins-i** *m.* – rracë.  
**xhok-a** *f.* – xhezve.  
**xhymlek-u** *m.* – një lloj këmishe.

## Y

**yrnek** *mb.* – njeri që ka naze në të ngrënë.  
**yzër** – me leje.  
**yzër** *mb.* – shtatzanë; *me ba:rr*.

## Z

**zbarit** *ndajf.* - pa kripë.  
**zek-a** *f.* – dele e zezë.  
**zevzek** *mb.* - njeri që nuk duron.  
**zgillat** *f.* – hapi koha; *zgillati koha*.  
**zijet** *ndajf.* - vështirësi.

## ZH

**zheleke-ja** *f.* – qengj njëvjeçar.

**zidõn-i** *m.* - siklet

## Tekste

Na gra:t ishim për gjeth n'pyllët // u trëndit veni // taliōni ishte n'pyllët // vu:m barrat me gjeth ene i:km // kur du:lm n'Qa:f t'Kaciqit / ishte mush plot me ushta:r / sa tërma tëpo:sht // kur sosm n'shpi / taljoni e mulo:j ve:n // kunata ime / Isenia / vinte vërdall / bānte me rujt shpi:n // aja ju shkrefte pushkët ushtaret // ene na shoshbosh t'bājim na // na vra:n dy qent / jini vojtn n'hajat / se dojin me ma:rr kuajt // na kishim hy n'hajat me kalamājti pri fryke // un kapa cucën n'kraha pri fryke / ene thoje „fryka / fryka“ // ene oj bi: kemi pa t'keqen fort // duln pri hajati / vojtn n'shpi / kthyn nijetn e pushkës // Isenja u tha / shkoni n'malt me gjeth komuniste // jini na i la:m rraçe e gjo n'shpi e me ik // ku me shku // vojtm n'Gjon // njā tri – katër di:t nitm n'Gjon // ata e kishin me teqen / se kishte organizu luftën // kur shkojm n'shpi na or bir / ata jarri:n e vun zjarmin shpi:s // plasi zjarmi n'qepena // i bijin me harita // jini bo:m konakn si kemi nashti.

Rabie Cuka – 90 vjeçe, lindur në Martanesh, pa arsim.

Kishin qe:n dy vllazën / njōni pri kt ne kishte qe:n qeros // kta dy tjerit nuk e dojin qerosn // me i hum kryt qerosit e çu:n ke i div // divi na kishte i stexhade // qerosi duhej me ja marr stixhaden // stixhadja na kishte 365 zile // qerosi u kërko:j vllaznet pamuk për t'shtupu zilet / se mos ta ni:jn divi ke ta ma:rr // i shtupo:j zilet ene e mu:r stixhaden ke kryt // çohet divi ene i tho:t bashkshortes vet / ku ā stixhadja // jini qerosi erdh prap natn e dy:t ene h ni mi hajati t'merrte kalin e divit / divi e ngjo:j / ky h ni n'grazhdit kalit // divi e rrafi kalin ene kali nuk u n mo për i gja:ll / ene qerosi e mu:r kaln // vllaznit kishin ene i naplon flori // për t'tretin i tho:n qerosit hajd e merr divn // qerosi u kërkoj vllaznet i pa:l rrobe flor ni / sha:rr / spa:t / maqinën ene katër go:zhd t'mëdhoja // vojti n'pyllt t'divit ene du:l divi / i tha / çare je tu bā / thot na u ka shpif i qeros dreqi / du ti bāj i a:rk / ta fus mr na e ta hudh n'de:t // pasi e maro:j arkën / i tha divit / shife ti pale a nriço mr na // ky n'fakt ishte qerosi ve:t // pastaj ky e m lli divn / e çoj ke vllaznit e vet // pasi piu divi kafen / ky i kishte shtru stixhaden ene kalin ja kishte lidh // kishte bā i hu:rdh t'madhe / aty ishte ul divi / pastaj divi ra n'gro:p // ky mu:r kazān e valës / ja huthi divit // i kshtu u gropos divi // qerosi mu:r tri naplonat e florinit // pralla an j / shnetja kn j.

Leme Zaboli – 65 vjeçe, lindur në fshatin Gjon të Martaneshit,

arsimi 7 – vjeçar.

Ishte n'Martanesh një bu:rr i vjetër / e qujshin Murat Koçi // po na rrëfente një ngjarje që ja kishte pas thā:n i jati kur ky ishte i vogël / për ardhjen e Abdyl Frashrit në teqen e Martaneshit // aj tregonte se një di:t Baba Jashari na kishte thi:rr që t'shkojm n'teqe për t'prit një mik që kishte ardh // ishim rreth 10-15 burra dhe taku:m Abdyl Frashrin // ishte një bu:rr i pashëm / që kur fliste sy:t i lshojn xixa e goja i nxirrte mja:lt // kur na foli për qëllimin që kishte ardh të gjithve na bëni për vete // na tha se ba:shk me Baba Jasharin dhe me disa burra të tje:r që ishin me tã do t'shkojm në një kuven të madh në Prizren / ku do venosej për fatin e Shqipni:s // na tha se Turqia po e thyn qafën / por disa uq qi kemi përreth du:n ta coptojn Shqipni:n e ta marrin për vete / por na ba:shk me ju e me gji:th shiptarët që e du:n atë nuk do t'i lãm t'ja mrijn ksaj dite // na ju përgjigjm se ene na jemi gati t'vijm me ju // jo / ju nuk do t'vini me ne / por ne na gzon fjala që po thoni / se po qe nevoja / masi t'venoset mledhja / athere do t'shofim se ku do shkohet // pas shu:m fjalve t' rofta qi nërrum me Baba Abdyl Beun / u nda:m me të / dhe aj me Baba Jasharn e me shokët qi kishte me vete u nish për Dibër // kjo ngjarje e ky takim me at person të ditur e atdhetar nuk m'hiqet nga menja sa t'jem gja:ll / tho:t Murati sa he:r trego për tã.

Qerim Lila-75vjeç, lindur në fshatin Gjon të Martaneshit, arsimi i lartë.

- Përshëndetje!
- Përshëndetje //
- Mund të na tregoni se si e kaloni kohën e lirë?
- Jo / shaka / ndonjëherë dalim për kafe me shoqni:n / ikim në internet / nojhe:r ja fusim noj lo:j pinpong ose bilardo / pastaj prap kafe / hapet noj muhabet / pastaj n'shpi // me pak fjalë kohë e humbur//
- Në shkollë ju ngarkojnë shumë me mësimë?
- Me raste / vetë orari është kshtu // nja dy di:t e kemi keq fare / noj he:r na binë shumë provime //
- Organizoni mbrëmje në shkollë?

- Po/organizojmë // tashti kemi ballo // pothuaj çdo fundjavë organizohet ndonjë parti i vogël me shoqëri të ngushtë // na duhen shumë lek (qesh)
- Keni pengesë nga prindërit tuaj për të marrë pjesë në mbrëmjet apo aktivitetet që ju organizoni?
- Mund t' më nxjerrin pengesa / po në të shumtën e rasteve ma bojn qefin // po noj herë a kupto //
- Keni më shumë shoqëri me djemtë apo me vajzat?
- Me djemtë kaloj shumicën e kohës / kupton ti / me vajzat më pak //
- Cila muzikë ju pëlqen më shumë?
- Tani më pëlqejnë më shumë baladat e rrokut //
- Pini duhan
- Jo //
- Pini pije alkoolike?
- Në raste të rralla fare // noj berrë / noj gjo t' let kshtu //
- Mendoni se një ditë mund të vareni nga alkooli
- Nuk e di / them se jo / se nuk e kam qef alkoolin // e pi kshtu sa për t' shoqëru //
- Cili është qëndrimi yt lidhur me paragjykimet që bëjnë shoqëria?
- Un them se nuk duhet të ekzistojnë paragjykimet / se e bëjnë individin të ndjehet keq dhe kjo nuk është gjë e mirë //
- Si ju duken marrëdhëniet dashurore një klase në shkollë?
- T' palezetshme // s' shtyhet / duhen të jenë jasht klase //

Hamdi Cuka – 17 vjeç, lindur në qytetin Krastë të Martaneshit,  
nxënës i vitit të tretë në shkollën e mesme të profilizuar “ Myslym Keta”.

- Mirmëngjes zonjë!
- Mirmgjes //
- Mund të na tregoni se çfarë keni gatuar sot?
- Sot kom gatu: gje:ll me mish me patate //
- Kjo është gjella juaj e preferuar?
- Po //
- Në rubrikën tonë radiofonike „Si të gatuajmë“ do të dëshironim të dinim recetën tuaj për këtë gjellë.
- Marrim dy kokrra qeçp, i fërgojm n’voj, pastaj i hudhim mishin / e përzi:m edhe mishin me qe:p // masi t’skuqen mi:r // hudhim domatet // i hudhim dy gota u:j dhe e lōm i gjymës ore tu zi: në presion // në kohën që mishi ã tu zi n’tenxhere / ne aqihere fërgojmë patatet // si ã zi mishi hudhim patatet e skuqme n’tenxhere / i lōm sa t’marrin i va:l / i hudhim ne kryp // pastaj gjella është e gatshme për t’u ngrënë //
- Faleminderit!
- S’ka përse / qe kënaqësi për mu //
- Mirupafshim //
- Mirupafshim //

Hike Cuka – 48 vjeçe, ka mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme, profesioni nëpunëse e gjendjes civile.

## Përfundime

Studimi „*E folmja dhe toponimia e Martaneshit*“ synon të përshkruajë gjendjen gjuhësore të kësaj krahine duke e hedhur vështrimin tonë rreth tipareve më të rëndësishme të kësaj të folmeje në fushën e fonetikës, të morfologjisë dhe të leksikut. Me këtë punim synojmë të japim ndihmesën tonë në përcaktimin e veçorive të kësaj të folmeje dhe vendin që i përket asaj në ndarjen dialektore të shqipes. Nga ana tjetër, duke qenë Martaneshi një krahinë malore, jeta e mbyllur në bashkësi fshatare dhe karakteri relativisht autonom i saj, kanë bërë që në këtë të folme të mbizotërojë karakteri ruajtës dhe të vazhdojnë të përdoren edhe sot trajta të vjetra, duke shpëtuar kështu një visar të paçmuar gjuhësor, i cili na jep një pamje përgjithësisht besnike të një të folmeje të ruajtur të krahinës së Martaneshit.

Nxjerrja në pah e një visari të tillë për këtë të folme ka rëndësi për të përcaktuar edhe kufijtë e shtrirjes së disa dukurive dialektore me vlerë në përcaktimin e ndarjes dialektore. Veç kësaj, një studim i gjendjes së sotme për këtë të folme, duke fiksuar edhe gjendjen e vjetër që ruhet mirë në brezin e moshuar, si dhe heqja e disa vijave, sigurisht të lëkundshme, mbi gjendjen e re gjuhësore të brezit të ri, mendojmë se do të jetë me vlerë për të ardhmen për të bërë krahasime me gjendjen e re që do të krijohet, si dhe për të njohur rrugët nëpër të cilën ecën zhvillimi gjuhësor i të folmes kur ajo vihet në raport me gjuhën standarde. Studimi ynë ndjek atë strukturë dhe atë metodologji pune, që është ndjekur në studimet të ngjashme, sidomos ato kushtuar marrëdhënieve dialekt-gjuhë standarde, prej të cilave veçojmë studimet e prof. Gjovalin Shkurtajt për të folmen e qytetit të Lezhës etj.

1. Vështrimi i fonetikës së kësaj të folmeje, në vija të përgjithshme, na dha mundësi të zbulojmë sistemin fonologjik të zanoreve e të bashkëitëgëllloreve, duke pasur si bazë sistemin fonologjik të gjuhës standarde.

Në të folmen e Martaneshit dallohen dy nënsisteme zanoresh në varësi nga vendi i theksit: zanore të theksuara dhe zanore të patheksuara. Inventarët e fonemave, që ngërthen çdonjëra nga këto dy sisteme, nuk janë të njëjta, sepse mbi zanoret e theksuara veprojnë në mënyrë të spikatur gjatësia dhe hundorësia, falë vlerës fonologjike të të cilave sasia e fonemave zanore në pozicion të theksuar del më e madhe sesa në pozicion të patheksuar.

Në sistemin zanor të kësaj të folmeje gjejmë 6 fonema zanore gojore *a, e, i, o, u, y* dhe përderisa veprojnë gjatësia e hundorësia, gjejmë një seri tjetër prej 6 fonemash zanore të gjata: *a:, e:, i:, o:, u:, y:*, që formojnë opozicione fonologjike me zanoret përgjegjëse të shkurtra dhe një seri prej 6 fonemash zanore hundore: *a, e, i, o, u, y*, që formojnë kundërvënie fonologjike me zanoret përgjegjëse johundore.



Përgjithësisht në nënsistemin e zanoreve të patheksuara gjendja e së folmes nuk dallohet shumë nga gjuha standarde. Mund të vihet re vetëm mospërputhje në dendurinë e përdorimit, sidomos të zanores *ë* në pozicion fundor, si dhe disa raste të neutralizimeve të *u-së*, *i-së*, *y-së*.

Në trajtimin e sistemit bashkëtingëllor rezultoi se fonemat bashkëtingëllore të kësaj të folmeje paraqiten, pothuajse, njësoj me ato të gjuhës standarde, çka dëshmon qartë unitetin gjuhësor që karakterizon mbarë shqipen.

Përveç 29 fonemave bashkëtingëllore të njëjta me ato të gjuhës standarde, në të folmen e Martaneshit ekziston edhe një fonemë tjetër: (bashkëtingullore hundore, disi e zhurmshme, si p.sh.: *rica* (*ngrica*), *arku*: (*ngrica*), *arku*: (*ngarkuar*), *rys* (*ngrys*), *upe a* (*upinga*) etj.

Pasi u vunë në dukje edhe një radhë neutralizimesh të kundërvënieve, si dhe grupet e bashkëtingëlloreve, arritëm në përfundimin se fonemat bashkëtingëllore grupohen në ndërlidhëri, duke formuar një sistem simetrik.

Duke lënë të painkuadruar laringalen shtegore *h*, sontante hundore *n*, *nj*, , anësoret *l*, *ll*, mesoren *j* dhe dridhëset *r*, *rr*, fonemat bashkëtingëllore hyjnë në një ndërlidhëri të qëndrueshme të përbëra nga këto tipare:

- a. *Zëshmëria*: të shurdhëta - të zëshme.
- b. *Lloji i pengesës*: mbylltore - shtegore.

Mbi këtë bazë rezultojnë:

- Mbylltore të zëshme: *b, d, x, xh, gj, g*.
  - Mbylltore të shurdhëta: *p, t, c, ç, q, k*.
  - Shtegore të zëshme: *v, dh, z, zh*.
  - Shtegore të shurdhëta: *f, th, s, sh*.
2. Më hollësisht u pa *morfologjia*. Duke vështruar të gjitha kategoritë morfologjike, duke dhënë të gjitha tabelat përkatëse të lakimit e të zgjedhimit, dolën mjaft trajta, forma, dukuri me interes dialektor.

Sistemi morfologjik i së folmes së Martaneshit paraqitet me dukuri të dallueshme nga të folmet e dialektit jugor e nga gjuha standarde dhe me disa veçori vetjake që e dallojnë edhe nga të folmet e Shqipërisë së Mesme. Por, megjithatë, si në mbarë të folmet e shqipes, këto dallime nuk janë të një karakteri të thellë strukturor.

Nga vëzhgimet dhe përjasjet e bëra u nxorën në dukje veçori të tilla me interes dialektor, si:

- a. Gjinia femërore e emrave: *tulja (tuli), shnetja (shëndeti), pylla (pylli), nerja (nderi)*, si edhe ruajtja e gjinisë asnjane, kryesisht në brezin e vjetër në disa emra që shënojnë lëndë. Por edhe këtu nuk janë të pakta rastet kur krahas këtyre formave, të njëjtat fjalë përdoren edhe në gjininë mashkullore: *djathët (djatht e dhenet), dyllët (dyllët e bletet), dhjomët (dhjomt e lopës), millët, ujt, tlynët (tlynt e lopës), grunët* etj., por thuhet *dhallti*. Kthimi i këtyre emrave në gjininë mashkullore është dukuri e të folmeve jugore të gegërishtes, të cilët në trajtën e shquar kanë ruajtur si fundore të temës bashkëtingëlloren *t*, që ka qenë mbaresë shquese e asnjansit, p.sh.: *ujti „uji“, dhallti „dhalli“*. Gjinia asnjane në zonën e Martaneshit ruhet ende në emrat e veprimit prejfoljor: *të ftohtët, të nxehtët, të vjellët*. Ashtu si edhe në gjuhën standarde edhe në të folmen e kësaj krahine, gjinia asnjane sa vjen e po ngushtohet, është reduktuar në një numër të kufizuar fjalësh;
- b. Ruajtja e gjinore-dhanores të trajtës së shquar pa *v*- epentetike: *dha<sup>o</sup>mët e pleqet, gishtat e duret, lesht e dhenet*. Kjo formë ruhet ende në të folmet jugore, që ndodhen në jug të Osumit dhe në një masë më të kufizuar edhe në disa të folme të izoluar malore të Shqipërisë së Mesme;
- c. Përdorimi i së ashtëquajturës rasë vendore, e cila nuk gjendet as në lakimin e pashquar të emrave as në lakimin e përemrave: *n'kafet, n'shpit, n'pyllët*. Këtë formë e kanë të folmet që ndodhen midis lumenjëve Mat dhe Vjosë (Shqipëria e Mesme dhe Toskëria Veriore);
- d. Prania akoma e mbaresave të vjetra, sidomos në brezin e vjetër, por edhe në atë të mesëm të mbaresave të së pakryerës të foljeve të zgjedhimit vepror: *(-j)im, (-j)it, (-j)in (shkojim, shkojit, shkojin)*. Shumica e të folmeve të gegërishtes janë larguar prej kohësh duke formuar tipin e së pakryerës me *-sh*;
- e. Përdorimi i formës sigmatike të kryerës së thjeshtë të vetës së parë, njëjës pësore: *u msush, u kujtush, u pajtush, u xërrush* etj. Kjo formë ruhet në të folmet e Jugut dhe të folmet e Shqipërisë së Mesme.

Në pjesën e palakueshme të ligjëratës u vunë në dukje trajta me interes, si te ndajfoljet: *kaqi, njaqi, njikaqi*, te parafjalët *mjer në*.

Veçori të tilla i japin së folmes së Martaneshit një fizionomi të veçantë, me tiparet e saj deri diku specifike dhe të pavëna re më parë edhe në të folmet fqinje me të.

3. Në fjalëformim dolën veçoritë vetiake e më kryesore të formimit të fjalëve, si dhe mjetet më produktive që përdoren për të formuar ato.

Në bazë të një materiali të mjaftueshëm dialektor, u shqyrtuan formimet parashtesore emrore, mbiemërore, foljore e ndajfoljore, si dhe kompozitat. U dallua një seri prapashtesash, si dhe larmia kuptimore e tyre. Si në gjithë gjuhën shqipe formimi parashtesor në këtë të folme ka një përdorim më të kufizuar se formimi prapashtesor. Më të përdorura janë parashtesat: *pa-*, *për-*, *shpër*, *stër-* (*i pala.*, *përdredh*, *shpërvjel*, *stërhollo etj*).

4. Gjatë ekspeditave në Martanesh jemi përqendruar në disa sfera që na janë dukur më kryesore për përfaqësimin e së folmes. Si të tilla kemi zgjedhur: 1. emra kafshësh shtëpiake; 2. Emra bimësh e pemësh të buta e të egra që rriten a kultivohen në zonë; 3. Emra veglash, mjetesh e orendishë; 4. Emra sëmundjesh (të njerëzve a kafshëve); 5. Fjalë onomatopeike dhe pasthirrma; 6. Fjalë pejorative; 7. Emra ushqimesh, gjellësh; 8. Fjalë që paraqiten me kuptime, që s'i ka fjalori i gjuhës shqipe dhe që ne na janë dukur me vlerë; 9. Fjalë që paraqesin interes për trajtat fonetike të dallueshme nga ato të mbarë gjuhës, herë falë një konservacioni të fortë, herë për arsye këmbimesh e risish të pjesshme të pavëna re në kreun e fonetikës.

Pjesë e këtij punimi është edhe një fjalorth me fjalë të rralla të Martaneshit, si një glosar i çmuar i kësaj të folmeje

5. Gjatë krahasimit të tipareve kryesore fonetike dhe leksikut të të fomes së Martaneshit me zonat përreth (Klos, Zerqan, Dibër, Shëngjin i Madh, Elbasan dhe Belsh) vëmë re se këto të fome karakterizohen nga disa dukuri specifike që rrokin shumicën e tyre. Afria gjeografike e Martaneshit me këto zona ka sjellë edhe afrimin në tiparet gjuhësore dhe në leksik herë me njëjër pikë e herë me tjetrën. Rezulton se e folmja e Martaneshit, në tiparet kryesore të saj, shkon më afër të folmes së Elbasanit, të Belshit dhe Shëngjinit të Madh.
6. Ligjërimi gojor ka disa veçori sintaksore që e bëjnë të dallueshme nga gjuha standarde. Ai ruan relike të vjetra, që kanë interes për studimin qoftë të fonetikës, qoftë të strukturës gramatikore etj., që kanë rëndësi të posaçme për pasurimin e gjuhës standarde dhe që hedhin dritë në shumë dukuri të sintaksës së gjuhës standarde, sepse ligjërimi popullor është burimi që përfaqëson veçoritë e gjuhës sonë.
7. Në këtë punim u kushtuam vëmendje edhe shqyrtimeve rreth risive dhe situatës leksikore. Zhvillimi ekonomik-shoqëror i vendit, gjallërimi dhe ngritja lart e jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe kodifikimi dhe kristalizimi i gjuhës standarde kanë gjetur pasqyrim edhe në gjuhë, kanë çuar në afrimin e dialekteve dhe të folmeve me gjuhën standarde. Ndikimi i gjuhës standarde ndihet më dukshëm në brezin e ri, sepse, duke qenë nën veprimin e vazhdueshëm të

zhvillimit arsimor, kulturor, tekniko-profesional, çdo ditë, së bashku me përmbajtjen, thith edhe elemente të formës së shprehjes, të leksikut, të strukturës gramatikore e, më pas, edhe trajta fonetike e morfologjike. Pra mund të themi se përgjithësisht në të folmen e Martaneshit ka filluar të vërehet një situatë e larmishme me trajta e dukuri me prejardhje të ndryshme, ku ndeshen e mpleksen me njëra-tjetrën, e vjetra me të renë, për t'i lëshuar vendin kësaj të fundit. Në brezin e mesëm dhe atë të ri, por në të rrallë edhe të ndonjë subjekt i vjetër, krahas trajtave: *pylla, turpja, shnetja, gishtat e duret, n'shpit, du:l, u kujtush* etj., janë edhe trajtat *pylli, turpi, shëndeti, gishtat e duarve, në shpi, doli, u kujtova*. Gjithnjë e më tepër po depërton gjuha standarde me mjetet e saj kodifikuese, gjithnjë e më tepër po zhvillohet procesi i shuarjes së variantit të vjetër si rrjedhojë e zhvillimeve të vrullshme të medias vizive dhe të shkruar, si dhe teknologjisë, si telefonia fikse dhe celulare apo interneti, të cialt ndikojnë drejtpërdrejt në format e komunikimit të shoqërisë njerëzore.

8. Në vëzhgimet tona lidhur me të folmen e Martaneshit kemi vënë re dhe ndryshime midis folësve dhe „lëkundje“ brenda të të njëjtit subjekt dhe këto, në varësi të disa ndryshorëve sociolinguistikë siç janë ato të gjinisë dhe moshës. Duke i'u përmbajtur formave apo varieteteve të të folurit, themi se gratë në këtë qytet ruajnë varietetin tradicional, ku spikat ruajtja e elementëve të qëndrueshëm të sistemit të vjetër. Theksojmë se, këtu bëhet fjalë kryesisht për femra me nivel arsimimi 8-vjeçar dhe të mesëm që nuk janë „rrahur“ aq shumë me situata të ligjëritimit standard. Ndryshe ndodh me folës të seksit tjetër, pra të meshkujve. Këta janë shumë më të aftë për të dalë nga situata të tilla. Sidomos mesoburrat arrijnë të artikulojnë më së miri fjalë në formën e tyre të njësuar brenda fjalive. Megjithatë, nuk mund të themi se ajo arrihet plotësisht, pasi ka edhe përdorim të fjalëve të gjuhës jostandarde, por në një masë më të vogël krahasuar me dendurinë e përdorimit të tyre te femrat. Lidhur me djemtë e brezit të ri, themi se këta, më pak se femrat e së njëjtës moshë, nuk arrijnë të flasin shumë mirë gjuhën standarde. Ata nuk arrijnë të krijojnë një ligjërim të rrjedhshëm dhe ndreqin fjalët siç duhet t'i thonin në fillim.
9. Toponimet dhe antroponimet shihen të mpleksura me emrat e përgjithshëm: nga emri i përgjithshëm *peshk,-u* kanë dalë edhe emra vendesh, si *Peshku* (fshat në krahinën e Martaneshit). Po kështu, emri *blet/ë,-a* ka shërbyer si toporrënjë e emrit të vendit *Nërbletëz*. Toponimi *Gjon* (fshat në Martanesh) na shpie tek emri vetjak *Gjon-i*, po kështu toponimi *Lena* (fshat në Martanesh) na shpie tek emri vetjak *Lena*. Ndërkalime të tilla, nga emrat e përgjithshëm në të përveçëm dhe, së andejmi në toponime, vëmë re edhe në raste të tjera qoftë kur rrënja është një emër kafshe, shpendi apo edhe me apelativa të tjerë të çfarëdoshëm. Emrat që shënojnë pika të caktuara (qafa, gryka, shkëmbinj, udhë, rrugë, shtigje e deri

dhiare, fusha, lëndina, kullota, pyje etj.) kanë rëndësi ekonomike të dorës së parë për banorët e Martaneshit. Në të vërtetë mikrotoponimia e Martaneshit, e parë në tërësinë e saj, na jep një pasqyrë të historisë ekonomike-shoqërore. Në Martanesh, ndonëse prej disa shekujsh banorët kanë ndërruar besimin dhe janë kthyer në bektashinj, ndeshen mikrotoponime me emra shenjtorësh, si: *Shëmtrina* (<*Shën Trinia*), *Snoi* (*Shën Ndoi*).re dhe kulturore të kësaj krahine.

Sa u përket ndërtimit të toponimeve, gjatë shqyrtimit është vënë re se ato janë formuar duke mbajtur parasysh dy aspekte bazë të apelativit: aspektin kuptimor dhe aspektin ndërtimor. E rëndësishme është të theksojmë se nuk ka pasur ndërrim të detyruar emërtime. Emërtimet që kanë zëvendësuar njëra-tjetrën ose që kanë bashkëjetuar, kanë qenë pasojë e trysnisë së të folmes, e cila është më e ndjeshme se toponimia ndaj ndryshimeve ekonomike, shoqërore e politike. Për pasojë, toponimia e Martaneshit, së bashku me të folmen e saj tepër ruajtëse, përbëjnë një pasuri dokumentare me interesa shumëplanësh.

Për sa i përket zbunimit dhe përkëdhelisë në të folmen e Martaneshit, nga lënda konkrete, që lidhet me hulumtime të shumta që kemi bërë në mjedise të shumta, por edhe në Zyrën e Gjendjes Civile në Martanesh, kemi vënë re se një dukuri e tillë si zbunimi dhe përkëdhelia tek emrat vetjakë në këtë zonë është e vonë. Brezi i vjetër i folësve në Martanesh, përgjithësisht, nuk i ka përdorur trajtat e dyta të emrave të njerëzve, qoftë me prapashtesa të zvogëlimit e të përkëdhelisë, qoftë edhe me mënyra të tjera. Emrat e njerëzve, qoftë në moshë të vogël, qoftë në moshë madhore, shqiptohen të plotë nga brezi i vjetër.

## Bibliografi historike

1. A.Q.SH., Fletore Zyrtare nr. 20, *Ligja e Katundarive (komunave)*, 16 prill 1929.
2. A.Q.Sh., Fletorja Zyrtare nr. 29, 19 maj 1934, *Mbi disa ndryshime të ligjës së komunave*.
3. At Giuseppe Valentini, “*E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare*”,
4. Fjalor enciklopedik shqiptar, V.I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008.
5. Fletore Zyrtare nr. 26, gusht 2001, Ligji nr. 8653, dt. 31.07.2000, “*Për ndarjen administrative në Shqipëri*”, dt. 31.07.2000.
6. Frashëri K., „*Skënderbeu*“, Tiranë, 2006.
7. Frashëri K., “*Trojet shqiptare në shek. XV*”, “*Shqiptarët dhe trojet e tyre*“, Tiranë, 1982.
8. Frashëri. K, “*Historia e Tiranës*”, Vëllimi I, Tiranë, ...
9. Hasluck M., “*Kanuni shqiptar, Listan*”, 2005.
10. Hylli i Dritës, “*Shqypnia Katolike në vjetë 1671,..... 1932*.”
11. Gjeçovi SH., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*,
12. Lila Q., “*Martaneshi, histori dhe etnokulturë*”, Tiranë, 2000.
13. Onuzi A., ” *Veshjet popullore të krahinës së Martaneshit*”, referat i mbajtur në konferencën “*Martaneshi, histori dhe kulturë*”, Tiranë, 2009.
14. Pulaha S., “*Lufta Shqiptaro-Turke në shekullin XV (Burime osmane)*”, Tiranë, 1968.
15. Skura M., “*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*”, Tiranë, 1965.
16. Shuflaj M., “*Serbët dhe shqiptarët*”, Tiranë, 2004.
17. Thëngjilli P., “*Disa aspekte të kombësisë shqiptare në burimet osmane në shek. XV-XVI*”, botuar në përmbledhjen “*Shqiptarët dhe trojet e tyre*”, Tiranë, 1982.

## Bibliografi gjuhësore

1. Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, V I, Universita degli di Napoli, L'Orientale, 2007.
2. Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, V II, Universita degli di Napoli, L'Orientale, 2007.
3. *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë 1995.
4. Beci B., “*E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*”, në “SF”, 3, 1972.
5. Beci B., “*E folmja e Reç- e - Dardhës së Dibrës*”, në “SF”, 4, 1964 dhe 5, 1965.
6. Beci B., “*Hulumtime Gjuhësore në Mat*”, në “BUSH, SSHSH”, 2, 1962 dhe 3 1963.
7. Beci B., “*Të folmet qendrore të gegërishtes*”, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
8. Çabej E., *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, BUSH, SSHSH1, 1958.
9. Çabej E., *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Problem i vendit të formimit të gjuhës shqipe, Tiranë, 1982.
10. Çeliku M., “*Mbi grupin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre*”, “SF”, 2, 1968.
11. Çeliku M., “*Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës*”, SF 2, 1966.
12. Çeliku M., “*Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*”, SF. 4, 1965.
13. Demiraj Sh., “*Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të Gjuhës Shqipe*”, Tiranë, 1999.
14. Domi M., -Shkurtaj Gj., “*Pyetësor për mbledhjen e toponimisë shqiptare*”, në “Dialektologjia shqiptare”, Tiranë, 1987.
15. Floqi S., “*Pyetësor për mbledhjen e materialit dialektor të gjuhës shqipe*”, Tiranë 1971.
16. Gjinari J. - Shkurtaj Gj., “*Pyetësor për mbledhjen e leksikut dialektor të shqipes*”, Tiranë, 1980.
17. Gjinari J., “*Dialektologjia shqiptare*”, 1963.

18. Gjinari J., “*Dialektet e gjuhës shqipe*”, Tiranë, 1989
19. Gjinari J., “*Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*”, në “SF”, 4, 1968.
20. Gjinari j., “*Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, në “SF”, 4, 1966.
21. Kostallari A., “*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa problem themelore të Drejtshkrimit të saj*”, Tiranë, 1973.
22. Shkurtaç Gj., “*Dialektet e shqipes. Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore sipas hartave të ADGJSH-së*”, Tiranë, Morava 2012.
23. Shkurtaç Gj., “*Dialektologjia*”, Tiranë, 2003.
24. Shkurtaç Gj., “*Onomastikë dhe Etnolinguistikë*”, Tiranë, 2001.
25. Shkurtaç Gj., “*Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë 2003.
26. Shkurtaç Gj., “*Sociolinguistikë e shqipes*”, Morava, Tiranë, 2009.
27. Shkurtaç Gj., “*Shtresëzime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*”, “*Sudime Filologjike*” 2, 1984.
28. Shkurtaç Gj., *Etnografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004.
29. Shkurtaç Gj., Jashari A., *Anketimi dhe ekspeditat gjuhësore*, Korçë, 2007.
30. Shkurtaç Gj. “*Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës*, në “*Studime Filologjike*”, 1981.
31. Shkurtaç Gj., *Emrat e kafshëve sipas ngjyrës*, SF, I, 1971.
32. Gosturani Xh., “*Struktura gramatikore e së folmes së qytetit të Elbasanit dhe leksiku i saj*”, *Dialektologjia shqiptare VII*, Tiranë, 2005.
33. Thomai J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.



